

KONTRATA E MARTESËS, ZHVILLIMI DHE APLIKIMI I SAJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Blerina Dodaj

Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës, në Shkenca Juridike, me
profil e Drejta Familjare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc. Dr. Juelda Lamçe

Numri i fjalëve: 65.000

Tiranë, Maj 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky punim është origjinal dhe nuk përmban plagjaturë.

Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesërisht.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Abstrakt

Angazhimi i politikave të ligjbërësve për integrimin e legjislacionit me normat bashkëkohore europiane, përvetëson edhe të drejtën familjare, duke përfshirë edhe institute të reja në ligj.

Një ndër risitë që solli ligji nr.9062 datë 08.05.2003, ishte pikërisht kontrata e martesës, sipas së cilës pasuria e bashkëshortëve nuk është e kushtëzuar nga lidhja e martesës dhe pavarësia e tyre ekonomike zhvillohet njëllë, si para martesës ashtu edhe pas saj.

Bashkëshortët vendosin që me kontratën e martesës të përcaktojnë mënyrën e shtimit dhe të pakësimit të pasurive gjatë martesës, për të qënë më të qartë në destinacionin e tyre në momentin final. Ky organizim i ekonomisë nxit komunikimin transparent midis tyre dhe ndërgjegjëson bashkëshortët edhe për investimin në familje. Marrëveshjet martesore, rritin pavarësinë ekonomike të bashkëshortëve, mbrojnë kreditorët në marrëdhënie juridike civile me secilin bashkëshort, garantojnë gëzimin e lirë të pasurisë të secilit bashkëshort gjatë martesës si dhe detyrojnë bashkëshortët për kontribut të përbashkët në detyrimet e familjes. Ato janë analizuar edhe si kontribut i balancave gjinore, duke përmirësuar kështu statusin e gruas në administrimin e pasurisë së saj, për rrjedhojë edhe ndikim në pozitën bashkëshortore.

Paratë dhe mungesa e komunikimit janë shkaqet kryesore që çojnë çiftet në divorc, prandaj vlerësimi paraprak i këtyre rrethanave parandalon ardhjen e pasojës. Gjithashtu bashkëshortët pas zgjidhjes së martesës, përplasen me numër të konsiderueshëm seancash gjyqësore, për gëzimin e lirë të pasurive të tyre, duke u ndjerë të pamundur të realizojnë atë çka u takon dhe duke humbur kështu edhe mundësinë e integritetit të mënjëhershëm në qarkullimin ekonomik me pasuritë e tyre.

Për të gjitha këto, vlerat e kontratës së martesës janë më të dukshme kundrejt regjimeve të tjera dhe proklamojnë atë çfarë bashkëshortët duan në të vërtetë të mos pësojnë gjatë martesës,

dëmtimin ekonomik. Objekti i tyre duhet të jetë i ligjshëm dhe në përputhje me rendin juridik, duke bërë kështu këtë akt me fuqi të plotë juridike dhe të zbatueshme për çdo rast, kur është e nevojshme.

Fjalë kyce: regjim pasuror, bashkëshortët, pavarësi ekonomike, kontrata e martesës.

Abstract

Engaging lawmakers' policies on integrating the legislation with the contemporary European norms also embraces the family law, including the new law institutes.

One of the novelties introduced by Law No. 9062 dated 08.05.2003 was the pre/postnuptial agreement, according to which spousal property is not conditional on marriage and their economic independence develops in the same way as before and after marriage.

Nowadays, the concept of a marriage contract has evolved. Spouses do not necessarily have assets of the property at the time of marriage, by the marriage agreement they decide to add or decrease these assets, so they can all be clear at a final moment.

The prenuptial agreement promotes, *inter alia*, the gender equality by engaging both spouses as equally responsible for their wealth and placing them in the capacity of parties with equal rights and obligations to one another and to the marriage as well.

This economical organization promotes a transparent communication between spouses making them well aware of their family investments.

Meanwhile the prenuptial agreement increases the economic independence of spouses, at the same time protects the creditors in the civil legal relations with each of the spouse, guarantee the free enjoyment of each husband's property during the marriage and compels the co-workers to jointly contribute to the family obligations.

Money and the lack of communication are the main causes that bring couples in divorce, so the

preliminary assessment of these circumstances prevents these consequences. In addition, after the marriage termination they deal with a significant number of court sessions in order for them to be free to enjoy their property. As a result they feel impossible to accomplish what they own with their full rights and thus losing the possibility of the immediate integration into the economic circulation with their own assets.

For all the above mentioned, the values of the marriage contract are more apparent than other regimes and proclaim what spouses do not want to undergo during the marriage, economic harm. Their object should be legal and in accordance with the legal order, thus making this act with full legal force and applicable in every case where necessary.

Key words: property regime, spouses, gender equality, marriage contract.

Dedikimi:

Dedikuar Babait tim!

Falenderime

Pas përfudnimit të këtij punimi, nuk do kisha bërë dot asgjë pa ndihmën e personave të duhur në jetën time. Është kënaqësi e imja që kam patur mundësinë të jem në këtë Universitet dhe kam mundur të angazhohem në një punim shkencor për të marrë një titull nga një institucion arsimor i vlersuar për merita të mëdha. Në çdo hap jam ndjekur dhe përkrahur nga udhëheqësja ime Prof.Asc.Dr. Juelda LAMÇE e cila ka vënë në dispozicionim tim të gjitha materialet e duhura dhe më ka ndihmuar në gjetjen, përzgjedhjen dhe formulimin e ideve në punimin shkencor. Kam gjetur tek ajo jo vetëm dije por edhe një shoqe të mirë e cila nuk ka reshtur së ndihmuari edhe jashtë orarit të punës.

Falenderoj kolegen time të zyrës znj.Emiljana KANE, për angazhimin në orientimin e çështjeve të pronësisë dhe problematikave që zgjoi në këtë punim për këtë fushë studimi.

Një falenderim i veçantë shkon për notere Blerta PEKU, e cila ka kontribuar në zgjidhjen e problematikave, në zgjidhjen e shumë ngërçeve, të cilat kanë dalë si rezultat i përballjessë ligjit me praktikën, duke më orientuar ashtu siç duhet në konkludimin e ideve. Nuk do lija pa falenderuar noterët të cilët që u angazhuan në dhënien e intervistave.

Gjithashtu dëshiroj të falenderoj dhe kolegen time Orneta KOLA, e cila me seriozitetin e saj më ka ndihmuar në realizimin e intervistave dhe të anketave.

Në këtë punim janë të pranishëm kolegët e mi, me propozimet dhe opinionet e tyre, duke më vënë në dispozicion raste praktike dhe më kanë ofruar rezultatet e çështjeve rast pas rasti duke e bërë punimin tim më konkret.

PËRMBAJTJA E LËNDËS	
DEKLARATA E AUTORËSISË	II
<i>Abstrakt</i>	III
<i>Dedikimi</i>	VI
<i>Falenderime</i>	VII
Hyrje	XI
KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK	15
1.1. Qëllimi dhe objektivat e punimit	15
1.2. Rëndësia e punimit	16
1.3. Metodologjia e punimit dhe metodat e kërkimit shkencor	17
1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit	18
1.4.1. Pyetjet kërkimore	18
1.4.2. Hipotezat e punimit	19
1.5. Kufizimet e punimit	20
1.6. Struktura e punimit dhe përmbajtja	21
KAPITULLI II: DEBATI TEORIK NË FUSHË	24
2.1. Qëndrimi teorik mbi kontratën e martesës	24
2.2. Vlerat e kontratës së martesës parë në aspektin e praktikës	28
KAPITULLI III: ZHVILLIMI HISTORIK I KONTRATËS MARTESORE	
NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR	31

3.1.	Rrënjët e kontratës së martesës në botë. Parashikimi i saj deri në Republikën e Shqipërisë.	31
3.2.	Analizë juridike e Kodit Civil të vitit 1929.	38
3.2.1.	Kontrata e martesës në kohën e Mbretit Zog	40
3.2.2.	Dota	42
3.2.3.	Pasuria parafernale.	46
3.2.4.	Bashkëpasunimi dhe bashkëzotnimi	49
3.2.5.1.	Objekti i Bashkëpasunimit.	50
3.3.	Pasuria gjatë martesës në periudhën 1945-1990.	54
3.3.1.	Karakteristikat e regjimit pasuror martesor deri në 1965.	50
3.3.2.	Regjimi pasuror në Kodin Civil të vitit 1965.	58
3.3.3.	Risitë e Kodit Civil të vitit 1981.	61
3.4.	Periudha e tranzicionit, ndryshimi i sistemeve politike.	63
3.4.1.	Dispozitat kryesore kushtetuese.	63
3.4.2.	Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në Kodin Civil të 1995.	65

KAPITULLI IV: ELEMENTËT JURIDIKË TË KONTRATËS SË MARTESES

4.1.	Kuptimi i kontratës së martesës.	66
4.2.	Qëllimet e kontratës së martesës.	74

4.2.1.	Qëllimi ligjor.	81
4.2.2.	Qëllimi social.	84
4.2.3.	Qëllimi funksional.	85
4.3.	Kontrata e martesës si marrëdhënie juridike civile familjare: kufizimet e saj.	89
4.3.1.	Pëlqimi i palëve.	92
4.3.2.	Objekti.	98
4.3.3.	Shkaku i ligjshëm.	102
4.3.4.	Forma.	103
4.3.5.	Autoriteti publik në formalizimin e kontratës së martesës.	106
4.3.6.	Kufizimet.	110
4.4.	Fuqia juridike.	121
4.4.1.	Veprimi i saj në kohë.	121
4.4.2.	Veprimi në hapsirë.	128

KAPITULLI V: REGJIMET PASURORE MARTESORE ME KONTRATË

133

5.1.	Të përgjithshme	133
5.2.	Regjimi me kontratë i pasurive të ndara.	140
5.2.1.	Objekti i kontratës martesore që rregullon regjimin e pasurive të ndara.	155
5.2.2.	Mbarimi i regjimit të pasurive të ndara.	155

5.3.	Regjimi me kontratë i bashkësisë universal.	156
5.3.1.	<i>Përbërja e bashkësisë universale</i>	160
5.3.2.	<i>Rregullat e administrimit të bashkësisë.</i>	161

KAPITULLI VI: VLERAT JURIDIKE - SOCIALE TË KONTRATËS SË MARTESËS 165

6.1.	Autonomia pasurore e bashkëshortëve.	166
6.2.	Barazia gjinore.	173
6.2.1.	<i>Të përgjithshme për barazinë gjinore në Republikën e Shqipërisë.</i>	173
6.2.2.	<i>Ndikimi i Kontratës së martesës në barazinë gjinore të bashkëshortëve.</i>	176
6.4.	Kontrata e martesës është ekonomia gjyqësore në proces: e drejta për process të rregullt ligjor	181
6.4.1.	<i>Procedura ligjore e pjesëtimit të pasurisë pas zgjidhjes së martesës.</i>	181
6.4.2.	<i>Aplikimi i kontratës së martesës menjëherë pas zgjidhjes së martesës.</i>	187

KAPITULLI VII: RREGULLIMI I PASOJAVE TË ZGJIDHJES SË MARTESËS ME KONTRATËN E MARTESËS. MBROJTJA E BASHKËSHORTIT PASJETUES 189

7.3.1.	Pasojat e zgjidhjes së martesës në Kodin e Familjes.	189
--------	--	-----

7.3.2.	Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët.	190
7.3.3.	Pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët.	193
7.4	Mbarimi i martesës me vdekjen e njërit bashkëshort	202
7.4.1	Pasuria bashkëshortore kundrejt asaj të trashëgimisë	205
7.4.2.	Mbrojtja e bashkëshortit pasjetues	208

KAPITULLI VIII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

8.1.	Konkluzione.	211
8.2.	Rekomandime.	224

ANEKS : SI TË SHKRUAJMË NJË KONTRATË MARTESE NË

REPUBLIKËN E SHQIPËRISË **233**

Të përgjithshme.....	233
Faza informuese.....	234
Faza planifikuese.....	238
Faza redaktuese.....	242
Faza e regjistrimit.....	245

BIBLIOGRAFIA **247**

Hyrje

Kontrata martesore është një marrëveshje e lidhur para ose gjatë martesës, nga bashkëshortët duke përcaktuar në të regjimin pasuror martesor që ata dëshirojnë të aplikojnë për pasurinë e tyre, ndryshe nga çfarë ligji parashikon. Ky është një institut juridik novator, i nxitur nga fenomeni social i konfliktit ndërmjet bashkëshortëve, për të përcaktuar destinacionin e pasurisë së vendosur gjatë martesës. Nga ana tjetër, legjislacioni ofron mundësinë e mbrojtjes së pasurisë së secilit bashkëshort, pa u kushtëzuar nga instituti i martesës dhe njëkohësisht pa humbur kjo e fundit funksionin fillestar. Në periudhat më të hershme, kjo lloj kontrate është trajtuar si mjet juridik për të mbrojtur pasuritë e grave, nisur nga fakti se, në momentin që gruaja martohej me bashkëshortin e saj të ardhshëm, gjithë pasuria e saj kalonte në duart e bashkëshortit. Në këtë mënyrë, pozita e saj ishte më e dobët kundrejt bashkëshortit të saj në aspektin ekonomik, por që ndikimi i tij pasqyrohej edhe në atë social.

Për herë të parë kontratën martesore në Republikën e Shqipërisë e gjejmë në Kodin Civil të mbretit Zog, të vitit 1929, për t'u shkëputur në vijim gjatë periudhës së komunizmit dhe rikthimi u bë me ligjin nr. 9062 datë 08.05.2003, duke rregulluar disa regjime me kontratë. Ky ligj u realizua si rezultat i fenomenit të rritjes së divorceve dhe bashkëshortët gjendeshin në rrethana të pamundura për të mbrojtur pasuritë e tyre dhe njëkohësisht të painformuar për pasojat. Kontrata e martesës hapi mundësinë e rimodelimit të mjeteve ligjore, për të mos kushtëzuar martesën nga pasuritë e secilit dhe njëkohësisht udhëzoi bashkëshortët në mbrojtjen e të drejtave të tyre pasurore, kundrejt përfitimit të padrejtë të bashkëshortit tjetër. Ky ishte një ndryshim i cili duhet të koordinohet dhe të ecte paralelisht me aspektin social, në mënyrë që sot pas 16 vitesh që është integruar në legjislacionin tonë kontrata, të mund të aplikohet në masë më të gjërë dhe më të efektshme kundrejt bashkësisë ligjore e cila është aktualisht në përdorim.

Ligjvënës, në momentin e prodhimit të normës juridike, kanë patur në konsideratë faktin se norma i paraprin fenomenit dhe është momenti për të përgatitur shoqërinë tonë për institute të reja juridike të cilat normalisht janë në shërbim të individit. Kontrata e martesës është një veprim juridik i cili varet nga lidhja e martesës dhe ka fuqi nëse martesë është e vlefshme. Kjo është e dukshme si nga emërtimi ashtu edhe në interpretim tërësor të dispozitave që rregullojnë këtë raport pasuror.

Në punimin tim sjell një trajtim historik se si ka lindur kontrata para martesore dhe si ka ardhur ndër vite deri në vendin tonë. Gjatë këtij trajtimi jam përpjekur të evidentoj karakteristikat e kësaj kontrate, të veçantat e saj dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë periudhave të ndryshme kohore. Më pas kam shtjelluar studimin e përgjithshëm të kontratës martesore në të gjitha elementet e saj juridik, duke filluar nga kuptimi i kësaj kontrate e duke vazhduar me qëllimet dhe trajtimin e detajuar të secilit element të kësaj marrëdhënie juridiko-civile familjare, të tilla si: pëlqimi i palëve i quajtur ndryshe “përputhja e mendjeve”¹, shkaku i ligjshëm, objekti dhe forma. Si një kontratë e mirëfilltë kontrata e martesës merr fuqinë juridike në çastin kur lidhet dhe nënshkruhet nga të dy bashkëshortët përpara noterit, por fuqia provuese për efekt të tretëve është në një moment të dytë të cilin do ta trajtojmë në vijim.

Në legjislacionin tonë hasim disa regjime pasurore martesore me kontratë, duke filluar nga regjimi i pasurive të ndara, i cili përbëhet nga regjimi me pjesë të përcaktuara në bashkësi ose nga regjimi i bashkësisë universale, si dhe mundësia e regjimit alternative.

Një ndër pjesët më interesante që përbën dhe qëllimin e punimi tim, është trajtimi i vlerave juridike-sociale që sjell kontrata e martesës. Këtu është e rëndësishme të përmendim vlerësimin e integritetit të kontratës martesore, si institut alternativ për destinacionin e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, duke marrë në konsideratë elementët juridik që duhet të përmbajë kjo kontratë, për të realizuar autonominë e bashkëshortëve, për të shmangur konfliktin final në pjesëtimin e pasurisë, fakt i cili promovon edhe barazinë gjinore në rritjen e ndërgjegjësimin të secilit bashkëshort për investimin e tij dhe origjinën e pasurisë bashkëshortore. Pasi bashkëshorti i diskriminuar dhe që është në tentacion për realizimin e barazisë është gruaja, autonomia pasurore, i jep asaj mundësinë të gëzojë të drejtat e saj kundrejt burrit.

Në njërin kapitull, kam trajtuar edhe problematikën e të shkruarit të një kontratë martesore. Kjo, pasi është shumë e rëndësishme për të dy bashkëshortët e ardhshëm ose aktualë që të kenë informacione mbi kontratën e martesës, përpara se të aplikojnë këtë regjim mbi martesën dhe pasurinë e tyre, duke marrë në konsideratë këtu arsyen bazë të lindjes të krijimit një kontrate të tillë: atë të mbrojtjes së familjes.

¹“*The meeting of the minds*” Revista “FORDHAM LAW REVIEW”, titulli i shkrimit “The origine of the objective theory of Contract formation and interpretation”, Volumi 69, Artikulli 4, faqe 429.

KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1.1. Qëllimi dhe objektivat e punimit

Me ndryshimin dhe evoluimin e fenomeneve sociale, legjislacioni duhet të shtrihet konform tyre dhe të mundësojë rregullimin e çdo defekti në marrëdhëniet ndëriracionale. Aktualiteti demonstroi të kundërtën, konfliktet gjyqësore me objekt të pjesëtimit të pasurisë ndërmjet bashkëshortëve sa vjen e rriten dhe pamundësia për të përcaktuar prerazi përkatësinë e pasurive, degradon situatën në pasoja më të rënda.

Ky studim ka si qëllim të evidentojë nevojën për një aplikim të kontratës martesore, si një nga mënyrat më të shëndetshme të mbrojtjes së martesës, të familjes dhe çdo lloj marrëdhënie ekonomiko-juridike që mund të krijohet në të ardhmen midis bashkëshortëve. Duke marrë në konsideratë që vitet e fundit numri i divorceve dhe problematika që ato kanë sjellë gjatë procesit gjyqësor kanë qenë shumë të mëdha, pjesëtimi pasuror midis bashkëshortëve shpesh kalon me konflikte dhe mosmarrëveshje midis tyre, ku në disa raste bashkëshortët dalin nga pjesëtimi i pasurisë të dëmtuar dhe të pambrojtur në rastin e bashkësisë ligjore². Prandaj, në këtë punim sjell dobishmërinë e një parashikimi paraprak në lidhje me destinacionin e pasurisë dhe mënyrën e njohjes së kontributit, që çifti duhet të bëjë për të zgjidhur konfliktet e mundshme në të ardhmen. Të paturit një kontratë martesore shpesh të jep ndjesinë e qetësisë për të patur një jetë familjare më të qëndrueshme dhe të lumtur, pasi çdo problematikë që mund të cënojë këtë qetësi në të ardhmen është paramenduar për t'i dhënë zgjidhjen më të volitshme për të dy bashkëshortët.

Për sa i perket objektivat, ato më kryesore në punimin në fjalë kanë të bëjnë me:

²Çështja “White v White”, vendimi i House of Lords 26 tetor viti 2000

1. Studimin e kontratës martesore që prej krijimit të saj dhe procesin e evoluimit në legjislacionin tonë deri në periudhën aktuale.
2. Trajtimin e elementëve të kontratës martesore si një marrëdhënie juridike-civile familjare
3. Evidentimi i faktorëve që e bëjnë këtë kontratë një zgjidhje më të mirë për situatën bashkëshortore në krahasim me moslidhjen e saj.
4. Nevoja për aplikim, në rastin e bashkëshortëve, të cilët kërkojnë të kenë qetësinë e duhur dhe të përcaktojnë fatin e pasurive të tyre në rastin e një divorci të mundshëm në të ardhmen.

1.2. Rëndësia e punimit

Ky studim do të jetë i rëndësishëm, pasi mund të konsiderohet si një kontribut i vlefshëm për zbatuesit e së drejtës dhe për të vënë në dukje përparësitë që ka nënshkrimi i kontratës martesore nga bashkëshortët në Shqipëri.

Mendoj se ky punim mund t'u shërbejë edhe akademikeve, kërkuesve shkencorë apo studentëve për të njohur dhe kuptuar evolucionin që ka pësuar ky institut, lindja e tij dhe nevoja që po shfaqet gjithnjë e më shumë në aplikimin e tij, për të forcuar marrëdhënien martesore midis bashkëshortëve dhe për të patur një jetë familjare të qëndrueshme.

Ky punim mundet të jetë i vlefshëm edhe për subjektet që vendosin të lidhin kontratën e martesës dhe mund ta gjejnë të shpjeguar më thjesht, më konkretisht në kapitullin e fundit të këtij punimi, ku është më e lehtë për t'u kuptuar për cilindo lexues pa patur formimin juridik. Gjithashtu, një rëndësi të konsiderueshme ka objekti i kontratës së martesës, i cili shërben për të rregulluar marrëdhëniet pasurore në çift, por jo vetëm në këtë aspekt, por

edhe në lidhje me të tretët shmang pasaktësitë dhe pasiguritë kur krijojnë marrëdhënie juridike civile me njërin nga bashkëshortët.

1.3. Metodologjia e punimit dhe metodat e kërkimit shkencor

Hulumtimet e bëra në literaturë, njohuritë teorike, doktrina, eksperiencia ime në punën si avokate, kanë bërë të mundur të përmbledh në këtë punim, të gjitha të dhënat sipas metodologjisë së duhur.

Metodat shkencore të përdorura në këtë studim janë: metoda historike, cilësore, analitike, krahasuese dhe metoda e mbledhjes së të dhënave, të gërshetuar në çështjet e trajtuara në këtë punim.

Metoda historike: Kjo metodë është përdorur për të pasqyruar lindjen e kontratës së martesës deri në formimin e saj të plotë në legjislacionin e sotëm. Nëpërmjet kësaj metode kuptojmë së pari se si është zhvilluar ky institut krahas të tjerëve dhe cili është pozicioni i kontratës së martesës në sistemin e së drejtës sipas sistemeve politike.

Metoda analitike: Përdorimi i kësaj metode bazohet kryesisht në analizën e thellë ligjore të dispozitave. Lloji i informacioneve të përdorura kanë bërë të mundur analizimin e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të shtruara.

Metoda cilësore: Përdorimi i kësaj metode bazohet në të dhëna të cilat do të përfitohen nga tekste të ndryshme, libra apo punime të ndryshme, praktike gjyqësore që janë marrë në studim, pra nga burime parësore dhe dytësore.

Metoda krahasuese: Nëpërmjet përdorimit të kësaj metode synohet të bëhet një interpretim i të dhënave që do të përfitohen me qëllim krahasimin midis parashikimit të

kontratës së martesës në vendin tonë me disa vende të ndryshme të botës, duke nxjerrë në pah edhe ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Për të arritur objektivat e punimit, grumbullimi i informacionit sekondar është bërë duke ndarë literaturën në teorike dhe empirike, literaturë që është përftuar nga libra të autorëve të ndryshëm, shqiptar dhe të huaj. Një rol të rëndësishëm kanë kryer edhe punimet akademike, si për shembull: kërkimet shkencore, konferencat ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, të cilat kanë plotësuar kuadrin e burimeve sekondare.

1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit

1.4.1. Pyetjet kërkimore

Me anë të pyetjeve kërkimore kam drejtuar dhe strukturuar shkrimin e punimit. Arritja në pyetjet kërkimore kalon në rastin konkret nga literatura, nga hendeku mes asaj që thuhet në të drejtën e shkruar dhe asaj që ndodh në të vërtetë, dhe sigurisht nga eksperiencia që kam përftuar nga puna ime si avokate, nga konferencat ndërkombëtare dhe nga takimet me ekspertë të huaj të fushës.

Pyetjet kërkimore të këtij punimi janë:

1. Cili është statusi juridik i kontratës së martesës si institut i së drejtës?
2. Çfarë mund të realizojnë bashkëshortët me kontratën e martesës?
3. Cilat janë arsyet e zgjedhjes së regjimit me kontratë dhe jo regjimit të bashkësisë ligjore?

4. A mundet që sipas legjislacionit tonë të formulojmë dhe kontrata atipike për regjimin pasuror?
5. A garanton legjislati aktual shqiptar efikasitet në rregullimin e marrëdhënieve mes bashkëshortëve gjatë dhe pas martesës? Po në raport me të tretët?
6. Cilat janë mangësitë në legjislacionin shqiptar në këtë drejtim?
7. Cilat janë zgjidhjet e ofruara nga vendet më me eksperiencë në këtë drejtim?
8. Cilat janë ndryshimet që propozohen të përfshihen në legjislacionin shqiptar për një rregullim më efikas të marrëdhënieve pasurore mes bashkëshortëve?
9. Si mund të shkruhet një kontratë e regjimit pasuror?

1.4.2. Hipotezat e punimit

Hipoteza është thjeshtë një pohim, i cili është realizuar nga përballja e koncepteve të cilat nxirren nga puna kërkimore dhe nga studimi empirik i rasteve praktike dhe literaturës së gjërë.

Normalisht që hipoteza realizon funksionin e saj për të konkluduar në të dhëna dhe fakte të cilat nuk i dinim, prandaj edhe përputhja e kërkimit me rezultatin nëpërmjet hipotezës nxjerr pohimin e duhur.

Hipotezat, duke shprehur një marrëdhënie midis koncepteve të përfuara, na japin mundësinë të përzgjedhim në mënyrë sa më korrekte të dhënat e përfuara.

Per t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura më sipër, në vijim gjejmë hipotezat e punimit.

Hipoteza I

- Aplikimi i kontratës së martesës është mënyra me efikase e mbrojtës së pasurisë së bashkëshortëve, në marrëdhëniet mes tyre dhe me të tretët, si gjatë martesës ashtu dhe në rastin eventual të zgjidhjes së saj.

Hipoteza II

- Legjislacioni Shqiptar nuk ka alternativa të shumta të regjimeve pasurore martesore me kontratë. Ai nuk ka vënë në dispozicion të gjithë mjetet juridike dhe nuk ka normuar shumë metoda për të nxitur këtë institute, duke vështirësuar regjistrimin e saj dhe për rrjedhojë publicitetin e saj.

Hipoteza III

- Zhvillimi i shpejtë i fenomeneve të reja të jetës familjare, përfshirja e çdo subjekti në një numër më të lartë marrëdhëniesh juridike, sjell nevojën e rregullimit me kontratë të së drejtave pasurore, pavarësisht martesës.

1.5. Kufizimet e punimit

Mundësitë për të trajtuar këtë temë janë të shumta, duke qenë se nuk ka një doktrinë të vetme dhe nuk ka shumë raste nga praktika, por nga ana tjetër mungesa e zhvillimit të këtij instituti kufizon mundësinë e studimit të problematikave që mund të sjellë kontrata e martesës në praktikë. Deri sa kontrata e martesës të jetë e aplikuar në masë, autorë të ndryshëm mund të motivohen në hedhjen e ideve të tyre mbi këtë institut të së drejtës. Rëndësia është specifike, pasi promovohet një institute i ri i së drejtës dhe në këtë mënyrë u vjen më shumë në ndihmë bashkëshortëve. Për zbatuesit e së drejtës do të ishte më e lehtë të interpretonin një kontratë martesë, ku normalisht është në frymën e vullnetit të lirë të bashkëshortëve, se sa regjimi i bashkësisë ligore ku shpesh ngjall reaksione në lidhje me formulën që ai parashton. Zotimi i çdo subjekti në mbrojtjen e të drejtave të tij pasurore

nëpërmjet këtyre mundësive ligjore, është nivel i lartë e lirisë së bashkëshortëve në vendimarrjet personale.

Ky punim kufizohet nga literatura vendase, sepse ka pak fletë të shkruara për kontratën e martesës dhe akoma më pak tekste zyrtare për këtë fakt. Ndër të tjera kufizohet në aspektin metodologjik cilësor, për shkak të mosstudimit të këtij instituti në të drejtën ndërkombëtare private, pasi është një fushë shumë e gjërë studimi që po të bëhej në këtë punim do të ishte një i veçantë i tëri dhe do të humbiste qëllimi parësor i temës së trajtuar.

Që në dispozitën e parë që rregullon marrëveshjet martesore në Kodin e Familjes në nenin 66 të tij, është i dukshëm kufizimi parësor që vendoset në lidhje me faktin se kontrata e martesës redaktohet në themel të vullnetit të bashkëshortëve, por nuk mundet të bjerë ndesh me ligjin dhe rendin juridik. Këtu legjislatori ka patur në konsideratë ruajtjen e instituteve me shumë rëndësi. sic është përgjegjësia prindërore, apo detyrimet që rrjedhin nga martesa, duke mos i lënë në dorë të bashkëshortëve të cilët rast pas rasti mund të jenë abuziv në parashikime të kësaj natyre. Mbrojtja e vecantë që gëzojnë fëmijët dhe jeta familjare e kushtëzojnë kontratën e martesës, si një kontratë me elemente të mirëfillta në fushën e detyrimeve.

1.6. Struktura e punimit dhe përmbajtja

Për të realizuar qëllimin e të gjithë punimit dhe për të arritur në konkluzionet e duhura, punimi është strukturuar në tetë kapituj.

Kapitulli i parë është kapitulli hyrës, i cili analizon qëllimin dhe objektivat e punimit, po ashtu merr në analizë metodologjinë që është ndjekur për të arritur në konkluzionet e këtij studimi, si dhe paraqet një tablo të argumentave kryesorë siç janë: qëllimi dhe objektivat e punimit, rëndësia e punimit, metodologjia e punimit dhe metodat e kërkimit shkencor, pyetjet kerkimore, hipotezat, kufizimet e punimit, duke qartësuar strukturimin e kapitujve vijues.

Kapitulli i dytë flet për strukturën e punimit në lidhje me kapitujt që është organizuar dhe si dhe një përmbledhje e shkurtër e punimit në tërësi për t'i paraprirë asaj që do të konkludohet nga ky punim.

Kapitulli i tretë, është një trajtim historik se si ka lindur kontrata paramartesore dhe si ka ardhur ndër vite deri në vendin tonë. Këtë kapitull e kam ndarë në disa periudha: Së pari, periudha e Kodit civil 1929, me të gjithë elementët që kanë të bëjnë me martesën dhe pasurinë martesore; Së dyti, periudha 1945-1990, me karakteristikat, regjimin pasuror të kodit civil 1965 dhe risitë që ka sjell kodi civil i vitit 1981; Së treti, periudha e tranzicionit dhe ndryshimi i sistemeve politike, në lidhje me dispozitat ligjore kushtetuese dhe marrëdhëniet pasurore të bashkeshortëve në Kodin Civil të 1995; Së katërti, është trajtuar legjislacioni aktual, institutet risitë, që solli Kodi i familjes 2013, në regjimin e bashkësisë ligjore dhe regjimin me kontratë.

Kapitulli i katërt, trajton elementet juridikë të kontratës së martesës duke u përqëndruar në çështje të tilla si: kuptimi i kontratës së martesës, elementët ligjorë dhe socialë të saj; qëllimi i kontratës së martesës, si institut i së drejtës; kontrata e martesës, marrëdhënie juridiko-civile; qëllimi i kontratës së martesës; kontrata e martesës marrëdhënie juridiko-civile – familjare me elementet e saj; fuqia juridike; veprimi i saj në kohë dhe në hapsirë; kufizimet ligjore të kontratës së martesës në kohë dhe në objekt. Në fund të këtij kapitulli kam paraqitur një kontratë shembull për të kuptuar më mirë ndërtimin e saj.

Kapitulli i pestë, trajton regjimet pasurore martesore me kontratë duke u ndarë përkatësisht në disa nën çështje si: regjimi i pasurive të ndara me kontratën e martesës dhe bashkësia universale me kontratë. Në këtë kapitull shpjegohen të gjithë rrethanat ligjore që duhen pasur në konsideratë në lidhje me regjimin me kontratë duke dalluar të dy llojet që ligji ofron por edhe mundësia e krijimit të regjimeve atipike.

Kapitulli i gjashtë, trajton vlerat juridiko-sociale të kontratës së martesës, duke përfshirë këtu: autonominë pasurore të bashkëshortëve; barazinë gjinore dhe së fundmi trajtohet çështja e mbrojtjes së bashkëshortit pasjetues.

Kapitulli i shtatë, trajton pasojat e zgjidhjes së martesës të cilat mund të parashikohen në kontratën e martesës, bashkëshortëve ju jepet mundësia të parashikojnë dhe amortizojnë pasojat që vijnë nga zgjidhja e martesës duke i parashikuar ato në një marrëveshje kur situatë mes tyre nuk është konfliktuale.

Kapitulli i tetë, trajton konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse për punimin.

Aneksi i këtij punimi, trajton mënyrën se si mund të shkruajmë një kontratë martese në Republikën e Shqipërisë, fazat nëpër të cilën duhet të kalojnë bashkëshortët për të formalizuar këtë akt. Në këtë kapitull është trajtuar edhe autoriteti përgjegjës për formalizimin e kontratës që është noteri si dhe fuqia juridike e kontratës së martesës.

KAPITULLI II: DEBATI TEORIK NË FUSHË

2.1. Qëndrimi teorik mbi kontratën e martesës

Për të trajtuar institutin e kontratës së martesës, duke u nisur nga legjislacioni jonë, shtrirja kohore fillon që me miratimin e Kodit Civil të vitit 1929 dhe deri më sot. Duke sqaruar se me ndryshimin e sistemeve dhe konkretisht me shfuqizimin e Kodit të Mbretit Zog³, nuk prashikohej edhe kontrata e martesës të cilën e rigjejmë vetëm në 2003 me miratimin e Kodit të Familjes⁴. Ky rikthim duhet parë si novacion, pasi rëndësia e alternativave të regjimeve pasurore martesore është evidente, jo vetëm për llojin e veprimit juridik por edhe për faktin se bashkëshortët me vullnet të lirë kanë mundësinë të zgjedhin në lidhje me mënyrën se si do të shtohen pasuritë e tyre gjatë martesës. Kontrata e martesës është konsideruar liri e bashkëshortëve, mbrojtje e pasurive gjatë martesës, më shumë pamvarësi për bashkëshortët⁵. Një rol të rëndësishëm që luan kontrata e martesës ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor, kohë e shkurtër në pjestimin e pasurisë, duke qënë se bashkëshortët kanë menduar për momentin final të tyre⁶. Një kontratë martese e vlefshme, është kohë e shkurtër e përfundimit të pjestimit të pasurisë, pasi Gjykata nuk do të merret me ndarje të pasurisë, por vetëm vlerësimin e ligjshmërisë së saj. Kjo shpjegohet si kursim i kohës dhe kursim i shpenzimeve për bashkëshortët, për rrjedhojë mundësi e bashkëshortëve për të disponuar lirisht pasurinë e tyre. Një kontratë duhet të jetë e drejtë dhe e arsyeshme,

³ Ligjin Nr.61, date 17.05.1945, “Mbi abrogimin e dispozitave ligjore te promulguara gjate okupacionit te huaj... dhe mbi vleften e dispozitave ligjore qe ishin ne fuqi para dates 7 prill 1939”

⁴ LIGJ Nr. 9062, datë 8.5.2003 KODI I FAMILJES

⁵ Carrilo J., (2017), “*Liberty and Community in Marriage: Expanding on Massey 's Proposal for a Community Property Option in New Hampshire*”, *Universiteti i Kalifornise*, faqe 299, SHBA

⁶ Weissbrodt, D., Wolfrum, R. (1997), “The right for a fair trial” (Eds.), faqe 85

në mënyrë që të jetë në juridiksionin gjyqësor dhe në vijim mos të pengojë në procesin e rregullt ligjor⁷.

Kontrata e martesës nxit më shumë barazinë e bashkëshortëve dhe i vendos ato në kushte akoma më të barabarta ndërmjet njëri-tjetrit, duke ju dhënë jo vetëm të njëjtin status social por edhe të njëjtin status juridik⁸. Duke analizuar në eksperiencat e shteteve të tjera dhe studimet e bëra ndër vite, kanë arritur të nxjerrin qëndrimin pro dhe kundra në lidhje me kontratën e martesës. Gjithmonë për të arritur në një konkluzion të saktë për avantazhet e konyratës së martesës, krahasimi bëhet kundrejtë regjimit të bashkësisë ligjore dhe regjimeve me kontratë. Kjo duhet për një konkluzion të saktë se cila është aryeja se pse duhet të kenë një kontratë martese bashkëshortët. Nga një studim i Harvardit në 2003 rezultoi se dy arsyt kryesore për mungesën e kontratave martesore janë:

1. njerëzit mendojnë se janë të panevojshme sepse kanë optimizëm të rremë se martesat do të zgjasin; dhe
2. njerëzit besojnë se të diskutojnë për të lidhur një kontratë martese tregon pasiguri rreth martesës.

Kohët e fundit, shumë studiues kanë argumentuar se marrëveshjet e tilla janë zgjidhje të mençura, duke pasur parasysh se norma e shkurorëzimit është e lartë (50% në SHBA dhe 38% në Kanada)⁹. Është e rëndësishme të theksohet se, edhe pse kontratat martesore zakonisht merren me pronën bashkëshortore, ato mund ta shtrijnë dobishmërinë e tyre në

⁷ Dematteo v. Dematteo, Supreme Judicial Court of Massachusetts, Plymouth, 08 shkurt 2002

⁸ Hertz F., Doskow E., “*Making It Legal*”, prill 2018, Botimi V, faqe 12

⁹ Mahar H., “*Why are there so few prenuptial agreements*”, studim nr.436, 09/2003

ndërtimin e një marrëdhënie solide dhe e mbrojtur nga situata të ndryshme që mund të vijnë në të ardhmen duke prishur qetësinë familjare¹⁰.

Heather Mahar, një hulumtues në Qendrën John M.Olin për Drejtësi, Ekonomi dhe Biznes në Shkollën e Drejtësisë në Harvard shpjegon se: “kontratat martesore mund të shkojnë përtej ruajtjes së pasurisë para martesës. Për shembull, marrëveshje të tilla mund të parashikojnë rregullimin e kujdestarisë ose parashikimin e elementit të fajit në rastin e ndarjes për shkak të kurorshkeljes dhe shpërblim për bashkëshortin tjetër. Prandaj, aftësia për të bërë marrëveshje të tilla e bën martesën më të qëndrueshme¹¹.

Nga ana tjetër ka mendime kundra vlerave të kontratës së martesës, edhe pse është në vullnetin e bashkëshortëve të lidhin një të tillë ose jo sërish ka mendime që kontrata e martesës nuk e promovon barazinë gjinore si dhe nuk e mbron bashkëshortin më të dobët ekonomikisht. Marrëveshjet martesore, mund të dëmtojnë gruan, e cila në disa vende për të njëjtën punë fiton më pak se bashkëshorti, por me kontratën e martesës duhet të investojë të njëjtat vlerë të ardhurash në ekonominë familjare dhe kështu e vë në vështirësi për t’ia dalë në aspektin ekonomik e për rrjedhojë e mposht në aspektin gjinor¹².

Po ashtu edhe në doktrinë shqiptare gjejmë qëndrime të cilat e shohin me kujdes kontratën e martesës dhe hedhin dyshime për sa i përket vlerësimit të saj maksimal pa u ndalur në detaje konkrete. Në momentin që kontrata do t’i nënshtrohet vlerësimit gjyqësor, duhet të hetohet mbi vlerën decizive të saj, në vijim me kontratën e martesës njëra palë mund të ushtrojë presion mbi tjetrën, po ashtu palët mund mos të kenë patur qëllimin e lidhjes së

¹⁰ Morley Jeremy D. (2011), “*International Prenuptial Agreements Necessary but dangerous*”, Revista “*Family Law Review*”, New York.

¹¹ Po aty.

¹² Brod F.G., “*Premarital Agreements and Gender Justice*”, Yale Journal of Law & Feminism, Volumi 6, 1993, faqe 241

kontratës së martesës, si dhe bashkëshortët mund të mos jenë të aftë të parashikojnë se çfarë është më e mira për të ardhmen e tyre¹³.

Ndërkohë këto qëndrime mund të shihen edhe në aspektin tjetër, pasi pavlefshmëritë për shkak të efektivitetit dhe për shkak të simulimit, moshës së detyrueshme për kryerjen e llojit të veprimit juridik janë kusht për t'u hetuar nga Gjykata në cdo rast jo vetëm në kontratën e martesës. Kjo për të shpjeguar se këto shkaqe nuk duhen parë vetëm si të meta në lidhje me kontratën e martesës por janë elementë të pavlefshmërisë në cdo veprim juridik dhe kontrata e martesës duke qënë në këtë kategori do t'i nënshtrohet këtij kontrolli.

Shtetet e *Common Law*, janë liberal në lidhje me ndërhyrjen që duhet të ketë autoriteti shtetëror në kontratën e martesës, duke e konsideruar të vlefshme cdo kontratë martese e cila nuk bie ndesh me rendin juridik dhe lë palët të sigurohen për vlefshmërinë e kontratës së martesës në momentin e nënshkrimit të tyre. Në rast se çiftet që kanë lidhur kontratë martese, do të zgjidhin martesën e tyre dhe i drejtohen gjykatës, atëherë kjo e fundit angazhohet të hetojë në lidhje me faktin nëse një kontratë është drejtë apo jo duke marrë në konsideratë elementët e detyrueshëm që nuk duhet të kalohen nga martesa¹⁴. Gjithashtu në sistemin e së drejtës *Common Law*, bëhet një ndarje e qartë të kontratave para-martesore dhe atyre pas-martesore, duke hedhur dritë mbi ndryshimet e tyre dhe duke dalluar edhe statusin e palëve në secilin rast.

Shteti Italisë është konservator në lidhje me marrëveshjet martesore pasi ka patur një debat të konsiderueshëm në lidhje me dobishmërinë e kësaj kontrate pa cënuar martesën, duke i

¹³ Mandro A., (2011), "*Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore*", Shkolla e Magjistraturës, Tiranë faqe 90-94

¹⁴ Radmacher v Granatino, 20 October 2010, Gjykata e Lartë e Anglisë

marrë gjithmonë me rezervë se kontratat e martesës nuk mund të jenë në Itali si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës¹⁵.

Duke parë se sa të ndryshme janë qëndrimet në lidhje me marrëveshjet martesore, marrim shkas të hedhim një këndvështrim në lidhje me mënyrën se si vëzhgohen dhe analizohen ato në Republikën e Shqipërisë. Prandaj është gjithmonë e nevojshme të dimë se si është trajtuar në vendet e tjera që kanë më shumë eksperiencë për të propozuar drejtë se cila është mënyra e integritetit të kontratave të martesës në Republikën e Shqipërisë.

2.1. Vlerat e kontratës së martesës parë në aspektin e praktikës

Gjatë punimit është studjuar dhe analizuar se çfarë munden bashkëshortët të përfitojnë bashkëshortët nga regjimi me kontratë dhe deri në çfarë pike ju vjen në ndihmë marrëveshja. Në këtë analizë është evidentuar fakti se bashkëshortët në procesin pas zgjidhjes së martesës në shumicën e rasteve i drejtohen Gjykatës për të kërkuar pjestimin e pasurisë duke qënë se nuk arrijnë në një marrëveshje për ta pjestuar pasurinë me vullnetin e tyre të lirë¹⁶. Në aspektin procedural pjestimi i pasurisë sipas legjislacionit shqiptar merr një kohë të konsiderueshme sikur procesi gjyqësor të vijojë vetëm në marrjen e provave dhe normalitet pa kërkesa të komplikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, pasi minimalisht do kalojë dy fazat e pjestimit të pasurisë. Kjo kohë nga ana tjetër konsiderohet, kufizim i mundësisë së secilit bashkëshort për të disponuar lirisht pasuritë e tij dhe vështirësi në riintegrimin e

¹⁵ Revista noteriale 10.12.2013

¹⁶ Sipas legjislacionit tonë neni 207 Kodi Civil, neni 369-370 Kodi I Procedurës Civile, neni 103 Kodi I Familjes

tij në fushën ekonomike dhe atë juridike. Në këtë periudhë pasuritë nuk mund të tjetërsohen e për rrjedhojë pronari-bashkëshort ndjehet i kufizuar në këtë drejtim. Situata do të ishte ndryshe në rastin e pjestimit të pasurisë në regjimin me kontratë, duke qënë se pasuritë janë të identifikuara, kontrata sjell marrëveshje dhe jo konflikt për at kohë sa është nënshkruar me vullnet të përbashkët, bashkëshortët nuk humbin më kohë në Gjykatë për të zgjidhur pjesën e pasurisë pas mbarimit të martesës. Kjo është realizuar me një studim të rasteve të marra në shqyrtim nga viti 2005 deri në 2015 për çështjet që kanë shkuar në Gjykatën e Lartë, vetëm për fazën e parë të pjestimit, duke konstatuar një kohë të konsiderueshme të gjatë deri në finale për këtë. E gjithë koha nga fillimi i procesit deri në përfundimin e pjestimit të pasurisë gjyqësore është konsidruar amortizim i procesit të rregullt ligjor, pasi parimi i lexueshëm kudo nëpër gjykatë “*drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar*”.

E gjithë ky diskutim i parë në vendimet e gjykatës, konkretizohet se sa gjatë shkon deri në ndarjen e plotë të ish-bashkëshortëve nga lidhja pasurore, duke arritur kështu edhe në një konkluzion tjetër në lidhje me faktin se kështu ka edhe një cënim të së drejtës së pronësisë së mbrojtur prej tërësisë së dispozitave ligjore në lidhje me pronën¹⁷.

Ndryshe do të ishte situata pas mbarimit të martesës të bashkëshortëve në regjimin me kontratë, duke vlerësuar kështu se këto subjektë janë më të cilruar kundrejtë detyrime pasurore dhe pasojave pronësore në lidhje me njëri tjetrin, si dhe më të qetë për faktin se janë në dijeni të efekteve të kontratës së martesës që në momentin e lidhjes së saj. Kontrata e martesës ka funksionin e saj edhe gjatë martesës por më evidente është në përfundimin e

¹⁷ Neni 1, Protokoli Nr.1, KEDNJ

martësës, pasi bashkëshortët negociojnë me kontratën për të mbrojtur interesat e tyre pikërisht në këtë stad.

Në rastet kur kontrata e martësës mund të jetë konflikt gjyqësor ka të bëjë, kur bashkëshortët i drejtohen gjykatës për çfarë nuk kanë negociuar drejtë ose për çfarë është shtuar dhe nuk ka qënë e rregulluar me kontratë, gjë e cila do t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Tërësia e kushteve favorizuese, sic është transparenca e marrëveshjes, koha e shkurtër e identifikimit të pasurive pas mbarimit të martësës, mbrojtja e të drejtave pronësore të secilit bashkëshort i jep qasje pozitive kontratës së martësës dhe ndikon në impaktin që ka tek çdo subjekt para se të lidhë martësën ose që ka lidhur martësë. Kjo është vlerësuar edhe si faktor që bashkëshortët nuk duhet t'i tremben martësës pasi ata mund të mbrohen mjaft mirë në lidhje me të drejtat e tyre dhe të marrin në konsideratë martësën mirëfillë për çfarë ka qëllim lidhja e saj. Prandaj edhe fryma që ndjek punimin ka të bëjë me nxjerrjen në pah të vlerave të regjimit me kontratë, për të analizuar në një kënvështim tjetër pasojat e zgjidhjes së martësës duke aplikuar në më shumë raste regjimin me kontratë.

KAPITULLI III: ZHVILLIMI HISTORIK I KONTRATËS MARTESORE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR SKELETI TEORIK, MODELI ANALITIK I TEMES

3.1. Rrënjët e kontratës së martesës në botë. Parashikimi i saj deri në Republikën e Shqipërisë

Kontrata martesore është një marrëveshje e lidhur para ose gjatë martesës nga bashkëshortët e ardhshëm duke përcaktuar në të regjimin pasuror martesor që ata dëshirojnë të aplikojnë për pasurinë e tyre, ndryshe nga parashikimet në ligjin aktual. Ndërkohë një përkufizim mjaft modern është se kontrata e martesës është një meditim për divorcin, duke i paraprirë çdo konflikti të mundshëm pasuror me anë të saj¹⁸.

Një ndër përkufizimet më të vjetra e të njohura për martesën është ai që ka dhënë Modestini¹⁹. Në këtë përkufizim thuhet tekstualisht se: “*Martesa është lidhja e një burri dhe e një gruaje, bashkimi për gjithë jetën dhe bashkësi e së drejtës hyjnore e njëjësore*”²⁰ (Nuptiae sunt coniunctio maris et feminae consortium omnis vitae, divini et humani iuris communicatio)

Në periudhat më të hershme kjo lloj kontrate është trajtuar si mjet juridik për të mbrojtur pasuritë e grave, duke qënë se gruaja i kalonte pasuritë e saj si pronë të bashkëshortit.

Të parët të cilët bënë kontratë paramartesore kanë qënë hebrenjtë dhe e quanin me termin ‘Ketubah, që do të thotë “gjë e shkruar”²¹. Ajo ishte një lloj i posaçëm i marrëveshjes paramartesore hebraike, konsiderohej pjesë përbërëse e martesës tradicionale dhe

¹⁸Alexander, G.S. “The New Marriage Contract and the Limits of Private Ordering”. Indiana Law Journal. Vol 73 (1998), 503-510.

¹⁹ Jurist romak i shek.IV p.e.s. dhe ku vërehet ndikimi i fesë kristiane.

²⁰Zaçë, V.(1996), “*Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*”, Logoreci, Tiranë. Fq.33.

²¹Gjuhë hebraishte.

përshkruante të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkëshortit në lidhje me bashkëshorten. Janë zbuluar mbi dyqind *ketubah* (*ketubot*), midis koleksioneve të dorëshkrimeve hebre, në Kajro të Egjiptit, të cilat datonin midis shekullit të IX-të dhe XIX-të. Në praktikën moderne, *ketubah* nuk ka vlerë monetare të përcaktuar dhe nuk zbatohet asnjëherë.

Rabitë (mësuesit e judaizmit) në kohët e lashta këmbngulnin që çifti i cili do të martohej do të hynte në *ketubah*, në mënyrë që gruaja të ishte e mbrojtur. *Ketubah* veptoi si një zëvendësim i zakonit të të paguarit një çmim nga dhëndri për nusen, apo prindërit e saj, para se të martohej (dmth. çmimi i nuses). Më pas, *ketubah* u bë një mekanizëm ku çmimi i gruas (shuma e parave për nusen) paguhej në rast se martesë përfundonte qoftë me vdekjen e burrit apo me divorc. Kushti i mëparshëm për t'u martuar²², pra pagimi i një sasive parash nga dhëndri ose familja e tij para se ai të martohej, krijoi një problem të madh shoqëror pasi shumë burra (në moshë për t'u martuar) nuk ishin në gjendje të siguronin sasinë e parave për të bërë pagesën në kohën e përcaktuar²³. Ndaj për t'u mundësuar këtyre të rinjve të martesën, shtynë kohën e pagimit të shumës, në mënyrë që ata të ishin në gjendje për ta siguruar atë. Gjithashtu mund të vërehet se si shuma e *moharit* (parapagimi i çmimit të nuses) dhe e *ketubahut* i shërbeu të njëjtit qëllim, pra mbrojtjes së gruas në rastin e vdekjes ose ndarjes nga bashkëshorti. I vetmi ndryshim midis dy sistemeve ishte koha e pagesës. Një tjetër funksion që shuma e *ketubah* kishte në mbrojtje të pozitës së gruas, ishte që burri në rast se dëshironte të divorcohej, duhet që të ishte në gjendje të paguante për gruan.

²²Ky kusht i quajtur mohar konsistonte në parapagimin e një shume që familja e nuses kërkonte prej dhëndrit të ardhshëm në mënyrë që ta jepnin vajzën për martesë.

²³ "The Value and Significance of the Ketubah" Broyde, Michael and Jonathan Reiss

Shumica e teksteve të Ketubah-ut sot reflektojnë në angazhimin e një çifti për t'u dashur e respektuar njëri-tjetrin²⁴. Aty përgjithësisht përfshihen gjithashtu data dhe vendi i dasmës, emri i nuses dhe i dhëndërrit, si dhe emrat e baballarëve të tyre. Përmbajtja Ketubah është në thelb një kontratë e njëanshme ku formalizoheshin kërkesat e ndryshme të Halakha-s (ligjit hebre) të një burri hebre kundrejt gruas së tij. Në Ketubah, bashkëshorti i ardhshëm hebre merrte përsipër detyrimin që t'i jepte bashkëshortes së tij: veshje, ushqim, marrëdhënie bashkëshortore dhe gjithashtu që ai do t'i paguante asaj një sasi të parave të paracaktuara në rastin e një divorci. Në këtë mënyrë, përmbajtja e Ketubah-s në thelb dikton sigurinë, mbrojtjen e gruas dhe të drejtat e saj në martesë²⁵.

Ndërkohë në vijim kontrata e martesës mori dhe zhvillim të mëtejshëm dhe zgjerimi, përdorimi i saj, forma e përmbajtja pësuan ndryshime të mëtejshme duke ecur paralelisht me institutet e tjera të së drejtës. Gjithashtu në ndryshimin e kontratës së martesës ka ndikuar edhe vetë martesë, shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe mënyra se si bashkëshortët kanë mësuar t'i paraprijnë këtij konflikti.

Një përshkrim i shkurtër në lidhje me vendet e Evropës që e kanë miratuar kontratën e martesës në sistemin e tyre të së drejtës, na njeh me shtetin fqinj të Italisë, ku rezulton përveç regjimit ligjor të bashkëpronësisë, bashkëshortët mund të adoptojnë edhe regjime atipike, duke mos cënuar ligjin në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga martesë (neni 160)²⁶.

Ndërkohë, në mënyrë të shprehur ligji njeh dy lloj regjimesh; regjimin e bashkësisë ligjore

²⁴ Epstein L.M, (2012), "*Ketubah the Jewish marriage contract*", The Jewish Theological Seminary, New York, faqe 25

²⁵ Hebrejtë konservatorë shpesh përfshinin një paragraf shtesë, të quajtur klauzola Lieberman-e, e cila përcakton se divorci do të gjykohej nga një gjykatë moderne rabbinike (një Beth Din) me qëllim që të parandalohet që grua të mund ngelej "e lidhur me zinxhir në martesën", në rastin kur bashkëshorti i së cilës refuzon ose nuk është në gjendje t'i japë asaj një dokument divorci në ligjin fetar hebre, i njohur si fitim.

²⁶Galano F, (1992) *E drejta Private*, Luarasi, Tiranë, faqe 947

dhe atë të ndarjes së të mirave materiale ndërmjet bashkëshortëve. Në këtë shtet vihet re se nuk gjenden kontrata të martesës tipike, pasi nuk e gjejmë në ligj të rregulluar me dispozita të tilla kontratën e martesës si në shtetet e tjera. Për të përforcuar i referohemi pyetjes: Çfarë është propozuar në vitin 2014 ku në vijim mbeti pezull deri në vitin 2017? Në këtë vit u miratua në Dhomën e Deputetëve dhe u integruan në nenin 162 të Kodit Civil Italian²⁷. Gjithashtu në të drejtën e shtetit të Italisë gjen në mënyrë të vecantë kujdesin që tregon legjislatori për të mos kaluar me marrëveshjen e bashkëshortëve rendin juridik²⁸ si dhe kujdesin që duhet të tregojmë në objektin e kontratës së martesës, pasi nuk mund të cënojë institutin e martesës dhe të anashkalojë detyrimet që rrjedhin nga lidhja e martesës²⁹. Fakti se detyrimi për të kontribuar në familje, detyrimi për besnikëri, si dhe të gjithë të drejtat dhe detyrat që burojnë nga ligji për martesën, marrin vlerë publike dhe si të tilla nuk mund të anashkalohen nga asnjë akt i regjimit pasuror martesor³⁰.

Për herë të parë në Europë e gjejmë në Mbretësinë e Bashkuar, ku në shekullin e XV mbreti Eduart IV konfirmoi që kishte një akt që rregullonte marrëdhëniet pasurore të tij me Eleanor Butler. Në vijim kontrata e martesës në MB mori zhvillim dhe aktet e sotme janë liberale në përmbajtjen e tyre dhe në formë. Në këtë rast është e qartë se kjo kontratë është e ndikuar nga parimet e sistemit të Common Law dhe në legjislacionin anglez nuk gjen një akt të shkruar për këtë institut.

Gjurmet e para në shtetet e Europës në sistemin *Civil Law*, të kontratës së martesës si një akt i mirëfilltë i gjejmë në Francë në fund të shekullit XIX, gjë e cila është vlerësuar si

²⁷Dhoma e deputetëve draft me nr.2669, prezantuar me 15 tetor 2014 me iniciativën e deputetëve

²⁸ Francesca C, (2011), *Gli accordi prematrimoniali*, Giuffrè, Milano, 2011, faqe 56

²⁹ Neni 143, 160 i Kodit Civil Italian

³⁰ Neni 1325 dhe 1418 paragrafi II i Kodit Civil Italian;

paradoks për sa i përket faktit të kohës së vonë duke qënë se Franca njihte barazinë gjinore që në vitin 1789 ndërkohë nuk i njihte gruas pavarësinë ekonomike³¹.

Në Evropë, mjaft të zhvilluar e gjejmë institutin e kontratës së martesës në Belgjikë, ku në vijim ka ndjekur Francën dhe së fundmi në disa aspekte ka përparuar edhe më shumë pasi disa parashikime që bëjnë bashkëshortët në kontratën e martesës sipas legjislacionit Belg, mund të parashikojnë rregullimin e marrëdhënieve pasurore jo vetëm në përfundimin e martesës, por edhe gjatë saj (po ashtu edhe Holanda)³². Kushti i kontratës së martesës në Belgjikë është në lidhje me faktin se nuk duhet të bjerë në kundërshtim me rendin juridik të shtetit si dhe duhet të respektojë edhe disa parashikime të tjera në lidhje me faktin e të drejtës për ushqim. Gjithashtu në këtë kontratë nuk mund të përcaktohet mbiemri pas zgjidhjes së martesës në kontratën e martesës, marrëveshje në lidhje me përgjegjësinë prindërore si dhe marrëveshje në lidhje me kafshët³³. Për herë të parë në Belgjikë, për regjim ndryshe nga ai i bashkësisë ligjore, gjenden gjurmë me ligjin e vitit 1976, me reformën e 14 korrikut, ku u përfshi edhe një regjim i ri me disa ndryshime nga i bashkësisë ligjore, duke mundësuar që bashkëshortët me marrëveshje të ngushtonin regjimin e bashkësisë ligjore³⁴.

Në vendet e Evropës është me mjaft rëndësi edhe Konventa e Hagës, me 14 Mars të vitit 1978, ku Holanda, Franca dhe Luksemburgu miratuan këtë Konventë për regjimet e martesës sipas të cilës përcaktohej në mënyrë të detajuar se si bashkëshortërt mund të

³¹ Nicolas F, Marion L, “*Wealth, marriage and prenuptial agreements in France (1855 - 2010)*” 2018, vol. 68, çështja C, 132-142.

³²Gregoire M, (1977) “*Regimes Matrimoniaux. Formulaire Commente*”, faqe 140.

³³Gregoire M, (1977) “*Le regimes conventionnels: principes et limites de l'autonomie de la volonte et les communes conventionnelles*”, 1977 faqe 275.

³⁴Pintens W, “*National report Belgium*”, Universiteti I Luven, 2008

rregullojnë me marrëveshje regjimin pasuror ndërmjet tyre³⁵. Ky akt përbënte një përparim për faktin se ndër rreshta gjen të parashikuar faktin se shtetet anëtare rregullojnë raportet juridike të shtetasve të tyre me ato që nuk kishin shtetësinë e këtyre shteteve me të drejtë pronësie, në rast se lidhnin ndonjë marrëveshje martesore me shtetas të shteteve të Konventës.

Konkretisht, gjejmë gjurmët e para në Francë, ku është mjaft e qartë se ajo mban trofeun e të drejtave dhe promovimin e tyre në çdo fushë të marrëdhënieve njerëzore: Një regjim martesor është një tërësi rregullash në lidhje me efektin e martesës në administrimin, gëzimin, disponimin e pasurisë së tyre nga bashkëshortët gjatë martesës³⁶.

Në kapërcim gjeografik në anën tjetër të oqeanit, kontrata martesore është aplikuar në masë edhe në Kanada. Rikujtojmë këtu që Kanadaja është vend “francophonique”, dhe rëndësia e krahasimit të kontratës së martesës në këtë shtet merr vlerë të veçantë për sa i përket faktit se është sistem *Common Law* dhe trajtimi i institute të së drejtës ka burime dhe zhvillime të ndryshme. Është gjithashtu interesant studimi i rastit të Kanadasë për faktin se në fillim Gjykatat në Ontario dhe krahina të tjera të Kanadasë, e kanë konsideruar kontratën e martesës në kundërshtim me politikat publike dhe të pazbatueshme, por më pas e kanë integruar në sistemin e tyre sic e kanë edhe sot³⁷ duke e parashikuar kontratën martesore në sistemin e tyre³⁸. Kjo është promovuese për sa i përket përhapjes që mund të gjejë kontrata e martesës edhe në shtetin tone, duke marrë në konsideratë shtrirjen kohore në

³⁵Boiche A, (2007) “Marriage Contract and prenuptial agreement in French Law”, Paris, faqe 5

³⁶ Boiche A., (2007), *Marriage Contracts and Prenuptial Agreements in French law*, Paris, faqe 25

³⁷Akti i Reformës Ligjore në Familje 1978 (tani Akti Juridik Familjar), Kanada

³⁸ Morley D. J, (2011), *International Prenuptial Agreements*,. *Law Shopping & Forum Shopping in International Prenuptial Agreements*, Revista “*Family Law Review*”, New York.

lidhje me njohjen që i duhet çdo shtetasi me rëndësinë dhe vlerat që mund të vijnë nga ky institut i së drejtës. Që nga 1978 deri më sot është normale që në këtë shtet të mund të gjejmë raste të vlefshme për studim dhe të veçanta në lidhje me kontratën e martesës. Nga ana tjetër, në përkufizimin e kontratës së martesës, Kanadaja i referohet shpesh marrëveshjeve të bashkëjetesës (cohabitation agreements) të cilat thuhet se janë fillesat e një kontrate martese dhe në një grupim ligjor të të dyjave do të quhen “*domestic contracts*”. Duke bërë këtu vetëm dallimin e faktit se kontratat e martesës kufizohen nga lidhja e martesës dhe në këto kushte objekti i tyre mbetet më i ngushtë se sa objekti i marrëveshjeve të bashkëjetesës.

Paraqet interes dhe rasti i Greqisë, ku i mundëson bashkëshortëvë të përcaktojnë lirisht destinacionin e pasurive të tyre, pa qënë të kushtëzuar nga lidhja e martesës. I kanë quajtur *marrëveshje paramartesore* dhe i kanë aplikuar gjithmonë e më shumë në realizimin e regjimeve pasurore ndërmjet bashkëshortëve. Veçantia e kontratave të martesës në Greqi ka të bëjnë me dominimin e regjimit të pasurive të ndara si dhe pozita e bashkëshortëve në realizimin e mbrojtjes së pasurisë nga instituti i martesës³⁹.

Në vazhdimësi edhe shumë shtete të tjera kanë parashikuar mundësinë e bashkëshortëve për të lidhur kontrata martesore, të tilla si: Australi me Ligjin për Familjen 1975 (Commonwealth), Greqi (që prej 1989), Japoni (Kodi civil Japonez, Ligji Nr. 89, datë 27.04.1896⁴⁰, neni 755 e

³⁹ Kodi Civil Grek, Neni 1400.

⁴⁰Kodi Civil Japonez (Pjesa IV dhe PjesaV) Shih në: <http://www.japaneselawtranslation.go.jp>.

në vijim⁴¹), Brazil (parashikuar në Kodin Civil të Brazilit, 1918, neni 256, Rusi (parashikuar në Kodin e Familjes të Federatës Ruse 1995), Kinë (që prej vitit 2001⁴²)etj⁴³.

Marrëveshjet paramartesore janë njohur prej kohësh si të vlefshme edhe në disa vende evropiane, si: Franca, Belgjika, Hollanda, Gjermania, Polonia, Zvicra, Suedia, Danimarka, Norvegjia dhe Finlanda. Ndërsa në disa prej këtyre vendeve ekzistojnë limite në lidhje me kufizimet që vetë gjykatat do i gjykojnë për zbatueshmërinë ose vlefshmërinë e një kontrate të shkruar dhe e konceptuar siç duhet, me marrëveshje të lirë, nuk mund të kundërshtohet, për shembull, për shkak të rrethanave në të cilat u ndërpre martesë ose për shkak të sjelljes së secilës pjesë. Në Francë dhe Belgjikë (si dhe në Quebec, që ka të njëjtën traditë gjyqësore) marrëveshjet paramartesore duhet të krijohen në praninë e një noteri, pasi formaliteti i këtij veprimi juridik nuk merr shkas vetëm për efekt të bashkëshortëve me njëri-tjetrin, por edhe për publicitetin e veprimit juridik në lidhje me të tretët, pasi ligji duhet të kujdeset gjithmonë për mbrojtjen e të tretëve.

3.2. Analizë juridike e Kodit Civil të vitit 1929.

Regjimi pasuror martesor në Shqipëri ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Kontrata e martesës është parashikuar për herë të parë në Kodin Civil të Mbretit Zog I në nenin 1325 të tij ku citohet: *“Kontrata e martesës duhet të stipulohet me akt publik përpara noterit dhe para martesës.”* dhe gjithashtu në nenin 52 pika 8, ku citohet:

Neni 52 Akti i martesës duhet të tregojë:

⁴¹ Morley D. J, (2011), International Prenuptial Agreements, *Law Shopping & Forum Shopping in International Prenuptial Agreements*, Revista “*Family Law Review*”, New York

⁴² Neni 19 i Ligjit “Për Martesën” (Kinë).

⁴³ Morley D. J, (2011), International Prenuptial Agreements, *Law Shopping & Forum Shopping in International Prenuptial Agreements*, Revista “*Family Law Review*”, New York

8) *Deklarimin q'i bajnë ofiqarit të gjendjes civile dhandri dhe nusja mbi pyetjen e tij në se asht redaktue kontato matese ose jo, dhe tregimin me sa asht e mundëshme, të datës të kontratos, në qoftë se ka, si dhe t'emnit dhe të vendit të qendresës së noterit q'e ka marrë....;*

Gjatë punimit në vazhdim është analizuar konkretisht zhvillimi dhe ndryshimet që ka pësuar regjimi pasuror martesor dhe konkretisht kontratës martesore.

Regjimi pasuror-martesor ka pësuar ndryshime dhe zhvillim të vazhdueshëm që prej periudhës kur Shqipëria ka qënë nën pushtimin Osman e deri në ditët tona, me miratimin e Kodit të Familjes. Analiza historiko-juridike e institutit të regjimit pasuror martesor, duke filluar nga aktet normative (burimet) më të hershme për të arritur tek Kodi aktual i Familjes, shërben për të studiuar evolucionin që ka pësuar rregullimi ligjor i këtij instituti në Shqipëri.

Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, hyri në fuqi më 1 Prill 1929, i njohur gjithashtu edhe si Kodi Civil i Zogut. Ky kod përmbante një frymë të moderuar, kjo jo vetëm sepse vetë Mbreti Zog donte që mbretërinë e tij ta bënte si mbretëritë më të përparuara të kohës, por gjithashtu sepse ai u hartua duke u bazuar në Kodin Civil Francez të vitit 1804, i njohur ndryshe si kodi i Napolonit.

Aty shohim që normat, mbi martesën pavlefshmërinë dhe zgjidhjen e saj ishin ndërtuar tërësisht, mbi bazën e Kodit Civil francez (*napoleonian*) dhe atij zviceran, të vitit 1907⁴⁴.

Martesa, mund të lidhej pasi burri të kishte mbushur moshën 18 vjeç dhe vajza 16 vjeç, por me kusht që të kishin marrë paraprakisht pëlqimin e prindërve. Bashkëshortët që ishin në moshën 20-25 vjeç, detyroheshin të provonin se kishin marrë ose kërkuar pëlqimin e prindërve. Kryetari i shtetit mund të lejonte për arsye të rënda që një djalë, i cili kishte

⁴⁴ Zaçe, V, (1996), *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Logoreci, Tiranë, fq.34.

mbushur moshën 15 vjeç dhe një vajzë në moshën 14 vjeç, të lidhnin martesë, por me kusht që prindërit ose gjyshërit e tyre, të kishin dhënë pëlqimin e duhur⁴⁵.

3.2.1. Kontrata e martesës në kohën e Mbretit Zog

Kodi Civil i mbretit Zog I pati rëndësi të madhe në atë kohë, sepse për herë të parë vendosi mbi baza ligjore marrëdhëniet familjare, të cilat do të ishin unike për të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, Kodi Civil ishte shumë i rëndësishëm, pasi për herë të parë u unifikuan dispozitat përsa i takon martesës dhe se ligji njëhte vetëm martesën e celebruar sipas Kodit Civil të kohës ndërkohë që martesat e celebruara në kishë apo në çfarëdolloj forme tjetër nuk do të gëzonin mbrojtjen juridike nga ligji⁴⁶. Kështu në kod ndalohej poligamia dhe sanksionohej martesa civile e detyruehme, duke caktuar edhe masa penale për mosbatimin e saj. Në nenin 152 të këtij Kodi, ndalohej çdo ceremoni martese fetare para se të lidhej martesa civile, nga nënpunësi kompetent i organeve të gjendjes civile dhe përcaktohej se klerikët që do të vepronin në kundërshtim me këtë dispozitë, do të dënoheshin sipas nenit 208 të Kodit Penal. Gjithashtu, përcaktohej se burri dhe gruaja që martohehin pa bërë të gjitha formalitetet e kërkuara nga ligji, do të dënoheshin me gjobë të rëndë deri në 1000 franga ari⁴⁷.

Marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve rregulloheshin me të ashtuquajturën “kontratë e martesës” në nenet 1321 – 1389. Që të ishte e vlefshme kontrata e martesës duhet të nënshkruhej me akt publik para noterit si dhe para aktit të martesës⁴⁸.

⁴⁵Po Aty.

⁴⁶Kodi Civil, 1929, neni 1324.

⁴⁷ Zaçe, V.(1996). *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Logoreci, Tiranë, fq.34.

⁴⁸Kodi Civil 1929, cit., neni 1325.

Gjithashtu në kontratën e martesës parashikohej mënyra e rregullimit të pasurisë midis bashkëshortëve⁴⁹, bazuar në parimin e pandryshueshmërisë së regjimit pasuror martesor, gjatë martesës. Kodi parashikonte që kontrata martesore mund të modifikohej vetëm para lidhjes së martesës. Sepse gjatë martesës ishte e ndaluar çdo mundësi e ndryshimit të regjimit pasuror martesor⁵⁰. Arsyeja për të cilën kontrata martesore nuk mund të ndryshohej, gjatë kohëzgjatjes së martesës, bazohej mbi tre arsye kryesore:

- *së pari*, kontrata martesore konsiderohej si një pakt (marrëveshje) i familjes, në lidhjen e së cilës merrnin pjesë jo vetëm bashkëshortët e ardhshëm, por edhe të tjerë persona si psh: prindërit e bashkëshortëve të ardhshëm, ose persona të tjerë që i dhuronin sende bashkëshortëve, kështu që modifikimi i saj nuk mund t'i lihej thjesht vullnetit të bashkëshortëve;
- *së dyti*, pandryshueshmëria ishte parashikuar në favor të mbrojtjes së bashkëshortit më të dobët (gruas), i cili gjatë martesës mund të bënte një zgjedhje jo të duhur dhe t'i bindej bashkëshortit tjetër në kërkesën e tij për të ndryshuar kontratën martesore;
- *së treti*, parimi i pandryshueshmërisë garantonte edhe mbrojtjen e të tretëve, kur ata kontraktonin me bashkëshortët⁵¹.

Kodi Civil parashikonte regjistrimin e kontratës martesore në aktin e martesës, bazuar në nenin 52/8 të kodit, ku dhëndrri dhe nusja, në momentin e lidhjes së martesës, duhet të tregojnë para nëpunësit të gjendjes civile, nëse kanë lidhur një kontratë martesore, si dhe

⁴⁹ Ashtu si Kodi Civil i vitit 1929 edhe Kodi aktual i Familjes, neni 66, parashikon mundësinë e bashkëshortëve për të rregulluar me marrëveshje (kontratë martesore) regjimin pasuror martesor që dëshirojnë.

⁵⁰ Kodi Civil 1929, neni 1328 dhe neni 1376, paragrafi 2.

⁵¹ Colomer, A. (2005), *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*. (12e ed), Publisher: LexisNexis, fq. 157-158, Francë

nëse është e mundur, datën e lidhjes së kontratës nëse ka, si dhe emrin e noterit që e ka hartuar kontratën⁵².

Në kuadër të zotësisë për të lidhur kontratën martesore, Kodi Civil i Zogut, sanksiononte parimin e mirënjohur të së drejtës “*habilis ad nuptias habilis ad pacta nuptialia*”, të cilin e ndeshim edhe në legjislacionet aktuale (kodi civil francez, italian, zviceran). Një rregullim ndryshe bën kodi aktual i familjes, në nenin 70, i cili parashikon që në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore, derisa të mbushë moshën 18 vjeç, rast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.

3.2.2. Dota

Regjimi më i rëndësishëm pasuror kontraktor, që parashikohej në Kodin Civil të Zogut, ishte regjimi “dotal” (*nenet 1331-1367*). Regjimi i Dotës është i vetmi regjim pasuror kontraktor, që gjen rregullim të detajuar në Kodin Civil. Në këtë regjimin pasuria e gruas përbëhej nga dy pjesë, pasuria e konsistuar *dotë* dhe *pasuria parafernale*.

Regjimi dotal ishte parashikur edhe në të drejtën romake. Në modelin e martesës “*matrimonium sine manus*”, regjimi pasuror martesor përbëhej nga dy elementë: *dota* dhe pasuria “*donazione ob nuziale*” (pasuria që burri i dhuronte gruas në rastin e martesës). Më poshtë do të shohim në mënyrë më të zgjeruar karakteristikat që parashikoheshin në lidhje me këto dy elementë të regjimit dotal nga e drejta romake.

Dota ishte pasuria që gruaja apo të tjerë jepnin ose premtinin me rastin e martesës, me qëllim përballimin e nevojave të jetës së përbashkët të familjes së re.

⁵² Nëse nëpunësi nuk pasqyron këto elementë në aktin e martesës, ai dënohet me gjobë deri në 200 franga ari.

Paterfamiljas fitonte vetëm posedimin “*manus*” mbi pasurinë e dotës dhe në asnjë rast pronësinë. Për sa i përket të mirave të tjera të cilat nuk përfshihen në dotë, por që gruaja mund të ketë, mbetën pronë e saj. Pra mund të thuhet se martesë *sine manu* nuk prodhon efekte në rregullimin ligjor të pasurisë së bashkëshortëve. Tërësia e të mirave që nuk përfshihen në dotë, të cilat më parë janë quajtur *bona recepticia*, ndërsa më vonë *bona extra dotem*, njihen me termin grek *παράφερνα*⁵³ (*shqipërimi paraferna*), domethënë të mira *parafernale*⁵⁴. Ky term i përdorur për analogji me dispozitat e sotme, e kuptojmë qartë nëse e krahasojmë me të mirat vetjake, në përdorim ngushtësisht personal të gruas, që janë krijuar pas lidhjes së martesës jo nga pasuri të dotës, pra janë extra dotem⁵⁵. Pasuria dotale ishte pasuria që bashkëshortja ose familja e saj i dërgonin bashkëshortit, në momentin e lidhjes së martesës, me funksionin e “*ad sustinenda onera matrimonii*”, përballimin e shpenzimeve të familjes (regjimi primar). Bashkëshorti kishte të drejtën e administrimit ekskluziv të pasurisë dotale dhe të mbledhjes së fruteve të saj.

Legjislatori në hartimin e Kodit Civil 1929, ka mbajtur qëndrimin se interesi i shtetit për ndërtimin e një familjeje të shëndoshë mbi bazat e martesës, nuk imponon domosdoshmërisht kufizimin e lirisë individuale në zgjedhjen e regjimit pasuror bashkëshortor. Megjithatë, liria në përcaktimin e regjimit pasuror bashkëshortor nuk mund të jetë absolute si në kontratat e tjera. Liria kontraktuale, në kuptimin e regjimit pasuror bashkëshortor, nuk mund të jetë e pakufizuar, por duhet të pësojë disa kufizime, të cilat shteti i konsideron të nevojshme për organizimin e shëndoshë të familjes. Edhe pse mbetet

⁵³Në shqip ky term ka kuptimin: *Rrobat, shtrojat shtëpiake dhe gjërat e tjera të mbledhura nga një nuse për martesën e saj.*

⁵⁴ Donatuti, G.(1936). “*Separazione dei beni*”. Enciclopedia Italiana, Itali, faqe 344

⁵⁵ VUKB nr.5 datë 20.01.2009.

principi i lirisë së palëve kontraktuese për të parashikuar në kontratë martesore, klauzola që legjislatori nuk i ka të ndaluara (neni 1321), autonomia individuale ka një fushe veprimi jo shumë të shtrirë, pasi legjislatori e ka konsideruar me vend të parashikojë shumë norma urdhëruese.

Regjimi dotal parashikohej si regjim pasuror ligjor në Kodin Civil Francez të vitit 1804, si dhe në Kodin Civil Italian, i vitit 1865. Ky regjim është rregulluar mbi bazën e dy instituteve “Dota”⁵⁶ dhe “Pasuria parafernale”⁵⁷. Në regjimin kontraktor dotal, pasuria e gruas ndahej në dy pjesë: a) pasuria dotale dhe b) pasuria parafernale, ku secili kishte një regjim juridik të veçantë, ndarje kjo e njëjtë me atë që i ishte bërë regjimit dotal në të drejtën romake siç e kemi shpjeguar edhe më sipër. Për nga natyra juridike, regjimi dotal ishte një lloj regjimi i pasurive të ndara.

Dota ishte pasuria që gruaja ose të tjerët në vend të saj ia jepnin burrit për të përballuar shpenzimet që do të vinin nga martesa⁵⁸. Karakteristikë ishte se të drejta e administrimit të pasurisë dotale e kishte vetëm burri gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës. Gjithashtu, bashkëshorti mund të ngrinte padi në gjykatë kundër debitorëve dhe nëdorësve të dotës, si dhe të mblidhte frutat dhe kamatat e saj. Mund të pohojmë se burri gëzonte një të drejtë uzufrukti mbi pasurinë dotale, dhe ishte përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga pakujdesia e tij në administrim⁵⁹.

Palët duhet të bënin një parashikim me shkrim të të mirave që do të përfshiheshin në dotë.

Dota mund të përfshinte tërësisht ose pjesërisht pasurinë e tashme dhe të ardhme të gruas,

⁵⁶Kodi Civil i vitit, 1929, nenet 1331-1360.

⁵⁷Po Aty, nenet 1368-1375.

⁵⁸Po Aty, neni 1331.

⁵⁹Po Aty, neni 1351.

ose dhe një send të caktuar si dhe mund të përfshinte edhe pasurinë e personave të tretë (pasuria atërore dhe amënore). Nëse në kontratën e martesës, objekti i pasurisë dotale ishte i rregulluar me fjalët “gjithë pasuria e gruas”, atëherë në dotë do të përfshihej vetëm pasuria e tashme e saj dhe jo ajo e ardhshme⁶⁰. Dota mund të konstituohej edhe nga persona të tretë, si psh. prindërit e gruas ose persona të tjerë të familjes së saj⁶¹. Sendet e fituara me të hollat e dotës nuk përfshihen në pasurinë dotale, me përjashtim të rastit kur në kontratën e martesës është parashikuar ndryshe⁶². Në rastin kur fitohej një pasuri nga shkembimi i një pasurie tjetër, pasuria e fituar bëhet dotale⁶³.

Rregullimi i dotës në kontratën e martesës, mund të realizohej vetëm para lidhjes së martesës dhe nuk mund t’i nënshtrohej ndryshimit, gjatë vazhdimit të saj⁶⁴.

Megjithëse gruaja ishte e përjashtuar nga e drejta e administrimit të pasurisë dotale, në rast se dota keqpërdorej nga bashkëshorti, ose rrezikonte të përdorej vetëm për shlyerjen e borxheve personale të tij, gruaja mund t’i drejtohej gjykatës së shkallës së parë dhe t’i kërkonte administrimin e dotës. Në qoftë se gjykata e vendoste veçimin e dotes, atëherë ajo kalonte nga administrimi që kishte burri ose të dy, sipas parashikimit në kontratën përkatëse martesore, në atë të gruas⁶⁵. Gjithashtu veçimi i dotës mund të kërkohej nga gruaja edhe kur ishte vendosur veçimi personal për faj të bashkëshortit, ose të të dyve. Kur gjykata vendoste veçimin e dotës, gruaja detyrohej të kontribuonte sipas fuqisë ekonomike të saj në shpenzimet familjare dhe në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Në këtë rast gruaja

⁶⁰Kodi Civil i vitit, 1929, neni 1332.

⁶¹Po Aty, nenet 1336-1338.

⁶²Po Aty, neni 1346.

⁶³Po Aty, neni 1349.

⁶⁴Po Aty, neni 1361.

⁶⁵Po Aty, neni 1361.

merrte administrimin e lirë të pasurisë së saj. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Diktimit për sa i përket dotës kryesisht është e lidhur me veçimin e dotës ose ndikimin e saj në marrëdhëniet me të tretët.

Në vendimin nr. 168, datë 07.09.1938, Gjykata e Diktimit, gjatë shqyrtimit të çështjes me objekt “Anulimin e kontratës së shitblerjes të një shtëpie e të një dyqani”, ka treguar se shtëpia dhe dyqani, pronë e bashkëshortit mashkull, ia kishte shitur bashkëshortes së tij në mashtrim të së drejtave të paditësve, me qëllim që paditësit të mos realizonin marrjen e detyrimit në të holla që i padituri kishte ndaj tyre. Si rregull i përgjithshëm, ishte i ndaluar tjetërsimi dhe hipotekimi i dotës, gjatë kohëzgjatjes së martesës⁶⁶. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, pasuria dotale mund të tjetërsohej ose hipotekohej, vetëm në dy raste të parashikuara në mënyrë taksative nga ligji: a) nëse tjetërsimi lejohej në kontratën e martesës; b) me pëlqimin e të dy bashkëshortëve nëse autorizohet në bazë të një vendimi gjyqësor, në rast nevojë ose dobie evidente⁶⁷. Çdo veprim juridik në lidhje tjetërsimin e dotës, në kundërshtim me rastet e parashikuara më sipër, do të ishte i pavlefshëm⁶⁸. Në rastin kur martesa përfundonte, atëherë dota kthehet në pasurinë e gruas ose të personit, në pronësi të të cilit, është pasuria dotale⁶⁹.

3.2.3. Pasuria parafernale

Pasuria parafernale ishte pasuria e bashkëshortes që nuk përfshihej në dotë, pra pasuria “*extra dotem*” dhe që mbetej në pronësinë e gruas, gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës dhe bashkëshorti nuk fitonte asnjë të drejtë mbi të. Sipas nenit 1368 të Kodit Civil të vitit 1929,

⁶⁶Kodi civil i vitit 1929, neni 1348.

⁶⁷Po Aty, neni 1347 dhe neni 1348.

⁶⁸Po Aty, neni 1959.

⁶⁹Po Aty, nenet 1942-1960.

përfshiheshin në pasurinë parafernale të gjitha të mirat që nuk ishin përfshirë në dotë. Megjithatë, administrimi dhe disponimi i pasurisë parafernale nga gruaja kushtëzohej nga dhënia e pëlqimit të bashkëshortit, pasi gruaja nuk gëzonte zotësinë e disponimit të lirë të pasurisë së saj⁷⁰.

Gruaja kishte të drejta absolute mbi pasurinë e saj parafernale. Referuar nenit 1370 të Kodit Civil, të vitit 1929, gruaja gëzonte të drejtën e zotërimit, administrimit dhe gëzimit të pasurisë parafernale të saj. Përfshirje bënë vetëm rasti kur ishte vetë gruaja ajo e cila ia kishte dhënë personalisht porosi burrit për të marrë të mira nga pasuria e saj. Në dallim nga dota, burri nuk gëzonte as të drejtën e administrimit dhe as të kërkonte kreditë e saj, në qoftë se nuk ishte autorizuar nga gruaja⁷¹. Madje, gruaja kishte të drejtën që të emëronte çdo person të aftë për të administruar pasurinë parafernale nëse nuk donte ta administronte vetë. Me anë të një prokure, gruaja mund të emëronte bashkëshortin e saj si administrator të pasurisë së saj⁷².

Për sa më sipër, shohim se është vullneti i lirë ai që i është atribuar gruas për të zgjedhur nëse do të administrojë vetë apo dikush tjetër pasurinë e saj parafernale. Këtu vërehet se Kodi Civil i Mbretërisë së Zogut I 1929, përbente vërtet një risi dhe ishte i përparuar për kohën kur u miratua dhe u zbatua. Dispozitat e sipërçiftuara që morën në shqyrtim, pasqyrojnë rritjen e të drejtave që gratë kishin dhe që u sanksionuan në formë ligjore në këtë Kod. Referuar interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimi Unifikues, nr. 5, datë 20.01.2009, për të dalluar se cilat të mirat parafernale nga pjesa tjetër e pasurisë duhet të analizohet nëse ishte bërë konstituimi i dotës dhe çfarë pasurie përfshihej

⁷⁰ Garofalo, L.(1997). *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, Torino, fq. 17.

⁷¹ Kodi Civil i vitit 1929, neni 1370.

⁷² Po Aty, neni 1371.

në dotë. Pra, duke përjashtuar pasurinë joparafernale, pasuria parafernale do të ishin të gjitha ato të mira të gruas së martuar, që nuk ishin të përcaktuara si dotale.

Bazuar në interpretimin e Gjykatës së Lartë, pasuri parafernale do të ishte:

- a) E gjithë pasuria që gruaja kishte në momentin e lidhjes së martesës, me përjashtim të pasurisë së konstituar dotë;
- b) Pasuria e fituar nga gruaja, gjatë martesës, me çfarëdolloj titulli, qoftë suksedimi, dhurimi, ose si rrjedhojë e punës së saj.

Interes përbën edhe paraqitja e mendimit të pakicës në vendimin e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të sipërçiftuar, të cilët janë të mendimit se shumica ka bërë një interpretim të zgjeruar të dispozitave që lidhen me këtë institut, dukë përfshirë në këtë pasuri, jo vetëm të mirat që gruaja kishte në momentin e lidhjes së martesës, por edhe ato që kishte fituar më vonë me çdo lloj titulli. Sipas arsytimit të pakicës, vetë fjala parafernale, rrjedh nga greqishtja “*parapherna*”, që do të thotë pasuri në pronësi të gruas, e cila në çastin e lidhjes së martesës nuk është ligjëruar si dotë, për rrjedhojë në pasurinë parafernale nuk përfshihet pasuria e fituar nga gruaja gjatë martesës⁷³.

Në një analizë të shpejtë të Kodit Civil Francez të vitit 1804, atë Italian të vitit 1865, si dhe në doktrinën përkatëse, vihet re që në përbërje të pasurisë parafernale do të përfshihet jo vetëm pasuria në pronësi të gruas para lidhjes së martesës (me përjashtim të pasurisë së konstituar dotë), por edhe çdo pasuri e fituar nga gruaja *constante matrimoni*, pra gjatë martesës.

Në trajtimin ligjor të problemeve të martesës dhe familjes, ky kod, në krahasim me të kaluarën solli disa ndryshime të rëndësishme në ligj; ndaloi poligaminë që ishte shumë e

⁷³Shih.VUKBGJL, nr. 5, datë 20.01.2009.

përhapur tek myslimanët; bëri të detyrueshme martesën civile dhe nuk njihte pasojat juridike të martesës fetare; nuk njihte ndalimin për martesë që ekzistonte deri atëherë për shkak të ndryshimit të fesë së bashkëshortëve si dhe i njohu të drejta të barabarta gruas për të kërkuar zgjidhjen e martesës⁷⁴.

Por, sërish duhet thënë se pavarësisht se Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare të vitit 1929, ishte Kod modern, ai nuk gjeti zbatim jo në pak raste në fushën e marrëdhënieve familjare për shkak të shoqërisë patriarkale që vazhdonte të kishte Shqipëria e atyre viteve⁷⁵.

3.2.4. Bashkëpasunimi dhe bashkëzotnimi

Sipas arsytimit të Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.5, datë 20.01.2009, nga leximi i dispozitave të Kodit Civil të Zogut, del qartë se bashkëpasunimi, në kuptimin juridik, dhe bashkëzotnimi nuk janë e njejta gjë. Bashkëzotnimi përfaqëson në vetvete bashkëpronësinë sipas kuptimit juridik, që i jepet bashkëpronësisë në legjislacionin aktual.

Bashkëpasunimi ka një kuptim më të gjërë sesa bashkëzotnimi. Zotnimi ose bashkëzotnimi është e drejta për të gëzuar ose për të disponuar sendet. Pra tek zotnimi dhe bashkëzotnimi ekzistojnë të dy tagrat, e drejta e gëzimit dhe e drejta e disponimit⁷⁶. Ndërsa tek bashkëpasunimi e drejta e gëzimit dhe e drejta e disponimit mund të qëndrojnë dhe të veçuara nga njëra-tjetra. Kjo del nga krahasimi i dispozitave që rregullojnë bashkëpasunimin⁷⁷, me dispozitat që rregullojnë të drejtën e parablerjes⁷⁸ midis

⁷⁴ Begeja, K.(1985). "*E drejta familjare e RPSSH*", Botimi i parë, Tiranë, fq.41.

⁷⁵ Mandro, A; Mecaj, Vj; Zaka, T; Fullani, A.(2006).*E drejta Familjare*, Tiranë, Kristalina-KH, fq. 311.

⁷⁶Neni 794, Kodi Civil 1929

⁷⁷Titulli i IV i librit të tretë 1929

⁷⁸Titullit të V të po këtij libri 1929

bashkëzotnuesve të pronave. Bashkëpasunimi konsiston kryesisht në gëzimin dhe në nxjerrjen e fitimeve të përbashkëta mbi sende të veçanta. Bashkëpasunimi ka më shumë karakteristikat e një shoqërie të thjeshtë, ku secili pronar ruan të drejtën e tij të pronësisë, duke pasur të drejtën e disponimit të lirë të këtyre sendeve tek të tretët, pa pëlqimin e bashkëpasunuesve të tjerë.

3.2.5.1. Objekti i Bashkëpasunimit.

Bazuar në Kodin Civil të Zogut, në objektin e bashkëpasunimit do të përfshihet pasuria e mëposhtme:

a) Sendet e luajtshme në pronësi të bashkëshortëve para lidhjes së martesës si dhe sendet e luajtshme të fituara nga bashkëshortët gjatë martesës, nëse nuk ekziston një përshkrim autentik i kësaj pasurie në emër të njërit bashkëshort.

Po t'i referohemi nenit 1380 të Kodit Civil, i cili citon si më poshtë:

“Bashkëshortët para martesës detyrohen të bëjnë një përshkrim autentik të pasurisë së luajtshme që kanë, si dhe një përshkrim për sendet e luajtshme që u vijnë sa vazhdon bashkëpasunimi. Në mungesë të një përshkrimi të tillë ose të një titulli autentik tjetër, sendet e luajtshme konsiderohen si fitime të bashkëpasunimit.”

Sipas një interpretimi të nenit 1380 të Kodit Civil, rezulton që sendet e luajtshme të fituara para lidhjes së martesës ose gjatë saj, për të cilat ekziston një përshkrim autentik, nuk përfshihen në objektin e bashkëpasunimit, por konsiderohen pasuri vetjake e secilit bashkëshort. Sipas Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009:

“presumimi i bashkëzotnimit është pranuar vetëm për sendet e luajtshme të fituara gjatë martesës, në rastet kur nuk ekziston një përshkrim autentik i kësaj pasurie në emër të njërit bashkëshort”.

b) E drejta e gëzimit të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të tashme ose të ardhshme, të secilit bashkëshort (neni 1378).

c) Pasuria e fituar gjatë martesës me fitimet e bashkëpasunimit (pasuria e paluajtshme e fituar me kontributin e përbashkët të të dy bashkëshortëve).

d) Në zbatim të të nenit 1379 të Kodit Civil, të gjitha fitimet që nxjerr burri dhe gruaja së bashku ose secili prej tyre veç e veç gjatë kohës që vazhdon regjimi i bashkëpronësisë, qofshin këto fitime të rrjedhura nga industria e përbashkët ose nga ekonomia e tyre, janë të përbashkëta dhe të ndashme, duke zbritur më parë debitë që rëndojnë mbi bashkëpronësinë e bashkëshortëve.

Nga ana tjetër, përjashtohen nga objekti i bashkëpasunimit të bashkëshortëve dhe për rrjedhojë konsiderohen pasuri vetjake të bashkëshortit në emër të të cilit janë fituar:

a) Pasuria e luajtshme e fituar para lidhjes së martesës ose gjatë saj, nga secili prej bashkëshortëve, për të cilën ekziston një përkthim autentik (neni 1380).

b) Aktivi dhe pasivi i pasurisë së fituar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës (neni 1367).

c) Pasuria e fituar me dhurim ose trashëgimi, gjatë kohëzgjatjes së martesës (neni 1367).

d) Pasuria e fituar nga njëri bashkëshort dhe që figuron e regjistruar në emër të njërit bashkëshort, gjatë kohëzgjatjes së martesës (nëse nuk është fituar me fitimet e bashkëpasunimit).

Në këtë rast lind pyetja: Pasuria e paluajtshme, që është fituar gjatë martesës nga njëri bashkëshort (duke përjashtuar sendet e fituara me dhurim ose trashëgimi) do të bëhet apo jo pjesë e objektit të bashkëpasunimit?

Po të sjellim në argument interpretimin e Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 5, datë 20.01.2009, mund të citojmë:

“Në rastet kur mungojnë pakte të posaçme të hartuara me akt publik para noterit para martesës dhe prona e vënë gjatë martesës figuron në emër të njërit prej bashkëshortëve, kjo pronë i takon bashkëshortit në emër të të cilit është regjistruar. Ekzistenca e titullit të pronësisë në emër të njërit prej bashkëshortëve është provë bindëse se pronësia mbi sendin nuk është rezultat i fitimeve të bashkëpasunimit dhe për pasojë pronësia i mbetet atij bashkëshorti që ka titullin e pronësisë. Pasuria e vënë gjatë martesës konsiderohet në bashkëpronësi vetëm kur vërtetohet se ajo është vënë me fitimet e bashkëpasunimit”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave del qartë se bashkëpasunimi i përcaktuar në nenet 1376 deri 1389 të Kodit Civil, shtrihet vetëm mbi të drejtën e gëzimit të kësaj pasurie dhe bëhet pasuri bashkëshortore vetëm ajo pasuri e vënë me fitimet e përbashkëta të dy bashkëshortëve dhe se sendet, që figurojnë në pronësinë individuale të secilit bashkëshort nuk përfshihen në pasurinë bashkëshortore. Nga ana tjetër, bazuar në mendimin e pakicës, në të njëjtin vendim, pasuria e fituar nga njëri prej bashkëshortëve, për sa kohë vazhdon martesa dhe pa qenë në asnjërën prej kushteve të tjera të nenit 1384 të këtij Kodi, do të konsiderohet si pasuri e të dy bashkëshorteve. I takon bashkëshortit që pretendon, të provojë se të ardhurat me të cilat është blerë pasuria kanë qenë të tijat dhe jo të përfshira në bashkëpasunim. Kodi Civil, vazhdon arsyetimin nëpërmjet përjashtimeve, të vendosura në nene të veçanta të tij, për kategori të caktuara të pasurisë që nuk mund të konsiderohen pjesë e bashkëpasunimit (e bashkëpronësisë), ka lënë të kuptohet se gjithçka tjetër që nuk është pjesë e këtyre përjashtimeve është pjesë e bashkëpasunimit dhe duhet trajtuar si e tillë. Kjo do të thotë se, në bashkëpasunim bën pjesë çdo pasuri tjetër përveç asaj që nuk është përjashtuar, nga neni 1378.

Së fundmi, mund të themi se Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare i vitit 1929, i hartuar sipas modelit francez, përfaqësonte një risi për realitetin shqiptar të asaj kohe. Dispozitat e këtij kodi mbi marrëdhëniet martesore e familjare, kanë përmbatje shumë më përparimtare, në krahasim me rregullimin juridik të këtyre marrëdhënieve, që zbatoheshin deri atëherë në

Shqipëri. Hyrja në fuqi e këtij kodi do të diktonte edhe përkatësinë e të drejtës civile shqiptare në familjen romano-gjermanike, duke e shkëputur atë përfundimisht nga e drejta otomane.

Bazuar në kontekstin historik dhe në marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore të shoqërisë shqiptare, të kohës së miratimit, duhet vlerësuar fakti që Kodi Civil i Zogut solli përmirësimin e pozitës shoqërore të gruas.

Referuar marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve Kodi solli si risi, njohjen e autonomisë së bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, brënda kufinjve të parashikuar nga ligji. Në mungesë të kontratës martesore, pasuria e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës do të rregullohej mbi bazën e regjimit të “bashkëpasunimit”. Parashikimi i kontratës martesore në Kodin Civil të Zogut, përbën një hap të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve familjare të asaj kohe, sidomos në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, duke patur parasysh pozitën shoqërore të gruas në atë kohë⁷⁹. Sidoqoftë, zbatimi i këtij kodi ishte i pakët për sa i përket rregullimit të marrëdhënieve familjare, pavarësisht risive dhe elementit modern që ai përmbante.

3.3. Pasuria gjatë martesës në periudhën 1945-1990

3.3.1. Karakteristikat e regjimit pasuror martesor deri në 1965

Me përfundimin e Mbretërisë Shqiptare në vitin 1939 si dhe ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste në vitin 1941, legjislacioni pësoi ndryshim, të cilat rrjedhimisht u pasqyruan edhe në marrëdhëniet familjare. Gjatë periudhës kur në pushtet ishte Partia Komuniste (1941-1991) legjislacioni për të drejtën familjare është ndryshuar disa herë.

⁷⁹ Zaka, T.(1999).*Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, Tiranë, fq 8.

Akti i parë që lidhet me të drejtën familjare në këtë periudhë mund të konsiderohet “Deklarata mbi të drejtat e qytetarëve” që u miratua në mbledhjen e Beratit më 23 tetor 1944. Në këtë deklaratë ndër të tjera thuhej se pushteti demokratik i popullit shqiptar garanton edhe: *“Të drejtat e barabarta të gruas me ato të burrit, si në jetën politike të vendit, ashtu edhe në veprimtarinë shoqërore...”*⁸⁰.

Në vitet e para të Çlirimit edhe marrëdhëniet martesore vazhduan të rregulloheshin përkohësisht sipas dispozitave të Kodit Civil shqiptar të prillit 1929, të cilat shërbenin vetëm si rregulla ndihmëse në qoftë se nuk vinin në kundërshtim me “frymën demokratike” dhe me normat e nxjerra nga organet kompetente të shtetit socialist.

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 14 Mars 1946, përcaktoi ndër të tjera edhe parimet më kryesore mbi të cilat do të ndërtohej e drejta familjare si degë e re dhe e veçantë e së drejtës socialiste. Kjo Kushtetutë në nënin 17 dhe 19 të saj sanksiononte sërish *“barazinë e gruas me burrin në çdo fushë të jetës politike e shoqërore (neni 17) si dhe shpalli njëkohësisht se martesa dhe familja gëzonin “mbrojtjen e shtetit”, se e ligjshme ishte vetëm martesa që lidhej para organeve përkatëse të shtetit dhe se për shqyrtimin e zgjidhjen e të gjitha çështjeve që kishin të bënin me martesën ishin kompetente vetëm gjykatat shtetërore (neni 19). Në të njëjtën dispozitë u shpall se shteti do të rregullonte me ligje të posaçme marrëdhëniet martesore e familjare*⁸¹.

Me rëndësi është përpunimi, studimi dhe analizimi i ligjit nr.601, datë 18.05.1948 “Mbi martesën” pasi me këtë ligj u rregulluan marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve, mënyra e ndarjes së pasurisë bashkëshortore, mënyra e administrimit të saj si dhe dhënia e

⁸⁰ Zaçe, V.(1996).*Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë, Logoreci, fq 22-46.

⁸¹Zaçe, V.(1996).*Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë, Logoreci, fq.34.

lirisë bashkëshortëve për mbajtjen e ekonomisë familjare. Tipari më dallues i këtij ligji ishte se dispozitat më kryesore të tij u ndërtuan në përshtatje të plotë me parimet dhe idetë e marksizëm-leninizëm mbi martesën dhe marrëdhëniet martesore në shoqërinë socialiste, sanksionuara në Kushtetutën e 14 marsit 1946.

Në ligjin nr. 601, datë 18.05.1948 “Mbi martesën”, u sanksionua parimi i barazisë përsa u përket të drejtave midis burrit dhe gruas gjatë jetesës së përbashkët (neni 3). Kjo barazi e burrit me gruan u trajtua dhe u përpunua si barazi të drejtash dhe detyrash jo vetëm në marrëdhëniet vetjake e pasurore ndërmjet bashkëshortëve, por edhe në marrëdhëniet e tyre ndaj fëmijëve dhe familjes në tërësi. Duke pasur si qëllim që të mos dobësonte pozitën ekonomike të gruas, ky ligj sanksionoi për herë të parë në historinë e legjislacionit shqiptar se pasuria që një bashkëshort kishte në kohën e lidhjes së martesës, mbetej pasuri vetjake e tij duke gëzuar të drejtën për ta vetadministruar lirisht dhe se çdo kontratë që mund të lidhej në kundërshtim me këtë rregull do të ishte e pavlefshme si për bashkëshortët ashtu edhe për të tretët⁸². Gjithashtu, referuar Ligjit “Mbi Martesën” (i vitit 1948), mënyra e mbajtjes së ekonomisë familjare caktohej me marrëveshje të bashkëshortëve dhe për mbajtjen e familjes duhej të kontribuonin të dy bashkëshortët në përpjesëtim me gjendjen e tyre ekonomike.

Duke iu referuar parimit të kësaj barazie, në këtë ligj u pranua jo vetëm se pasuria që vihej gjatë martesës bëhej pasuri e të dy bashkëshortëve, por edhe se, në rast konflikti për caktimin e pjesës takuese të çdo bashkëshorti duhej të merreshin parasysh, krahas të ardhurave që kishte realizuar secili, edhe ndihma që ju kishin dhënë njëri-tjetrit, kryerja e punëve shtëpiake, si dhe çdo pune ose bashkëpunim tjetër në administrimin dhe shtimin e

⁸²Zaçë, V.(1996). *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë: Logoreci, fq.37.

kësaj pasurie të përbashkët⁸³. Pasuria që kishte secili bashkëshort në momentin e lidhjes së martesës mbetej e tyre vetjake dhe kishin të drejtë ta administrojnë atë lirisht, ndërsa pasuria që bashkëshortët fitonin me punë gjatë martesës bëhej pasuri e tyre e përbashkët. Në qoftë se bashkëshortët, për arsye të ndryshme kërkonin ndarjen e pasurisë së tyre të përbashkët, ata duhet t'i drejtoheshin gjykatës, e cila në caktimin e pjesëve bazohej në kontributin e dhënë nga secili bashkëshort⁸⁴. Kjo, duke patur parasysh jo vetëm fitimet e çdo bashkëshorti, por edhe ndihmën që njëri bashkëshort i kishte dhënë tjetrit, si dhe çdo kontribut tjetër në administrimin, mbajtjen e pasurisë së përbashkët. Për detyrimet që një bashkëshort kishte pasur para lidhjes së martesës, si dhe për detyrimet që merrte për interesa të tij gjatë martesës, nuk do të ishte përgjegjës bashkëshorti tjetër, ndërsa për detyrimet që merrte një bashkëshort gjatë martesës, për nevojat e përditshme të jetesës së përbashkët, do të ishte përgjegjës kundrejt kreditorëve edhe bashkëshorti tjetër, sikur t'i kishte marrë vetë këto detyrime⁸⁵.

Deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil 1965, rregullimi ligjor i marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve ishte Ligji “Mbi Martesën” dhe gjithashtu Dekreti “Mbi Pronësinë” nr. 2083, miratuar datë 06.08.1955. Në këtë dekret parashikohej në mënyrë të veçantë bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve duke përmirësuar rregullimin që Ligji “Mbi Martesën” bëri. Ky dekret parashikonte se pasuria e fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës së tyre i përket në tërësi të dy bashkëshortëve, përdorimit thjesht personal si dhe sendet dhe veglat e ushtrimit të veprimtarisë ose mjeshtërisë së tyre⁸⁶.

⁸³Po Aty, fq.37.

⁸⁴ Mandro, A; Mecaj, Vj; Zaka, T; Fullani, A.(2006).*E drejta Familjare*, Tiranë, Kristalina-KH, fq. 312.

⁸⁵Mandro, A; Mecaj, Vj; Zaka, T; Fullani, A.(2006).*E drejta Familjare*, Tiranë, Kristalina-KH, fq. 312.

⁸⁶ Zaka, T.(1999).*Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, Tiranë, fq. 22.

Si konkluzion, shohim se nga viti 1945, e në vijim nuk hasim asnjë element të kontratës së martesës pasi humbasin koncepte akoma më të rëndësishme, nuk kishte të drejtë pronësie në kuptimin e mirëfilltë të së drejtës së pronësisë, si e drejtë reale madhore e cila është e pakufizuar në gëzimin e saj. Gjithashtu në këtë periudhë nuk ekzistonte hapsira e veprimeve juridike në atë gamë si në të sotmen, as mundësia e krijimit të instituteve të reja të së drejtës e cila ishte tërësisht e kufizuar dhe nuk ishte e nevojshme të mundësoheshin veprime juridike për transaksionet e pasurive pasi mungonin pasuritë.

Periudha kohore e ndryshimit të regjimeve juridike nuk solli ndonjë të re në legjislacionin e së drejtës familjare, pasi rregullimet juridike të legjislacionit në lidhje me formën e qeverisjes dhe në shtetin e së drejtës merrnin vëmendjen më të madhe të ligjbërësve, duke anashkaluar institutet e së drejtës për rregullimin e marrëdhënieve për bashkëshortët.

3.3.2. Regjimi pasuror në Kodin Civil të vitit 1965

Kuvendi Popullor më 26.06.1965, miratoi ligjin nr.4020 “Për Kodin e Familjes të Republikës Popullore të Shqipërisë”, i cili përbënte edhe kodin e parë të familjes në legjislacionin shqiptar. Ky kod hyri në fuqi më 1 Janar të vitit 1966.

Nenin 2 i Kodit të Familjes citon se:

“Martesa lidhet me hirin e lirë të burrit dhe të gruas dhe mbështetet në ndjenja të shëndosha dashurie midis bashkëshortëve dhe mbi parimet e barazisë, të ndihmës dhe respektit midis tyre”.

Vërejmë që në këtë kod, ndër të tjera, sanksionohen parime të tilla si: martesa lidhet me vullnetin e lirë të bashkëshortëve të ardhshëm, mbështetet në ndjenjat e shëndosha të dashurisë së ndërsjellë dhe në barazinë, ndihmën e respektin midis tyre, moslejimi i lidhjes së martesës me anë të një përfaqësuesi si dhe në raste të jashtëzakonshme, me vendim

gjyqësor, u lejua martesë midis atyre që kishin lidhje të ngushta krushqie, marrëdhënie birësimi ose kujdestarie.

Gjithashtu në nenin 3 sanksionohet rëndësia që ky kod i vuri familjes dhe martesës duke çiftuar se: *“Martesa dhe familja janë nën mbrojtjen e veçantë të shtetit.”*

Kodi i Familjes i vitit 1965, në lidhje me regjimin pasuror martesor, parashikoi një rregullim të ngjashëm me dy ligjet e sipërpërmendura⁸⁷. Në lidhje me regjimin juridik të pasurisë së vënë nga secili prej bashkëshortëve gjatë martesës bëhet pasuri e përbashkët e të dy bashkëshortëve dhe çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Referuar neni 45 citojmë se:

“Pasuria që ka një bashkëshort në kohën e lidhjes së martesës mbetet pasuri e tij. Pasuria e fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës bëhet pasuri e përbashkët e të dy bashkëshortëve. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.”

Sipas këtij parashikimi, tregohet që bashkëshortët nuk mund të lidhnin marrëveshje që dëmtonin interesat pasurore të njëri-tjetrit, pasi në të kundërt ajo nuk do të ishte e vlefshme.

Në lidhje me parashikimin e këtij neni i referohemi edhe një vendimi gjyqësor i vitit 1973, në të cilin Gjykata ka mbajtur qëndrimin se: *Gjatë martesës secili bashkëshort mund të blejë sende të përdorimit familjar me të ardhurat e tij personale, por kjo nuk do të thotë se këto sende i përkasin në pronësi vetëm atij që i blen.*

Gjykata e Rrethit Shkodër shqyrtoi padinë e T.B kundër D.A dhe vendosi lejimin e pjesëtimit midis palëve në pjesë të barabarta të plaçkave të poshtëshënuara: një dhomë gjumi, dy shtretër etj. I padituri ankimoi vendimin dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pas

⁸⁷Më sipër kemi përmendur Ligjin “Mbi Martesën” dhe dekretin “Mbi Pronësinë”.

shqyrtimit të çështjes ka lënë në fuqi vendimin⁸⁸ me arsyetimin se marrëdhëniet e punës janë mjaftueshëm kontribut në pasurinë e bashkëshortëve.⁸⁹

Për sa më sipër, në një interpretim më të zgjeruar të nenit 45/2 (të sipërcituar) kuptojmë që çdo marrëveshje midis bashkëshortëve, që do të kishte për objekt përcaktimin e një regjimi pasuror martesor të ndryshëm nga regjimi ligjor, do të ishte e pavlefshme, pra me pak fjalë ndalohej rregullimi kontraktor i regjimit pasuror martesor. Kjo do të thotë se regjimi ligjor ndërmjet bashkëshortëve ishte një lloj i bashkëpronësisë në pjesë.

Referuar Nenit 46 të Ligjit Nr.4020, datë 23.6.1965 “Mbi Kodin e Familjes të Republikës Popullore të Shqipërisë citojmë:

“Në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve nuk përfshihen sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim ose me trashëgimi, sendet e përdorimit thjeshtë personal, sendet dhe veglat e ushtrimit të mjeshtërisë ose të profesionit, kundërvlehtë që ka zëvendësuar një pasuri individuale ose pasuria në të cilën është kthyer kjo kundërvlehtë si dhe çdo pasuri tjetër që nuk është fituar me punë.”

⁸⁸ “Pretendimi i të padituri, se shumë nga sendet e fituara gjatë martesës, për të cilat pretendohet pjestimi nga pala tjetër, janë blerë vetëm me të ardhurat e tij dhe për rrjedhojë nuk duhet t’i nënshtrohen pjestimit, me të drejtë nuk është marrë parasysh nga gjykata e faktit. Gjatë martesës, secili bashkëshort mund të blejë sende të përdorimit familjar me të ardhurat e tij personale, por kjo nuk do të thotë se këto sende i përkasin në pronësi vetëm atij që i blen. Sipas nenit 45 të Kodit të Familjes, ajo pasuri që vihet gjatë martesës me fitimet nga puna e të dy bashkëshortëve është e përbashkët dhe çdo marrëveshje e kundërt, konsiderohet nga ligji e pavlefshme. Gjykata me të drejtë ka pranuar si punë e kontribut të paditëses edhe ato të dhëna për rritjen e nëntë fëmijve të lindur nga martesa.

⁸⁹ Ne vijim të arsyetimit të vendimit të Gjykatës: “Veç kësaj, ajo ka më se 12 vjet në marrëdhënie pune, prandaj me të drejtë kontributi i saj në vënien e pasurisë bashkëshortore është konsideruar i barabartë me atë të të paditurit.”

Në një interpretim të dy neneve të mësipërme arrijmë në përfundimin që nga bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve, përjashtohet:

- a) Pasuria që ka një bashkëshort në kohën e lidhjes së martesës (neni 45/1); dhe
- b) Sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim ose me trashëgimi, sendet e përdorimit thjeshtë personal, sendet dhe veglat e ushtrimit të mjeshtërisë ose të profesionit, kundërvlefata që ka zëvendësuar një pasuri individuale ose pasuria në të cilën është kthyer kjo kundërvlefatë si dhe çdo pasuri tjetër që nuk është fituar me punë.

Nga analiza e mësipërme, në lidhje me natyrën juridike të regjimit pasuror martesor të parashikuar në Kodin e Familjes të vitit 1965, arrijmë në tri konkluzione:

- *së pari*, Normat rregulluese përbënin dispozita urdhëruese, duke qënë se bashkëshortëve u ndalohej çdo lloj marrëveshje që pëcaktonte një regjim pasuror të ndryshëm nga ai ligjor;
- *së dyti*, regjimi ligjor ishte një regjim bashkëpronësie i pjesshmem, ku në bashkësi përfshihej vetëm pasuria e fituar me punë, gjatë martesës nga secili bashkëshort
- *së treti*, në këtë ligj nuk prashikohet asgjë për kontratën martesore që bashkëshortët mund të lidhin midis tyre.

Pra, shohim se veçori dalluese e kësaj bashkëpronësie ishte që pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët gjatë martesës (përveç atyre të përdorimit vetjak profesional) u përkisnin në tërësi të dy bashkëshortëve d.m.th. pjesët ideale të tyre mbeteshin të panjohura dhe caktoheshin vetëm në rastin e pjesëtimit të kësaj pasurie sipas mënyrës së përcaktuar me ligj⁹⁰.

⁹⁰ Zaçe, V.(1996).*Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë: Logoreci, fq.38.

3.3.3. Risitë e Kodit Civil të vitit 1981

Kuvendi Popullor me ligjin nr. 6599, datë 29.06.1981, miratoi Kodin e dytë të Familjes i cili hyri në fuqi më 1 janar 1982. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve u rregulluan nga Kodi Civil në kapitullin “Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve”. Por, ligji organik i vetëm sipas të cilit rregulloheshin marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve vazhonte të ishte Kodi Civil i vitit 1982 i cili i parashikonte ato në nenet 86 dhe 87⁹¹. Referuar neneve 86 dhe 87 të Kodi Civil i vitit 1982⁹², interpretojmë se ishte pranuar sistemi i bashkëpronësisë ku sendet, depozitat e kursimit si dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët *gjatë* martesës (*per nuptias*), referuar nenit 86 të tij, konsideroheshin në bashkëpronësi të të dyve. Kjo formë e regjimit ishte e detyrueshme sepse ishte e përcaktuar nga ligji që çdo marrëveshje mes bashkëshortëve që cënonte regjimin e detyrueshëm të bashkëshortëve do të konsiderohej e pavlefshme. Pra, shohim që në këtë pjesë ky kod nuk solli ndryshim nga Kodi i Familjes 1965.

Përsa i përket ndryshimeve që Kodi Civil i vitit 1982, solli lidhur me bashkëpronësinë e bashkëshortëve, ato ishin në dy drejtime:

1. U pranua bashkëpronësia në pjesë për bashkëshortët dhe prezumimi i barazisë së pjesëve.

⁹¹ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq.106.

⁹²Neni 86 citon se: *Sendet, depozitat në arkat e kursirnit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës janë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.*

Në bashkëpronësi të bashkëshortëve nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak.

Ndërsa neni 87 citon se:

Rregullat e caktuara nga neni 85 zbatohen edhe për pasurinë bashkëshortore.

Veprimet juridike, të kryera nga cilido bashkëshort në lidhje me sendet e përbashkëta të tyre, janë të vlefshme edhe kur janë kryer pa pëlqimn e bashkëshortit tjetër. Por tjetërsimi i pasurive të përbashkëta të paluajtshme duhet të bëhet gjithmonë me pëlqimin e të dy bashkëshortëve.

Pjesa e secilit bashkëshort caktohet duke u nisur nga barazia e pjesëve. Por, duke marrë parasysh të ardhurat nga puna e çdo bashkëshorti, kryerjen e punëve shtëpiake, si edhe të çdo pune tjetër në administrimin, mbajtjen dhe shtimin e objekteve në pronësi të përbashkët, pjesa e secilit mund të shtohet ose të pakësohet.

2. Rrethi i objekteve/sendeve në bashkëpronësi u zgjerua, pasi nuk u përfshinë vetëm pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët gjatë martesës së tyre por edhe sendet, depozitat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës⁹³.

Pra si konkluzion, avancimi i kësaj periudhe ishte i dukshëm në lidhje me faktin se bashkëshortët me hyrjen në fuqi të ligjit të ri deklaroheshin e përbashkët çdo pasuri e fituar jo vetëm nga njëri bashkëshort, por nga secili më vete me anë të dhurimit, trashëgimit apo çdo forme tjetër të ligjshme⁹⁴. Në këtë pohim është e dukshme se nuk bëhet fjalë për marrëveshje të bashkëshortëve në lidhje me ndonjë ndryshim nga parashikimi ligjor si dhe po aq e dukshme se për pjesëtimin e pasurisë, nuk kishte rëndësi origjina e saj në bashkëpronësi ndërmjet bashkëshortëve në martesën e këtyre viteve.

3.4. Periudha e tranzicionit, ndryshimi i sistemeve politike.

Vitet '90 për popullin shqiptar përbëjnë vite shumë të rëndësishme pasi sollën revolucion në çdo fushë të jetës. Ndryshimi parësor ishte në politikë. Pluralizmi dhe hapat e parë të demokracisë sollën ndryshime themelore në të gjithë legjislacionin. U sanksionua prona private dhe më pas të gjitha rregullimet që e pasuan. Të gjitha fushat e së drejtës u ndikuan nga ky ndryshim duke përfshirë të drejtën familjare dhe mbi të gjitha regjimet pasurore martesore të saj.

3.4.1. Dispozitat kryesore kushtetuese

Me përmbyshjen e regjimit socialist dhe me vendosjen e regjimit ku themeli bazë ishte prona private, ndryshuan edhe marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve. Deri në këtë

⁹³Mandro, A; Mecaj, Vj; Zaka, T; Fullani, A.(2006). *E drejta Familjare*, Tiranë, Kristalina-KH, fq.312-314.

⁹⁴Begeja K, "*E drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*" 1985, Tiranë 137, faqe 146

kohë, pasuria bashkëshortore përbëhej kryesisht nga sendet e përdorimit shtëpiak, të ardhurat nga puna, si dhe ndonjë pasuri të tjera të fituara me dhurim ose trashëgim.

Referuar Ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” zhvillimet e viteve '90, në nenin 10 të tij sanksionohet e drejta e pronës private. Ky nen citon: *“Ekonomia e vendit bazohej në shumëllojshmërinë e pronave, nismën e lirë të të gjithë subjekteve ekonomike si dhe në rolin rregullues të shtetit.”*

Në vitin 1992 u miratua ligji “Për privatizimin e banesave shtetërore”, duke i bërë bashkëshortët bashkëpronarë të apartamenteve të tyre të banimit. Çmimi i shitjes së banesave shtetërore ishte simbolik, duke bërë kështu që bashkëshortët të cilët përfituan nga ky privatizim të ktheheshin në bashkëpronarë në pjesë të barabarta.

Privatizimi i banesave krijoi problem të madh për bashkëshortët të cilët kishin zgjidhur martesë para privatizimit të banesës, por që vazhdonin të jetonin në banesë si nëndorës (posedues) të përkohshëm. Vitet e fundit, vështirësi në praktikën gjyqësore ka krijuar dhe ndarja e pasurisë bashkëshortore, në kushtet kur njëri bashkëshort është larguar dhe punon në emigracion. Megjithëse Kodi Civil parashikon futjen në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve të çdo gjëje të fituar prej tyre gjatë martesës, praktikisht kjo ka mbetur e parealizuar⁹⁵.

Në një çështje gjyqësore me objekt zgjidhje martese dhe lënie e banesës bashkëshortore, gjykata e rrethit Tiranë ka zgjidhur martesë për fajin e të paditurit (bashkëshortit) dhe banesën prej një dhome dhe një kuzhine ia ka lënë paditëses, me kushtin që i padituri të banojë aty përkohësisht deri sa Këshilli Popullor i lagjes t'i gjejë një banesë tjetër me

⁹⁵ Islamaj, F.(2005). “Regjimi pasuror martesor”, Tiranë, fq. 20.

arsyetimin se fajtor për tronditjen e martesës është i padituri⁹⁶. Regjimi juridik i bashkëpronësisë në pjesë të bashkëshortëve, ka karakter urdhërues dhe prandaj nuk mund të përjashtohet ose të ndryshohet me marrëveshje të bashkëshortëve. Këtej del se është absolutisht e pavlefshme çdo marrëveshje e tyre e kundërt, dmth çdo marrëveshje që përjashton ose kufizon rrezen e veprimit apo vëllimin e kësaj bashkëpronësie të caktuar me ligj⁹⁷.

Gjithashtu, është e pavlefshme çdo marrëveshje e bashkëshortëve, e cila parashikon se kjo bashkëpronësi e tyre nuk do të zbatohet fare ose do të kufizohet vetëm në sendet që do të fitohen gjatë martesës me të ardhurat nga puna, duke mos u shtrirë mbi pasuritë që bashkëshorti ose bashkëshortja do të fitojë me anë të trashëgimisë ose dhurimit apo nëpërmjet mënyrave të tjera të ligjshme të fitimit të pronësisë. Pra, në çdo rast dhurimi, do të kemi përfshirjen e këtij dhurimi në pasurinë bashkëshortore, në qoftë se është bërë gjatë martesës, pavarësisht nga koha e dhurimit, në fillim apo në fund të martesës⁹⁸.

3.4.2. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në Kodin Civil të 1994.

Hyrja në fuqi e Kodit Civil të vitit 1994⁹⁹, nuk solli asnjë ndryshim në drejtim të rregullimit të regjimit pasuror martesor. Bazuar në dispozitat përfundimtare të tij, neni 1167, hyrja në fuqi e këtij kodi sillte shfuqizimin e Kodit Civil të vitit 1981¹⁰⁰ me

⁹⁶Për këtë shih. Indeksi i Gjykatës së Rrethit Tiranë, viti 1991, vendimi nr.9/05.01.1991.

⁹⁷ Xhafaj, P.(2010).*Evoluimi i regjimeve pasurore martesore në të drejtën Shqiptare*. rezultate dhe objektiva. Tiranë, fq. 43.

⁹⁸ Xhafaj, P.(2010).*Evoluimi i regjimeve pasurore martesore në të drejtën Shqiptare*. Rezultate dhe objektiva. Tiranë, fq 44.

⁹⁹ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë hyri në fuqi më 1 nëntor 1994 (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994)

¹⁰⁰Ligjit nr.6340, datë 26.6.1981 “Për Kodin Civil”.

*përjashtim të dispozitave që rregullonin bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve*¹⁰¹.

Ndaj, nga interpretimi literal i këtij neni, kuptojmë që marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve do të vazhdonin të rregulloheshin ende nga neni 86 dhe 87 i Kodit Civil të vitit 1981, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të Familjes, 21 Janar të vitit 2003.

KAPITULLI IV: ELEMENTËT JURIDIKË TË KONTRATËS SË MARTESËS

4.1. Kuptimi i kontratës së martesës

Në këtë punim fillimisht është e rëndësishme të përkufizojmë kontratën e martesës duke u nisur nga karakteristikat e saj dhe pozicioni që ka në legjislacion. Identifikimi i elementëve juridikë bëhet me krahasimin e parimeve të përgjithshme të institutit të martesës dhe karakteristikave të kontratave, në të drejtën e detyrimeve. Gjatë këtij trajtimi, do të përdoret për të njëjtin qëllim koncepti “kontrata paramartësore” dhe “kontrata e martesës”, me të njëjtën përmbajtje, por ndryshojnë në kohën që do të redaktohen. Këtë dallim do ta

¹⁰¹Bëhet fjalë për nenin 86 dhe 87 të Kodit Civil të vitit 1981.

analizojmë në kapitujt në vijim, për të qënë më të qartë mbi arsyen e përdorimit të dy terminologjive të ndryshme të përdorura për institutin e regjimit me kontratë. Për momentin mjafton të sqarojmë se koncepti kontratë e martesës do të përdoret njëlloj për të dy rastet. Kontrata e martesës hyn në kategorinë e veprimeve juridike të dyanshme, duke u nisur nga koncepti i veprimeve juridike të dyanshme sipas doktrinės tonë¹⁰². E drejta jonë në këtë kuadër e ka origjinën në të drejtën gjermane¹⁰³, pasi ka të veçantë që veprimin juridik si koncept teorik e trajton në kodin civil, ndërsa në kodet e tjera vihet re se elementët juridikë të veprimeve juridike, trajtohen nëpërmjet karakteristikave të përgjithshme të kontratave ku janë të integruara edhe këto karakteristika.

Një përkufizim i thjeshtë i kontratës së martesës, duke u nisur nga dispozitat e Kodit të Familjes, është një marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve për të përcaktuar mënyrën e rregullimit të aspekteve pasurore gjatë martesës si dhe kryesisht destinacionin e pasurisë në rastin konkret të zgjidhjes së martesës. Vështirësia në përkufizimin e kontratës së martesës e ka zanafillën në terminologjinë që përdor Kodi i Familjes në lidhje me këtë institut, pasi në nenin 66 thuhet se në rast të mungesës së një marrëveshje, zbatohet regjimi i bashkësisë ligjore. Në vijim, në nenin 69 gjejmë titullin e dispozitës “Forma e kontratës” dhe kështu është disi e paqartë se si do t’i drejtohem institutit që rregullon marrëdhënien pasurore të bashkëshortëve gjatë martesës me vullnetin e tyre. Filimisht, për të bërë këtë dallim do t’i referohemi kodit tonë civil për përkufizimin që gjejmë në kod për secilin nocion.

Përkufizimi i veprimit juridik

Neni 79

¹⁰²Nuni A, (2012) “Parime të përgjithshme të së drejtës Civile”, Tiranë, faqe 319

¹⁰³ Kodi Civil Gjerman, BGB, Titulli 2, Regjimi kontraktuale pasuror, Kapitulli 1, Dispozitat e përgjithshme, Seksioni 1408.

Veprimi juridik është shfaqja e liqishme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile. Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm.

Kuptimi i detyrimit

Neni 419

Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditore), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

Përmbajtja e kontratës

Neni 659

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Nga analiza e këtyre tre dispozitave, vihet re se legjislatori nuk ka dashur të thotë të njëjtën gjë me këto koncepte “marrëdhënie juridike”, “veprim juridik” dhe “kontratë”. Për sa i përket “kontratës” dhe “veprimit juridik” është e thjeshtë të përgjigjemi, sepse e gjejmë në nenin 79 dhe në nenin 659 Kodi Civil, ku arrijmë në përfundimin se kontrata është një veprim juridik dhe për rrjedhojë gama e veprimeve juridike është më e gjërë se sa kontrata, pasi në përkufizimin e kontratës në nenin 659 të Kodit Civil thuhet se “Kontrata është veprimi juridik...”, pra, është e qartë se në cilën kategori hyn kontrata. Kuptohet se kategoria e kontratave është më e vogël se gama e veprimeve juridike e ky rezultat vjen nga një silogjizëm i thjeshtë pasi mjafton të kujtojmë veprime juridike që nuk janë kontrata, konkretisht akti i përfaqësimit i redaktuar para noterit “*prokurë e posaçme*” nuk është kontratë, por veprim juridik i njëanshëm, sipas të cilit i përfaqësuari delegon kompetencat e tij me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit. Bazuar në nenin 659 të Kodit Civil dhe në nenin 66 të Kodit të Familjes, kontrata martesore përkufizohet si *një veprim juridik me anë të së cilit bashkëshortët, krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një regjim pasuror, të ndryshëm nga regjimi ligjor.*

Ligjberësit e kanë caktuar shumë qartë se veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit, pa e përcaktuar formën dhe detajimin e të drejtës që ka subjekti i së drejtës, pasojat që vijnë nga shfaqja e ligjshme e vullnetit krijojnë marrëdhëniet juridike. Për analogji sipas dispozitës së detyrimit, thuhet se ky i fundit lind nga marrëdhënia juridike kur një subjekt i detyrohet një subjekti tjetër, për të kryer ose moskryer një veprim të caktuar. Nga kjo dispozitë kuptohet se marrëdhënia juridike ka lidhje me subjektet e së drejtës dhe rregullon raportin juridik të tyre, që mund të jetë raport detyrimi, por jo vetëm i tillë. Marrëdhënia juridike e detyrimit lind nga ligji dhe nga kontrata, thuhet në Kodin Civil, “*Lindja e detyrimeve, Neni 420: Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji*” Në një analizë të sofistikuar, është pohuar se detyrimet në kategorinë e marrëdhënieve juridike mund të lindin edhe me kontratë, prandaj ne mund të pohojmë se marrëdhëniet juridike janë një bashkësi më e vogël se veprimi juridik, por një bashkësi më e madhe se kontrata, pasi kjo e fundit mundet të rregullojë një kategori marrëdhëniesh juridike dhe jo të gjitha. Marrëdhënia juridike, që kontrata krijon, ndryshon ose shuan, duhet të jetë marrëdhënie pasurore, pra duhet të ketë si objekt sende ose detyrime personale të vlerësueshme ekonomikisht, ndryshe nuk do të ishte kjo kategori e detyrimit, por do të merrte tiparet e institutive të tjera të së drejtës¹⁰⁴.

Ndër të tjera, në doktrinën shqiptare gjejmë përkufizim të kontratës referuar kryesisht marrëdhënieve të detyrimit, duke e trajtuar si pjesë të posaçme të së drejtës civile dhe në vijim nxjerr përkufizimin e kontratës nisur nga marrëdhëniet reciproke që kanë palët ndaj

¹⁰⁴ Galgano, F.(2003).*E drejta Private*, Shtëpia Botuese: Luarasi, Tiranë, fq.53.

njëra tjetrës¹⁰⁵. Martesa është veprim juridik i dyanshëm por nuk është kontratë, ndërsa rregullimi i regjimit pasuror të bashkëshortëve, është kontratë me specifikat e veta *sui generis*, pasi herë pas here shfaq sjellje të posaçme ligjore, të ndryshme nga grupi i gjërë i kontratave. Ajo çfarë është për t'u theksuar në këtë analizë ka të bëjë me faktin, se vullneti i palëve është parësor në realizimin e një marrëveshjeje e duke ecur me analizën na duhet të kemi objektin e ligjshëm, në mënyrë që të mund t'i drejtohem dispozitave ligjore për të rregulluar vullnetin e palëve dhe në përfundim kërkohet që të vishet ky vullnet mbi objektin e ligjshëm me formën e duhur ligjore¹⁰⁶. Që të përshkojmë këtë rrugëtim do të ndjekim çdo fazë me rradhë, ashtu siç na mundësojnë parimet e përgjithshme, dispozitat ligjore konkrete dhe deri tek rasti praktik, pjesë e jurisprudencës. Kështu është e nevojshme që objekti i kontratës së martesës ka të bëjë vetëm me rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve brenda rendit juridik, duke mos shkelur dispozitat e Kodit të Familjes, pra çdo dyshim në lidhje me faktin se me kontratën e martesës mund të rregullohen edhe marrëdhënie familjare, bie poshtë, pasi vetëm ligji e sqaron. Asaj që mund t'i referohet çdo studjues i së drejtës, në lidhje me përfundimet që nxjerr dhe interpretimin e ligjit është Gjykata e Strasburgut, ku në disa vendime haset nocioni 'familje' dhe transformimet që ka pësuar ajo deri në modalitetet më moderne duke mos i lidhur domosdoshmërisht me akte juridike të posaçme. Jeta familjare nuk përfshin vetëm marrëdhëniet me karakter shoqëror, moral ose kulturor, por edhe interesa materiale¹⁰⁷. Janë bërë interpretime të shumta për sa i

¹⁰⁵ Tutulani-Semini, M. (2006). *E drejta e detyrimeve dhe e kontratave*, Shtypshkronja: Real-Stam, Tiranë , fq. 1-2.

¹⁰⁶ Di Cecca D., Ferri G., Marcattili M., (1941) "*Il pensiero giuridico italiano*", Itali, faqe 62

¹⁰⁷ Çështja *Marckx kundër Belgjikës*, vendim i 13 qershorit 1979, faqe 519 Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.

përket detyrimit të shtetit për të respektuar jetën familjare, duke u bazuar në doktrinë¹⁰⁸ ku thuhet se neni 8 (1) *jo vetëm që parandalon shtetin për të ndërhyrë në jetën familjare të dikujt por edhe gjithashtu vendos detyrime mbi shtetin që të respektojë të drejtën për jetë familjare*. Komisioni Evropian kishte interpretuar këtë deklaratë në mënyrë mjaft të gjerë dhe diku në të thuhet: *“Në formësimin e jetës familjare, shteti duhet të veprojë në mënyrë e cila do t’i mundësojë personat përkatës të çojnë jetë normale familjare...Komisioni mendon se kjo konsideratë vlen jo vetëm për legjislacionin i cili rregullon marrëdhëniet familjare, mirëpo gjithashtu edhe për legjislacionin i cili rregullon çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pronës dhe në të njëjtën kohë bie ndesh me shfrytëzimin e pronës për qëllime familjare”*¹⁰⁹.

Pra kontrata e martesës nuk mund të jetë një kontratë normale dhe me karakteristikat kontratave të tjera, por është tërësisht unike si rezultat i kushtëzimit që ka ajo nga martesë si marrëdhënie familjare dhe elementet sociale të cilët tashmë janë rregulluar edhe me ligj. Kontrata e martesës në përkufizimin e saj dhe qëllimin që ka kushtëzohet përkatësisht nga vetë emri i saj *“kontrata”* dhe *“martesa”*, dy institute që në bashkimin e tyre për të dhënë një institut të ri duhet të ndërthuren, duke kufizuar dhe lehtësuar njëra-tjetrën. Kontrata si veprim juridik në përgjithësi, është ligjërisht e rregulluar dhe gjen pothuajse gjithmonë sanksionim në ligj sipas dispozitave ligjore të Kodit Civil, kështu që i kemi mjaft të qarta elementet dhe karakteristikat e saj, ndërsa martesë është një institut më i ndjeshëm dhe më i padepërtueshëm ligjërisht, pasi kushtëzohet gjithmonë nga ndjenjat njerëzore, qëndrimi psikologjik i subjektit, elemente subjektive, të cilën sado të mundohemi ta kufizojmë është

¹⁰⁸Vrojtimet e Gjykatës Evropiane në rastin Marckx kundër Belgjikës

¹⁰⁹ OSBE, (2003), Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, Raport mbi Qendrat për Punë Sociale, shkurt , Kosovë, fq. 10.

gjithmonë e paparashikueshme në pasojat e saj. Këtë thotë edhe juristi i vjetër, Italian Jemolo, i cili shprehet se si rregullohet sfera familjare nga ligji *“ishull të cilin deti i së drejtës mund ta prekë lehtësisht por jo të depërtojë në të”*¹¹⁰.

Nga analiza e mësipërme dalim në konkluzionin se përkufizimi i kontratës së martesës vjen si evolucion i marrëveshjes deri te kontrata, prandaj e gjejmë tek neni 66 i Kodit të Familjes “marrëveshje”¹¹¹, që është e ditur që në thelb të saj se mbart përputhje të vullnetit në realizimin e një qëllimi, që mund të jetë për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike civile, ndërmjet dy ose më shumë subjekteve. Për rastin në fjalë, kjo marrëveshje është në formën e përcaktuar në ligj me kontratë, bashkëshortët mund të heqin dorë nga regjimi pasuror ligjor dhe të shprehin tërësisht vullnetin e tyre në një nivel të avancuar për të përcaktuar destinacionin e pasurive të tyre. Nga ky formulim kuptojmë superioritetin që ka regjimi me kontratë ndaj regjimit ligjor. Legjislacioni mban këtë qëndrim jo vetëm në rastin në fjalë, por edhe në veprime të tjera juridike. Për analogji mund të rikujtojmë edhe rastin e testamentit dhe trashëgimisë ligjore¹¹² ku thuhet shprehimisht se: trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, duke na bërë të qartë kështu se testamenti prevalon në rast të ekzistencës së tij dhe se ligji kujdeset për destinacionin e pasurisë vetëm në rast se vetë pronari s’e ka bërë këtë. Duke marrë shkas nga të dy këto raste si dhe të tjera që ligji parashikon mund të kuptojmë frymën që përshkon tërësinë e legjislacionit, në vlerësimin dhe përparësinë që ka vullneti i subjektit, në krahasim me rregullimin ligjor në këto lloj marrëdhëniesh juridike. Edhe pse flitet për

¹¹⁰ Jemolo A.C., Tedeschi G, (1950), *“Il matrimonio, il regime patrimoniale della famiglia”*, UTET, Botimi i II, Torino.

¹¹¹Çështja *Radmacher (formerly Granatino) v Granatino* [2010] UKSC 42.

¹¹²Neni 317 Kodi Civil.

liri kontraktore, disponim të lirë, “kontrata është ligj për palët”, gjithmonë shtrirja arrin deri në kufizimin ligjor. Pra subjekti i së drejtës ka lirinë e disponimit dhe të realizimit të qëllimit, por gjithmonë brenda kufijve që ligji parashikon.

Nga ana tjetër përkufizimi i martesës, nga përcaktimi i saj deri më sot ka pësuar transformime të ndryshme, duke evoluar deri në nocionin modern me të gjitha elementet e mundshme deri sot. Shumë herë martesë është konsideruar si kontratë. E drejta romake është e para që hedh idenë e martesës si kontratë¹¹³. Gjithashtu me të njëjtën frymë ka qënë edhe Franca¹¹⁴, ku shprehet se “*ligji e konsideron martesën si kontratë civile*”. Për t’ju kundërvënë këtyre qëndrimeve që vendosin shenjë e barazisë së martesës me kontratën, sjellim në vëmendje faktin se natyra juridike e saj është e papërputhshme me kushtet, të drejtat dhe detyrimet nëse nuk do të përshkohej nga ndjenja e dashurisë, respektit reciprok dhe qëllimit për të krijuar familje, rrymë kjo e mbështetur nga shkenctarët Lefevre, Emanuel Levi, A.Bonkas të cilët tentojnë të shmangin ngurtësimin që ka rryma tjetër në lidhje me martesën, pasi ata e arsyetojnë faktin se martesë nuk mund të ketë pasojat që ka një kontratë, nuk mund të materializohet qëllimi i krijimit të familjes deri në një formulë ligjore¹¹⁵.

Martesa është një institut i së drejtës që qëndron në majën e piramidës për nga rëndësia e vullnetit të lirë, duke i angazhuar kështu ligjbërësit të gjejnë cilindo mjet juridik për të siguruar vetëm qëllimin e saj unik, sepse përfshirja e elemnetëve ndjesorë të subjektit në një veprim juridik, kërkon transparencën më të lartë të vullnetit, ku duhet të sigurohet jo

¹¹³Zaçe, V.(1996).*Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Shtëpia Botuese Logoreci, Tiranë, fq. 43.

¹¹⁴Kodi Civil Francez i vitit 1791.

¹¹⁵Zaçe, V.(1996).*Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Shtëpia Botuese Logoreci, Tiranë, fq. 45.

vetëm shfaqja e tij, por edhe fakti se nëse ky vullnet i shfaqur është i njëjtë me vullnetin e brendshëm. Prandaj, shpesh në legjislacionin familjar do të hasen mekanizma ligjorë që testojnë vullnetin e bashkëshortëve të ardhshëm dhe ligji shmanget nga aftësia për të realizuar tërësisht të pastër këtë akt juridik vetëm nëpërmjet normimit ligjor.

Tentativat që kanë bërë shumë autorë në vendosjen e shenjës së barazisë ndërmjet kontratës dhe martesës, ka ndodhur për faktin se në përkufizimin e martesës (neni 1 K.F) gjejmë fjalë kyçe të përkufizimit të kontratës së martesës, konkretisht fjalët barazi, reciprocitet, bashkëshortët (subjekte të së drejtës), në emër të një qëllimi, do të mendonim lehtësisht se është një marrëveshje ligjore. Por nga ana tjetër, ndjenja e dashurisë, respekti, uniteti i familjes nuk janë objekt i një kontrate dhe kurrësi nuk mund të rregullohen me një marrëdhënie detyrimi dhe kjo është edhe arsyeja pse nuk mund të themi që martesa është kontratë. Ndër të tjera, sot me evoluimin e nocionit të kontratës, e kemi të qartë se objekt i kontratës mund të jenë sendet dhe të drejtat jopasurore, por kurrësi ato martesore.

Në këtë moment ligji i ka siguruar bashkëshortëve mundësinë të zgjedhin lirisht orientimin pasuror gjatë martesës duke mos cënuar asnjërin nga ky bashkim dhe duke mundësuar që ata lirisht të ndjehen sërish të pavarur në marrëdhëniet e tyre pasurore. Për sa më sipër, prej këtij neni, mund të themi se çfarë është kontrata martesore: *Kontrata martesore është një kontratë e lidhur ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët me autonominë private që rendi juridik i njeh, ndryshojnë regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore duke e zëvendësuar më një regjim kontraktor tjetër ose e anasjelltas, duke respektuar dispozitat ligjore të Kodit të Familjes dhe të legjislacionit përkatës.*

Vetëm Kodi i Familjes i vitit 2003, solli risinë për të cilën do të zgjerohemi në vijim, sipas të cilit tashmë bashkëshortët mund të përcaktonin lirisht regjimin pasuror dhe nuk janë më

të kushtëzuar domosdoshmërisht nga martesë ku përzierja e pasurive dhe bashkëpronësia bashkëshortore tani është bashkëpronësi në tërësi¹¹⁶.

4.2. Qëllimet e kontratës së martesës

Në trajtim të dispozitës për martesën¹¹⁷ vëmë re se të lidhësh martesë duhet të ketë ndjenjë dashurie reciproke, detyrimin për besnikëri që nis si bazë e martesës dhe në vijim do të shikojmë që bashkëshortët e kanë kusht për të respektuar martesën e vërtetë. Detyrimet që lindin nga martesë angazhojnë bashkëshortët shpesh herë të bien pre e martesave fiktive ose kushtëzojnë bashkëshortët në lidhjen e martesës, duke harruar se kushtëzohen nga ndjenja e dashurisë për të qënë të martuar. Rast pas rasti, vihen re edhe qëndrime të ndryshme nga çdo subjekt në lidhje me martesën, përse i përket pasojave që ka ky institut. Si fillim nis me nënshkrimin e aktit të lidhjes së martesës në zyrën e Gjendjes Civile dhe vijon me gjithë përgjegjësitë që angazhon bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit e në vijim të fëmijëve nëse ka. Është e qartë se disa nga bashkëshortët që vendosin të martohen e kuptojnë rrugës rëndësinë e këtij instituti duke u njohur, dhe me detyrimet që i ka angazhuar ata në këtë bashkim. Megjithatë, ligji njëlloj do të angazhohet si për subjektet që duan të martohen dhe kanë shumë informacion nëpërmejt të cilit kërkojnë të rregullojnë çdo pasojë apo element juridik që ndryshon nga lidhja e martesës, si edhe për ata që nuk kanë informacion, por në momentin që hyjnë në marrëdhënie konfliktuale kërkojnë që ligji t'u vijë në ndihmë për të zgjidhur kaosin social dhe juridik të krijuar.

¹¹⁶ Kodi Civil, neni 231.

¹¹⁷Neni 1 i Kodit të Familjes.

Me nënshkrimin e aktit të martesës, bashkëshortët preken nga ndjenja e pasigurisë (e shprehur me rezervë përsa i përket përgjithësimin), në lidhje me pasuritë e tyre dhe zhvillimin ekonomik që mund të ketë secili si dhe transformimet që do të pësoje pasuria që ata kanë nga ndryshimi i statusit civil të tyre. Para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Familjes, bashkëshortët me lidhjen e martesës, hynin automatikisht në zonën e formulës ligjore në lidhje me pasuritë dhe këta ishin në pamundësi për të mbrojtur pasuritë e tyre vetëm si rezultat i lidhjes së martesës. Çdo pasuri e vënë pas lidhjes së martesës, deklarohet e përbashkët. Ky fakt nuk cënonte vetëm të drejtat e bashkëshortëve në regjimin e bashkësisë ligjore, ku ishte edhe ligji që mendonte për pasuritë e tyre, duke vendosur shenjë barazie midis bashkëshortëve, si atij kontribues edhe atij përfitues, por ka goditur rëndë institutin e martesës, pasi shumë bashkëshortë i janë shmangur lidhjes së martesës duke patur për veten e tyre projeksionin e zgjidhjeve të martesave në komunitetin e tyre dhe pasojave që kanë patur të tjerët nga ky proces. Disa të tjerë që kanë qënë të martuar, i janë shmangur zgjidhjes së saj prej pamundësisë së shkëputjes së pasurisë së tyre dhe mbrojtjes së kontributit financiar në familje gjatë martesës, duke rritur kështu numrin e martesave fiktive, por duke sjellë edhe pasoja sociale. Pra, ideja qëndron në faktin se martesa lidhet për qëllimet e saj shpirtërore të cilat janë të padepërtueshme nga ligji, por pasojat ligjore sqarohen në Kodin e Familjes dhe mund të paraidentifikojmë çdo hap që na pret në vijim.

Dy nga elementët më të ndjeshëm dhe më i dukshëm, që lehtësisht identifikohen edhe nga masa, janë pasojat pasurore dhe krijimi i klipesë që domosdoshmërisht bashkëshortët janë në bashkëpronësi me lidhjen e martesës. Cënimi i të drejtave pasurore, konkretisht atyre pronësore janë mjaft të ndjeshme për subjektin e së drejtës, prandaj edhe gëzojnë mbrojtje

të konsiderueshme dhe e drejta ofron në vijim instrumente ligjore për mbrojtjen e tyre¹¹⁸të cilat jë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , Kodi Civil, në detajimin e mbrojtjes së drejtës së pronësisë.

Lidhja shpirtërore dhe pasojat ligjore, janë dy gjëra për të cilat ligji nuk mund të kujdeset njëllor për to, por mundëson alternativat e ndryshme në mënyrë që të realizohet sa më mirë e drejta në funksion të individit, për vetë faktin se nuk është detyrë e ligjit të arrijë të depërtojë edhe në këto funksione të njeriut. Prandaj fillon dhe merr vlerë aplikimi i kontratës së martesës si mundësi që i jepet bashkëshortëve në planifikimin e këtyre pasojave dhe alternativat që ligji jep për të qënë komod në zgjedhjen e secilës mënyrë të administrimit të pasurisë pas martesës, përfitimet e bashkëshortëve me lidhjen e martesës janë të shumta¹¹⁹, pasi të qënurit në grup është më e thjeshtë.

Ndërkohë në lidhje me pasojat ligjore, lind nevoja që në funksion të martesës, ligjbërësit të vënë në dispozicion të bashkëshortëve skemat ligjore të shtimit dhe pakësimit të pasurisë gjatë gjendjes së martesës.

Rregulli i njohur pëgjithësisht “*Çfarë është e imja është e imja dhe çfarë është e jotja është jotja, por ndoshta jo*”¹²⁰, do të thotë se pasuria e njërit bashkëshort duhet të jetë e atij, por ndodh që në mungesë të një marrëveshje të mos përcaktohet sakt destinacioni i pasurisë tek pronari i saj. Martesa në mungesë të marrëveshjes i bashkon të ardhurat dhe përfitimet e tyre, që bashkëshortët i zotërojnë gjerat së bashku është deri diku asimilues, pasi përfshin secilin bashkëshort në detyrimin për të qënë në një të vetme. Këtë mënyrë fitimit të

¹¹⁸Protokolli nr.1, *Pronësia*, KEDNJ.

¹¹⁹Dylan S.Mitchell, (2011), Revista “*New York Metro Super Law yers*”.

¹²⁰Silberberg, F. (2015), “*Community property law governs the apportionment of a business interest*” faqe 12

pronësisë nëpërmjet martesës, nuk e parashikon Kodi Civil shprehimisht si mënyrë klasike të fitimit të pronësisë, por e kemi mjaft të qartë se hyn te kategoria e fitimit të pronësisë *ex lege*. Gjithashtu bashkëshortët me emancipimin e së drejtës e kanë të nevojshme të jenë në dijeni të çdo transformimi që i ndodh pasurisë së tyre dhe ashtu sic sigurojnë jetën, biznesin, mund të sigurojnë asetet e tyre veçmas ndaj çdo transformimi të statusit civil¹²¹. Jo të gjithë mund të integrohen me këtë pasojë dhe jo gjithmonë unifikimi i të mirave mund të jetë i suksesshëm në emër të krijimit të familjes. Prandaj martesa duhet të konceptohet një lidhje shpirtërore, pa patur nevojë të provohet me lidhje kontributesh, të mira të përbashkëta, pasuri bashkëshortore, etj.

Me lidhjen e martesës, fillon bashkëjetesa e përbashkët e bashkëshortëve, të cilët i angazhon në përfshirje të shpeshtë të kontributeve jetësore, që rast pas rasti mund të jenë herë nga njëri e herë nga tjetri. Nga ana tjetër, bashkëshortët marrin pjesë edhe në marrëdhënie juridike, ekonomike me të tretët të cilat sjellin pasoja juridike për secilin apo për të dy bashkëshortët. Të gjendur, në këto kushte lind nevoja e identifikimit të titullarit të këtyre të drejtave dhe normalisht është i qartë fakti se ligji duhet të gjejë formulat e aplikueshme, pasi nuk mund të parashikojë çdo marrëdhënie juridike që do të hyjnë bashkëshortët dhe ta rregullojnë në mënyrë specifike pasojën e tyre.

Në kuadër të vlerësimit të vullnetit të individit, aq të ndryshëm sa në pamundësi për të bërë unifikim të kërkesave, ligji vë në dispozicion zgjedhjen e mënyrës se si do të shtohen pasuritë e tyre dhe si do të garantohet paprekshmëria e tyre nga instituti i martesës.

Disa njerëz nuk e pëlqejnë marrëveshjen standarte, ndërsa disa të tjerë do të preferonin një marrëveshje tjetër, ku prona të ndahet në një mënyrë ndryshe. Sido që të jetë vendimi i tyre

¹²¹Haboubi C. (2016), “*Mon droit, mes libertes*”, Francë, fq.12

ka mjaft rëndësi fakti që me kontratën e martesës, të gjithë mund të vendosin me vullnetin e tyre destinacionin e pasurisë së tyre. Mënyra për të arritur këtë është një kontratë martesore që parashikon se çfarë do të ndodhë me pasurinë e bashkëshortëve në rast të ndarjes (divorcit)¹²² si dhe disa marrëveshje të tjera që rregullojnë edhe mënyrën e administrimit të pasurisë gjatë martesës.

Ligjberësit këtë kanë patur parasysh, në parashikimin e institutit të kontratës së martesës, me të gjitha qëndrimet pro dhe kundra, për t'i mundësuar bashkëshortëve edhe këtë alternativë duke synuar gjithmonë që *ratio leges* të jetë i drejtë *recta ratio*, në shërbim të individit. Kjo, sepse e drejta duhet të jetë në shërbim të subjekteve dhe të lehtësojë mënyrën e qeverisjes së tij në jetën e përditshme, duke i shërbyer atij si rregullator i çdo cënimi që mund t'i vijë nga individë të tjerë dhe nga tërësia e marrëdhënieve juridike që ai përfshihet në normalitetin e tij¹²³.

Në një trajtim më konkret, për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike, nuk mjafton thjesht vullneti i palëve, por duhet patjetër ekzistenca e shkakut, pra e justifikimit ekonomiko-social të aktit të autonomisë kontraktore¹²⁴. Këtu rikujtojmë dallimin që u trajtua më lart në lidhje me veprimin juridik dhe kontratën, ku nga ky pohim duket qartë se kontrata e martesës është tërësisht e specifikuar si veprim juridik i cili duhet të sjellë pasojat e duhura dhe jo vetëm shprehjen e vullnetit që kërkohet nga veprimi juridik, apo vetëm krijimi i marrëdhënieve ndërmjet subjekteve që kërkohet si kusht tek marrëdhënia juridike civile.

¹²² Claire J. Vannette, (2016), *The purpose of a prenuptial agreement*, "What is the purpose of a prenuptial agreement" Shih në Quora.com: <https://www.mondroitmeslibertes.fr>, Parë në Janar 2017

¹²³ Sofokliu shprehet se "*Kush ka të drejtën me vete mund të dalë në krye*".

¹²⁴ Galgano, F.(2011), *Il contratto*, Cedam, Padova, fq. 149.

Kontrata duhet të përmbajë një dobishmëri ekonomiko-sociale për shoqërinë, të justifikojë redaktimin e saj dhe fuqinë juridike, sigurisht kur flitet për të qënë në juriksion gjyqësor. Autorë të tjerë e kanë kritikuar teorinë e dobishmërisë ekonomiko-sociale si shkakun apo qëllimin e kontratës. Ky grup autorësh mbështetet në argumentin se kontratat që ndeshim në qarkullimin civil, nuk janë vetëm ato kontrata të cilat kanë një dobishmëri ekonomiko-sociale, (për pasojë meritojnë mbrojtje ligjore)¹²⁵ por gjithashtu edhe kontrata që sjellin pasoja negative në aspektin ekonomiko-social (për pasojë, jo vetëm nuk meritojnë mbrojtje ligjore, por janë të dënueshme). Gjithashtu, në qarkullimin civil ndeshen edhe kontrata, që nuk sjellin as dobishmëri ekonomiko-sociale, por nga ana tjetër as pasoja negative. Këto kontrata duhen toleruar nga ligji për aq kohë sa subjektet zgjedhin me vullnet të lirë të rregullojnë raportet e tyre në këtë formë, duke kujtuar kështu parimin se çdo gjë që s'është e ndaluar është e lejuar. Në vijim të këtij arsytimi, shkak i kontratës është “funksioni” që vetë palët i japin kontratës, në shprehjen e plotë të autonomisë së vullnetit, për të qënë në shërbim të subjekteve. Për sa më sipër duhet të mbrohen nga ligji edhe ato kontrata, që megjithëse nuk kanë një funksion ekonomiko-social të caktuar, nuk janë shoqërisht të dëmshme për secilin në komunitet¹²⁶.

Në lidhje me kontratën martesore argumenti i mësipërm nuk vlen, sepse në terma abstraktë, çdo kontratë e cila gjen rregullim në legjislacionin civil, duke përfshirë këtu edhe kontratën martesore, ka një funksion ekonomiko-social të caktuar, përderisa ligjvënësi e ka gjykuar të arsyeshme t'i japë rregullimin ligjor. Pavarësisht se ligji nuk merret me analizimin e dobishmërisë së secilës kontratë, këtë e bën doktrina. Çdo kontratë tipike ka një shkak në

¹²⁵G.Viney, (2006), “*Les conditions de la responsabilite*”, botimi III, LGDJ, faqe 640

¹²⁶Roppo, V. (2011) “*Il Contratto*”. Publisher: Giuffrè, Torino, faqe 346.

kuptimin abstrakt të saj dhe ky shkak gjendet në interpretimin e parë literal të normimit të kësaj kontrate. Në këto rrethana në drejtim të kontratës martesore nuk shtrohet problemi i ekzistencës së shkakut (ekzistencës së një funksioni ekonomiko-social të kontratës), pasi ai deklarohet nga ligji dhe si i tillë është i qartë se shkak është ekonomiko-social si dhe tërësisht i ligjshëm¹²⁷.

Nëse i referohemi nenit 677 të Kodit Civil, shkak i kontratës duhet të jetë i ligjshëm. Në një kontratë, shkak ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet shkak për të shmangur zbatimin e një norme. Sërish, parë në terma abstraktë, shkak i kontratës martesore, presumohet, nga ligji, që është i ligjshëm, arsyeja për të cilën palët po hyjnë në një marrëdhënie kontraktore duhet të jetë e ligjshme. Konkretisht, ligjin material që rregullon kontratën e martesës, e parashikon si institut më vete dhe në këto kushte është i ligjshëm shkak ligjor për aq kohë sa rregullon së pari të drejtat e pashmangshme¹²⁸ si dhe të drejtat dytësore, rast pas rasti me vullnet të bashkëshortëve.

Qëllimi i ligjvënësit, për të sanksionuar institutin e kontratës së martesës, nuk është vetëm ligjor, por është edhe funksional¹²⁹ (në shërbim të subjektit të së drejtës), për aq sa është e mundur të zbatohet nga subjektet e së drejtës, në statusin bashkëshortë si dhe të mbrojtë të tretët nga veprimet juridike me pasuritë e vëna gjatë martesës apo transaksionet monetare me bashkëshortët.

Për nga natyra e zgjidhjeve që jep kontrata e martesës si dhe për vetë rezultatin që gjejnë bashkëshortët në rastin konkret të ekzistencës së saj, qëllimet e kontratës së martesës

¹²⁷ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*. Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, faqe 75

¹²⁸Neni 67 Kodi i Familjes.

¹²⁹Në shërbim dhe në funksion të dickaje..., fjalori i Gjuhës Shqipe.

konkretizohen dhe do të mund t'i ndanim në tri grupe, shkak për të cilin është bërë e mundur që në ligjin tonë të kishim kontratën e martesës. Kjo ndarje bëhet për efekt të studimit duke marrë shkas nga qëllimi që ka patur ligjvënësi në sanksionimin e kontratës së martesës në ligj dhe përdorimi i kontratës që bëhet nga bashkëshortët.

4.2.1. Qëllimi ligjor

Koherenca e zhvillimit të legjislacionit tonë me të drejtën moderne, nuk do të mund të linte pas dore institutet e reja të së drejtës dhe përfshirjen e tyre në sistemin tonë. Pa dashur të përsëritim të njëjtin fakt në lidhje me sanksionimin e këtij instituti në Kodin Civil të vitit 1929, e drejta jonë përveç se regres pësoi dhe stopim në periudhën komuniste, duke mos u rimëkëmbur menjëherë me ndryshimin e sistemeve qeverisëse.

Detyra e ligjit është që të ndërhyjë në momentin e duhur dhe të ofrojë mundësitë më të favorshme për palët, ose të paktën të mundësojë alternativën ligjore të zgjedhjes së regjimeve martesore. Duket shumë e vonuar duke parë se ku i gjejmë rrënjët e kontratës së martesës, por nga ana tjetër është në koherencë të plotë me nevojën momentale që pati praktika për t'i referuar këtij instituti. Jo vetëm gjatë periudhës komuniste, por deri në vitin 2003 me kodin e ri të familjes, regjimi i bashkësisë ligjore kishte mbetur i vetmi në fuqi dhe aplikohet pa alternativë. Rikuperimi i kontratës së martesës me Kodin e Familjes të vitit 2003, vjen konform instituteve të tjera të së drejtës, pasi ky kod në tërësi të tij pati rëndësi për novacionet dhe mundësinë që i dha subjekteve të ndjehen më të lirë në marrëdhëniet familjare, (kujtojmë këtu institutin e bashkëjetesës, që rregullohet në mënyrë specifike nga ky Kod). Me këtë frymë nuk mund të anashkalohej kontrata e martesës e cila kishte qënë një herë në sistemin tonë të së drejtës dhe si padashje ishte harruar në ligjet tona

me ndryshimin e sistemeve. Në kuadër të ndryshimit paralel të së drejtës sonë me atë Evropiane, ligji ynë ishte i detyruar të përshtatej, sipas sistemeve të shteteve të zhvilluara. Nga njëra anë, Kodi i Familjes është hartuar mbi bazën e Kodit Civil Francez dhe atij Italian, ndërsa nga ana tjetër është ruajtur tradita shqiptare, në drejtim të ruajtjes së elementëve që kanë qenë bazë në konsolidimin e traditës shqiptare¹³⁰. Sjellim këtu në vëmendje se të parët që e morën në Europë ishin francezët¹³¹ dhe në vijim vendet e Beneluksit, ku edhe sot gjen zbatimin më të gjërë në Evropë¹³². Regjimi pasuror martesor është rregulluar mbi bazën e modelit ligjor të sistemit Francez, deri diku ai Italian si dhe është mbajtur gjithashtu në konsideratë edhe Kodi i Familjes i RPSSH¹³³, i vitit 1965¹³⁴.

E drejta familjare nuk është ndërkombëtare pasi kushtëzohet shumë nga kultura nacionale, por deri në mundësinë e shkëputjes së martesës nga aspekti pasuror, pronësor do të konsiderohet zhvillim i detyrueshëm dhe jo i guximshëm për të drejtën tonë. Në momentin që sanksionohet një normë ligjore, synohet të realizohet mbrojtja e një instituti, konkretisht është ligji ai që jep garancinë e pasurisë së bashkëshortëve nga martesa. Interesi i ligjshëm për të cilin mundësohet ekzistenca e këtij institute, është më i dukshëm kundrejt përdorimit

¹³⁰ Zaka, T. (2004), “Kodi i ri i Familjes - Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” në Jeta Juridike, Nr. 2, Tiranë: Botim i Shkollës së Magjistraturës, fq.5.

¹³¹ Në legjislacionin francez, kemi një parashikim të pjesëmarrjes në blerje që është vetëm një regjim opsional. Çdo pasuri që ka secili bashkëshort para martesë është pasuri vetjake, ndërsa pas martesës çdo gjë që blehet nga bashkëshorti përdoret edhe nga bashkëshorti tjetër. Për këtë shih. Kodin Civil Francez, nenet: 1569-1581.

¹³² Grégoire, M. (1995). *Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Bruylant Akademia s.a., fq.92.

¹³³ Zaka, T. (1999). *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, Tiranë, fq.11.

¹³⁴ Kodi ka hyrë në fuqi 1 Janar 1966.

të saj në praktikë. Me rritjen e marrëdhënieve ekonomiko - financiare të subjekteve në jetën e tyre si dhe me ritmet e shpejta që po ecën sot i gjithë zhvillimi i shoqërisë, po e vënë ligjin në kërkim të instituteve të reja në shërbim të individit për t'i mundësuar subjektit të së drejtës praktitet, garantimin e të drejtave, drejtësi të shpejtë dhe shanse të barabarta. Duke analizuar kryesisht mbi këto elemente, kuptohet qartë se kontrata e martesës konsiderohet si institut praktik, pasi janë vetë bashkëshortët e ardhshëm që përcaktojnë destinacionin e pasurisë, garantojnë të drejtat e pronësisë si dhe të tjera që do t'i trajtojmë më poshtë. Në pjesëtimin e pasurisë është ekonomia gjyqësore, pasi lehtëson dhe shmang mjaft procedura që kryhen në fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë.

Fazën e parë të pjesëtimit¹³⁵, do të konsiderohet si mundësi për shanse të barabarta ku secilit subjekt i jepet mundësia që të zgjedhë lirisht formulën e destinacionit të pasurisë së vet.

4.2.2. Qëllimi social

Bashkëshortët me lidhjen e martesës, krijojnë përshtypjen e bashkimit në tërësi të tyre dhe unifikimit në një celulë për të mundësuar krijimin e familjes. Siç sqarohet edhe më lart, ky perceptim e ka goditur institutin e martesës dhe me ndërhyrjen e ligjit si rregullator për të rivendosur solemnitetin e martesës në kuadër të mbrojtjes së familjes, si dhe ofron mundësinë e ligjshme të ndarjes paraprake të të drejtave pasurore me vullnet të tyre.

Nëse në regjimin e bashkësisë ligjore, kontributi është i prezumuar (*praesumptionem*) dhe si i tillë ndodh shpesh që të anashkalohet e drejta e angazhimi special i secilit bashkëshort dhe të kamuflohet vlera reale e pasurisë individuale të bashkëshortit, me kontratën e martesës mund të identifikojmë drejtëpërsëdrejti pasuritë e secilit edhe pse nuk janë

¹³⁵ Neni 107 i Kodit të familjes, neni 370 (e në vijim) i Kodit të Precedurës Civile.

vetjake. Me nënshkrimin e kontratës së martesës, bashkëshortët angazhohen njëllor për shtimin e pasurive përkatëse, për hyrjen e marrëdhënieve juridike civile me të tretët si dhe me potencialin ekonomik individual të secilit. Kështu integrohen personalisht në marrëdhëniet e punës, menaxhojnë individualisht asetet përkatëse dhe kursejnë në mënyrë të pavarur tepricën e tyre. Shmangia nga “*skuadra*” perfeksionon alternativën e integritetit social të bashkëshortit më të dobët, në rastin në fjalë gruas, fillimisht lind si detyrim, pasi i duhet të kontribuojë njëllor dhe të mirëmbahet vetëm, pasi nuk përfiton vetëm nga ato që sjell bashkëshorti, por ajo vetë angazhohet në përfaqësimin e saj për qëllim ekonomik dhe në vijim social e politik. Në këtë mënyrë, bashkëshorti pasiv deri më dje, me kontratën e martesës, ndjen detyrimin të perfshihet në vendimarrjen e vendit të tij, të punojë po aq sa burri dhe të mund të kërkojë për veten e saj aq të drejta sa burri, duke mos iu trembur angazhimit në shoqëri. Pasiguria që mund të përfitojë nga martesa e bashkëshortit të pakonfirmuar, nxit këtë të fundit në pjesëmarrjen sociale dhe i jep mundësinë të kërkojë dhe të japë si çdo subjekt i së drejtës.

4.2.3. Qëllimi funksional

Në vijim të gjithë studimit, çdo element që vihet në evidencë në lidhje me kontratën e martesës, mbart ngjyrim pozitiv në lidhje me mundësinë e saj, sepse zgjidhja që ofrohet nga ky punim shkencor është për t'i ardhur në ndihmë bashkëshortëve në organizimin e pasurive të tyre. Pra, me qëllim funksional do të kuptojmë shërbimin për të cilin është sanksionuar kjo kontratë dhe është vendosur nga ligjvënësi për ndihmë të subjektit të së drejtës. Sipas së drejtës sonë, bashkësia ligjore përfundon në tre forma: *të parën* atë

standarde siç është parashikuar në ligj¹³⁶, me mbarimin e martesës, *së dyti* me pjesëtimin e pasurisë që rast pas rasti mund të pranohet edhe në rastet e keqadministrimit të pasurisë nga bashkëshorti tjetër apo nga paaftësia e bashkëshortit jo kërkues, kur ky i fundit vë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër, dhe mënyra *e tretë* me ndryshimin e regjimit pasuror martesësor (neni 72 Kodi i Familjes), e cila kufizohet në afat nga data e lidhjes së martesës, jo më herët se dy vite nga lidhja e martesës. Këto forma të mbarimit bashkësisë ligjore, na provojnë edhe një herë se në rast se bashkëshortët nuk bien dakord vullnetarisht për mënyrën se si do t'i ndajnë pasuritë e vëna gjatë bashkësisë ndërmjet tyre, atëherë ato detyrohen t'i drejtohen Gjykatës për të bërë pjesëtimin e pasurisë. Në këtë moment ata përballen me kalvarin e seancave gjyqësore, pasi vetë legjislacioni ynë këtij lloj procesi gjyqësor i ka dhënë një status tjetër duke e renditur tek proceset e posaçme të cilat kanë një specifikë në zhvillimin e gjykimit¹³⁷. Procesi gjyqësor i pjesëtimin të pasurisë, siç është edhe ky ndërmjet ish bashkëshortëve, e ka të përcaktuar rrethin e palëve në process, sepse domosdoshmërisht duhet të jenë bashkëpronarët dhe kjo quhet bashkëndërgjyqësi e detyruar¹³⁸ dhe gjykata në asnjë moment nuk mund të vërë në dyshim ndërgjyqësinë e cila është e dukshme që në seancë përgatitore. Në vijim në ligj parashikohet se ky proces do të zhvillohet në dy faza, të cilat kanë specifikat përkatëse për sa i përket objektit të secilës, vendimit të fazës së parë dhe vendimit të e fazës së dytë, ankimi mbi këto vendime etj, të cilat në tërësi kërkojnë kohë të konsiderueshme për të realizuar të drejtat e palëve. Duke u gjendur në këto lloj kushtesh, bashkëshortët janë të detyruar të kalojnë këto faza dhe të angazhohen në çdo kërkesë që ligji parashikon për këtë proces gjyqësor. Pikërisht këto

¹³⁶ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, (2014), neni 96.

¹³⁷ Kodi i Procedures Civile i Republikës së Shqipërisë, neni 369 e në vijim.

¹³⁸ Brati, A.(2008). *Procedura Civile*, Botimet Dudaj, Tiranë, fq 68.

procedura kushtojnë kohë gjyqësore, kohë e gjatë deri në identifikimin e pasurisë së secilit, kohë e konsiderueshme për të gëzuar këto pasuri deri në momentin final të përfundimit të procesit gjyqësor. Këto lloj vendimesh nga praktika vihet re se në shumicën e rasteve nuk kanë kaluar dot pa u ankimuar, për secilën fazë më vete dhe për rrjedhojë pothuajse kanë kaluar në tri shkallë gjykimi. Kjo frymë ka ndjekur bashkëshortët për faktin se ata i janë drejtuar gjykatës me këtë lloj padie, pikërisht se nuk kanë rënë dakord për pjesëtimin vullnetar dhe në këto kushte kërkojnë ndërhyrjen e autoritetit gjyqësor për të gëzuar pasurinë e vënë gjatë martesës, në këtë mënyrë mosmarrëveshjet ecin gjatë gjithë procesit gjyqësor duke kundërshtuar dhe duke mos pranuar me asnjë vendimarrje të ndërmjetme dhe përfundimtare në lidhje me pretendimet e tyre. Nga një studim i bërë rasteve nga viti 2005-2015, të regjistruara në Gjykatën e Lartë, me këtë objekt gjykimi, është vënë re një hapsirë kohore e konsiderueshme deri në përfundimin e këtij lloj procesi gjyqësor.

Prandaj i rikthehem i oportunitetit të kontratës së martesës, pasi nënshkrimi i kontratës së martesës bëhet në momentin kur bashkëshortët kanë nivelin më të lartë të dëshirës për të ndërtuar familjen së bashku dhe pikërisht në këtë moment vendosin të bashkëpunojnë në të mirë të tyre dhe interes të përbashkët për pasurinë, kontributin dhe çdo të drejtë tjetër që kërkojnë mos t'u cënohet nga lidhja e martesës. Në këtë moment ata janë edhe të drejtë dhe të aftë për të vendosur paktin ndërmjet tyre për mënyrën se si do të procedojnë në lidhje me pasuritë dhe kjo marrëveshje do t'ju duhet në rast se ata vendosin të përfundojnë martesën. Në këtë moment kur bashkëshortët të jenë konfliktuar ose qetësisht do të kenë vendosur të përfundojnë martesën, nuk do jenë në kërkim të çdo mënyre për të zvarritur ndarjen finale të pasurisë, pasi nuk do ta kenë këtë mundësi duke qënë se këtë e kanë vendosur që në fillim dhe tani mbetet vetëm për t'u ekzekutuar. Ndër të tjera edhe gjatë martesës ata kanë qënë

në dijeni të plotë se si do të ndahen pasuritë e tyre në fund, nëse një ditë do të ndahen dhe nuk i shoqëron ndjenja e pasigurisë gjatë martesës në lidhje me pronësinë e pasurive të tyre. Pra, ekonomia gjyqësore e cila përfitohet me pasjen e kontratës së martesës, është e dukshme krahasuar me atë të pjesëtimit të pasurisë kur bashkëshortët janë në regjim të bashkësisë ligjore dhe në këto kushte do të duhet të kalojnë në numrin e konsiderueshëm të seancave gjyqësore për të cilat duhen edhe specifikat përkatëse për këtë lloj procesi. Pasi jemi të qartë për dëmin që i shkaktohet procesit të rregullt ligjor në zgjatjen e proceseve gjyqësore, sjellim këtu parimin e fuqishëm *“drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”*. Të pasurit një kontratë martese ndihmon ndjeshëm bashkëshortët, në momentin më kritik të tyre dhe nga ana tjetër është një garanci paraprake e procesit të rregullt gjyqësor në lidhje me ekonominë gjyqësore.

Si qëllim funksional duhet parë edhe momenti tjetër që kontrata e martesës i ofron bashkëshortit, kur martesa mbaron me vdekjen e njërit bashkëshort dhe bashkëshorti pasjetues duhet të përballë me dy institutet rradhazi, së pari me pjesëtimin e pasurisë së vënë gjatë martesës duke veçuar kështu nga pasuria e bashkësisë ligjore pjesën e tij dhe kontributin përkatës sipas asaj që ligji parashikon dhe njëkohësisht përballë edhe me trashëgiminë ligjore, duke u përfshirë në pjesët takuese të pasurisë që përfiton si trashëgimtare. Për sa i përket kësaj të fundit, është pjesë e cila studjohet dhe sqarohet mjaft mirë nga disiplina e veçantë e së drejtës, trashëgimia, por ka rëndësi të veçantë përcaktimi i pasurisë trashëgimore për bashkëshortin pasjetues. Siç do ta shohim edhe në vijim të këtij studimi, do të duhet të bëhet veçimi i pasurisë bashkëshortore nga totali i pasurisë që mund të rezultojë në emër të bashkëshortit të ndjerë, në momentin që është shpallur nga jeta dhe pastaj pasuria e mirëfilltë e trashëgimtarit mund t'i nënshtrohet formulës ligjore dhe asaj

vullnetare pas vdekjes, *post mortum*, ku ka karakteristikat e veta si një mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë¹³⁹.

Sistemi i së drejtës sonë, si moment i përfitimit të së drejtave pasurore, në rastin e institutit të së drejtës njeh momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe kjo ka rëndësi specifike për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm për formulën ligjore të ndarjes së pasurisë. Prandaj vlen të kujtojmë dhe parimin e së drejtës së pronësisë se askush nuk mund të kalojë më shumë të drejtat se sa ka ai vetë. Nëse trashëgimlënësi ka qënë i martuar dhe në regjimin e bashkësisë ligjore, ku pasuritë e shtuara gjatë martesës mund të përzihen dhe kombinohen me të dy bashkëshortët duke i bërë bashkëpronarë në tërësi, formë e detyruar e bashkëpronësisë, në momentin e vdekjes së njërit bashkëshort, pasjetuesi duhet domosdoshmërisht të bëjë identifikimin e pasurisë së tij dhe pasuria e mbetur është ajo që në kohën e ndërrimit jetë të të ndjerit, do të konsiderohet pasuri trashëgimore. Vetëm kjo pasuri, duke i zbritur barrët, detyrimet, të jenë bërë kompensimet e duhura dhe kur të jetë e pastër dhe e plotë, pjesa e mirëfilltë e të ndjerit vazhdohet me formulën e trashëgimisë ligjore të ndarjes së pasurisë. Nga ana tjetër, nëse bashkëshortët janë në regjimin me kontratë, bashkëshorti pasjetues është i mbrojtur duke veçuar automatikisht pasuritë e tij, mjafton paraqitja e kontratës dhe në këto kushte pasuria që kalohet tek trashëgimtarët është pasuri e mirëfilltë e trashëgimisë ashtu siç ligji e parashikon dhe me të drejtë ndahet sipas pjesëve takuese ndërmjet tyre, duke përfshirë edhe bashkëshortin këtu.

Sqaroj se, me kontratën e martesës nuk mund të ndërhyjmë në pjesët takuese të bashkëshortit si trashëgimtar, por para identifikimit të pasurisë trashëgimore, bëhet veçimi i

¹³⁹ Nuni dhe Haneziri, (2010), *E drejta Civile III- Pronësia*. Tiranë, fq.102.

pasurisë së bashkëshortit pasjetues, me kontratën e martesës si rezultat i një instituti tjetër të së drejtës.

Këto qëllime funksionale që janë sqaruar në këtë pjesë të punimit, kanë të bëjnë me qëllimet e kontratës së martesës, efikencitetin e saj në përdorimin final dhe me zbatimin e saj për sa i përket mundësisë që kanë bashkëshortët për t'u mbrojtur nga transformimet që mund të pësojë çifti në vijim.

4.3. Kontrata e martesës si marrëdhënie juridike civile familjare: kufizimet e saj

Bashkëshortët hyjnë në marrëdhënien juridike familjare të martesës, si rezultat i ndjenjës së dashurisë, qëllimit të tyre për të krijuar jetë të përbashkët dhe në vijim realizimin e familjes. Në përkufizimin e marrëdhënies juridike të martesës, na vjen në ndihmë instituti martesës i përkufizuar tek neni 1 i Kodit të Familjes dhe në kushtet kur detyrimi i bashkëshortëve për të krijuar familje duket sikur duhet domosdoshmërisht të përshkohet nëpërmjet martesës është zgjeruar në interpretim nga Gjykata e Strasburgut, ku familja gëzon mbrojtje të veçantë nga ligji dhe si e tillë nuk kushtëzohet vetëm në formën ligjore të saj. Në bazë të vendimmarrjes të partnerëve që kërkojnë të lidhin ose jo martesë, varet edhe mënyra ligjore se si ata do të rregullohen në marrëdhëniet ndërmjet tyre. Martesa në përmbajtje të saj ka karakter jopasuror, por bashkimi në një raport të tillë mund të sjellë pasoja pasurore të cilat shoqërohen herë pas here me elemente kontradiktore, ku do të ishte mirë që të parashikoheshin dhe akoma më mirë të mund të rregulloheshin. Deri në momentin që raporti afektiv i partnerëve nuk është formalizuar në martesë, detyrimet ligjore janë të një forme tjetër që nuk janë në rëndësi të këtij punimi, ndërsa momenti i lidhjes së martesës kërkon nga bashkëshortët një angazhim tjetër duke i bërë me dije ata se do t'i nënshtrohen

regjimit të pasurisë së bashkëshisë ligjore në rast se nuk shprehin vullnetin për një regjim tjetër. Në këto kushte bashkëshortët gjenden përpara faktit që me lidhjen e martesës, duhet të kujdesen për zgjedhjen e formulës së duhur në mbrojtje të pasurive të tyre gjatë martesës, duke zhveshur kështu martesën nga çdo efekt anësor që mund të sjellë si rezultat i padijenisë, por që është mjaft e qartë se kjo e fundit nuk përjashton nga përgjegjësia.

Siç shihet, marrëdhënia juridike e martesës është një marrëdhënie shoqërore e cila merr veshjen juridike si rezultat i rregullimit ligjor që gjen ajo në sistemin e së drejtës. Për aq kohë sa subjektet futen në një marrëdhënie juridike, ato angazhohen me detyrime dhe gëzojnë të drejta reciproke kundrejt njëri-tjetrit duke formuar kështu atë çfarë vullenti i tyre ka gjetur në ligj për t'u rregulluar si raport. Normat juridike nuk krijojnë marrëdhënie juridike, por janë parakusht i lindjes së tyre, pra martesa rregullohet me ligj si dhe pasojat e tyre i mundësohen bashkëshortëve deri në kufijtë e lejuar me ligj të mund ku mund organizohen nga ana e tyre duke amortizuar sado pak konsumimin formal të martesës. Duke qënë se kontrata e martesës rregullohet me ligj të posaçëm, në vijim të lidhjes së martesës, ne mund të nxjerrim në analizë juridike elementët dhe karakteristikat e kontratës së martesës duke mundësuar kështu çfarë përfaqëson kontrata e martesës në të drejtën tonë dhe cili është pozicioni i saj juridik në rrjetin e së drejtës. Në vijim edhe martesa është një marrëdhënie juridike e krijuar në bazë të fakteve të lindura të cilat krijohen nga personat të cilët kanë si qëllim të bashkëjetojnë dhe të krijojnë familje, e cila nga karakteristikat është marrëdhënie juridike, pasi rregullohet me normat juridike në fuqi. Si e tillë na lind nevoja të identifikojmë dhe analizojmë me radhë elementet e marrëdhënies juridike civile, të cilat në bazë të llojit të marrëdhënies juridike kanë karakteristika të ndryshme. Duke qënë se

kontrata e martesës është pasojë e martesës, karakteristikat e saj kushtëzohen nga instituti i martesës dhe nga instituti i kontratës sipas së drejtës së detyrimeve.

Prandaj, në analizë të elementëve thelbësorë të kontratës së martesës dhe kushteve që duhet të plotësojë për vlefshmëri të saj, do t'i referohemi dispozitave të kodit civil në nenin 663 dhe në nenin 69/1 Kodit të Familjes. Të parat do t'i quajmë kushte të përgjithshme të cilat burojnë nga e drejta e detyrimeve, ndërsa të dytat do t'i quajmë kondita të veçanta të kontratës së martesës të cilat nxirren në interpretim funksional të dispozitës.

Neni 663 “Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”.

Neni 69/1 “Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre”.

4.3.1. Pëlqimi i palëve

Kontrata e martesës është me detyrime të dyanshme të bashkëshortëve dhe si e tillë pëlqimi i palës që detyrohet përkthehet në pëlqim të bashkëshortëve për të zgjedhur kontratën e martesës si formë të regjimit të tyre pasuror. Pëlqimi i bashkëshortëve duhet kuptuar në të dy anët e shprehjes së vullnetit edhe në lidhje me mosshprehjen e vullnetit për zgjedhjen e një regjimi dhe për rrjedhojë aplikimin e regjimit të bashkësisë ligjore si dhe shprehja e vullnetit për regjimin me kontratë.

Ky raport juridik që të ketë pëlqim të pavesuar, duhet të jetë vendosur ndërmjet personave dhe këto të fundit në momentin që futen në marrëdhënie juridike marrin emërtimin *subjekte*. Këto persona vendosin me vullnetin e tyre të lirë ose për shkak të rrethanave të përfshihen në marrëdhënien juridike civile. Pra, është e dukshme se subjekti i kontratës

duhet të ketë aftësinë për të kuptuar rëndësinë e veprimit juridik që po kryen dhe të ketë vullnetin e lirë në përfshirjen në marrëdhënie juridike.

Ndërkohë, momenti i shprehjes së vullnetit për të hyrë në një kontratë është një nivel më i lartë i angazhimit intelektual të subjektit të së drejtës dhe kjo kushtëzohet nga disa elemente që janë vlerësuar nga ekspertët si të nevojshme për të kuptuar rëndësinë e veprimit juridik. Pikërisht momenti i shprehjes së vullnetit lidhet me konceptin e zotësisë për të vepruar e cila kërkon një vëllim të drejtash të caktuara për të qënë i mundëshëm subjekti që të shprehë vullnetin drejtëpërsëdrejti. Kriteri i parë është kriteri i moshës i cili sipas legjislacionit tonë është përcaktuar që subjekti i së drejtës fiton zotësinë e plotë për të vepruar me mbushjen e moshës 18 vjeç, pra siç shihet nuk është e nevojshme të jepet një vlerësim konkret apo të kushtëzohet në plotësimin e disa rrethanave, mjafton kalimi i moshës së miturisë dhe është e mjaftueshme për t'u veshur me mundësinë e shprehjes së vullnetit në lidhje me veprimet që ai ndermerr për veten e tij. Elementi i dytë që kërkohet nga ligjvënësi për të patur mundësinë e shprehjes së vullnetit të pavesuar, përveç moshës së caktuar kanë të bëjnë me gjendjen mendore të subjektit të së drejtës.

Kufizimi i të drejtave mund të jetë i justifikueshëm vetëm në emër të përfitimit të të drejtave të tjera që në balancimin e tyre marrin epërsi të drejtat për të cilat po kufizohen të parat. Pra, më qartë bëhet ky lloj vlerësimi për subjektin e së drejtës, pasi nëse është me një sëmundje të rëndë mendore që i humb aftësinë për të kuptuar rëndësinë e marrëdhënies juridike civile, ky subjekt mund të ndërmarrë veprime në kundërshtim me interesin e tij si dhe mund të jetë lehtësisht pre e veprimeve të padrejta të të tretëve¹⁴⁰. Konkretisht në institutin e martesës, subjekti duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar në mënyrë që të

¹⁴⁰Omari, S. (2012). *E drejta familjare*: Shtëpia Botuese Morava, Tiranë. fq 55-56.

mund të shprehë pëlqim për lidhjen e martesës dhe në vijim pëlqimin reciprok për llojin e regjimit¹⁴¹.

Pëlqimi në një kontratë ka karakteristikat e tij në lidhje me faktin se palët e kësaj kontrate duhet të jenë të qarta në lidhje me pasojat e aktit juridik që lidhin si dhe në lidhje me detyrimet që angazhohen për të kryer në përmbushje të objektit të kontratës. Prandaj dhënia e pëlqimit nuk konsiston vetëm për lidhjen e kontratës, por edhe në marrjen përsipër të detyrimeve që vijnë nga kjo kontratë. Për kontratën e martesës duhet bërë dallimi ndërmjet pëlqimit për lidhjen e martesës dhe pëlqimit për llojin e regjimit, konkretisht, atij me kontratë që është në interes të studimit. Pëlqimi për lidhjen e martesës ka karakteristika të tjera që lidhjen me situatën shpirtërore dhe dëshirën për lidhjen e martesës për shkak të ndjenjës së dashurisë dhe qëllimit të përbashkët për familje. Ndërsa pëlqimi për lidhjen e kontratës së martesës është i një natyre racionale i cili bazohet në elemente material, kryesisht duke marrë në vlerësim ato ekonomike, pasuror dhe potencialë, në aftësinë menaxhuese dhe mirëmbajtëse të familjes për secilin bashkëshort. Në rastin e dytë, bashkëshortët ose bashkëhsortët e ardhshëm marrin status tjetër, zhvishen nga përfshirja emocionale në redaktimin e kontratës dhe analizojnë pasojat e lidhjes së kontratës së martesës në krahasim me mundësitë e tyre ekonomike.

Prandaj ishte e nevojshme të sqaronim se kontrata e martesës është veprim juridik *sui generis* dhe si i tillë në çdo fazë të redaktimit dhe analizës së saj prodhon transformime ligjore ndryshe nga kontratat e tjera. Për të pasur një vullnet të pavesuar dhe të pastër në lidhje me zgjedhjen e llojit të regjimit, normalisht që është e rëndësishme ku mund të jetë jo vetëm zotësia e plotë për të vepruar, por edhe aftësia për të kuptuar rëndësinë e veprimit

¹⁴¹Po Aty, fq. 56.

juridik. Në vende të ndryshme ka qëndrime të ndryshme në lidhje me moshën e lidhjes së martesës, duke marrë në konsideratë pothuajse të njëjtët elementë por faktorë të ndryshëm ndikojnë edhe në kufirin e moshës sipas rastit. Për shembull, legjislacioni francez parashikon moshën 18 vjeç për burrin që lidh martesë dhe 16 për gruan, legjilacioni gjerman parashikon moshën 21 vjeç për burrin dhe 16 vjeç për gruan¹⁴².

Ndërkohë nga ana tjetër legjislacioni njeh edhe përjashtimin i cili ka të bëjë me rastet e jashtëzakonshme, të cilat për shkaqe objektive mund të lejohet që bashkëshortët të lidhin martesë pa mbushur moshën 18 vjeç. Kur kemi të bëjmë me përjashtime nga rregulli i përgjithshëm dhe kemi të bëjmë me vlerësime rrethanash subjektive që nuk merren automatikisht, atëherë autoriteti përcaktues për të lejuar këtë përjashtim do të jetë Gjykata, e cila do të vlerësojë nëse me të drejtë janë shkaqet objektive ose jo.

Bazuar në nenin 7 të kodit të familjes, i cili i jep mundësi të gjerë vlerësimit të gjykatës, në praktikën gjyqësore vihen re koncepte të ndryshme në drejtim të kushteve të nevojshme për lejimin e martesës së të miturit. Kështu, nga një analizë e vendimeve me këtë objekt gjykimi, vërehet se pjesa më e madhe e praktikave gjyqësore, arsyeton lejimin e martesës së të miturit duke u bazuar vetëm në një rrethanë objektive, për shembull shtatëzania, lindja e një fëmije, bashkëjetesa, jetesa e njërit partner jashtë kufijve dhe pamundësia e të miturit për t'u nënshtruar procedurave të bashkimit familjar etj¹⁴³. Ndonëse shtatëzania është një motiv i rëndësishëm dhe i bazueshëm, jo gjithnjë ajo është edhe e mjaftueshme për të lejuar lidhjen e martesës. Kjo, sepse mund të mos shoqërohet me një aftësi të kuptimit të martesës si një detyrë për jetë të përbashkët me përgjegjësi dhe ndërgjegjësim, për ta zhvilluar atë në

¹⁴²Omari, S. (2012). *E drejta familjare*: Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 57.

¹⁴³PoAty, fq. 62.

mënyrë të pavarur prej prindërve sikur mund të mos shoqërohet me pëlqimin e lirë për martesë, por vetëm sa për të mbuluar problemin¹⁴⁴.

Është me rëndësi për të rikujtuar statusin që përfiton subjekti i së drejtës, me lejimin e lidhjes së kësaj martese me vendimin e Gjykatës, bashkëshortëve u mundësohet edhe përfitimi i zotësisë së plotë për të vepruar, pasi tashmë janë bashkëshortë dhe shkaqet objektive i veshin me përgjegjësi për krijimin e familjes dhe ndërmarrjen e veprimtarive më të avancuara pikërisht për rrjedhojë të këtij shkakut të ri. Këtë status që e përfitojnë bashkëshortët me lidhjen e martesës nuk e humbin pas zgjidhjes së saj edhe nëse nuk e kanë mbushur moshën 18 vjeç për të fituar zotësinë e plotë për të vepruar ashtu siç ligji e parashikon në përgjithësi¹⁴⁵.

Të gjitha këto analiza në lidhje me moshën për lidhjen e martesës kanë të bëjnë me vullnetin e pavesuar të lidhjes së martesës që është ndryshe nga kontrata e martesës. Ndërsa vullnetin në lidhje me kontratën e martesës legjislatori shqiptar e ka kufizuar me moshën 18 vjeç, pasi në Kodin e Familjes, ndalohet redaktimi i kontratës së martesës për martesat e mitura duke mos e dhënë një justifikim se pse, por në një analizë të detajuar në kapitujt në vijim do të mundohemi të kuptojmë edhe qëllimin e ligjvënësit në rastin në fjalë.

Tani t'i kthehemi kontratës së martesës, e cila si një kontratë e mirëfilltë në elemente, por objekti i saj është i ndryshëm nga gama e gjërë e kontratave dhe duke qënë e një lloji të veçantë, doktrina i quan veprime juridike *sui generis* (e veçantë në llojin e saj), pasi janë specifike në llojin e tyre dhe duhet të kalojnë disa hapa të posaçëm për t'u konsideruar të vlefshëm. Kontrata e martesës ka vlerë juridike vetëm me lidhjen e martesës dhe fuqinë

¹⁴⁴Mandro, A. (2009), *E drejta familjare*, Tiranë, fq. 107.

¹⁴⁵Po Aty.

juridike e merr menjëherë pas lidhjes së saj ose mund të lidhin kontratë edhe bashkëshortët që kanë qënë të martuar, por me një kufizim 2 vjeçar nga momenti i lidhjes së martesës¹⁴⁶. Duke qënë se kjo kontratë kushtëzohet nga lidhja e martesës, do të thotë që dhënia e pëlqimit për regjimin pasuror është post factum, të ekzistencës së lidhjes së martesës. Nga analiza e dispozitave të kodit të familjes në lidhje me kontratën e martesës, në rastin e bashkëshortëve të ardhshëm, kuptojmë se pëlqimi jepet para lidhjes së martesës për llojin e regjimit dhe me lidhjen e martesës hyn në fuqi edhe regjimi me kontratë i zgjedhur prej bashkëshortëve. Kjo fazë konsiderohet një lloj konservimi i pëlqimit dhe merret i mirëqënë në momentin e lidhjes së martesës duke pranuar që është i njëjtë për aq sa nuk është kundërshtuar. Konkretisht, vëmë re se në nenin 69 të Kodit të Familjes, kërkohet dhënia e njëkohshme e pëlqimit të të dy bashkëshortëve, që do të thotë se merret i mirëqënë quhet i mirëqënë pëlqimi me nënshkrimin e njëkohshëm të të dy bashkëshortëve. Gjithashtu në karakteristikat e përgjithshme të pëlqimit duhet të jetë i pavesuar, kjo buron nga detyrimi që na sanksionon Kodi Civil në nenin 92 të tij, pasi është e qartë se për të sjellë pasojat e kërkuara nga ky akt, duhet të jetë i pastër vullneti i palëve. Ky detyrim është kusht i vlefshmërisë dhe i është lënë në dorë autoritetit publik për të vendosur në lidhje me marrjen e pastër të vullnetit të palëve, por pa analizuar mundësinë e provueshmërisë së mëvonshme të një prej veseve të vullnetit, sic mund të jetë lajthimi, mashtrimi ose kanosja. Një karakteristikë tjetër e pëlqimit në rastin e kontratës së martesës, si të gjithë kontratat e tjera, por ndryshe nga vendet e tjera, lejohet që pëlqimi të jepet nga përfaqësuesit e tyre. Nga ky sanksionim kuptojmë se kontrata e martesës nuk hyn në kategorinë e veprimeve ngushtësisht personale, siç është lidhja e martesës apo formulimi i testamentit, etj.

¹⁴⁶ Shih nenin 72 të Kodit të Familjes.

Përfaqësimi në rastin në fjalë bëhet nëpërmjet prokurës, ku vullneti i shprehur duhet të jetë direkt për këtë veprim juridik, duke kuptuar këtu prokurën e posacme si veprim juridik në ndihmë të kryerjes së këtij veprimi juridik dhe me tagra konkrete në lidhje me llojin e regjimit me kontratë¹⁴⁷, ndërsa prokura duhet të ketë formën e aktit noterial për të cilin është lëshuar¹⁴⁸, pra noteriale për faktin se veprimi juridik për të cilin është lëshuar është i detyrueshëm me akt noterial dhe si e tillë sipas legjislacionit tonë edhe prokura duhet të ketë këtë formë për efekt të vlefshmërisë.

4.3.2. Objekti

Objekti i kontratës është qëllimi i subjekteve për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie juridike civile¹⁴⁹ duke përputhur vullnetin e tyre në të njëjtin drejtim. Në rastin konkret bashkëshortët me lidhjen e kontratës së martesës kanë krijuar regjimin pasuror të tyre për gjatë martesës dhe kanë shuar regjimin ligjor duke planifikuar këtë sipas vullnetit të tyre, brenda kufijve të ligjit. Gjithashtu duhet mbajtur në konsideratë se objekti i kontratës së martesës është i kushtëzuar edhe nga fakti i vetë institutit të martesës¹⁵⁰.

Le të ndalemi në mënyrë më të detajuar në lidhje me objektin e kontratës së martesës për të kuptuar drejtë se çfarë mund të bëjnë bashkëshortët me kontratën e martesës. Fillimisht duhet të rikujtojmë faktin se kontrata e martesës është një veprim juridik aksesori në

¹⁴⁷ Colomer, A. (2005). *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*. (12e ed), Publisher: LexisNexis, Francë, faqe 139.

¹⁴⁸ Neni 72 i Kodit Civil.

¹⁴⁹ Neni 678 i Kodit civil, shprehet objekti i kontratave në përgjithësi, që do t'i referohemi kësaj dispozite për të redaktuar objektin e ligjshëm, por konkretisht për kontratën e martesës edhe pse nuk gjejmë një nen i cili të sanksionojë qartësisht objektin e kontratës së martesës, në interpretim të zgjeruar të nenit 66 si dhe dispozitave 108 e në vijim mund të shprehemi se objekti i kontratës së martesës s' duhet të bjerë ndesh ligjit por edhe institutit të martesës pasi nuk mund të rregullohen në kontratë ndjenjat apo detyrimet e pashmangshme që burojnë nga lidhja e martesës, apo të çenohet mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

¹⁵⁰ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*.: Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 90.

shërbim të lidhjes së martesës dhe që i vjen në ndihmë bashkëshortëve për të rregulluar regjimin pasuror të ndryshëm nga ai ligjor. Si e tillë karakteristikat janë të kushtëzuara nga martesa dhe prandaj objekti përveç se i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të caktohet, duhet të jetë në kufijtë e caktimit të pasurive ndërmjet bashkëshortëve, nuk mund të shmangë detyrimet reciproke të bashkëshortëve që burojnë nga martesa si dhe nuk mund të çenojë në asnjë rast parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Me anë të kontratës bashkëshortët mund të rregullojnë të drejta pasurore dhe jo pasurore. Në mënyrë të përgjithshme, në analizë të kombinuar të dispozitave të Kodit të Familjes, vëmë re se bashkëshortët munden me kontratën e martesës të zgjedhin si më poshtë:

- Zgjedhin llojin e regjimit me kontratë
- Zgjedhin regjimin e bashkësisë me kontratë
- Zgjedhin regjimin e pasurive të ndara
- Zgjerojnë ose ngushtojnë objektin regjimin e bashkësisë ligjore¹⁵¹
- Zgjedhin kombinime regjimesh duke krijuar kështu regjime atipike¹⁵²
- Rregullojnë edhe marrëdhëniet *jopasurore*:
 - Vendosin mënyrën e rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës
 - Vendosin mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pa cenuar parashikimet ligjore.
- Në lidhje me sqarimin e mësipërm për mënyrën se si rregullohen marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në bazë të llojit të regjimeve, arrijmë të kuptojmë se bashkëshortët vendosin mbi ndarjen tërësore të pasurive me regjimin e pasurive të ndara po

¹⁵¹ Cubeddu M. Giovanna, (2011). “*Le convenzioni matrimoniali*”, Torino, fq. 46-47.

¹⁵² Galgano, F. (1995). “*Il diritto private*”, Milano: Giuffrè. Editore, fq. 925.

ashtu vendosin të bashkojnë pasuritë deri në mundësinë maksimale të lejuar me ligj me anë të regjimit të bashkësisë me kontratë, konkretisht duke e quajtur bashkësi universale. Të drejtat pasurore në kontratën e martesës mbahen në konsideratë dhe trajtohen të kushtëzuara nga Kodi Civil në lidhje me kapitullin e pronësisë, si dhe në lidhje me veprimtarinë tregtare do të zbatohen rregullat e parashikuara nga ligji 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar¹⁵³. Për të kuptuar se cili është grupi i pasurive që regjimi me kontratë mund të negociojë në objektin e saj do t’i referohemi pasurive të bashkësisë dhe pasurive vetjake. Konkretisht në Kodin e Familjes gjejmë listimin e pasurive që bashkëshortët kanë të përbashkët në bashkësi ligjore, duke sqaruar kështu shkurtimisht natyrën e bashkësinë ligjore. Është me vend të sqarohet se bashkësia ligjore nuk është bashkësi universale dhe i ka të përcaktuara në mënyrë takstative grupet e pasurive që përfshihen në të pasuritë e cituara në nenin 74¹⁵⁴ Kodi i Familjes.

Grupi i parë i pasurive, që kanë të bëjnë: *a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës, nuk bën dallim për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, apo sipas llojit të sendeve, të pjesëtueshme apo jo, të konsumueshme apo jo, etj. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është se pasuritë duhet të jenë shtuar pas datës së lidhjes së martesës, pasi ky moment i jep tagrat e bashkëpronarit të dy bashkëshortëve. Në interpretimin literal të kësaj pasurie si edhe nga doktrina,*

¹⁵³ Ligj nr. 129/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008

¹⁵⁴ “**Përbërja e bashkësisë** Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës. Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit.”.

ky grup pasurish hyn menjëherë në bashkësi sapo fitohet, pa patur nevojë për ndonjë sqarim të mëtejshëm¹⁵⁵.

Grupi i dytë i pasurive: *b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë*, ka të bëjë me të ardhurat e kursyera nga bashkëshortët nëpërmjet punës së përbashkët dhe kushtëzohet në lidhje me kohën, me elementin kohë. Kjo do të thotë se këto sende, merren në konsideratë në rastin eventual të përfundimit të bashkësisë, pra aty lind nevoja si dhe duhet domosdoshmërisht të ekzistojnë në kohën e mbarimit të bashkësisë.

Grupi i tretë i pasurive: *c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë*, kanë të bëjnë me pasuri të përfituara nga grupi i parë dhe i dytë i pasurive që listohen në nenin 74 të Kodit të Familjes dhe është e qartë se edhe këto kushtëzohen nga ekzistenca e tyre në kohën e përfundimit të bashkësisë.

Grupi i katërt i pasurive të bashkësisë ka të bëjë me: *ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës*, pasuri e cila nuk gjendet në doktrinë në mënyrë të shprehur se në cilën formë përfshihet në pasuri të bashkësisë. Gjithashtu, këtu hasen edhe problematika për sa i përket analizës së kombinuar të dy legjislacioneve atij familjar me atij tregtar, pasi ky i fundit nuk e trajton në asnjë moment *bashkëshortin ortak*, ndërkohë ligji familjar detyron shoqërinë tregtare të jetë pjesë e regjimit të bashkësisë ligjore të bashkëshortëve. Në praktikë është parë si kufizim i ortakut¹⁵⁶ në veprimtarinë tregtare të tij dhe aktivitetin organizativ të shoqërisë tregtare, pasi duhet të rikujtojmë një ndër karakteristikat e personit juridik që ka autonomia organizative. Janë ortakët ata që ndërmarrin veprime si ndarjen dhe bashkimin e

¹⁵⁵ Mandro, A. (2009), *E drejta familjare*, Tiranë, fq.227

¹⁵⁶ Lamçe J., Aliu B., “*Përfshirja e kuotave/aksioneve të shoqërive tregtare në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve*”

shoqërisë, por nga ana tjetër ortaku – bashkëshort, kushtëzohet nga nënshkrimi i kontratës së tjetërsimit të kuotave nga ana e bashkëshortes. Këto mbeten për t’u trajtuar në tema specifike, pasi kërkojnë një analizë më të detajuar në lidhje me qëndrimin *pro* dhe *kundër* të çështjes se deri në ç’masë duhet të përfshihet bashkëshorti jo-ortak në shoqëri tregtare¹⁵⁷.

Ndërkohë Kodi i Familjes parashikon mundësinë e bashkëshortëve të shprehin pëlqimin e tyre për llojet e regjimeve me kontratë duke ju propozuar atyre të paktën dy regjime, atë të *bashkësisë universale* dhe atë të *pasurive të ndara*. Në vijim të analizës, për të arritur deri tek objekti i mirëfilltë dhe i plotë që mund të rregullohet me kontratën e martesës, duhet të analizojmë elementin e dytë ligjor ku parashikohet edhe në kodin tonë se me kontratën e martesës mund të eksperimentojmë regjime juridike atipike, për aq kohë sa kushtëzohemi vetëm nga rendi juridik.

4.3.3. Shkaku i ligjshëm

Në vijim të detyrimit të sanksionuar nga Kodi Civil¹⁵⁸ për vlefshmërinë e kontratës në përgjithësi, edhe kontrata e martesës i nënshtrohet detyrimit për të justifikuar shkakun për të cilën palët kanë shprehur vullnetin në arsyetimin e qëllimit ekonomiko-social që kanë patur subjektet në lidhjen e kësaj kontrate. Në kuadër të lirisë kontraktore palët e kontratës nuk duhet të kuptojnë mundësinë për të lidhur çdo lloj kontrate, pasi për vlefshmërinë e saj janë të kushtëzuar të plotësojnë elementët ligjorë. *Causa* i marrëveshjes *pacta*, është veprimi aktiv i palëve që i bën ato të përfshihen në një marrëdhënie juridike civile, sipas të

¹⁵⁷ Trinchillo C., (2002) “*Partecipazioni sociali e comunione legale dei beni*”, *Revista del Notariato*, faqe 851.

¹⁵⁸ Neni 677, që na detyron të mbahet në konsideratë për efekt të vlefshmërisë që mos të bjerë ndesh me rendin publik.

cilës duhet të përputhet me qëllimin e vërtetë të palëve¹⁵⁹. Në momentin fillestar palët nisen të rregullojnë marrëdhënien e tyre me kontratë për shkak të rregullimit të regjimit pasuror martesor, ndryshe nga ai që ligji ofron automatikisht dhe deri në përfundim të funksionit të kontratës duhet t'i qëndrojnë këtij qëllimi. Për të kuptuar drejtë shkakun e kontratës së martesës do t'i referohemi kushtit të përgjithshëm për kontratat në lidhje me ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre¹⁶⁰. Është mjaft e rëndësishme të arsyetojmë mbi shkakun e ligjshëm të kontratës së martesës ose kur mund të jetë rreziku që shkakun të jetë i paligjshëm. Konkretisht, duhet mbajtur në konsideratë që shkakun të jetë i paligjshëm duhet të jetë në kundërshtim me ligjin, të jetë lidhur kontrata për t'u shmangur zbatimit të normave ligjore ose të jetë në kundërshtim me rendin publik. Në këto situata kontrata është e pavlefshme dhe si e tillë nuk mund të sjellë pasojat e dëshiruara nga kontrata. Në lidhje me kontratën e martesës, duke marrë shkas edhe nga praktika, mund të ketë prirje që bashkëshortët të lidhin një kontratë martese për t'u shmangur detyrimeve me të tretët. Këtë mund ta bëjnë me mirëkuptim të dyanshëm, ku bashkëshorti debitor i dhuron pasuritë bashkëshortit tjetër dhe ndryshojnë regjimin nga ai ligjor në atë me kontratë, duke zgjedhur regjimin e pasurive të ndara dhe në këtë mënyrë pasuritë në emër të bashkëshortit jo-debitor, janë të mbrojtura deri sa të provohet keqbesimi dhe shkakun përse është bërë ndryshimi i regjimit.

Një formë tjetër që mund të përbëjë shkakun e paligjshëm të kontratës është kufizimi tërësisht i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të njërit prind ose kushti dhe afati që janë elemente që mund të gjenden në disa kontrata në kontratën e martesës nuk bëjnë sens etj. Të gjitha këto veprime në rast se arrijnë të provohen e bëjnë shkakun në kundërshtim me

¹⁵⁹ Planiol, M. (1959). “*Traite élémentaire de droit civil*”, Botimi i VI. V.I/2, Louisiana State Law Institute, fq. 29.

¹⁶⁰ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*. Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 90.

ligjin, pasi duhet të jetë e qartë se palët në kontratën e martesës hynë në këtë marrëdhënie juridike për të rregulluar regjimin pasuror martesor të ndryshëm nga ai me ligj. Në rast se shkak i lidhjes së kontratës nuk ka qenë pikërisht rregullimi i regjimit, atëherë jemi përpara faktit të pavlefshmërisë së kontratës së martesës.

4.3.4. Forma

Kontrata në kategorinë e veprimeve juridike¹⁶¹, për të sjellë pasojën e kërkuar nga palët duhet ndër të tjera të përmbushë edhe kushtin e formës së kërkuar nga ligji. Forma e kontratës është veshja e jashtme e vullnetit të palëve, që për efekt të provueshmërisë dhe për efekt të vlefshmërisë merr rëndësinë e duhur dhe sipas rastit ka funksione të ndryshme. Rast pas rasti vihet re fleksibiliteti i ligjvënësit në përcaktimin e formës së kontratës, që ka të bëjë me mundësinë që palët mund të vendosin për formën e kontratës në rats se ligji nuk e ka përcaktuar që për efekt të vlefshmërisë (*ad substantiam*), duhet të jenë në një formë të caktuar. Forma e kontratës martesore, është e kushtëzuar nga Kodi i Familjës, në të cilën duhet të shfaqet vullneti i bashkëshortëve me qëllim që të krijojë, ndryshojë apo shuajë regjimin martesor, me anë të aktit notarial.

Qëndrimi i sistemit të së drejtës vendase duket sikur është liberal përsa i përket formës, pasi shpesh nuk kushtëzon palët në mënyrën e kryerjes së veprimit juridik, por sipas rëndësisë së veprimit juridik, ligjvënësi ka vlerësuar edhe ratsin kur është e detyruar forma në nivelin më të lartë të garancisë së vullnetit të pavesuar, ajo noteriale, kërkohet për pasuritë e paluajtshme¹⁶². Sipas kësaj dispozite kuptohet se qëndron njëkohësisht edhe detyrimi për të nënshkruar aktin noterial para noterit dhe regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të

¹⁶¹Nga neni 80 deri në nenin 83 të Kodit Civil.

¹⁶²Neni 83 i Kodit Civil.

Paluajtshme për të sjellë pasojat e duhura juridike. Ndërkohë, nga ana tjetër është interpretuar nga Kolegjet e Bashkuara¹⁶³, se detyrimi për të regjistruar kontratën e shitblerjes së pasurive të paluajtshme buron nga publiciteti i kontratës për efekt të tretëve. Sistemi ynë i së drejtës konfirmon momentin e ardhjes së pasojës së veprimit juridik, momentin e shprehjes së vullnetit, ndryshe momenti i lidhjes së kontratës, pasi pasojat juridike në një kontratë vijnë si rezultat i konkludimit të vullnetit në formën e kërkuar.

Si përjashtim nga parimi i lirisë së formës që karakterizon lidhjen e kontratës në sistemin tonë të së drejtës, sipas të cilit palët mund të zgjedhin lirisht formën që dëshirojnë, në rastin e kontratës martesore neni 69 parashikon se vullneti duhet të dekalohet në formën e aktit noterial. Në zbatim të nenit 72 paragrafi i dytë, kjo formë kërkohet jo vetëm në rastet kur kontrata martesore lidhet për herë të parë nga bashkëshortët, por edhe në rastin kur marrëveshja e bashkëshortëve ka për qëllim të ndryshojë një kontratë të mëparshme martesore. Parë në këndvështrimin e formës, kontrata martesore bën pjesë në kategorinë e kontratave formale. Kjo formë parashikohet si kusht për vlefshmërinë e kësaj kontrate dhe jo vetëm për provën e saj. Në këto rrethana, kontrata martesore e lidhur me shkresë të thjeshtë apo me çdo formë tjetër të deklarimit të vullnetit, do të tjetër e pavlefshme. Në një hipotezë të tillë bashkëshortët do t'i nënshtrohen regjimit të bashkësisë ligjore¹⁶⁴.

Në Suedi kontrata martesore hartohet me shkrim, e nënshkruar nga bashkëshortët aktual ose bashkëshortët e ardhshëm dhe regjistrohet në gjykatë. Kontrata martesore e lidhur nga bashkëshortët e ardhshëm fillon zbatimin që nga data e lidhjes së martesës, me kusht që ajo të dorëzohet në gjykatë brenda një muaji nga lidhja e martesës. Përndryshe një marrëveshje

¹⁶³Vendimi nr.1 datë 06.01.2009.

¹⁶⁴ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*. Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq.91.

zbatohet nga data në të cilën është paraqitur në gjykatë. ***Një marrëveshje për të hyrë në një kontratë martese nuk është e detyrueshme.*** Është e mundur, megjithatë, të duhet të hysh në një marrëveshje paraprake lidhur me ndarjen e pronës¹⁶⁵.

Nga ana tjetër Danimarka, pranon kontratën e martesës si një akt të ligjshëm për bashkëshortët në mënyrë që të vendosin regjimin pasuror martesor. Në këtë shtet regjimi i bashkësisë ligjore është i është regjimi që aplikohet menjëherë me lidhjen e martesës¹⁶⁶ në rast se bashkëshortët nuk kanë kërkuar një regjim tjetër. Legjislacioni tyre parashikon regjimet primare dhe sekondare duke detyruar bashkëshortët që të mos shmangen nga detyrimet familjare¹⁶⁷. Në vijim të arsyetimit të dispozitës së Kodit të Familjes në lidhje me formën e kontratës së martesës, vëmë re se vullneti i bashkëshortëve jo vetëm që do të shprehet para noterit, por edhe në mënyrë të njëkohshme nga të dy, që do të thotë se noteri duhet t'u bëjë të qartë njëkohësisht pasojat juridike të aktit dhe të sigurohet që palët i kanë kuptuar dhe e shprehin vullnetin në mënyrë reale dhe serioze¹⁶⁸, edhe pas marrjes së përgjegjësisë me lidhjen e kontratës¹⁶⁹.

Legjislacioni ynë detyron këtë lloj forme për shkak të vlefshmërisë së kontratës së martesës duke u nisur edhe nga detyrimet e CEFL në kapitullin “*Mbi marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve*”¹⁷⁰, ku noteri ka funksione edhe këshilluese dhe orientuese për pasojat, të

¹⁶⁵ Commission Européenne, General Direction Justice And Home Affaires, (2001), *Study on Matrimonial Property Regimes, and the Property of Unmarried Couples*, in *Private International Law and Internal Law*, National Report, Sweden, Pg. 11-13.

¹⁶⁶ Nielsen L., (2001), “*Study on matrimonial property regimes and the property of unmarried couples in private international law and internal law*” Juridiske Fakultete, Kobenhavens Universitet, faqe 6.

¹⁶⁷ Po aty, faqe 9

¹⁶⁸ De Rubertis, G. (1975). “*Le convenzioni matrimoniali in generale*”. Vita Notarile, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo: Buttitta Edizioni Giuridice, fq. 940

¹⁶⁹ Neni 63 i ligjit 110/2018, “*Për noterinë*” i ndryshuar.

¹⁷⁰ Parimi 4:13 “*CEFL principles regarding property relations between spouses*”

dy bashkëshortëve ose veçmas, por në mënyrë më të detajuar këtë fazë do ta sqarojmë në aneksin e këtij punimi: “Si të shkruajmë një kontratë martesore?” të këtij punimi.

4.3.5. Autoriteti publik në formalizimin e kontratës së martesës

Kodi i Familjes i 2003-it, për sa i përket formës së kontratës martesore në kapitullin e regjimeve pasurore martesore në Kreun I, neni 69, parashikon që kontrata martesore bëhet me akt noterial.

Jo çdo lloj vullneti i shprehur prej palëve lidhur me regjimin ka vlerë dhe sjell pasoja juridike. Nëse bashkëshortët e ardhshëm dëshirojnë të kenë një regjim me kontratë, për përpilimin e kontratës dhe shprehjen e vullnetit duhet të paraqiten tek një zyrë noterie me qëllim që noteri të redaktojë një akt noterial lidhur me regjimin me kontratë. Ky formalitet nuk ekziston nëse bashkëshortët e ardhshëm vendosin për regjimin e bashkësisë ligjore. Neni 69 i Kodit të familjes nënvizon se kontrata martesore bëhet me: *“akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre”*.

Sipas ligjit 110/2018 “Për Noterinë” (i ndryshuar) i vetmi person përgjegjës dhe kompetent për redaktimin dhe hartimin e akteve noteriale është noteri (neni 4 e në vazhdim).

Çdo marrëveshje tjetër e bërë nga përfaqësuesit e palëve ose vet palët, pa praninë e noterit dhe jo në formatin e një akti noterial nuk ka asnjë vlerë juridike. Prania e noterit i jep aktit vlefshmëri juridike dhe siguri që akti është hartuar nga një jurist (sepse vetëm juristët mund të ushtrojnë profesionin e noterit) që nënkupton se ka njohuri të duhura për ligjin, masën e diskrecionit të palëve për vetëvendosje në një marrëveshje e cila është jo si të gjitha kontratat e tjera dhe kujdesin ndaj parimeve që lidhen me interesin publik apo

dispozitat impeative të cilat nuk mund të cënohen nga asnjë vullnet. Noteri është siguria që çdo regjim me kontratë të mos vijë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të familjes dhe parimet e legjislacionit në fuqi. Noteri ka detyrimin të sqarojë palët mbi pyetjet apo paqartësitë që ato mund të kenë¹⁷¹. Kjo garanton edhe një herë mosdevijimin nga disa të drejta dhe detyrime nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.

Pra, kodi ka përcaktuar qartazi rregullat që kanë të bëjnë me aspektet formale dhe thelbësore të kontratës lidhur me regjimin pasuror duke u ndalur në ato aspekte formale dhe thelbësore të cialt nuk mund të cënohen ose të modifikohen. Në çastin e nënshkrimit të kontratës, noteri i lëshon palëve një akt noterial, i cili përmban identitetin e plotë, adresën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe datën e lidhjes së kontratës. Noteri ka detyrimin të depozitojë kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës. Në qoftë se në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore¹⁷². Këtu duhet të përmendet fakti se në Regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile nuk gjen një hapsirë të lejuar në lidhje me regjistrimin e kontratës së martesës. Këtu noteri gjendet në vështirësi për të formalizuar kontratën e martesës dhe për të zbatuar urdhërimet e ligjit. Ndryshe nga shtete të tjera në të cilat gjen hapsirë në regjistrin e martesave, konkretisht në Norvegji është një seksion i posaçëm, ku përveç regjistrimit të të dhënave të bashkëshortëve në martesë, vendoset edhe kontrata e martesës si informacion¹⁷³. Po ashtu Franca detyron noterin që të lëshojë një vërtetim në lidhje me ekzistencën e kontratës së

¹⁷¹ Ieva, M. (2012). “*Le convenzioni matrimoniali*”, Seconda edizione Milano: Giuffrè. Në “*Il regime patrimoniale della famiglia*”, fq. 77-78.

¹⁷² Kodi i Familjes, (2003), neni 69.

¹⁷³ Merckoll E, “*Family law in Norway*”, (2017), faqe 12

martësës, që në ditën e martësës së çiftit, ku ky vërtetim të jetë në dosjen para oficerit të Zyrës së Gjendjes Civile¹⁷⁴.

Qëllimi kryesor, për të cilin kemi të parashikuar formën noteriale, për kontratën martësore, është mbrojtja e palëve kontraktore. Nëpërmjet formës noteriale dhe pjesëmarrjes së njëkohshme të të dy bashkëshortëve ose përfaqësuesve të tyre për lidhjen e kontratës martësore, duket që ligjvënësi ka dashur të bëjë të mundur që bashkëshortët të kuptojnë “pasojat” që mund të sjellë për to zbatimin i regjimit ligjor dhe zbatimin i regjimit të ri kontraktor si dhe të realizojë një shprehje reale dhe serioze të vullnetit të tyre, të pandikuar nga faktorë të tjerë¹⁷⁵.

Gjithashtu vihet re imponimi, jo vetëm i formës që është ajo e nivelit më të lartë të provueshmërisë para noterit, por kërkohet edhe regjistrimi në regjistrat publik. Faza e fundit ka të bëjë me publicitetin e veprimit juridik, në rastin kur kontrata prek interesat e palëve të treta *ratio* i ligjvënësisë ka qënë mbrojtja e tyre nga ndryshimet e mundshme në lidhje me titujt e pronësisë apo në lidhje me subjektet e marrëdhënies juridike të pronësisë.

Në interpretim të paragrafit të III dhe të IV të nenit 69 të Kodit të Familjes, duket se është detyrim për regjistrimin e kësaj kontrate në regjistrat publik të Zyrës së Gjendjes Civile, para lidhjes së kontratës për kontratat paramartësore dhe menjëherë për kontratat *post-martësore*¹⁷⁶. Në interpretim të paragrafit të IV të nenit 69 të Kodit të Familjes, mospasja e një kontrate për regjimin pasuror ndërmjet bashkëshortëve në ditën e lidhjes së martësës, bashkëshortët do të hynë në martesë me regjimin e propozuar nga ligji. Por kjo nuk prek

¹⁷⁴ Guchet L. (2010) “Contrats de mariage regimes matrimoniaux”, Botimi i II, Shtëpia Botuese Puits Fleuri, Francë, faqe 43.

¹⁷⁵ De Rubertis, G. (1975). “*Le convenzioni matrimoniali in generale*”. Vita Notarile, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo: Buttitta Edizioni Giuridice, fq. 940.

¹⁷⁶ Neni 72 i Kodit të Familjes.

vlefshmërinë e kontratës së martesës sepse në elementet ligjorë, kontrata e martesës është tërësisht e rregullt, por nuk sjell pasojat juridike të kërkuara nga palët për efekt të mosplotësimit të kushtit të publicitetit¹⁷⁷. Vlefshmëria është kusht i cili e bën të ligjshëm ose jo veprimin dhe kërkon kushtet përkatëse për të qenë i saktë dhe i plotë regjistrimi në regjistrat public i cili nuk ka të bëjë me vlefshmërinë, por ka të bëjë me anën deklarative të një veprimi juridik.

Ndër të tjera publiciteti i kontratës së martesës, gjendet edhe në nenin 71 të Kodit të Familjes¹⁷⁸, sipas të cilit noteri është i detyruar ta regjistrojë edhe në Qendrën Kombëtare të regjistrimit të Biznesit (QKB), në rast se njëri nga bashkëshortët ka aktivitet tregtar. Duke marrë në konsideratë se në objektin e kontratës së martesës rregullohen edhe pasuritë e bashkëshortëve (me rezervë sipas llojit të regjimit që zgjedhin), atëherë legjislatori duhet të kishte parashikuar edhe detyrimin për ta regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme, pasi është e nevojshme që për qarkullimin civil të sendeve, të bëhet publiciteti i duhur. Duke marrë shkas që e gjejmë në vendet e Evropës këtë detyrim, në Kodin Civil Belg¹⁷⁹, po ashtu edhe sipas legjislacionit Italian, gjendet detytimi i noterit për të depozituar në regjistrin e pasurive të paluajtshme ndryshimet në lidhje me kontratën e martesës¹⁸⁰. Parashikimi i kësaj dispozite mbron kryesisht të tretët dhe shmang çdo pasojë që mund të vijë nga mungesa e informacionit për statusin e pronës apo numrin e bashkëpronarëve.

¹⁷⁷Omari, S. (2012). *E drejta familjare: Shtëpia Botuese Morava*, Tiranë, fq. 91.

¹⁷⁸ Neni 71 Në qoftë se një nga bashkëshortët ushtron veprimtari tregtare, ndryshimet në kontratën e martesës lidhur me veprimtarinë tregtare duhet të depozitohen, në çdo rast, edhe në regjistrin tregtar. Efektet për personat e tretë fillojnë nga çasti i depozitimit të ndryshimit, parashikuar në paragrafin e parë.

¹⁷⁹ Neni 1399 Kodi Civil Belg

¹⁸⁰ Neni 2236 Kodi Civil Italian

4.3.6. Kufizimet

Pas analizës së detajuar të subjekteve në tërësi të marrëdhënieve juridike civile dhe analizës së subjekteve të martesës, është e lehtë të nxjerrim karakteristikat e subjekteve të kontratës së martesës të cilat kanë këto karakteristikat të posaçme:

Së pari, këto subjektë janë vetëm bashkëshortë, askush tjetër nuk mund të lidhë kontrata martese përveç se bashkëshortët, të cilët janë në marrëdhënien e posaçme të martesës dhe në kuadër të përcaktimit të regjimit martesor vazhdojnë të jenë bashkëshortë dhe lirisht mund ta ndryshojnë regjimin nga ai i bashkësisë ligjore në atë me kontratë. Pra, në cilëndo lloj situate të lidhjes së kontratës së martesës, subjektet janë vetëm bashkëshortët e si të tilla këto subjekte nga statusi i posaçëm i tyre janë të kufizuar në numër. Herë pas here na shfaqet edhe pala e tretë për të cilin kontrata nuk sjell pasoja të drejtëpërdrejta, por për realizimin e qëllimit të saj duhet edhe kontributi i një pale të tretë, ku në rastin e kontratës së martesës kjo është një teori e cila nuk gjen mbështetje pasi në cilëndo rrethanë palët e treta do të rregullojnë marrëdhëniet juridike me anë të kontratave të tjera të parashikuara në kodin civil¹⁸¹.

Së dyti, është dukshme për rrjedhojë edhe të parimit të monogamisë si dhe analizës së mësipërme në lidhje me martesën, numri i subjekteve në kontratë është dy: i kufizuar i përcaktuar. Siç e thamë, sipas legjislacionit tonë martesa lejohet vetëm nëse bashkëshortët kanë *status libertatis*, duke kuptuar kështu se nuk mund të jetë e vlefshme një martesë me shumë burra dhe shumë gra, në cilindo lloj kombinacioni të jetë¹⁸².

¹⁸¹ De Rubertis, G. (1975). "*Le convenzioni matrimoniali in generale*". Vita Notarile, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo: Buttitta Edizioni Giuridice, fq. 940.

¹⁸² Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*, Tiranë, fq. 222.

Së treti, duke qënë se janë vetëm bashkëshortë dhe në përmbledhje të analizës më lart është e dukshme se mosha për lidhjen e kësaj kontrate është mosha 18 vjeç ashtu siç legjislacioni e kufizon subjektin në lidhjen e martesës, përveç përjashtimit që analizuam më lart. Ndërkohë në lidhje me kontratën e martesës ka një përjashtim, pasi është e sanksionuar shprehimisht se nëse bashkëshortët lejohen nga Gjykata të martohen, nuk mund të lidhin kontratë martese dhe regjimi i tyre është vetëm ai i bashkësisë ligjore. Kështu kodi i familjes në nenin 70 të tij parashikon si të detyrueshme zbatimin e regjimit pasuror të bashkësisë ligjore në rastin e martesës së të miturit. Në qoftë se bashkëshortët do duan që ta ndryshojnë këtë regjim pasuror, ata mund ta bëjnë vetëm pasi të kenë mbushur moshën 18 vjeç¹⁸³.

Cila është arsyeja e këtij kufizimi që bën legjislatori? Sipas doktrinės *ratio leges* në këtë rast ka qënë për të mundësuar një lloj sigurie dhe garancie në lidhje me ekonominë e familjes. Legjislatori në këtë mënyrë synon të mbrojë sa më mirë interesat e të miturit duke mos e emancipuar atë në këtë pjesë të normave të së drejtës familjare pavarësisht se sipas Kodit Civil fiton zotësinë e plotë për të vepruar, pra edhe në fushën kontraktore. Ky tregon kujdes edhe një herë se kontrata e regjimit pasuror nuk është një kontratë e zakonshme dhe kjo është arsyeja që ka një kujdes të veçantë në pjekurinë intelektuale që detyrimisht varet dhe nga mosha¹⁸⁴.

Së katërti, subjektet e kontratës së martesës janë vetëm persona fizik dhe jo persona juridik. Vlen të behët ky dallim, pasi nga emri i institutit të së drejtës “kontratë martese”, do të mendonim që në kontratë mund të marrin pjesë çdo subjekt i së drejtës, por përcaktimi

¹⁸³ Neni 70 i Kodit të Familjes.

¹⁸⁴ Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*, Tiranë, fq.223.

“martese” nga pas kufizon këtë pjesë përse i përket llojit të marrëdhëies juridike siç është martesa. Kjo e fundit ka në përmbajtje të saj elemente sociale, psikologjik, shpirtërore që ndërthuren ndërmjet tyre me qëllimin për krijimin e familjes. Në funksion të këtyre elementëve personat mund të jenë vetëm fizik, pasi janë vetëm ata që ju atribuohet mundësia për t’u martuar.

Gjithashtu kusht tjetër për lidhjen e martesës është edhe gjendja mendore e bashkëshortëve e cila kërkohet të jetë e nivelit dhe mundësisë për të kuptuar rëndësinë e lidhjes së martesës dhe pasojat që vijnë prej saj. Pra si rregulli i përgjithshëm për subjektet e së drejtës edhe subjekti i martesës duhet të plotësojë këto kushte. Janë dy parime kryesore që kushtëzojnë subjektet në lidhjen e martesës, parimi i heteroseksualitetit dhe parimi i monogamisë. I pari kushtëzon seksin e bashkëshortëve të ardhshëm, ku martesa sipas legjislacionit tonë është lidhja ndërmjet një burri dhe një gruaje dhe së dyti numrin e tyre vetëm “një” burrë dhe vetëm “një” grua.

Parimi i monogamisë nuk është një parim i ri për të drejtën familjare¹⁸⁵. Rëndësia dhe ekzistenca e tij nënvizohet në pjesë të ndryshme të Kodit të Familjes si: “martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje...”¹⁸⁶; “nuk mund të lidhë martesë të re personi që është i martuar¹⁸⁷; “martesa e lidhur gjatë vazhdimit të një martese të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve është e pavlefshme”. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë lidhje me institutin e martesës, një martese e realizuar midis një burri me dy (bigamia) ose më shumë gra (poligamia) dhe një gruaje me dy ose më shumë burra (poliandria). Monogamia është një parim me vlerë themelore për të drejtën tonë familjare dhe martesore, respektimi i të

¹⁸⁵ Begeja, K. (1985). “*E drejta familjare e RPSSH*”, Botimi i parë, Tiranë, faqe 97, 111

¹⁸⁶ Neni 7 i Kodit të Familjes.

¹⁸⁷ Neni 9 i Kodit të Familjes.

cilit është i detyrueshëm. Por, ky parim ligjor ka cënimet e veta në jetën e përditshme, ku ndonëse ligjërisht respektohet parimi i monogamisë, në fakt jeta e shumë personave, qoftë burra apo gra, endet në raporte “bi” dhe poli” jashtë martesore, të cilat shpesh herë bëhen kërcënim serioz për kualitetin emartësës dhe të jetës familjare të qëndrueshme e krijuar prej martesës¹⁸⁸. Gjithashtu, nga një interpretim *per a contrario* i nenit 9 të kodit të familjes, rezulton se statusin e personit që mund të lidhë martesë *status libertatis* të re e gëzon personi, martesa e mëparshme e të cilit është shpallur e pavlefshme ose martesa e të cilit është zgjidhur.

Të gjitha opsionet e zgjerimit të parimit të parë deri më sot kanë mbetur vetëm kuadrin e propozimeve apo diskutimeve dhe nuk kanë marrë asnjë lloj forme ligjore për të konkluduar në martesën e personave me të njejtin seks, duke pranuar kështu në ligj martesën homoseksuale. Prirja është për të ndryshuar këtë parim, ndërsa në lidhje me parimin e dytë nuk pritet ndonjë progres pasi martesa me më shumë se dy aktorë është konsideruar regres dhe është njohur si fenomen në shoqëritë primitive, duke rikujtuar këtu poligaminë të ndarë në *poliandri* dhe *poligini*.

Teoria e së drejtës bën dallimin midis kushteve dhe ndalesave për martesë, ndonëse të dyja lidhen me zotësinë për martesë. Kështu si kushte për martesë quhen ato elemente thelbësore të përgjithshme, mungesa e të cilave bën që martesa të jetë e pavlefshme. Kushtet janë elemente me ngarkesë positive, të cilat duhet të përmbushen, të ekzistojnë, të plotësohen prej bashkëshortëve të ardhshëm. Pra, kjo do të thotë se rendi juridik i ka përcaktuar këto kushte si elemente thelbësore të përgjithshme. Sipas këtij përkufizimi rezultojnë se të tilla janë edhe elementet e formës dhe të përmbajtjes, si: mosha (neni 7), pëlqimi për martesë

¹⁸⁸ Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*, Tiranë, fq .91.

(*affectio maritalis*) (neni 8) dhe forma e kërkuar ligjore¹⁸⁹. Lidhur me pengesa ose ndalesat, ato interpretohen si elemente individuale, ekzistenca e të cilave duhet të verifikohet dhe të kontrollohet rast pas rasti, por nëse ekzistojnë e bëjnë martesën të pavlefshme. Pra, nëse do të shpreheshim në mënyrë figurative, këto janë elementet me ngarkesë negative, që përcaktohen ose sanksionohen si të tilla nga ligji. Kjo do të thotë se, për të realizuar një martesë ato nuk duhet të ekzistojnë, sepse ekzistenca e tyre e pengon lidhjen e martesës, e ndalon lidhjen e saj. Pra, kushtet janë të përgjithshme, ndësa ndalesat janë konkrete. Ato lidhen me një person të caktuar në një rast konkret, me një individ konkret, pavarësisht se si rezultat, pasojat e mospërmbyshjes së të parave dhe të ekzistencës së të dytave janë të njëjta, të cilat sjellin pavlefshmëri të martesës¹⁹⁰. Në trajtimin e elementëve kryesorë të kontratës së martesës, u hasën shpesh ndalesa për të cilat kujdeset ligji dhe themi që s'mund të kalojë më tej kontrata e martesës pasi kufizohet nga kritere të rëndësishme të vendosura në ligj.

Fillimisht është e nevojshme të sqarojmë se si veprim juridik, vjen në radhë të redaktimit të saj nëse ka një martesë mes bashkëshortëve dhe normalisht kufizohet në lloj të tij nga martesa. Nga ana tjetër ligji kujdeset gjatë gjithë kohës të vendosë kufij të tjerë që duket sikur janë në mbrojtje të marrëdhënies specifike familjare dhe për të mos lejuar materializimin tërësor të qëllimit të martesës. Kontrata e martesës është veprim juridik *sui generis*, duke qënë se kushtëzohet nga ekzistenca e vetë martesës, lloji i marrëdhënies juridike që ka natyrë të veçantë dhe merr karakteristika specifike nga veprimet e tjera juridike. Kushtëzimi që i bëhet kontratës së martesës nga instituti i martesës është lehtësisht

¹⁸⁹Shih kreu II, neni 15 e vijues të Kodit të Familjes.

¹⁹⁰ Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*, Tiranë, fq.100-101.

i parashikueshëm për atë kohë sa kontrata e martesës lind në shërbim të martesës dhe jetës familjare, në rregullimin e mbarëvajtjes së ekonomisë familjare dhe në organizimin e kësaj të fundit. Mënyra se si ndikon martesë tek kontrata e martesës e kemi trajtuar edhe më lart dhe nuk është e nevojshme t'i rikthehemi sërish.

Rëndësi specifike në lidhje me kufizimet merr ajo që është e parashikuar në ligj si kushtëzim dhe si i tillë duhet përmendur *që në objektin e kontratës së martesës* (neni 66 dhe 67 Kodi i Familjes) së pari, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me ligjin¹⁹¹ dhe së dyti, kontrata e martesës nuk mund të ndryshojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, përgjegjësinë prindërore, rregullat e administrimit ligjor dhe kujdestarinë.

Për sa i përket detyrimit të parë nuk duhet të bjerë ndesh ligjit që është mjaft përgjithësues dhe duket sikur jemi tërësisht të lirë me lirinë kontraktore dhe bashkëshortët mund të bëjnë çfarë të duan me kontratën e martesës ashtu siç do të mund të bënin në kontrata të tjera. Ndërkohë do të vëmë re se nuk mund të negociojmë çfarë të duam në kontratë dhe rastet shpëruese se kur nuk mund të flasim në kontratë për këtë, kanë të bëjnë me vijimin e dispozitave më poshtë.

Detyrimi për besnikëri, ndihmë dhe bashkëpunim; Mbiemri i bashkëshortit; Mbiemri i fëmijëve; Detyrimi ndaj fëmijëve; Kontributi i bashkëshortëve; Vendbanimi i bashkëshortëve; Largimi nga vendbanimi; Pëlqimi i bashkëshortit; Autorizimi i gjykatës; Autorizimi i përfaqësimit; Disponimi i të ardhurave; Administrimi i sendeve vetjake; janë të drejta-detyrim të cilat rrjedhin nga lidhja e martesës, si të tilla në rast se me kontratën e martesës do të rregullonim një nga këto dhe do të ndryshonin me marrëveshje bashkëshortët mënyrën se si i duan pasojat nga lidhja e martesës do të ishte në mënyrë të

¹⁹¹Sanatoro – Passarelli, (1961) “*L'autonomia privata nel diritto di famiglia*”, volumi I, Napoli, faqe 386

pashmangashme e paligjshme. Kontrata e martesës nuk mund të depërtojë aty ku martesë ka themelet e saj dhe në bazë të këtyre kriterëve mban institutin e martesës të ngritur. Nëse do të lihej në vullnetin e lirë të bashkëshortëve do të kishte në kontratën e martesës dispozita abuzuese, të cilat do të bënin që bashkëshortët të devijonin nga qëllimi i lidhjes së martesës dhe nga objekti i martesës duke e cënuar haptazi këtë institut.

Nëse bashkëshortët do të fillonin të sanksiononin në kontratë se njëri heq dorë nga ndihma reciproke dhe bashkëpunimi, apo se do të lejojnë lirisht të thyejnë kurorën bashkëshortore dhe këtë ta promovojnë në kontratë, atëherë kjo do të cënonte edhe rendin juridik në prishjen e ekuilibrave të vendosur me ligj për ruajtjen e familjes. Martesa nuk mund të jetë e rregulluar me kontratë, pasi është e panegociushme dhe bie ndesh me çdo parim të së drejtës për institute me kaq rëndësi, prandaj mbrohen me ligj dhe gëzojnë status të posaçëm, ku mekanizmat ligjorë angazhohen t'u vijnë në ndihmë subjekteve të së drejtës për të qënë të gjithë të barabartë dhe në rast se do të lejonin të ndërhyjnë dhe në detyrimet e martesës do të cënohej mbase edhe barazia gjinore, përgjegjësia prindërore, interesi më i lartë i fëmijës, etj.

Kujtojmë kështu KEDNJ, në vijim Kushtetutën, ligjin special që rregullon marrëdhëniet familjare Kodi i Familjes, ku gjithmonë thuhet se martesë dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ligji. Prandaj hasim gjatë gjithë kohës ndërprerje të lirisë kontraktore në lidhje me objektin e kontratës të martesës, ku ligji angazhohet direkt që të mos lejojë shkelje të parashikimeve bazë. Me të drejtë ligjvënësi ka vendosur që mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore mos ta lërë të negociushme në kontratë, duke e përjashtuar nga objekti i kontratës së martesës pasi fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe në çdo ligj ku rregullohen marrëdhënie me fëmijët i rikujtohet zbatuesit të së drejtës se duhet të mbajë në

konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve dhe këtë nuk mund ta lërë në dorë të bashkëshortëve për të rregulluar raportet e tyre me fëmijët nëpërmjet kontratës. Gjithashtu në lidhje me rregullat e administrimit ligjor, kemi të bëjmë jo vetëm në mbrojtje të bashkëshortëve në martesë dhe mbrojtjen e institutit të martesës, por kjo e fundit lidhet me vullnetin e bashkëshortëve e cila s'mund të prishë ekulibrat e rendit juridik pasi në lidhje me të tretët përfaqësimin, detyrimin dhe çdo angazhim që mund tu lind bashkëshortëve në kryerjen e veprimeve juridike nuk mund të shmanget nëpërmjet kontratës. Së fundmi instituti i kujdestarisë me po aq rëndësi sa të gjithë të tjerët, nëse do të rregullohet me kontratën e martesës duke vënë të drejta dhe detyrime për subjektet e kujdestarisë, do të cënonte thelbin e vetë kujdestarisë dhe ndër të tjera do të nxiste abuzimin.

Një kufizim që haset në ligj në lidhje me kontratën e martesës është në nenin 7, 70 të Kodit të Familjes, neni 7 Kodi Civil, të cilët në interpretim të kombinuar na lënë të kuptojmë qëllimin e ligjvënësisë. Një ndër kushtet thelbësore të lidhjes së martesës është mbushja e moshës 18 vjeç, por legjistatori ka vendosur hapsira të tjera, ku për shkaqe objektive mund të lejojë lidhjen e martesës para mbushjes së kësaj moshe, siç parashikohet në nenin 6 të Kodit Civil. Se kush do ta vlerësojë këtë shkak objektiv dhe do të shprehet me një vendim, kjo nuk përcaktohet. Kodi i Familjes thotë se do të jetë Gjykata ajo e cila do të lejojë lidhjen e martesës. Nga këto dispozita na rezulton se me lidhjen e martesës, ky person fiton zotësinë e plotë për të vepruar dhe Kodi Civil, në paragrafin e dytë shprehet se ky subjekt nuk e humbet këtë zotësi edhe në rast se martesë zgjidhet ose shpallet e pavlefshme. Pra, është e dukshme se zotësia e plotë për të vepruar fitohet, pasi lidhet martesë dhe martesë lidhet në Zyrën e Gjendjes Civile dhe deri në atë moment llogaritet koha e kryerjes së procedurave të tjera. Vendimi i gjykatës në kuptim të thjeshtë heq kufizimin e moshës së

bashkëshortëve të ardhshëm, por nuk jep akoma zotësinë e plotë për të vepruar. Prandaj arrijmë në konkluzionin se arsyeja se pse ligjvënësi ka imponuar formulën e regjimit të bashkësisë ligjore në këtë rast për mosmbushje të moshës madhore, por nga ana tjetër për veshjen me zotësi të plotë për të vepruar, mund të justifikohet vetëm me kohën e lidhjes së kontratës së martesës.

Më qartë, me marrjen e autorizimit në Gjykatë, për lejimin e lidhjes së martesës, pa mbushur moshën e zotësisë së plotë për të vepruar, bashkëshortët nuk kanë akoma zotësi të plotë për të vepruar. Ndërkohë nëse duan të zgjedhin regjimin me kontratën e martesës duhet të drejtohen tek noteri për të redaktuar kontratën e martesës. Duke qenë se kjo e fundit është veprim juridik formal dhe solemn dhe do të redaktohet para autoritetit publik, noteri duhet të sigurohet për zotësi të plotë për të vepruar, që të legjitimojë lidhjen e kontratës dhe të konsiderojë të mundshme kryerjen e veprimit juridik. Edhe pse në këtë faze bashkëshortët kanë një vendim gjykate që mund të lidhin martesë për shkaqe objektive të vlerësuar nga ajo vetë, është hapsira kohore ku akoma nuk e kanë lidhur martesën, pasi bashkëshortët e ardhshëm mund të vendosin të mos e lidhin martesën për shkaqe të tjera, sepse nuk janë të detyruar që apriori ta lidhin martesën vetëm nga autorizimi i gjykatës. Është mjaft e qartë se bashkëshortët e ardhshëm me lidhjen e martesës e fitojnë zotësinë e plotë për të vepruar, deri në atë çast kur autorizimi i Gjykatës i zhvesh ata vetëm nga kushti detyrues i mbushjes së moshës, por nuk i zhvesh nga ndalesa të tjera të sëmundjes psiqike, të pëlqimit të lirë apo lidhjes gjinore, që do të vlerësohen në një moment tjetër.

Për ta kuptuar më qartë, mund ta ilustrojmë me një shembull të thjeshtë. Në rast se njëri nga bashkëshortët e ardhshëm ndërron jetë para lidhjes së martesës, bashkëshorti i ardhshm gjallë nuk e fiton zotësinë e plotë për të vepruar, pasi këtë do ta merrte vetëm me

autorizimin e Gjykatës për të lidhur martesën dhe pasi ta ketë lidhur këtë do të vijë pasojat.

Rikujtojmë sërish se duke qënë veprim juridik sui generis nuk i shmanget të veçantave dhe reagon ndryshe nga veprime të tjera juridike, rast pas rasti duhet të marrim në vlerësim gjithmonë kushtëzimin që ka kjo kontratë ndryshe nga kontratat e tjera. Po t'i referohemi vendeve të tjera që e kanë të zhvilluar kontratën e martesës në praktikë si dhe legjislacionit të tyre në këtë fushë, konkretisht në Belgjike¹⁹², parashikohet se të miturit jo vetëm që mund të lidhin kontratë martese pasi kanë marrë autorizimin në Gjykatën Rinore, e quajnë ata, por edhe mund të bëjnë ndryshime deri në momentin e lidhjes së martesës në kontratë para noterit. Kjo është për faktin se ata e paraqesin të mundshme lidhjen e kontratës për atë kohë sa lejohet lidhja e martesës dhe subjekti vishet me përgjegjësi të plotë për të vepruar.

Kufizim tjetër që ka hasur praktika dhe vetë subjektet e së drejtës së martesës, ka qënë për faktin se bashkëshortët nuk mund ta ndryshojnë regjimin e tyre pa kaluar 2 vite nga lidhja e martesës. Origjina e kësaj ndalese vjen si garanci për ekonominë familjare, duke u zhvilluar me një formë fillimisht dhe pasi të jetë konkluduar rezultati mund të ndryshohet. Duke qënë se me hyrjen në një lloj regjimi do të aplikohet formula për pasuritë në qarkullim civil do të vendoset një lloj stabiliteti ekonomik dhe të tretët janë njohur me këtë lloj regjimi ku ndryshimi i menjëhershëm do të sjellë pasojë dhe bashkëshortët mund t'i shmangen detyrimeve. Në rast se bashkëshortët kanë hyrë me regjimin e bashkësisë ligjore, ata paraqiten të dy së bashku në kryerjen e veprimeve juridike në lidhje me të tretët. Këto të fundit duhet të sigurohen për titullin e pronësisë dhe të mund të hyjnë në marrëdhënie juridike me subjektet. Në rast se e fillojnë martesën me regjimin me kontratë, përfaqësimi i

¹⁹² Neni 1309, Kodi Civil Belg.

secilit do të jetë sipas dispozitave që kanë përcaktuar bashkëshortët në kontratë dhe prandaj është e nevojshme që ata të paraqiten së bashku me kontratë për të provuar tagrat përkatëse mbi sendet objekt të veprimit juridik.

Është e dukshme se ligji kujdeset për të dy palët në të njëjtën mënyrë dhe për bashkëshortët dhe për të tretët. Kalimi nga njëri regjim në tjetrin për periudha të shkurtra dhe i pajustificuar do të sillte kaos në përcaktimin e titullarit të së drejtave në pasuritë objekt të transaksionit. Prandaj kushti dyvjeçar nga lidhja e martesës, është pikërisht për pasojat juridike në lidhje me pasuritë në qarkullim, i cili nga momenti që hyn në transaksione dhe deri në përfundim të destinacionit i duhet një kohë për këtë kalim.

Kontrata e martesës nuk kushtëzohet vetëm për atë çfarë është e ndaluar shprehimisht në ligj, por edhe për elemente të cilat nuk mund të sanksionohen në kontratën e martesës si lloj i veprimit juridik, duke qenë se ky veprim derivon nga martesë dhe kryesisht do të kushtëzohet nga martesë.

4.4. Fuqia juridike

4.4.1. Veprimi i saj në kohë

Gjatë hulumtimit, jam hasur me përdorimin e terminologjive të ndryshme në lidhje me marrëveshjet e bashkëshortëve për regjimin pasuror martesor. Një ndër përdorimet më të rëndësishme në bazë të kohës se kur redaktohet ky akt, referuar datës së lidhjes së martesës, doktrina njihet “kontrata para-martesorë” dhe “kontrata pas martesës”. Këto dy terminologji kanë lidhje me kohën kur lidhet kjo kontratë, që do të thotë në grupin e parë bashkëshortët e ardhshëm vendosin paraprakisht se si do të jetë regjimi i tyre martesor pasi kontrata formulohet para lidhjes së martesës ku normalisht ky akt ka fuqi juridike nga lidhja e

martësës e në vijim¹⁹³, ndërsa në grupin e dytë kemi të bëjmë me rastin kur bashkëshortët janë të martuar me regjimin e bashkësisë ligjore dhe kërkojnë ta ndryshojnë këtë duke kaluar në regjimin me kontratë. Në legjislacionin tonë nuk e gjen një dallim të tillë dhe të kësaj natyre duke e bërë më të vështirë identifikimin, por në përmbajtje të dispozitave që rregullojnë regjimet pasurore martesore, në interpretimin e tyre të kombinuar mund të gjejmë dallimin e këtyre dy koncepteve.

Për të qënë më të qartë në këto dy terminologji, do të krahasojmë shtetet e Common Law që e kanë shumë të dukshme këtë lloj dallimi dhe do të arrijmë deri tek legjislacioni i Republikës së Shqipërisë ku për efekt studimi ka rëndësi ta identifikojmë edhe në Kodin e Familjes këtë rast. Në shtetet e Bashkuara të Amerikës, e gjejmë shumë të zhvilluar konceptin e kontratave para-martësore dhe atyre pas-martësore, të ndara si terminologji dhe dallimin e përdorimit të tyre. Në këto vende gjejmë dallimin jo vetëm për kohën se kur lidhen këto kontrata, por edhe faktin se përmbajtja e tyre ndryshon deri diku, duke qënë se me kontratën pas-martësore, bashkëshortët mund të shprehen edhe për mënyrën se si do të ndahen pasuritë e vendosura nga lidhja e martësës deri në momentin e ndryshimit të regjimit¹⁹⁴. Këto koncepte janë shumë të zhvilluara edhe në Mbretërinë e Bashkuar, ku fuqia juridike e kontratave ndryshon në Angli dhe Uells konsiderohen jo të detyrueshme, ndërsa në Skoci (që ka një sistem ndryshe nga dy të parat), kanë fuqi ligjore gati detyrueshme të zbatueshme. Subjektet e marrëveshjeve martesore, janë më të lirë në redaktimin e kontratave të martësës dhe në Gjykatë vlerësohet vetëm nëse përmbajtja e marrëveshjes mos të bjerë ndesh me rendin juridik si dhe mos të çënohet bashkëshorti më i

¹⁹³ Morley D. J., (2011), *International Prenuptial Agreements*, faqe 42

¹⁹⁴ Kadish J. (2006) “*Pre- and postnuptial agreement tips and traps*”, revista “In brief”, faqe 98.

dobët financiarisht. Në lidhje me interesin tonë të kontratave para dhe pas martesore, qëndrimi që mbajnë në Mbretërinë e Bashkuar ka të bëjë me faktin se këto dy koncepte ndryshojnë vetëm me kohën e lidhjes së kontratës si dhe për faktin se kontratat pas martesës bëhen edhe pasi bashkëshortët të kenë kaluar pak kohë sëbashku dhe të kenë konfirmuar martesën¹⁹⁵. Pra, sic vihet re kontratat *para* dhe *pas* martesore kanë ndryshime shumë të vogla që kanë të bëjnë me kohën kur marrin fuqi juridike dhe deri diku me ndonjë ndryshim në përmbajtje për vetë kushtëzimin që subjektet e kontratës pas martesore tashmë janë në martesë. Kështu po të kthehemi në legjislacionin tonë vëmë re ndryshimin në kontratën para-martesorë në nenin 69 të Kodit të Familjes dhe në nenin 72 të Kodit të Familjes kontrata pas-martesorë. Por sipas legjislacionit tonë, ndryshimi është kohor normalisht, duke qënë se fuqia juridike e kontratës para-martesorë është në momentin që lidhet martesa, ndërsa kontrata pas-martesorë kushtëzohet nga disa kriterë ligjorë që bashkëshortët duhet të ndjekin për të ndryshuar regjimin pasuror martesor¹⁹⁶.

Është mjaft e qartë se kontrata e martesës ka një datë fillimi të përcaktuar, por nuk mund të përcaktojmë përfundimin e saj ose të paktën nuk mund ta kushtëzojmë, pasi kjo do të binte ndesh me parimet e së drejtës familjare në lidhje me martesën, duke e kushtëzuar dhe kthyer martesën në një formalitet të materializuar Nisur nga ajo sa kemi sqaruar, për sa i përket lidhjes së ngushtë të kontratës së martesës me martesën, normalisht që ky veprim juridik është në shërbim të veprimit kryesor, është e qartë se rastet e mbarimit të martesës, duhen konsideruar dhe mbarimi i rregullimit të pasurive sipas kontratës së martesës.

¹⁹⁵ Fairbairn C. "Pre-nuptial agreements", Revista Numër 03752, 21 June 2017

¹⁹⁶ Mandro A. (2009), "E drejta familjare"(2009), Botimi I Parë, faqe 224

Kontrata e martesës nuk mund të ketë një afat tjetër fillimi, përveç atij të fillimit të martesës. Në rastin kur bashkëshortët hyjnë me regjimin ligjor dhe pas 2 vitesh vendosin ta ndryshojnë atë, nuk mund të parashikojnë në kontratë që kjo e fundit hyn në fuqi pas 5 vitesh. Kjo ndalesë bëhet për mbrojtje të të tretëve¹⁹⁷.

Sërish po t'i drejtohem vendëve të Common Law, që janë mjaft liberale në këto marrëveshje, ligji i tyre nuk parashikon një datë mbarimi të kontratës së martesës, por nga ana tjetër kjo duhet parë në dy aspekte:

Së pari, bashkëshortët në çdo moment mundën të revokojnë kontratën e martesës dhe të kalojnë në një regjim tjetër me vullnetin e tyre. Kjo konsiderohet mënyrë e heshtur e mbarimit të kontratës, që do të thotë bashkëshortët s'kanë nevojë ta parashikojnë në kontratë por ju lejohet ta ndryshojnë atë pasi ligji e parashikon këtë mundësi;

Së dyti, bashkëshortët mundën të vendosin afate, për fuqinë juridike të kontratës, në kuadër të garancisë së jetës bashkëshortore, duke caktuar kështu një kohë të cilën fillimisht do të jenë në regjimin me kontratë dhe pas një afati të caktuar do t'i nënshtrohen një regjimi tjetër. Kjo është parë si konfirmim i martesës dhe si përforsim i lidhjes martesore dhe marrëdhënies familjare të krijuar ndërmjet bashkëshortëve¹⁹⁸.

Ndryshimi i regjimit pasuror duke kaluar nga njëri regjim në tjetrin, duke e ndryshuar pjesërisht ose tërësisht regjimin aktual që kanë bashkëshortët, mënyra se si ligji e lejon ndryshimin është i kufizuar në kohë, i kushtëzuar nga shkaku dhe është specifike¹⁹⁹.

¹⁹⁷ Kodi Civil Francez, neni 1399.

¹⁹⁸ Downing A. (2018) "*A thoughtful approach to prenuptial agreements*", Wolters Kluwer Legal & Regulatory, SHBA, faqe 12.

¹⁹⁹ Kodi Civil Francez, Neni 1397.

Konkretisht në analizë të nenit 72 i Kodit të Familjes, do të shikojmë me detaje se cili është qëllimi i saj dhe se si duhet interpretuar dhe zbatuar.

Duke qenë se më lart kemi sqaruar dallimin e dy koncepteve “kontrata para- martesore” dhe “kontrata e martesës”, ky është momenti ku bëhet fjalë për kontratën e martesës. Këtu bashkëshortët tashmë e kanë zgjedhur një regjim pasuror dhe në vijim shihet nëse ky është ose jo i duhuri dhe nëse këto subjekte arrijnë në konkluzionin se nuk është regjimi më efektiv për to ai regjim që kanë zgjedhur, kanë të drejtë ta ndryshojnë. Por ky ndryshim nuk mund të jetë një procedurë e lehtë, duhet të plotësojë kritere dhe t’i nënshtrohet kontrollit të ligjit, të cilin do ta studjojmë më poshtë.

Fillimisht kërkohet vullneti i bashkëshortëve “*bashkëshortët bien dakord*”, i cili derivon që nga fakti i parimit të konsensusit të palëve në një kontratë, pra duhet të kenë vullnet në përcaktimin e regjimit të tyre dhe për këtë arsye të jenë në të njëjtin mendim për çfarë do të rregullojnë. Konsensusi shprehet që në momentin se bashkëshortët vendosin të ndryshojnë regjimin, pastaj vendosin për formën e zgjedhur se si do të shtohen apo pakësohen pasuritë e tyre gjatë martesës. Nga ana tjetër kërkohet edhe parimi i lirisë kontraktore, që është parim tjetër i rëndësishëm dhe thelbësor i cili duhet të jetë në frymën e lidhjes së kontratës. Këtë parim e shqyrtuam më lart se si munden bashkëshortët të zgjedhin se çfarë duan të rregullojnë me kontratë dhe si duan të përcaktojnë çdo gjë që ligji u lejon. Kjo dispozitë ka lidhje direkt vetëm me konceptin “kontratë martesë”, pra asaj që bashkëshortët vendosin të ndryshojnë regjimin pas lidhjes së martesës dhe mund të vendosin të kalojnë nga njëri tek tjetri.

Në vijim të dispozitës gjejmë togfjalëshin “*në interes të familjes*”, ku me këtë kuptojmë që duhet të vlerësojmë se cili është interesi i familjes. Në këtë pikë ligjvënësi kushtëzon

bashkëshortët për të ndryshuar regjimin pasuror për cilëndo arsye, pasi duhet të jetë i justifikuar interesi i familjes për të kaluar nga njëri regjim në tjetrin dhe duhet të vlerësojnë se cili mund të jetë rasti për interesin e familjes, domosdoshmërisht duhet që bashkëshortët të provojnë se ndryshimi i regjimit është interesi i familjes. Se si mund të vlerësohet kjo pjesë është subjektive dhe nuk mund të analizohet siç duhet për aq kohë sa ligji ka dhënë kushtin, por jo mekanizmat e realizimit të tij. Pra nuk na thuhet se kush duhet ta vlerësojë dhe se cili është interesi i familjes që duhet justifikuar për ndryshimin e regjimit. Për aq kohë sa thuhet bashkëshortët me marrëveshje mund të ndryshojnë regjimin, duket sikur do të jenë vetë bashkëshortët ato që do të vlerësojnë interesin e familjes. Nga ana tjetër na lind dyshimi se a mund ta vlerësojnë vetë bashkëshortët interesin e familjes? Ata mund ta pretendojnë, por nuk mund ta vlerësojnë drejtë se cili është interesi i familjes në ndryshimin e regjimit si dhe për aq kohë që ligjvënësi e ka vënë në dispozitë që bashkëshortët e kanë vlerësuar se duhet vetëm për interesin e familjes. Ky ndryshim, duket se ka një rëndësi specifike për përcaktimin e interesit të familjes. Në një vështrim në vendet e Evropës, konkretisht në Francë²⁰⁰, për një rast të tillë ligji parashikon që është Gjykata ajo që vendos nëse bashkëshortët mund ta ndryshojnë regjimin nëse ato arrijnë të provojnë se cili është interesi i familjes në këtë ndryshim. Bashkëshortët nëpërmjet avokatit të tyre dhe nga kopja e draftit të kontratës, do t'i drejtohen Gjykatës për të vlerësuar interesin e familjes. Edhe për legjislacionin tonë dhe të drejtën tone është më se e logjikshme dhe e mundshme të bëhet në këtë mënyrë, sepse akoma nuk është kultivuar kontrata e martesës dhe në çdo moment mund të bëhen shkelje të ligjit edhe pa qënë në qëllimin e bashkëshortëve.

²⁰⁰ Neni 1397 Kodi Civil Francez.

Kushtëzimi dyvjeçar, i vendosur në këtë dispozitë është i shpjeguar më lart dhe në këto kushte nuk është e nevojshme që të ndalemi sërish, pasi është vlerësuar drejtë nga ligjvënësi, duke ju referuar sërish Francës, në të njëjtën dispozitë që çiftuam, e cila ka parashikuar këtë afat dyvjeçar në mundësinë e ndryshimit të regjimit pasuror.

Ajo që është me rëndësi në këtë nen, ka të bëjë me kalimin nga njëri regjim në tjerin, duhet të bëhet me formën e kontratës, pra përpara noterit. Ky kalim parashikon përfundimin e një regjimi dhe fillimin e një regjimi të ri. Me këtë rast kuptojmë dy koncepte në lidhje me veprimin në kohë të kontratës së martesës, të cilët do t'i trajtojmë me kujdes.

Së pari, nëse bashkëshortët kanë qënë me regjimin e bashkësisë ligjore dhe vendosin të ndryshojnë regjimin duke kaluar në atë me kontratë sipas nenit 72 të Kodit të Familjes, sipas parashikimeve që bën ligji në lidhje me këtë fakt, kemi të bëjme me momentin e fillimit të kontratës së martesës. Sipas trajtimit të konceptit “kontrata para- martesore” ku fuqia juridike e saj fillon me lidhjen e martesës, për rastin në fjalë fuqia juridike së “kontratës së martesë” qenka dhe në një moment të dytë më vonë se lidhja e martesës, pasi të kenë kaluar minimalisht 2 vite nga martesa, por kur bashkëshortët të kenë shprehur vullnetin para noterit për redaktimin e kontratës së martesës dhe noteri ka detyrimin ligjor ta cojë sa më shpejt këtë kontratë në Zyrën e Gjendjes Civile. Ndërkohë kushtëzohet edhe nga një afat i dytë, ku duhet të kalojnë 3 muaj nga regjistrimi sepse gjatë kësaj kohe të tretët duhet të njihen me këtë ndryshim të regjimit dhe pasojat vijnë për to siç e kemi trajtuar për titullarët e së drejtës.

Së dyti, në rast se bashkëshortët kanë lidhur martesën dhe regjimi që kanë zgjedhur ka qënë ai me kontratë, por pasi kanë kaluar dy vite këto vendosin të ndryshojnë regjimin, pasi të kenë përmbushur kriteret që kërkon neni 72 i Kodit të Familjes, duke provuar çdo kusht që

kërkohet ato janë të detyruar ta bëjnë këtë kalim me formën e kontratës duke revokuar kontratën e martesës. Në këtë rast kemi të bëjmë me veprimin në kohë të kontratës së martesës duke na dalë koncepti i një afati, pasi kontrata e martesës është trajtuar si veprim juridik në llojin e saj që nuk mund të ketë afat dhe në këto kushte mbaron me mbarimin e martesës. Pikërisht me këtë kalim ka mbaruar efekti i kontratës së martesës dhe bashkëshortët janë vendosur në regjimin e bashkësisë ligjore efekti i të cili regjimi *ex lege*, vjen 3 muaj pas regjistrimit të ndryshimit në aktin e martesës²⁰¹. Këtu vihet re se regjimi me kontratë mund të përfundojë edhe pa përfunduar martesë dhe nuk duhet kushtëzuar me lidhjen apo zgjidhjen e martesës, pasi vullneti i shprehur në të, për sa i përket objektit që rregullon, është një trajtim i veçantë ligjor.

Por mundësia që të ketë një parashikim të natyrës që kontrata mund të ketë 5 vite fuqi juridike, kjo nuk është e parashikuar dhe nuk gjendet në dispozitat e ligjit tonë, pasi rastet e mbarimit të martesës janë edhe rastet e mbarimit të kontratës së martesës.

Regjimi pasuror që bashkëshortët vendosin të zgjedhin duhet të “transpozohet” në aktin e martesës të përgatitur nga nënpunësi i gjendjes civile në çastin e lidhjes së martesës. Në të kundërt do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.

4.4.2. Veprimi në hapësirë

Konventa e Hagës e datës 14 mars 1978 “Për Celebrimin dhe njohjen e vlefshmërisë së martesave”, mund të shihet si zbatuese për situatat ndërkombëtare dhe në veçanti ato ndërkufitare. Dispozita e nenit 23 të Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara

²⁰¹ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*.: Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 92.

për të Drejtat Civile dhe Politike²⁰², e vendos të drejtën e martesës së burrave dhe grave të moshës martesore në plan të parë dhe bazon martesën në pajtimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve. Për këtë qëllim, Konventa e Hagës kryen dy funksioneve: së pari, ajo lehtëson celebrimin e martesave dhe së dytë, siguron njohjen e vlefshmërisë së martesave përtej kufijve kombëtarë. Pjesa I e Konventës merret me celebrimin e martesës ndërsa Pjesa II me njohjen e martesave të huaja.

Pjesa I, mbi celebrimin, e bën ligjin e vendit ku bëhet celebrimi, *lex loci celebrationis*, pra referencë primare. Kjo aplikohet para së gjithash ndaj kërkesave formale për martesë: formalitetet, dëshmitarët, etj (Neni 2). Nuk është për t'u habitur, pasi është një nga paktat pyetje për zgjedhjen e ligjit mbi të cilën shumica e sistemeve të së drejtës ndërkombëtare private bien dakord. Gjithashtu kjo zbatohet edhe për kërkesat materiale ose thelbësore të martesës (neni 3, paragrafi 1). E cila është në përputhje me qasjen që kanë marrë disa vende, veçanërisht vendet e emigracionit, por është diçka e re për shumë vende të së civil laë dhe në disa prej vendeve me traditën e common laë, të cilat tentojnë të zbatojnë ligjin personal të çdo bashkëshorti të ardhshëm për të përcaktuar kërkesat thelbësore të martesës. Qasja e nenit 3, paragrafi 1, për zgjedhjen e ligjit ku do të kryhet celebrimi është i thjeshtë dhe ka tri avantazhe të mëdha:

1. Autoritetet lokale mund të zbatojnë kërkesat e ligjit të tyre në lidhje me pëlqimin e palëve ose moshës dhe shkallën e marrëdhënies së ndaluar (p.sh. , xhaxhai dhe mbesa), dhe

²⁰² Neni 23 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të 16 dhjetorit 1966 thotë si vijon:

“1. Familja është njësi grupore natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

2. Të njihet e drejta e burrave dhe grave të moshës së martesës për t'u martuar dhe për të gjetur një familje.

3. Asnjë martesë nuk mund të lidhet pa pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve që synojnë të martohen.

4. Shtetet palë të këtij Pakti do të marrin masat e duhura për të siguruar barazinë e të drejtave dhe përgjegjësisë të bashkëshortëve në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në shpërbërjen e saj. Në rastin e shpërbërjes duhet të sigurohet mbrojtja e nevojshme e çdo fëmije.”

jo kërkesat e ligjit të vendbanimit, kombësisë ose bashkësisë të bashkëshortëve të huaj që do lidhin martesë;

2. Shmang problemet e karakterizimit, për shembull, problemi i përcaktimit nëse pëlqimi i një prindi është një çështje e formës apo e substancës, sepse ligjet në fuqi do të përkojnë;

3. Lejon që kërkesa të pazakonta ose shtypëse të një ligji të huaj (p.sh., çdo kërkesë e bazuar në racë ose ngjyrë) të injorohen.

Duhet të theksohet se nenet 3-6 zbatojnë një teknikë që i lë shteteve kontraktuese një fleksibilitet të caktuar, ku njëra anë, ata mund të rezervojnë, sipas nenit 6, të drejtën për të mbajtur disa përjashtime nga rregulli i referencës në nenin 3 (1)²⁰³. Mirë po asnjë nga shtetet palë në Konventë, nuk ka bërë rezervë të nenit 6.

Nga ana tjetër, shtetet kontraktuese mund të zgjerojnë *lex loci celebrationis* për të gjitha celebrimet e martesave. Këtë ka bërë Australia kur ratifikoi Konventën²⁰⁴. Prandaj, një martesë duhet të celebroidhet në atë shtet ku bashkëshortët e ardhshëm përmbushin kërkesat thelbësore të ligjit të tij të brendshëm. Kjo qasje vjen gjithashtu edhe si thjeshtëzim i Neneve 3-6, sepse i vetmi ligj i zbatuar do të jetë ligji i brendshëm, jo çdo ligj i huaj.

Ndërkohë Pjesa I e Konventës, për celebrimin, është fakultative dhe mund të përjashtohet, ndërsa pjesa II, për njohjen e vlefshmërisë së martesës, në ndryshim nga e pjesa e I është e detyrueshme. Çështja e njohjes së vlefshmërisë së martesave është kritike në një epokë ku po rritet gjithnjë e më shumë lëvizshmëria e njëjërëve për shkak të globalizimit. Rregulli

²⁰³ Domethënë, Zbatimi i *lex celebrationis* në kërkesat thelbësore për celebrimin e martesave.

²⁰⁴ Ligji për Amandamentin e Aktit të Martesës Australiane (1985) zgjodhi të mos ruante rregullin ekzistues që kërkonte zbatimin e ligjit të vendbanimit të bashkëshortëve të ardhshëm për çështjet e vlefshmërisë materiale dhe për të rregulluar zgjedhjen australiane të ligjit në tërësi sipas *lex loci celebrationis*.

bazë i Konventës është i thjeshtë: shteti i celebrimit (është e rëndësishme të theksohet se ky mund të jetë çdo shtet, jo vetëm një shtet tjetër kontraktues) përcakton vlefshmërinë e martesës dhe Shtetet Kontraktuese janë të detyruara, si subjekt i një numri të kufizuar përjashtimesh dhe gjithashtu i nënshtrohen *ordre public* të tyre, për të njohur vlefshmërinë e martesës nëse është e vlefshme sipas ligjit të shtetit të celebrimit (neni 9). Kjo ka përparësinë e madhe për të shmangur nevojën për të rishikuar ligjin nëse është i aplikueshëm sipas konfliktit të rregullave ligjore të shtetit njohës.

Në rastin e martesave të përfunduara nga diplomatët ose konsullët është parashikuar një dispozitë e veçantë. Kur një autoritet kompetent i Shtetit ku celebrohet martesa ka lëshuar një certifikatë martese, martesa deklarohet e vlefshme derisa të vërtetohet e kundërta (Neni 10).

Megjithatë Konventa e Hagës ende nuk është ratifikuar nga shumë shtete (aktualisht shtete palë janë Australia, Luksemburgu dhe Holanda), ajo është shumë moderne në qasjen e saj. Ka qenë një model i ndjekur në punën e fundit nga Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile. Konventa është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë dhe në shumë mënyra përpara kohës së saj. Ajo meriton të shihet më shumë nga sa ka qenë ndoshta deri më tani.

Duke qenë se gjithnjë e më shumë persona që mendojnë për martesë mund të martohen me persona nga vende të tjera ose që banojnë në më shumë se një vend, hartimi dhe zbatimi i kontratave martesore me më shumë dhe më shpesh, ngre çështje komplekse juridike ndërkombëtare.

Si rezultat, do të jetë më e rëndësishme që bashkëshortët dhe gjykatat të kenë njëfarë kuptimi të ligjeve thelbësore të çdo vendi ose shteti të përfshirë, si dhe doktrinat e

përdorura për të zgjidhur juridiksionin ndërkombëtar dhe zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ligjore.

KAPITULLI V: REGJIMET PASURORE MARTESORE ME KONTRATË

5.1. Të përgjithshme

Momenti i shprehjes së vullnetit për të zgjedhur regjimin pasuror martesor, lidhet me momentin e lidhjes së martesës, për të dy regjimet si me atë me kontratë po ashtu edhe atë të bashkësisë ligjore. Konkretisht në fillim bashkëshortët zgjedhin nëse duan regjim të ndryshëm nga ai i bashkësisë ligjore ose jo dhe së dyti nëse vendosin regjimin me kontratë, cilin nga regjimet do të zgjedhin.

Në aspektin kohor duket sikur kontrata e martesës kushtëzohet për t'u caktuar vetëm para martesës, por siç e kemi sqaruar më lart, bashkëshortët edhe pas lidhjes së martesës mund të kalojnë nga njëri regjim në tjetrin edhe pas lidhjes së martesës, e kushtëzuar kjo nga kriteret ligjore të përcaktuara në legjislacion. Edhe kur bashkëshortët kanë lidhur martesë pa kërkuar një regjim ndryshe, por kanë pranuar atë që ligji garanton, konsiderohet në të vërtetë që ata kanë zgjedhur regjimin e bashkësisë ligjore. Në këto kushte është shumë e qartë se në çdo rast bashkëshortët e ardhshëm ose aktual, disponojnë lirisht mbi pasuritë e tyre dhe nuk mund t'u imponohet mënyra se si do të shtohen, pakësohen apo disponohen pasuritë e tyre të luajtshme e të paluajtshme.

Në interpretim të nenit 66 Kodi i Familjes, është e qartë se regjimi i cili merr përparësi është ai me kontratë, që do të thotë nëse është një i tillë prevalon dhe nuk aplikohet regjimi ligjor. Regjimi me kontratë u jep mundësinë bashkëshortëve të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre që nuk ju shmangen dot. Ndër të tjera bashkëshortët mundën lirisht të

zgjedhin, të ndajnë çdo gjë ose të bashkojnë pothuajse çdo gjë. Mund të kombinojnë formulat që ligji u ofron, por edhe apilikojnë regjime atipike për të cilat ligji nuk i ndalon.

Qëllimi i çdo subjekti për të hyrë në një marrëdhënie juridike civile duhet të vishet me formën e duhur ligjore me qëllim që të sjellë pasoja ligjore dhe të njihet. Prandaj duhet që ligji t'i vijë në ndihmë subjektit të së drejtës për të realizuar çfarë ka në qëllim dhe t'i mundësojë atij mjetet juridike me anë të të cilave mund të realizojë të drejtat e tij. Kontrata e martesës është një ndër institutet e së drejtës që ndihmojnë individin në realizimin e të drejtave të tyre dhe i ofrojnë atij mundësinë për të disponuar lirisht mbi pasurinë e tij ashtu sic e kemi përmendur edhe më lart për të krijuar, ndryshuar ose shuar një marrëdhënie pasuore duhet marrëveshje ose përputhje të vullnetit ndërmjet palëve²⁰⁵.

Konkretisht në kontratën e martesës, e kemi përmendur mjaft parimin e lirisë kontraktore dhe për rrjedhojë duhet të konkretizohet se si gjen zbatim ky parim edhe tek ky akt. Së pari, ky parim ka funksion që në momentin kur bashkëshortët duhet të zgjedhin një regjim kontrate apo duhet t'i nënshtrohen regjimit ligjor pa u shqetësuar për formulën. Së dyti, palët në një kontratë zgjedhin lirisht se me kë subjekt duan të lidhin këtë akt, për rastin e kontratës së martesës kjo kushtëzohet që tek lidhja e martesës, pasi këtu bashkëshortët e ardhshëm apo bashkëshortët i janë nënshtruar parimit tjetër të rëndësishëm të pëlqimit reciprok për lidhjen e martesës²⁰⁶. Së treti, palët e një kontrate zgjedhin vetë se cila do të jetë përmbajtja e kësaj kontrate dhe kushtet e saj që kanë fuqi për palët, duke u vendosur në rolin e autorëve të regjimit pasuror martesor. Sërish këtu siç e kemi sqaruar më lart tek kontrata e martesës, palët kushtëzohen nga ligji për të mos përcaktuar gjithçka në kontratë,

²⁰⁵Galgano F, "E drejta Private", faqe 265, botimi i III, Luarasi, 2006 Tiranë

²⁰⁶ Neni 8 i Kodit të Familjes.

por ajo që është e lejuar me ligj mundet të disponohet pa asnjë pengesë nga palët. Së katërti, brenda konceptit të lirisë kontraktore, përfshihet edhe fakti se palët në kontratë mundën të dalin nga kontrata sipas një mënyre që ato kanë përcaktuar²⁰⁷. Edhe në rastin e kontratës së martesës, bashkëshortët e lënë kontratën e martesës duke qënë të martuar nëse ndryshojnë regjimin sipas nenit 72 të Kodit të Familjes, ose nëse martesa mbaron, për rrjedhojë duke qënë se objekti i kësaj kontrate është regjimi pasuror martesor, mbaron dhe ky i fundit kur mbaron martesa²⁰⁸.

I gjithë sqarimi për lirinë kontraktore është shumë i rëndësishëm për t'u kuptuar drejt dhe në vijim për t'u zbatuar nga bashkëshortët në formulimin, redaktimin dhe nënshkrimin e kontratës, sepse në zgjedhjen e regjimit si dhe në përmbajtje të çdo neni të kontratës është kusht që të jetë vullneti i dyanshëm i bashkëshortëve.

Sipas legjislacionit tonë duket sikur bashkëshortët kushtëzohen brenda zgjedhjes së regjimit me kontratë, duke qënë se Kodi i Familjes përcakton regjimet me kontratë, por në tërësi të këtyre dispozitave, në asnjë pjesë nuk është e ndaluar që bashkëshortët mundën të zgjedhin edhe regjime siç e vlerësojnë ato të përshtatshme për të disponuar pasuritë e tyre. Ndarja që bëhet në Kodin e Familjes nuk është shtruese, është thjeshtë indikative, pasi bashkëshortët mund të vendosin si të duan në kontratën e martesës, përveç ndalesës së vetme që është neni 67, ku nuk i shmangemi dot ashtu siç e thotë edhe vetë titulli. Se si e realizojnë bashkëshortët kontratën e martesës, do të trajtohet në një kapitull tjetër, por në rastin në fjalë është e nevojshme që ato të njohin vetëm faktin se çfarë mund të bëjnë me kontratën e martesës dhe deri në çfarë pike mund të disponojnë me kontratën e martesës.

²⁰⁷ Dauti N., (2001), *E drejta e detyrimeve*, Prishtinë, fq. 57.

²⁰⁸ Kodi i familjes, nenet 123-132.

Duke parë Kodin e familjes se çfarë mund të disponojmë me kontratën e martesës, vëmë re se kontrata e martesës nuk është veprim juridik që kërkohet vetëm nga të pasurit duke i konsideruar ata si të mundshëm për të përcaktuar destinacionin e pasurive dhe si potencial për të patur pasuri. Sot kontrata e martesës kërkohet edhe nga subjekte të cilat nuk kanë domosdoshmërisht pasuri të konsiderueshme në momentin e lidhjes së martesës, pasi duhet konceptuar si mundësi e mbrojtjes së të drejtave pasurore. Në këtë pike mjafton të kuptojmë drejtë konceptin e kontratës së martesës pasi është e dukshme se me këtë kontratë administrojmë kryesisht pasuritë *pas* dhe *gjatë* martesës me përjashtim të pasurive të luajtshme tek regjimi i bashkësisë universale, pra nuk janë objekt i kësaj kontrate në asnjë lloj mënyre pasuritë e paluajtshme para martesës. Për shumicën, kontrata e martesës është një mjet mbrojtës i pasurive të secilit, por në të vërtetë është një raport juridik i bashkëshortëve me mirëkuptim të të dyve në ndërgjegjësimin e secilit për destinacionin e pasurive²⁰⁹. Kjo është shumë e drejtë për faktin se, kur bashkëshortët arrijnë të përputhin vullnetin e tyre në administrimin e pasurive ata janë një skuadër dhe kanë eliminuar problematikën më të madhe siç është ajo financiare në lidhje me jetën familjare. Janë të vetëdijshëm për secilën nga pasojat që vijnë dhe janë më të aftë për t'i paraprirë dëmit që mund t'u shkaktohet nga çdo vendim në lidhje me jetën martesore²¹⁰. Ka shumë rëndësi që çdo individ të vendosë vetë në lidhje me pasuritë e tij dhe të ndjehet i lirë në rregullimin e të drejtave pasurore, pa u kushtëzuar nga bashkëshorti tjetër po ashtu edhe nga martesë.

Për shembull në një nga qytetet e Portugalisë, Gaia, me një popullsi prej rreth 100'000 banorë, gjatë vitit 2001 u celebruan gjithsej 892 martesë. Midis tyre 31 martesë ishin midis

²⁰⁹ Cochran, J. (2002), *Journey to Justice*, Neë York: Ballantine Books, faqe 79.

²¹⁰ Halley J., (2010) "*Behind the Law of Marriage*", Shtetet e Bashkuara të Amerikës, faqe 11.

portugezeve dhe shtetasve të huaj, nga të cilat vetëm 5 çifte zgjodhën regjimin e pasurive të ndara në një kontratë martesë. Në këtë mënyrë hoqën dorë nga aplikimi i regjimit që Ligji i Familjes portugeze parashikon për pasurinë, atë të bashkësisë ligjore ndërmjet bashkëshortëve. Në vitin 2002 u celebruan 41 martesa midis qytetarëve portugezë dhe të huajt (nga një total prej 816 martesash). 7 çifte (nga 41 martesa) vendosën për regjimin e pasurive të ndara në një kontratë martesore. Gjithashtu gjatë këtij viti nuk u zhvillua asnjë divorc me karakter ndërkombëtar në këtë zyrë²¹¹.

Nga një këndvështrim praktik, në lidhje me regjimin e pasurisë bashkëshortore të shtetasve të huaj të martuar në Portugali, ndoshta një nga problemet më të vështira ka të bëjë me mbishkrimin në Regjistrimin Civil të Portugalisë të regjimeve të pronave të huaja martesore, të ndryshme nga ato që pranohen nga ligji portugez. Për shembull, nëse një qytetar portugez martohet me një shtetas gjerman në Gjermani, sipas regjimit të Zugeëinnngemeinschaft, Zyrtari i Gjendjes Civile në Portugali nuk do ta përmendi atë regjim si regjimin e pronës martesore të çiftit. Në rastin më të mirë, Zyrtari i Gjendjes Civile mund të marrë në konsideratë se shtetasi portugez është i martuar nën regjimin portugez të bashkësisë ligjore midis bashkëshortëve për pronat dhe asetet që nuk janë fituar gjatë martesës, gjë që në mënyrë të qartë nuk korrespondon ose nuk përputhet me regjimin gjerman të Zugewinnngemeinschaft. Ky fakt mund të ketë pasoja të rëndësishme në të ardhmen, për shembull kur bashkëshortët duan të divorcohen në Portugali dhe gjykata portugeze duhet të zbatojë regjimin e pronës martesore të çiftit. Fakti që sipas Shërbimeve të Regjistrimit Civil të Portugalisë, çifti konsiderohet i martuar nën regjimin e parazgjedhur

²¹¹ Commission Européenne, (2001), Study On Matrimonial Property Regimes And The Property Of Unmarried Couples In Private International Law And Internal Law , Addendum, Portugal, JAI/A3/2001/03, pg.4-6.

të bashkësisës së pronës, do të sjellë pasoja negative për çiftin i cili duhet të sqarojë se regjimi i pasurisë martesore nuk është ajo që duket *a priori*²¹².

Shumë çifte të famshëm, duke përfshirë Michael Douglas dhe Catherine Zeta Jones, apo Denise Richards dhe Charlie Sheen kanë nënshkruar një kontratë martesore, ku shpesh, marrëveshje të tilla do të përcaktonin sasinë e parave që një bashkëshort do të marrë si mbështetje ekonomike për çdo vit të martesës, si dhe një klauzolë shtesë në rast të shkeljeve të kurorës²¹³.

Martesa ka një impakt financiar të rëndësishëm, për vetë faktin se çfarë marrëdhëniesh rregullon dhe në mbarëvajtjen e jetës familjare është e nevojshme angazhimi për administrimin e ekonomisë. Ka një tërësi rregullash që i dedikohen pikërisht marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve. Këto rregulla përbëjnë atë që Kodi i Familjes e përfshin në “regjimet pasurore martesore” dhe i japin përgjigje një sërë pyetjesh që ndikojnë në cilësinë e jetës bashkëshortore pasqerisht se konteksti pasuror nuk është ai që predominon në një lidhje martese apo raport martesor. Shpeshherë, edhe në situata normale, por kryesisht në situata krizash apo pasigurish, bashkëshortët ndihen të paqartë dhe të shqetësuar lidhur me kualifikimin e pasurive të caktuara, të krijuara para ose pas martesës, bashkërisht ose individualisht, të dhuruara ose të trashëguara, të luajtshme ose të paluajtshme, etj. Pikërisht kjo është e lidhur ngushtësisht me regjimin pasuror që rregullon marrëdhëniet pasurore. Padyshim që çasti i lidhjes së martesës ka ndikim në kategorizimin e pasurisë martesore ose

²¹² Commission Européenne, (2001), Study On Matrimonial Property Regimes And The Property Of Unmarried Couples In Private International Law And Internal Law , Addendum, Portugal, JAI/A3/2001/03, pg.4-6.

²¹³ Stoner, Katherine E.; Irving, Shae, (2012), *Prenuptial Agreements: How to Write a Fair & Lasting Contract*, 4th Edition. NOLO.

post martesore, por kjo nuk do të thotë që për të gjitha regjimet ajo që është fituar përpara martesës është vetjake dhe anasjelltas gjithçka e fituar pas martesës është e përbashkët. Pra regjimi i zgjedhur ndikon në këtë vendosje²¹⁴.

Nga një lexim i shpejtë i dispozitave të regjimit pasuror të bashkëshortëve, kuptojmë se këtu do të gjejmë disa rregulla që janë unike për të gjitha regjimet e tjera të cilat janë në varësi të llojit të regjimeve pasurore martesore. Të tilla janë ato që kanë të bëjnë me klasifikimin e një pasurie të caktuar në varësi të regjimit; rregulla lidhur me administrimin e pasurisë; rregulla lidhur me përfaqësimin e bashkëshortëve; çështje të kompensimit ndërmjet bashkëshortëve dhe të përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve; mbarimit të një regjimi; ndryshmit të regjimit; etj.

Regjimet me kontratë nënkuptojnë që bashkëshortët nëpërmjet një marrëveshje të lidhur midis tyre vendosin të përcaktojnë një regjim pasuror martesor të ndryshëm nga regjimi i bashkësisë ligjore. Kjo mund të jetë një marrëveshje “paramartesore” si edhe “pasmartesore”. E rëndësishme është që për llojin e regjimeve bashkëshortët të zgjedhin me mirëkuptim një regjim që i përshtatet më mirë interesave të bashkëshortëve dhe që i vjen në ndihmë krijimit të një familje sa më të shëndetshme dhe një jete familjare të plotësuar.

Në Kodin e Familjes 2003, gjenden dy lloj regjimesh me kontratë “regjimi i pasurive të ndara” (neni 115) dhe “regjimi i bashkësisë universale”(neni 114), të njëjtë e gjejmë edhe në shtetin e Belgjikës, të parashikuar në kodin civil në nenin 1470. Ndryshe është Franca e cila përfshin dhe sjell një regjim që nuk haset në këto dy legjislacione, i cili ka të bëjë me regjimin e pasurive të ndara por quhet “*regjimi i pasurive të ndara dhe i ofertave*”, në

²¹⁴ Mandro, A., (2009), *E drejta familjare*, Tiranë, fq. 215.

nenin 1569 të Kodit Civil Francez dhe i është i sanksionuar²¹⁵. Ky regjim është një tjetër alternativë e regjimit me kontratë dhe sipas këtij kodi, bashkëshortët janë gjatë martesës njëëlloj si me regjimin e pasurive të ndara, por ndryshimi qëndron tek fakti se pas zgjidhjes së martesës bashkëshorti jo pronar i pasurive ka të drejtën e parablerjes ose gëzon mundësinë e përdorimit të këtyre pasurive në rast se bashkëshorti pronar ka vdekur dhe në trashëgim thirren edhe fëmijët edhe bashkëshorti pasjetues.

5.2. Regjimi i pasurive të ndara

Regjimi i pasurive të ndara është një prej regjimeve me kontratë që parashikohet në Kodin e Familjes aktual sipas të cilit orientohen bashkëshortët se cilën nga formulat mund të marrin në redaktimin e kontratës së tyre duke ofruar formula të gatshme. Kështu e kanë më të qartë edhe në ligj se si do të administrohen pasuritë e tyre gjatë martesës duke i dhënë shpjegim ligjor normave të kontratës.

Në vetë interpretimin literal regjimi i pasurive të ndara, kuptojmë në pamje të parë se këtu bashkëshortët do të jenë veçmas dhe pasuritë e tyre janë të pandjeshme dhe të paprekura nga lidhja e martesës, gjithmonë duke rikujtuar të detyrimet e pashmangshme pas martesës. Sipas kësaj dispozite kuptojmë qartë se nëse bashkëshortët zgjedhin si regjim atë me kontratë, brenda kësaj zgjedhje kanë edhe alternativë tjetër për të përcaktuar regjimin e pasurive që është konkretisht regjimi i pasurive të ndara. Në vijim të kësaj dispozite, vëmë re se legjislatori e ka përcaktuar dhe interpretuar vetë se çfarë duhet të kuptojmë në me regjim të pasurive të ndara. Rikujtojmë këtu tagrat e pronarit nga konceptet e së drejtës së pronësisë, karakteri dhe përmbajtja e së drejtës së pronësisë, në kuptimin juridiko-civil

²¹⁵ Stoner, Katherine E; Irving, S .(2012). *Prenuptial Agreements: How to Write a Fair & Lasting Contract*, 4th Edition. NOLO, fq 98.

është sanksionuar në nenin 149 të Kodit Civil, sipas të cilit “*Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji*”. Nga kjo dispozitë, si dhe nga përmbajtja e neneve 296, 302, 304 të Kodit Civil rezulton se posedimi, gëzimi dhe disponimi janë tre tagrat (pushtetet) kryesore të pronarit²¹⁶.

Në nenin 115 Kodi i Familjes, është përdorur koncepti gëzim me administrim, që duhet të sqarojmë se janë përdorur për të njëjtin qëllim dhe kanë të njëjtin kuptim në aspektin juridik dhe atë praktik në lidhje me të drejtat e bashkëshortëve. Duke qartësuar të tre tagrat e pronarit kuptojmë se në këtë lloj regjimi secili bashkëshort i gëzon i lirë tagrat e tij mbi pasurinë e tij dhe vendos me vullnet të lirë pa u kushtëzuar nga të qënurit i martuar në lidhje me pronësinë e tij. Ky regjim është shumë i përdorur në shtetin e Belgjikës dhe të Francës pasi është më i lehtë për t’u kuptuar dhe më i mundshëm për t’u aplikuar²¹⁷.

Bashkëshortët në këtë regjim arrijnë nivelin më të lartë të barazisë, duke e konsideruar që pavarësia ekonomike është pavarësi politike, prandaj edhe promovimi i kontratës së martesës duhet parë si nxitje drejtë mbrojtjes edhe më të ndjeshme të të drejtave të njeriut²¹⁸.

Secili prej bashkëshortëve ruan mëvetësinë në pasurinë e vet, përfshirë këtu edhe të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë të kësaj pasurie. Bashkëshortët përballojnë secili më vete detyrimet që i kanë lindur, para ose gjatë martesës, me përjashtim

²¹⁶ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.5/2011.

²¹⁷ Grégoire, M.(1995). *Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Bruylant Akademia s.a., Francë fq.57.

²¹⁸ Namarong, Martyn, (2012), *The Story of Independence – Economic and Political Independence*, faqe 37.

të rastit²¹⁹ kur detyrimet vijnë nga regjimi i bashkësisë ligjore, e cila ka qenë një regjim i detyrueshëm ligjor në rastet e martesave nën moshë.

Sipas nenit 115 të Kodit të Familjes, kur bashkëshortët kanë përcaktuar në kontratën martesore regjimin e pasurive të ndara, secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij. Edhe pse nuk vihet elementi kohë, pra për cilat pasuri e ka fjalën ligjvënësi, duhet të interpretojmë duke u zgjeruar në tërësinë e dispozitave. Parimi i përgjithshëm në lidhje me disponimin e pasurive nëpërmjet regjimeve pasurore martesore, konsiston në pasuritë pas lidhjes së martesës, pra nga dita e lidhjes dhe deri në përfundim të saj. Ky koncept buron si element i institutit të veprimit në kohë të ligjit, ku çdo normë sjell pasoja për një subject, pasi të ketë hyrë në fuqi dhe nuk mundet një dispozitë e mëvonshme të aktivizojë të drejta më përpara në kohë. Por në rastin e regjimeve do të shikojmë se te regjimi i bashkësisë universale me kontratë, do të tejkalojmë këtë kufi kohor dhe do të përfshihen në pasuri të bashkëshortëve edhe pasuritë para martesës. Kthehemi tek regjimi me kontratë i pasurive të ndara, sipas të cilit nuk na thuhet se për cilat pasuri bëhet fjalë për ato para apo pas. Është shumë e qartë se bëhet fjalë vetëm për pasuritë e vendosura gjatë martesës, pra pas lidhjes së saj dhe nuk është aspak e nevojshme të parashikohet në nen ky fakt për aq kohë sa ne dimë parimin e përgjithshëm për efektet që vijnë nga momenti i lidhjes së martesës dhe prirja e ligjit është të jetë në mbrojtje të shtetasit dhe t'i garantojë atij në çdo kohë mundësinë për të mbrojtur të drejtat e tij pasurore.

²¹⁹Rasti i parashikuar në nenin 70 për të miturin, ku sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore derisa të mbushë moshën 18 vjeç, çast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.

Tek regjimi i pasurive të ndara, ndryshe nga regjimi i bashkësisë, secili bashkëshort ruan të drejtën ekskluzive mbi sendet e fituara gjatë martesës dhe për këtë shkak mund të ushtrojë i vetëm administrimin e disponimin e sendeve dhe të drejtave të fituara prej tij dhe të përmbushë gjithashtu detyrimet personale. Subjekti bashkëshort në këtë rast është tërësisht i pavarur nga të qenurit i martuar, duke i dhënë atij mundësinë të anagzohet në çdo raport me të tretët duke llogaritur vetëm riskun personal. Si pasojë e këtij regjimi, edhe pse sendi apo çdo e drejtë tjetër fitohen gjatë martesës, ato mbeten të bashkëshortit që i ka fituar²²⁰.

Bashkëshorti përfaqëson i vetëm vullnetin e tij, prezantohet i vetëm në mirëmbajtjen, shtimin, pakësimin, pjesëmarrjen e veprimtarive tregtare si dhe ndjehet përgjegjës direkt për çdo investim apo lëvizje në lidhje me pasuritë personale të tij²²¹. Në asnjë moment nuk ndjen detyrimin e të qenurit i martuar kur ai vetë është i ndërgjegjshëm për veprimet që ndërmerr. Në rast se njëri nga bashkëshortët do të donte të autorizonte bashkëshortin tjetër për të kryer veprimtari të administrimit të pasurisë së tij, këtë gjë do ta bëjë nëprmet aktit të përfaqësimit dhe sipas rregullave të përgjithshme të përfaqësimit të parashikuara nga Kodi Civil²²².

Rëndësi për t'u trajtuar në këtë studim, merr roli i bashkëshortit jopronar në pasuritë e bashkëshortit pronar. Kjo duhet trajtuar pasi jeta familjare nuk mund të konturizohet në sjellje të përcaktuara në kontratë dhe nuk mund të përcaktohet drejtëpërsëdrejti si formë bashkëpunimi racional me të drejta dhe detyrime. Prandaj, edhe pse secili bashkëshort është pronar i pasurisë së tij dhe është në regjimin e pasurive të ndara, kjo nuk duhet të çënojë jetën familjare, pasi do të ishte tërësisht e padrejtë nëse bashkëshorti jopronar të mos mund

²²⁰ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*. Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 138.

²²¹Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*. Shtëpia Botuese Emal, Tiranë, fq.260

²²²Po aty

të përdorte pasuritë e bashkëshortit tjetër. Prandaj duhet konceptuar se edhe pse nuk parashikohet në ligj, bashkëshorti jopronar ka të drejtën e përdorimit të banesës familjare edhe pse është në emër të bashkëshortit pronar. Kjo për faktin se banesa familjare ka një status tjetër superior në krahasim me pasuritë e tjera të regjimit, duke qenë se gëzon mbrojtje të posaçme nga ligji, pikërisht për faktin se është streha familjare²²³. Këtë mbrojtje të veçantë e gjejmë edhe në vende të tjera të sanksionuar më qartë duke e sanksionuar në akt ligjor të drejtën e posedimit të banesës familjare ndërmjet bashkëshortëve, pavarësisht se në pronësi të kujt është kjo pasuri²²⁴. Këtë përdorim e bën në kuadër të bashkëjetesës familjare dhe në kuadër të mirëqënies së marrëdhënies së tyre, pasi nuk mund të ndalohej të jetojë aty ku jeton njëri bashkëshort sepse kjo do të binte ndesh me thelbin e martesës, e cila bazohet në jetesën e përbashkët. I rikthehemi së drejtës së pronësisë, tagrave të pronarit, ku në thelb ne e dimë që pronari ka 3 tagra, gëzimin, posedimin dhe disponimin. Kur kemi sqaruar këto tagra kemi shprehur faktin se gëzimi dhe posedimi janë të drejta të cilat mund t'i kalohen subjektit jopronar me vullnetin e pronarit ndërkohë disponimi është e drejtë e lidhur ngushtë me pronarin dhe nuk mund të tjetërsohet, pasi nëse tjetërsohet thjeshtë subjekti pronar zhvishet nga e drejta e pronësisë duke ia kaluar atë dikujt tjetër. Për rastin e kontratës së martesës, bashkëshorti i cili nuk është pronar në një pasuri të caktuar ka të drejta të posedimit dhe nëse caktohet në kontratë edhe të gëzimit, por nuk mund të ketë të drejta të disponimit pasi askush nuk mund të kalojë në më shumë të drejta nga çka vetë.

²²³Neni 153 Kodi I Familjes

²²⁴ The Family Property Act 1997 Canada

Ky regjim zgjidhet me vullnetin e palëve, sqaruar më lart, por edhe pa vullnetin e tyre, pasi bashkëshortët në momentin e mbarimit të martesës deri në fazën e pjesëtimit përfundimtar të pasurive që kanë patur gjatë martesës, me cilindo regjim të kenë hyrë në martesë, i nënshtrohen regjimit të pasurive të ndara. Pra, edhe nëse bashkëshortët kanë zgjedhur regjimin e bashkësisë ligjore dhe zgjidhin martesën në Gjykatë, me marrjen e formës së prerë të vendimit të gjykatës për zgjidhjen e martesës, bashkëshortët i nënshtrohen regjimit të pasurive të ndara dhe në këto kushte bashkëshortët nuk shtojnë gjë për të përbashkëtën dhe për të tërën. Përfundimisht, regjimi i pasurive të ndara mund të zbatohet *ex lege*, pa vullnetin e palëve apo edhe kundër këtij vullneti, në rastet e pjesëtimit gjyqësor të bashkësisë ligjore, në kushtet e parashikuara nga neni 98 i Kodit të Familjes. Njëri nga bashkëshortët mund të kërkojë në disa raste taksative pjesëtimin e bashkësisë gjatë vazhdimin të martesës. Nëse gjykata e gjen me vend kërkesën dhe vendos mbarimin dhe pjesëtimin e bashkësisë, sipas nenit 98, paragrafi i fundit, bashkëshortët vendosen automatikisht nën regjimin e pasurive të ndara.

Nga ky përshkrim, regjimi me kontratë i pasurive të ndara duhet konsideruar regjim racional dhe regjim i cili gjen lehtësisht aplikim. Nga ana tjetër, zgjedhja e këtij regjimi parandalon një sërë konfliktesh ndërmjet bashkëshortëve, si atyre që lindin nga administrimi i përbashkët i bashkësisë gjatë martesës, por në mënyrë të veçantë atyre që lindin pas mbarimit të martesës, kur pjesëtohen sendet e fituara gjatë martesës²²⁵.

Në mendimin shkencor, në mënyrë të veçantë në fushat jojuridike, nuk kanë munguar kritikën e shumta në drejtim të regjimit të pasurive të ndara. Kështu, sipas një opinionit, ky regjim bie ndesh me konceptin e martesës, e cila ka për qëllim të krijojë një bashkësi jetese

²²⁵ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*. Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 139.

dhe interesash ndërmjet bashkëshortëve, gjë e cila nuk realizohet nën regjimin e pasurive të ndara. Ky opinion mund të mbështetet, pasi edhe pse bashkëshortët zgjedhin regjimin e pasurive të ndara, ata ruajnë dhe zbatojnë detyrimin e kontributit material në interes të familjes dhe të bashkëjetesës, i cili parashikohet nga neni 54 dhe 63 i Kodit të Familjes dhe në drejtim të bashkëshortëve që zgjedhin këtë regjim pasuror. Në këto rrethana, bashkësia e jetesës, ajo shpirtërore dhe materiale, realizohen në kushte edhe më të favorshme në hipotezën e regjimit të pasurive të ndara, pasi kjo bashkësi familjare nuk do të ndikohet nga konfliktet që rrjedhin prej ushtrimit të të së drejtave pasurore gjatë martesës, të cilat duhet pranuar, sepse janë ato që shkaktojnë më së shumti krizat familjare. Nga ana tjetër, regjimi i bashkësisë, në mënyrë të veçantë ai i bashkësisë ligjore, çon në një solidarizim aq të tepruar ndërmjet interesave të bashkëshortëve, sa që cënon në shumë raste padrejtësisht bashkëshortin që ka kontribuar më tepër në fitimin e pasurisë së përbashkët dhe për pasojë ndikon në begatimin pa shkak të bashkëshortit tjetër. Në këto kushte, ekzistenca e regjimit të pasurive të ndara duhet konsideruar si një risi në favor të forcimit të martesës, e cila ka patur rënie të vazhdueshme të numrit të saj si pasojë e shtimit të numrit të bashkëjetesave. Në të kundërt, regjimi i pasurive të ndara do të ndikojë në forcimin e familjes që rrjedh nga martesa, pasi nëpërmjet kësaj mundësie bashkëshortët mund të ruajnë një pavarësi të plotë të interesave pasurore, duke përjashtuar ndërhyrjet e bashkëshortit tjetër, si në fitimin e pasurisë, ashtu edhe administrimin e saj²²⁶.

Ndonëse pasuritë janë të ndara, kjo nuk do të ndikojë në bashkëjetesën e bashkëshortëve dhe plotësimin e detyrimeve ndaj familjes. Pra ka shumë pika kontakti të cilat i japin jetë plotësimit të detyrimeve që burojnë nga martesa. Bashkëshortët kanë të drejtë të

²²⁶ Omari, S. (2012). E drejta familjare. Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 140.

përcaktojnë në kontratë dhe madje të respektojnë mënyrën e plotësimit të detyrimeve që burojnë nga martesë. Po t'i referohemi nenit 116 të Kodit të Familjes, do të kuptojmë që nëse një rregullim i tillë nuk është bërë në mënyrë autonome nga bashkëshortët, atëherë prezumohen të pranuar rregullat e Kodit të Familjes, lidhur me masën e kontributit të secilit “sipas kushteve dhe aftësive të tyre”. Pra ka gjithnjë një sasi fondi që bashkohet (në natyrë apo në të ardhura) me qëllim që të plotësohen në mënyrën më të mirë të mundshme interesat familjare e martesore. Gjithmonë në rast se bashkëshortët nuk e parashikojnë këtë, kujdeset ligji për të caktuar se si do të bëhet kontributi në familje dhe si do ta realizojnë bashkëshortët mirëmbajtjen e familjes²²⁷.

Për sa i përket administrimit, nënvizojmë se secili ka të drejtë të administrojë lirisht pasurinë e vet të ndarë²²⁸, por nëse gjatë martesës njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij për këtë duhet të zbatohen rregullat e përfaqësimit të rregulluara nga Kodit Civil lidhur me përfaqësimin me prokurë dhe mandatin e heshtur²²⁹. Kjo është tërësisht e kuptueshme si dispozitë pasi bashkëshortët janë të veçuar nga pasuritë e njëri-tjetrit dhe prandaj nuk mund të merret e mirëqenë mbrojtja e interesave të bashkëshortit tjetër.

Në këtë rast, nëse kemi të bëjmë me një prokurë, në tagrat e përfaqësimit mund të shënohen edhe çështje që kanë të bëjnë me kthimin e fryteve (natyrore apo civile) të pasurisë që administrohet pasuria e ndarë e bashkëshortit prokurëdhënës. Nëse kjo nuk është përcaktuar, atëherë bashkëshorti përfaqësues nuk është i detyruar të japë llogari për kthimin

²²⁷ Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*, Tiranë, fq.260.

²²⁸Në nenin 64 të Kodit të Familjes citohet: *Secili nga bashkëshortët ka të drejtën e administrimit dhe të tjetërsimit lirisht të sendeve të tij vetjake, pa qenë nevoja e pëlqimit të bashkëshortit tjetër*. Gjithashtu shih edhe: Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*, fq.260.

²²⁹ Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*. Tiranë, fq.260.

e fryteve, nëse prokura nuk e detyron shprehimisht për një gjë të tillë. Këtu nuk bëhet asnjë dallim lidhur me frytet e konsumuara ose jo²³⁰. Ky rast i referohet mandatit të heshtur (Kodi i Familjes, neni 118), nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë e bashkëshortit tjetër, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij (me mirëbesim). Në këtë rast, tagrat përfshijnë çështje të akteve të administrimit, në përgjithësi duke përjashtuar tagrin e disponimit, ndryshe nga rasti i përfaqësimit me prokurë, ku bashkëshorti përfaqësues përgjigjet ndaj bashkëshortit tjetër vetëm për frytet që ekzistojnë dhe nuk përgjigjet për ato që janë konsumuar.

Rregullat ndryshojnë në rastin e administrimit me keqbesim. Nëse njëri nga bashkëshortët, me gjithë kundërshtimin e tjetrit (përfaqësues me keqbesim), administron pasurinë e këtij të fundit ose kryen veprime lidhur me këtë pasuri, ai përgjigjet për dëmin dhe për frytet që duhet të ishin marrë. Edhe në rastin e këtij regjimi, me gjithë kujdesin për të ndarë pasuritë, është e pamundur që kjo ndarje të shtrihet dhe të konceptohet deri në ekstrem, për aq kohë sa jetojnë së bashku, po kështu së bashku (si të ndara dhe jotë ndara) jetojnë edhe pasuritë e tyre. E themi këtë, sepse ka raste që ndodh edhe këtu i ashtuquajtur i procesi i difuzionit apo përzierjes së pasurive²³¹. Kjo e bën në ndonjë rast të vështirë procesin e ndarjes në çdo kohë për pasuritë e luajshme.

Statusi i qartë i pasurive të ndara merr rëndësi kur cënohen interesa të kreditorëve. Ka raste që plotësimi i detyrimeve ndaj tyre kërkon një reagim më të shpejtë. Për të mos vënë në vështirësi pozitën e kreditorëve, atë të bashkëshortëve, por edhe për të qartësuar statusin e një pasurie në varësi të përdorimit apo destinacionit të saj, Kodi i Familjes (neni 119), gjen

²³⁰Po Aty, fq. 260-261.

²³¹Vetë pasuria e sendeve është e tillë.

me vend të bëjë tri prezumime të rëndësishme. Së pari, Kodi i Familjes nënvizon rregullin se pasuria e luajtshme që posedohet (pra çka posedohet nuk nënkupton detyrimisht pronësinë sikurse edhe nuk e përjashton detyrimisht) nga njëri prej bashkëshortëve ose nga të dy bashkëshortët presumohet, në lidhje me kreditorët e secilit prej tyre, se i përket bashkëshortit debitor. Me të drejtë, ky prezumim nuk është i vlefshëm në rastin e ndërprerjes së jetësës së përbashkët ku secili ka marrë pjesën e vet të ndarë. Së dyti, sa i përket të drejtës për restitucion (kthimi), kjo pasuri e luajtshme që posedohet nga të dy bashkëshortët presumohet, në lidhje me njëri-tjetrin, se i përket të dy bashkëshortëve në pjesë të barabarta. Pra prezumimi i pjesëve të barabarta në tërësinë e sendeve të luajtshme të cilat posedohen nga të dy bashkëshortët mundëson gjithashtu që të matet kontributi ndaj kreditorëve dhe të realizohet e drejta e kompesimit. Së treti, është fjala për prezumimin e një pasurie si vetjake. Kështu, pasuria e luajtshme, e paracaktuar për përdorim vetjak nga njëri prej bashkëshortëve, presumohet se i përket këtij të fundit. Këto dy prezumimet e fundit janë të rëndësishme për t'u mbajtur parasysh në çastin e mbarimit të regjimit të pasurive të ndara²³².

Regjimi i pasurive të ndara do të thuhet se nuk mbaron, pasi edhe me zgjidhjen e martesës sipas ligjit tonë bashkëshortët kalojnë në regjimin e pasurive të ndara që do të thotë me zgjidhjen e martesës rregullohen pasojat e zgjidhjes së martesës dhe në rastin eventual të përzierjes së ndonjë pasurie në mënyrë të pashmangshme do të ndahet sipas formulës së regjimit të pasurive të ndara²³³. Në rastin e parë, pra të vdekjes së njërit bashkëshort, në mungesë të një testamenti të vlefshëm, vlen të rikujtojmë të drejtën e trashëgimisë me

²³² Mandro, A., (2009), *E drejta familjare*. Tiranë, fq.260-261.

²³³ Kodi i Familjes, neni 120.

ligj. Di dhe mundësi kompensimi për të cilat mund të vendoset që diferenca e mundshme të paguhet me para në dorë²³⁴.

Sa i përket të drejtës së kthimit, edhe në rastin kur martesë mbaron (vdekje e bashkëshortit, zgjidhje) edhe në rastin kur shpallet e pavlefshme, nëse pasuria e njërit prej bashkëshortëve është shtuar që nga lidhja e martesës, bashkëshorti tjetër, në rastin kur ai ka kontribuar në një mënyrë ose në një tjetër për këtë shtim, ka të drejtën të kërkojë kthimin e pjesës së shtuar nga kontributi i tij (Kodi i Familjes, neni 121). Kjo e drejtë e kthimit i kalon në kontratë për shkak të vazhdimit të një gjykimi të filluar, e cila parashkruhet me kalimin e 2 vjetëve nga mbarimi ose shpallja e pavlefshme e martesës²³⁵.

5.2.1. Objekti i kontratës martesore që rregullon regjimin e pasurive të ndara

Kontrata martesore që rregullon regjimin e pasurive të ndara, si rregull duhet të parashikojë këto aspekte pasurore ndërmjet bashkëshortëve:

a) Pasuritë e ndara

Objekti kryesor i kësaj kontrate mbetet rregullimi i gjendjes juridike të pasurisë që do të fitohet gjatë martesës së bashkëshortëve. Në këtë kuptim, nëpërmjet regjimit të pasurive të ndara, bashkëshortët bien dakord që të drejtat dhe detyrimet që fitohen gjatë martesës do të mbeten të atij bashkëshorti që i ka fituar.

Kontrata martesore që rregullon këtë regjim mund të lidhet para martesë, në këtë rast regjimi i pasurive të ndara do të zbatohet që nga data e lidhjes së martesës ose pas lidhjes së martesës, në këtë mënyrë regjimi i pasurive të ndara zëvendson regjimin e mëparshëm të

²³⁴ Omari, (2012), *E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 119 - 120

²³⁵ Kodi i Familjes, neni 122.

bashkësisë ligjore apo eventualisht atë të bashkësisë me kontratë. Në këtë hipotezë të fundit kujtojmë që kontrata martesore që përmban regjimin e pasurive të ndara, në zbatim të nenit 72/1, mund të lidhet vetëm pasi ka kaluar 2 vjet nga zbatimi i regjimit të mëparshëm martesor²³⁶.

Në drejtim të objektit material të kësaj kontrate, pra të sendeve që do të bëjnë pjesë në pasuritë e ndara, duhet të dallojmë:

- a) Regjimi i pasurive të ndara kundrejt të gjithë pasurisë që do fitohet gjatë martesës. Në këtë hipotezë bashkëshortët parashikojnë se të gjitha të drejtat apo detyrimet që lindin gjatë martesës i nënshtrohen regjimit të pasurive të ndara. Ky është rasti më ekstrem dhe më i pastër për të kuptuar regjimin e pasurive të ndara, pasi këtu fillon edhe mbaron martesa në rast se bashkëshortët nuk vendosin ndryshe në regjimin e pasurive të ndara ku secili ka të drejtat dhe detyrimet më vete në lidhje vetëm me pasuritë e tij.
- b) Regjimi i pasurive të ndara vetëm për disa sende dhe anasjelltas, përjashtimi i disa sendeve nga regjimi i pasurive të ndara. Natyrisht sikur kemi theksuar edhe në rastin e bashkësisë me kontratë, nuk përjashtohet mundësia që bashkëshortët mund të vendosin që edhe pse nën regjimin e pasurive të ndara, një apo më shumë sende të jenë të përbashkëta, sikurse ndodh në praktikë veçanërisht në drejtim të banesës familjare. Aplikimi i këtij rasti kërkon angazhimin e të dy bashkëshortëve për të përfshirë vullnetin e tyre në realizimin e qëllimit final të administrimit të pasurive të tyre. Ky rast duket më i pranueshëm dhe më i leverdisshëm, pasi bashkëshortët duke u angazhuar në përcaktimin e pasurive në regjim të ndarë dhe pasuritë e përbashkëta, mund të mbrojnë më mirë interesat e familjes dhe kështu nuk e çënojnë jetën e familjes.

²³⁶ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 120.

Duhet nënvizuar themi se, këto sende do t'i nënshtrohen regjimit të bashkësisë ligjore vetëm nëse bashkëshortët e kanë përcaktuar këtë shprehimisht në kontratën e martesës. Në të kundërt, nëse bashkëshortët i referohen ekskluzivisht regjimit të pasurive të ndara, por gjatë martesës vërtetohet se disa sende fitohen me kontributin e të dy bashkëshortëve, të cilët ndajnë ndërmjet tyre çmimin apo kontribuojnë në mënyra të tjera në ftimin e pasurisë, këto sende do të konsiderohen bashkëpronësi në pjesë dhe jo bashkësi ndërmjet bashkëshortëve. Kësaj hipoteze i referohet neni 121 të Kodit të Familjes, i cili parashikon se bashkëshorti që ka kontribuar në një mënyrë apo tjetër në shtimin e pasurisë së bashkëshortit tjetër, edhe pse nën regjimin e pasurive të ndara, mund të kërkojë kthimin e pjesës që është fituar me kontributin e tij. Duke qenë se këto sende do të konsiderohen bashkëpronësi në pjesë, ato do t'i nënshtrohen regjimit juridik të kësaj bashkëpronësie të parashikuar nga Kodi Civil dhe jo bashkësisë së parashikuar nga Kodi i Familjes²³⁷. Prandaj është e nevojshme që në redaktimin e kontratës, bashkëshortët të mos lënë hapsira për keqinterpretim dhe të mund të parashikojnë fatin e secilës pasuri siç duhet dhe si do të ishte më e mira.

b) Kontributi material për detyrimet që rrjedhin nga martesë

Në kontratën që parashikon regjimin e pasurive të ndara, bashkëshortët duhet të parashikojnë kontributin që do të japë secili në interes të bashkëjetesës dhe të familjes. Ky kontribut përbëhet nga të ardhurat e nevojshme për shpenzimet e përditshme të familjes; shpenzimet në drejtim të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve, detyrimin për ushqim në favor

²³⁷ Omari, S. (2012). *E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq 140,141.

të bashkëshortit tjetër. Kjo e fundit vlen vetëm në hipotezën kur bashkëshorti është i paaftë për punë dhe nuk mund të sigurojë i vetëm të ardhurat e nevojshme për të jetuar²³⁸.

Bazuar në këto detyrime që rrjedhin nga martesë, secili nga bashkëshortët do të angazhohet me pjesën e tij nga të ardhurat që fiton me punën e tij apo me ato që rrjedhin nga pasuria vetjake e secilit. Si rregull, ky kontribut përcaktohet në vlerë monetare nëpërmjet një sasie të përcaktuar apo të përcaktueshme parash. Nuk përjashtohet mundësia që kontributi në favor të familjes të përmbushet edhe në natyrë. Kështu për shembull, vënia në përdorim të familjes të sendeve vetjake të njërit bashkëshort, si për shembull banesa familjare, një banesë e dytë ku familja kalon pushime, autovetura, apo sende të tjera të përdorimit të përditshëm, mund të konsiderohen nga bashkëshortët mënyrë e përmbushjes së kontributit në familje. Gjithashtu, aktiviteti që njëri bashkëshort ushtron në favor të familjes apo administrimit të pasurisë së bashkëshortit tjetër, nëpërmjet mirëmbajtjes dhe vënies së saj në shfrytëzim, mund të konsiderohet kontribut në natyrë, i cili zëvendëson kontributin material që duhet të përmbushë secili prej bashkëshortëve²³⁹. Ky lloj regjimi i detyron bashkëshortët më shumë se kurrë të përcaktojnë detyrimin e tyre në lidhje me kontributin në familje, pasi kur hynë në regjimin e pasurive të ndara mundet që të harrohet e vërteta e detyrimit për kontributin në familje. Ky lloj parashikimi është edhe një mënyrë e mirë për të planifikuar organizimin ekonomik të familjes si edhe sigurinë financiare të familjes. Bashkëshortët, që para lidhjes së martesës, e dinë se duhet të kontribuojnë në këtë mënyrë dhe se familja kërkon një shumë të caktuar minimum të investimit duke i përgatitur bashkëshortët për të mirat materiale personale dhe ato familjare. Qëllimi i bashkëshortëve

²³⁸ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq.141.

²³⁹Po Aty.

për të lidhur një kontratë martesë nuk mund të jetë ai i shmangies nga detyrimet që lindin nga martesë, përkundrazi përcaktimi i tyre në kontratë i bën më të qarta angazhimet dhe ndërgjegjësimi sjell efektivitet në realizimin e këtij detyrimi.

c) *Mënyra e administrimit të pasurive vetjake*

Në rastin e regjimit të pasurive të ndara, pasuri vetjake nuk janë pasuritë që ka secili bashkëshort, por ato që doktrina i ka quajtur vetjake sipas nenit 77 të Kodit të Familjes. Nëpërmjet kontratës që rregullon regjimin e pasurive të ndara bashkëshortët mund të parashikojnë mënyrën se si do të administrojnë secili pasurinë vetjake. Në këtë rast njëri nga bashkëshortët mund të japë pëlqimin që pasuria e tij vetjake të administrohet nga bashkëshorti tjetër. Në kontratë mund të parashikohen shprehimisht edhe veprimet juridike që nuk i lejohen bashkëshortit që administron pasurinë e tjetrit, apo veprime për të cilat duhet të marrë pëlqimin paraprak të bashkëshortit pronar. Duke qënë se mënyra e administrimit të sendeve vetjake të bashkëshortëve shpeshherë nuk parashikohet në kontratën martesore si edhe bazuar në faktin se në më të shumtën e rasteve kjo rregullohet nëpërmjet veprimeve konkludente të palëve, ku dispozitat e Kodit të Familjes parashikojnë disa rregulla të posaçme²⁴⁰. Bashkëshortët mund të duan të jenë të detajuar në administrimin e pasurive vetjake dhe kërkojnë të parashikojnë çdo gjë në kontratën e tyre, pasi është tërësisht e mundur që ata të shprehin vullnetin e tyre për mënyrën se si do të jetë raporti i pasurive vetjake.

²⁴⁰ Omari, S.(2012), *E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 142.

5.2.2. Mbarimi i regjimit të pasurive të ndara

Regjimi i pasurive të ndara mund të përfundojë gjatë martesës, si rezultat i një kontrate martesore nëpërmjet së cilës ky regjim zëvendësohet me bashkësinë ligjore apo bashkësinë me kontratë. Në çdo rast, regjimi i pasurive të ndara përfundon me mbarimin e martesës, pasi shkak për të cilin ekziston ky regjim pasuror është cilësia e bashkëshortit. Në të gjitha këto raste, ndryshe nga mbarimi i regjimit të bashkësisë ligjore, për të cilin shtrohet çështja e pjesëtimit të sendeve të përbashkëta, në rastin e regjimit të pasurive të ndara, si rregull, nuk paraqiten probleme të veçanta, pasi secili nga bashkëshortët merr sendet që ka fituar gjatë martesës dhe përmbush i vetëm detyrimet që ka marrë përsipër kundrejt të tretëve²⁴¹. Për këtë, lehtësimi që kanë bashkëshortët në pjesëtimin e pasurisë, vihet re pikërisht në faktin se nuk kanë procedura hierarkike dhe burokraci në arritjen e pasurive të tyre. Me mbarimin e martesës, bashkëshortët e kanë të qartë tablonë e pasurive dhe nëse ka patur ndonjë moment ku ka ndonjë pasuri që pretendohet të jetë me kontributin e të dyve, mjeti juridik që ofron ligjvënësi mund të jetë Gjykata kur këto nuk bien dakort për të kërkuar kontributin e tij, konkretisht në Kodin e Familjes në nenin 121, ku hasen të drejtat e regresit.

Në përmbajtje kjo dispozitë legjitimon bashkëshortin kontribues për të kërkuar pjesën e tij, pasi ai pretendon që ka investuar. Nga këto karakteristika duket se është padi regresi, me anë të së cilës kërkohet të rivendosen të drejtat e investimit. Këto të drejta mund t'u kalohen trashëgimtarëve në rast të mbarimit të martesës nga vdekja e njërit bashkëshort dhe në këto kushte mund të kërkohet pjesa e trashëgimlënësit për t'u kompensuar dhe është pjesë e pasurisë trashëgimore.

²⁴¹ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 143.

Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, si dhe padia e rivendikimit është e paparashkrueshme, por në rastin në fjalë na rezulton se pasurinë trashëgimore që duhet ta përftojnë trashëgimtarët nga pasuria bashkëshortore duhet ta kërkojnë brenda dy viteve, në të kundërt parashkruhet. Qëllimi i ligjvënësit në këtë rast ka qënë për të garantuar sigurinë juridike të bashkëshortit pasjetues, pasi nuk mundet që ky subjekt të vazhdojë të jetë në kërcënim për pakësimin ose jo të pasurisë në pritje të kësaj padie gjatë gjithë jetës ku vetë instituti i martesës ka mbaruar efektet e saj.

Në krahasim të këtyre dispozitave e kemi të qartë se ligji është kujdesur gjithmonë që pasuria të shkojë në destinacionin e duhur tek pronari dhe të disponohet lirisht nga ai. Kjo mundësi u jepet në mënyrë të posaçme trashëgimtarëve të trashëgimlënësit që ka qënë në regjim me kontratë të pasurive të ndara, pasi këtu mund të fshihet më mirë se në cilindo regjim pasuria e pronarit, duke qënë se në pamje të parë me regjimin e pasurive të ndara, bashkëshortët janë tërësisht të shkëputur nga njëri-tjetri dhe në këto kushte pasuria nuk është përzier. Nga ana tjetër nëse ka ndodhur që në një pasuri të kenë kontribuar të dy, por për shkak të rrethanave nuk është përcaktuar drejt se e kujt është, bashkëshorti që disponon kontributet e bashkëshortit tjetër nuk mund të mbajë pasurinë e ish bashkëshortit të tij.

5.3. Regjimi i bashkësisë universale me kontratë

Ky regjim është i veçantë për sa i përket faktit se tejkalon bashkimin ligjor të pasurive dhe hedh poshtë mitizimin se me regjimin me kontratë vetëm i largon bashkëshortët, por me sa shihet nga ana tjetër ky regjim mundëson bashkëshortëve të gjitha alternativat. Sipas kërkesave të subjekteve të së drejtës, kjo e fundit iu është përshtatur atyre duke iu

mundësuar edhe bashkimin e pasurive më shumë se sa ligji e parashikon nëse bashkëshortët duan ta bëjnë një gjë të tillë.

Në kodin tonë ky regjim gjen zbatim te neni 108, e në vijim dhe shpjegohet me hollësi të veçanta që ka ky regjim. Është e kuptueshme së në kushtet kur bashkësia është njëkohësisht edhe regjimi ligjor²⁴² i parashikuar nga Kodi i Familjes, nëpërmjet bashkësisë me kontratë bashkëshortët, veçse mund të ndryshojnë disa nga rregullat e parashikuara nga Kodi i Familjes në drejtim të bashkësisë ligjore. Sikurse rezulton nga leximi i nenit 108 deri tek neni 114, në rastin e regjimit të bashkësisë me kontratë, liria kontraktore e bashkëshortëve është e kufizuar. Kështu, ata mund të ndryshojnë regjimin e bashkësisë ligjore, duke e shndërruar në një bashkësi që i përshtatet më shumë interesave të tyre, por nuk mund të ndryshojnë tërësisht rregullat e tij²⁴³.

Në konceptin e bashkësisë universale duhet të kuptojmë mirë bashkësinë ligjore dhe të rikujtojmë pasuritë vetjake, pasi regjimi i bashkësisë universale është një kombinim i këtyre dy instituteve. Më qartë me bashkësinë universale mundemi të përfshijmë në regjim pasuror martesor çdo pasuri e luajtshme e fituar nga bashkëshortët para lidhjes së martesës dhe çdo pasuri e fituar nga secili prej tyre, gjatë martesës, (duke përfshirë edhe pasurinë e fituar me dhurim ose trashëgimi) është pasuri e përbashkët, nëse bashkëshortët nuk kanë zgjedhur një regjim tjetër pasuror. Pasuria e fituar me dhurim ose trashëgimi përjashtohet nga bashkësia, vetëm nëse dhuruesi ose trashëgimlënësi e ka përjashtuar shprehimisht këtë pasuri nga përfshirja në bashkësi. Nisur nga neni 108 i Kodit të Familjes, duket sikur bashkëshortët që duan të kenë bashkësi universale me kontratë duhet të kenë lidhur martesë një herë dhe të

²⁴² Galletta F.(1989).*La comunione convenzionale*, në *La comunione legale a cura di C.M. Bianca*, Milano, fq. 1043.

²⁴³ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq. 143.

jenë në regjimin e bashkësisë ligjore pastaj të ndryshojnë regjim më vonë. Kjo mund të jetë një alternativë dhe mund të ndodhë, por qëllimi i ligjvënësit nuk ka qënë ky, por në këtë dispozitë ka përkufizuar objektin e kontratës së martesës në regjimin e bashkësisë universale²⁴⁴. Duke na treguar kështu se është bashkësi ligjore së bashku me pasuritë vetjake. Tek kjo e fundit duhet të sqarojmë faktin se këto nuk mund të përzihen asnjëherë deri në fund pasi pasuritë vetjake kanë natyrë posaçërisht të tillë të paktën në 3 raste që ligji e ka parashikuar si ndalesë. Në nenin 109 paragrafi i dytë thuhet se *“Mbetet pasuri vetjake dhe nuk mund të përfshihet në bashkësi pasuria e luajtshme e parashikuar në shkronjat “c”, “ç”, “d” të nenit 77 të këtij Kodi.”*.

Nga ana tjetër shtrohet pyetja se a mundet që bashkëshortët të gjejnë një formë tjetër ligjore për t’i bërë pjesë të regjimit ose pasuri të bashkëshortit tjetër? Për t’u përgjigjur kësaj pyetje fillimisht do t’i referohemi të drejtës së brendshme, pasi nuk është e ndaluar që secili bashkëshort të mund t’i dhurojë tjetrit cilëndo pasuri, mjafton që të jetë në emër të dhuruesit. Kjo situatë është e logjikshme, pasi çdo gjë që s’është e ndaluar është e lejuar, në asnjë dispozitë se kemi hasur kufizimin e dhurimit të pasurive ndërmjet bashkëshortëve apo në emër të bashkësisë, kështu që lirisht secili mundet që me institutin e dhurimit të përgjithshëm, pra sipas konceptit të kontratës së dhurimit, të japë në favor të bashkëshortit tjetër ose bashkësisë pasuri të tijat dhe kështu u tjetërson status këtyre pasurive duke përcaktuar një fat tjetër për to²⁴⁵.

Së dyti, nëse do të hidheshim në të drejtën Belge gjatë gjithë shpjegimit të regjimeve pasurore të martesës, përmendet instituti i dhurimit ndërmjet bashkëshortëve si institut më

²⁴⁴ Mandro, A., Mecaj, V., Zaka, T., Fullani, A., (2006). *E drejta Familjare*. Shtëpia Botuese Kristalina, Tiranë, faqe 356.

²⁴⁵ Vendimi Unifikues nr.3 viti 2006.

vete për shkak të statusit tërësisht të veçantë që kanë bashkëshortët në këtë regjim²⁴⁶. Në këtë shtet dhurimi bëhet që në fillim me këtë sqarim dhe është i parevokueshëm, ku destinacioni kësaj pasurie është sipas legjislacionit dhe nuk ka ndonjë preferim si pasuri për mënyrën se si është fituar²⁴⁷.

Është e dukshme se ky regjim në thelb të tij përmban një besim shumë më të avancuar të bashkëshortëve për njëri-tjetrin, por jo vetëm, edhe besim tek instituti i martesës si edhe të gatshëm për t'u mos u ndarë²⁴⁸.

Në këtë lloj regjimi vëmë re se bashkësia si e tillë e njohur edhe si një regjim i rregulluar plotësisht nga Kodi i Familjes në kontekstin e bashkësisë ligjore, ka ruajtur thelbin e vet si një tërësi elementesh të përbashkëta, por është ridimensionuar, modifikuar përmes kontratës (marrëveshja) të realizuar ndërmjet bashkëshortëve. Sa i përket kufijve të ndërhyrjes në këtë modifikim, nënvizojmë se këto nuk mund të çenojnë dispozitat urdhëruese lidhur me detyrimet që burojnë nga martesa²⁴⁹. Nga ana tjetër, u duhet bërë e qartë bashkëshortëve që në rastin e bashkësisë me kontratë, mbeten të zbatueshme rregullat e bashkësisë ligjore për ato çështje që palët nuk kanë pasur asnjë rezervë apo modifikim në kontratën e tyre²⁵⁰. Në këtë rast flasim për një regjim të përzier si të thuash *quasi* ligjor dhe *quasi* me kontratë të bashkësisë²⁵¹.

²⁴⁶ Grégoire, M. (1995). *Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Bruylant Akademia s.a.

²⁴⁷ Kodi Civil Francez, neni 1081-1090.

²⁴⁸ Grégoire, M. (1995). *Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Bruylant Akademia s.a.

²⁴⁹ Kodi i Familjes, neni 66 dhe 67.

²⁵⁰ Spaht K., dhe Karrol A., (2009), *Louisiana Matrimonial Regimes*, Vandeplas Publishing, faqe 354.

²⁵¹ Mandro, Arta, (2009), *E drejta familjare*, Tiranë, fq.257.

Regjimi i bashkësisë me kontratë na shfaqet në disa forma në varësi të modifikimeve që bëjnë bashkëshortët në përmbajtjen e pasurisë së bashkësisë duke e etiketuar këtë rast pas rasti në bashkësi të thjeshtë me kontratë, në bashkësi të pjesëve jo të barabarta ose në bashkësi universale.

5.3.1. Përbërja e bashkësisë

Bashkëshortëve u njihet mundësia të zgjerojnë rrethin e sendeve të bashkësisë në raport me atë të bashkësisë ligjore, i cili parashikohet nga neni 74²⁵² e 75 i Kodit të Familjes.

- Zgjerimin e kategorive të sendeve të përbashkëta
- Bashkësia me kontratë mund të përfshijë sende të luajtshme të fituara para lidhjes së martesës dhe/apo fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës
- Bashkësia me kontratë të jetë bashkësi universale ku nuk mund të përfshijë disa sende të cilat Kodi i Familjes i parashikon me dispozita urdhëruese si sende vetjake. Janë të tilla sipas nenit 114, ato që parashikohen nga neni 77 gërma c); ç) dhe d). Një marrëveshje e kundërt, e cila do të përfshijë në bashkësi universale edhe këto kategori të sendeve vetjake, do të jetë e pavlefshme.
- Bashkësia me kontratë të realizojë kombinime të kategorive të parashikuara më sipër. Kështu për shembull; mund të përfshijë në bashkësi vetëm një send të paluajtshëm të fituar para lidhjes së martesës sikurse ndodh në praktikë në rastin e banesës familjare. Apo

²⁵² Mënyra se si e ndan doktrina kategorinë e sendeve që hyjnë në bashkësi që nga data e fitimit të tyre (pikat a, d të nenit 74), duke formuar kështu një bashkëpronësi të menjëhershme, e cila njihet si bashkësi aktuale; b) Sendet që hyjnë në bashkësi në datën e përfundimit të saj, nëse janë të pakonsumuara (pika b, c të nenit 74), e cila njihet si bashkësia në të ardhmen ose si bashkësi eventuale. Sendet e bashkësisë eventuale kanë natyrë dualiste. Megjithatë të fituara gjatë martesës, konsiderohen vetjake të bashkëshortit që i ka fituar, por njëkohësisht janë të destinuara ta humbasin këtë karakter, në momentin e mbarimit të bashkësisë, duke u shndërruar në sende të përbashkëta. Për më shumë shih: Omari, S.(2012). *E drejta familjare*, vep e cit, fq. 95-103.

mund të përfshijnë në bashkësi kategori të tjera nga ato që parashikohen në rastin e bashkësisë ligjore si sende vetjake ose si sende të bashkësisë eventuale²⁵³.

5.3.2. Rregullat e administrimit të bashkësisë

Nëpërmjet bashkësisë me kontratë edhe pa modifikuar përmbajtjen e bashkësisë apo së bashku me këtë modifikim, bashkëshortët mund të ndryshojnë rregullat e parashikuara nga Kodi i Familjes në drejtim të administrimit të bashkësisë ligjore. Sipas nenit 11 të Kodit të Familjes, bashkëshortët mund të bien dakord që të gjitha veprimet e administrimit, si ato të zakonshme ashtu edhe ato jo të zakonshme, të bëhen me pëqimin e të dy bashkëshortëve. Në këto raste, njëri bashkëshort nuk mund të kryejë i vetëm asnjë veprim, sado i zakonshëm të jetë ai në raport me administrimin e pasurisë së përbashkët²⁵⁴.

Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton se bashkëshortët nuk mund të ndryshojnë rregullat që lidhen me veprimet e administrimit jo të zakonshëm. Kështu, duke iu referuar vetëm mundësisë së pjesëmarrjes së të dy bashkëshortëve në çdo veprim administrimi *per a contrario* lihet jashtë mundësia e kundërt që bashkëshortët të rregullojnë me marrëveshje mundësinë e kryerjes së të gjitha veprimeve të administrimit, vetëm nga njëri bashkëshort²⁵⁵.

Bashkëshortët mund të ndryshojnë me kontratën martesore pjesët e barabarta që i përkasin seclit në pjeëstimin e bashkësisë ligjore. Në këtë hipotezë, bashkëshortët mund të parashikojnë konkretisht pjesë të tjera ideale, apo mund të parashikojnë kriteret sipas të cilave do të përcaktohet pjesa ideale. Kështu, për shembull; ata mund të parashikojnë se

²⁵³ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq.143.

²⁵⁴ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq.143.

²⁵⁵Po Aty.

“kontributi efektiv në fitimin sendeve të përbashkëta”, do të jetë kriteri në bazë të të cilit do të pjesëtohen sendet e bashkësisë me kontratë. Bashkësia me kontratë ndikon në përmbajtjen e pasurisë në skemën e kredive (të ardhura dhe përfitime) e detyrimeve të bashkëshortëve. Në rastin e bashkësisë me kontratë, përsëri kemi një bashkëjetesë midis pasurisë së bashkësisë dhe pasurisë vetjake. Së pari, përmes këtij regjimi me kontratë, bashkëshortët mund të bien dakort që bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme para martesës dhe fitimet që vijnë nga pasuritë, pasuria e bashkëshortëve vinin në bashkësi nëse “mbesnin” pra nuk konsumoheshin. Këto dy standarte i kemi të modifikuar në rastin e bashkësisë me kontratë.

Kjo është një bashkësi e thjeshtë me kontratë, sepse pjesën më të madhe të rregullimeve e gjejmë përsëri në dispozitat e Kodit të Familjes (pjesa e bashkësisë ligjore). Në këtë rast, pasuria në bashkësi përbëhet nga pasuria në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore, nga pasuria e luajtshme para martesës dhe fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës të cilat hyjnë menjëherë në bashkësinë me kontratë. Sa i përket pasurisë vetjake, nga përmbajtja e nenit 77 të Kodit të Familjes, duhet të zbresim atë që bashkëshortët vendosin të kalojnë në bashkësinë me kontratë.

Në këtë rast legjislatori i ka kushtuar një rëndësi ruajtjes së masës së domosdoshme që pasuria vetjake të mos çënohet në thelbin e kuptimit dhe të rolit të vet si e tillë. Kështu, jo çdo pasuri e luajtshme mund të përfshihet në bashkësinë me kontratë. E tillë mbetet (pra vetjake) pasuria e luajtshme e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesoret e pasurisë vetjake; mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare; pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të

ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë. Sa i përket detyrimeve të bashkëshortëve para martesës këta duhet të përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi deri në kufirin e vlerës së pasurisë së tyre, e cila në bazë të kontratës së lidhur, është pjesë përbërëse e bashkësisë²⁵⁶.

Së dyti, lidhur me modifikime të tjera në përmbajtjen e bashkësisë (pasurisë) me kontratë, vëmë re se bashkësia me kontratë mund të konceptohet edhe në pëmasat e një *bashkësie universale*. Kjo do të thotë që bashkëshortët bien dakort që të përfshijnë në pasurinë e bashkësisë çdo pasuri e të ardhur (Kodi i Familjes, neni 114) të luajtshme dhe të paluajtshme, që ekziston në çastin e lidhjes së martesës dhe që do të vihet në të ardhmen (gjatë martesës). Përsëri legjislatori nënvizon rezervën e përjashtimin të pasurisë vetjake të parashikuar në shkronjat c, ç, d të nenit 77 të Kodit të Familjes²⁵⁷.

Sa i përket detyrimeve, bashkësia universale përballon të gjitha detyrimet e bashkëshortëve, që ekzistojnë në çastin e lidhjes së kontratës dhe gjatë martesës. Pavarësisht nga mënyra e shprehjes së legjislatorit lidhur me detyrimet që ekzistojnë në çastin e lidhjes së kontratës, çdo regjim merr vlerë dhe bëhet i detyrueshëm nëse martesa është lidhur.

- Bashkësia me kontratë ndikon në përbërjen e pjesëve duke vendosur rregulla të reja lidhur me pjesët dhe ndarjen e tyre, ndryshe nga bashkësia ligjore që nënkupton barazinë e pjesëve. Në këtë mënyrë, bashkëshortët bien dakort që të kenë në bashkësi pjesë jo të barabarta (neni 112-113 i Kodit të familjes). Kjo ndarje jo e barabarte duhet të reflektohet edhe në përgjegjësinë ndaj detyrimeve, çka do të thotë që detyrimet janë në përpjestim të drejtë me pjesën që i takon secilit bashkëshort me bashkësinë me kontratë. Çdo rregullim

²⁵⁶Kodi i Familjes, neni 110.

²⁵⁷ Omari, S.(2012).*E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, fq.143.

në kundërshtim me parimin e reciprocitetit është i pavlefshëm. Çdo klauzolë e kontratës është e pavlefshme nëse detyron bashkëshortin me pjesë të kufizuar ose trashëgimtarët e tij të përballojnë një detyrim më të madh se pjesa e tyre në raport me këtë pjesë. Kjo vlen edhe për trashëgimtarët e bashkëshortëve të cilët i përballojnë detyrimet në raport me pasurinë që kanë trashëguar nga bashkësia²⁵⁸.

- Bashkësia me kontratë mund të ndryshojë rregullat lidhur me administrimin e pasurisë. Bashkëshortët mund të bien dakort që ta administrojnë së bashku pasurinë e bashkësisë, pra asnjë veprim të mos prezumojë pëlqimin apo përfaqësimin e tjetrit. Në këtë rast, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë së bashkësisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të dy bashkëshortëve dhe përmbajnë detyrimin solidar të tyre²⁵⁹.

²⁵⁸Po Aty, fq 143-144.

²⁵⁹Kodi i Familjes, (2003), neni 111.

KAPITULLI VI: VLERAT JURIDIKO - SOCIALE TË KONTRATËS SË MARTESËS

Lidhja e një kontrate martesore mund të forcojë marrëdhënien mes dy bashkëshortëve duke reduktuar konfliktet për sa i përket të drejtave pasurore e për rrjedhojë duke sqaruar çdo dyshim apo paqartësi në lidhje me abuzimin në rastin eventual të zgjidhjes së martesës. Shpesh njërëzit imagjinojnë se negociatat për një kontratë martesore çojnë në konflikt, ndërkohë që komunikimi rreth çështjeve të pasurisë mund të përmirësojë cilësinë e marrëdhënies dhe komunikimin në martesë. Edhe nëse diskutimi nuk përfundon me nënshkrimin e një marrëveshjeje të shkruar, duke folur sinqerisht rreth aspekteve pasurore të secilit bashkëshort, mund të eliminohen keqkuptimet që mund të shfaqen në të ardhmen. Herët ose vonë bashkëshortët e ardhshëm do t'u lindin nevoja për të diskutuar rreth temës së ekonomisë bashkëshortore dhe në këto kushte do të duhet të përballen me gjithë kompleksitetin që kanë këto lloj çështjesh ndërmjet bashkëshortëve. Në rast të komunikimit të hapur ndërmjet bashkëshortëve, është vënë re rezultati i këtyre bisedave në administrimin e pasurive në të ardhmen dhe financave të familjes²⁶⁰. Bashkëshortët me lidhjen e martesës fillojnë dhe krijojnë për veten e tyre profil unik si të martuar. Ky format për disa subjekte është kufizim dhe mohim i mundësisë së tij për të qënë i lirë ekonomikisht për sa i përket investimeve të tij. Prezantimi i paketës pasurore para lidhjes së martesës është konsideruar si nivel i lartë i lirisë së secilit bashkëshort, duke i mundësuar atij martesën, por pa kufizimin e autonomisë pasurore.

²⁶⁰ Bartholomew & Wasznicky, (2012), “*Prenuptial Agreements*” California, faqe 12

6.1. Autonomia pasurore e bashkëshortëve

Bashkëshortët vendosin me mirëkuptim se cilin regjim do të zgjedhin në vijimin e martesës së tyre duke rregulluar kështu problemin ekonomik me një kontratë të thjeshtë ose duke lejuar ligjin të administrojë me formulën standarte pasuritë gjatë martesës. Secili bashkëshort shpreh vullnetin e tij dhe në rast se arrijnë të përputhin vullnetet e tyre në një të vetëm atëherë angazhohen në aplikimin e njërit regjim apo tjetër. Duke njohur mirë të drejtat e tyre dhe mundësitë që ligji iu ofron në zgjedhjen e regjimeve, zgjedhja bëhet më e drejtë dhe më e ndërgjegjshme për pasojat.

E drejta e pronësisë ka një status specifik në doktrinë, pasi në legjislacionin tonë dhe është përkufizuar si e drejtë absolute, reale madhore, që duket se është e garantuar mjaft mirë nga ligji. Rëndësia e saj buron që nga lashtësia, pasi pronësia është konsideruar si pushtet i pronarit mbi pasurinë e tij dhe në lidhje me të tretët gëzon statusin detyrues për ta respektuar këtë pushtet. Bashkëshorti pronar, qoftë njëri apo tjetri, ka detyrimin ndaj të drejtës së tij të pronësisë të mund të disponojë lirisht pasuritë e tij. Këtë të drejtë e siguron automatikisht që nga momenti që fiton pronësinë në një nga mënyrat e parashikuara në ligj, konkretisht neni 162 i Kodit Civil e në vijim. Që nga ai moment, ligji i garanton të drejtën e pronësisë me instrumentët përkatës, neni 1 i Protokollit nr.1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut “*Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij*”, në vijim neni 41 i Kushtetutës “*E drejta e pronës private është e garantuar*”, si dhe Kodi Civil në kapitullin e pronësisë.

Deri vonë bashkëshortët kur lidhnin martesë e merrnin të prezumuar edhe bashkimin e pronësive në vijim dhe me qëllim krijimin e familjes, nuk i shmangeshin dot përzierjes së pasurive. Ndërkohë legjislacioni ka përparuar, pasi në rastin e martesës që krijohet

automatikusht regjimi pasuror ligjor, ligjbërësit kanë avancuar në lidhje me krijimin e alternativave të tjera që me lidhjen e martesës secili bashkëshort i ardhshëm të ruajë pasuritë e tij. Sado që bashkëshortët ndjehen të lirë në redaktimin e një kontrate martese, duhet të rikujtojmë se gjithmonë kushtëzohen nga ligji për të mos devijuar nga parimet themelore²⁶¹.

Në rastin e kontratës së martesës e kemi shpjeguar se vullneti duhet të jetë i shprehur pasi po nuk u shpreh ky vullnet, merret e mirëqenë sikur bashkëshortët kanë pranuar regjimin e bashkësisë ligjore. Me kontratën e martesës ata mund të përcaktojnë nëse duan regjimin e pasurive të ndara ose të bashkësisë universale dhe të mund të avancojnë deri në përcaktimin konkret të secilës pasuri. Pikërisht, zgjedhja që duan të bëjnë secili nga bashkëshortët në lidhje me pasuritë e tyre është një formë e shprehjes së vullnetit²⁶² në lidhje me pasuritë e tyre dhe në të vërtetë është një e drejtë që buron nga potenciali që ka e drejta e pronësisë, prandaj ligjvënësi ka mundësuar këtë lloj instituti, që të mund të martohen pa u kufizuar e drejta e pronësisë. Çdo kufizim i së drejtës duhet të jetë i justifikuar në kuadër të parimit të proporcionalitetit²⁶³ për të mundësuar gëzimin e një të drejte, duke justifikuar kufizimin e një tjetre. Kjo arrihet nëpërmjet metodës së balancimit të të drejtave dhe përparësisë të njëjës vetëm për rastin konkret²⁶⁴. Prandaj ka një rëndësi specifike të ndalemi në mënyrë të detajuar se si e realizon kontrata e martesës mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe si e lejon realizimin e këtij vullneti pa u ndikuar nga asnjë institut tjetër i së drejtës.

²⁶¹VUGJL Civil nr.5 viti 2009.

²⁶² Kreitner R., (2007), *“Calculating Promises; the emergence of modern American contract doctrine”* Stanford University Press, Standford, California.

²⁶³Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

²⁶⁴Kujtojmë këtu parimin se të drejtat e njeriut janë të pandashme, të padhunueshme, të patjetërsueshme neni 15 I Kushtetutës

Ajo çfarë munden bashkëshortët të realizojnë me kontratën e martesës janë dy lloj regjimesh kemi shpjeguar *supra*, regjimin e pasurive të ndara dhe regjimin e bashkësisë universale me kontratë. Në të dy rastet do të vëmë re se si bashkëshortët munden të disponojnë mbi pasuritë e tyre dhe mund të dialogojnë me to në kontratë, qoftë për ndarjen e plotë dhe të pastër të pasurive po ashtu edhe në bashkimin e tyre.

Tagrat e pronarit në lidhje me gëzimin, posedimin dhe disponimin, bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara i gëzojnë pothuajse të pastra tërësisht. Tagrin e parë në lidhje me gëzimin²⁶⁵ bashkëshorti pronar i një pasurie të caktuar, në regjimin e pasurive të ndara e gëzon i vetëm të drejtën për ta përdorur ose mospërdorur, që do të thotë se frytet e këtij sendi i merr ai, vendos ai për mënyrën e përdorimit të këtij sendi, vendos ai se si do të sillet me sendin deri edhe shkatërrimin e tij²⁶⁶.

E drejta e gëzimit të një sendi, nga ana e bashkëshortit pronar nuk ka pse të jetë e kushtëzuar nga vullneti i bashkëshortit tjetër. Kështu pronari ka lirinë e plotë dhe vullneti i tij në lidhje me këtë send vihet re se si e shfrytëzon ai dhe kur shpreh qëndrimin për frytet e tij.

Për sa i përket të drejtës së dytë, *posedimi*, është më kritike situata në lidhje me autonominë pasurore, pasi bashkëshorti pronar mund të ketë një lloj kushtëzimi për shkak të martesës dhe jetës së përditshme normale. Së pari, kujtojmë se posedimi është gjendje faktike mbi sendin, ndërsa pronësia është gjendje juridike²⁶⁷, që do të thotë që posedimin e pasurisë pronari e bën në rastet kur e përdor atë dhe jo në çdo rast, pasi edhe mund të mos e

²⁶⁵ Nuni, A. & Hasneziri L. (2010), *E drejta civile II, Pronësia*, Tiranë, fq.222.

²⁶⁶ Vep e cit, Galgano, F. (1992). *E drejta private*, Botimi i III, fq. 138.

²⁶⁷ Po Aty, fq. 170.

posedojë, por vazhdon të jetë pronar si dhe më tej edhe nëse e përdor bashkëshorti i cili ka marrë vetëm mundësinë e posedimit dhe jo tagrat e tjera të pronarit.

Lind pyetja: Si do të shfrytëzohet ky tagër për bashkëshortët?

Ka rëndësi t'i përgjigjemi kësaj pyetje, pasi edhe vetë legjislatori ka bërë rregullime përkatëse për këtë rast, por jo vetëm duke u nisur nga fakti se jeta familjare është më e gjërë se sa objekti i kontratës²⁶⁸, prandaj e kemi emërtuar kontratën e martesës si veprim juridik *sui generis*, për shkak të reaksionit që ai jep në marrëdhënie juridike të posaçme. Prandaj do të trajtojmë dy rastet e posedimit dhe të gëzimit, sipas regjimeve me kontratë se si duhet të sillen secili bashkëshort për të drejtat e në pronën e bashkëshortit tjetër. Në të drejta reale të pronësisë janë njohur edhe të drejtat që ka subjekti jopronar mbi pronën e tjetrit sipas një akti të ligjshëm. E drejta e pronësisë ndahet nga dy lloj të drejtash: në grupin e parë janë të drejtat e pronarit mbi sendin e tij dhe në grupin e dytë janë të drejtat e jopronarit mbi sendin e tjetrit, përkatësisht *ius in re propria* dhe *ius in re aliena*. E drejta e posedimit është një e drejtë reale²⁶⁹, për të cilën subjekti jopronar është subjekt që ka mundësi të përdorë sendin e tjetrit sipas një akti të ligjshëm²⁷⁰. Pikërisht në këtë pikë do zgjerojmë analizën, për sa i përket rastit të regjimit me kontratë për regjimin e pasurive të ndara dhe regjimin e bashkësisë universale. Në lidhje me regjimin e pasurive të ndara, sipas legjislacionit e kemi të qartë se “*secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij.*”²⁷¹. Sipas këtyre dispozitave, administrimi i pasurisë nga bashkëshorti

²⁶⁸Lamçe J. “Bashkëjetesa në çift në të drejtën familjare shqiptare:kuadri normativ aktual dhe debati për reformim”

²⁶⁹ Nuni A. & Hasneziri L., (2010), *E drejta civile II, Pronësia*, Tiranë, fq.524.

²⁷⁰ PoAty, fq.540.

²⁷¹Neni 115 Kodi i Familjes, (2003).

jopronar bëhet sipas rregullave të përfaqësimit²⁷², që do të thotë veprimet e kryera nga i përfaqësuari janë për llogari dhe detyrim të të përfaqësuarit. Në pamje të parë duket një akt përfaqësimi i mirëfilltë, por në të vërtetë në një interpretim më të thellë, legjislatori tregohet më liberal në këtë rast në lidhje me përfaqësimin, pasi nga vetë lloji i marrëdhënies, ndërmjet bashkëshortëve, marrëdhënie familjare, e drejta anon më shumë në mbrojtje të kësaj të fundit kundrejt të tjerave. Prandaj vëmë re në këto dispozita, koncepte të reja në lidhje me përfaqësimin. Konkretisht thuhet se:

“Bashkëshorti përfaqësues nuk është i detyruar të japë llogari për kthimin e fryteve, nëse prokura nuk e detyron shprehimisht për një gjë të tillë.”. Një përfaqësues në kushte dhe rrethana të tjera, është i detyruar të kthejë frytet, ndërkohë ligji këtu është liberal vetëm për shkak të llojit të marrëdhënies së krijuar dhe duke marrë në konsideratë se prezumohet që marrëdhënia martesore i pranon vullnete të kësaj natyre dhe në rast të kundërt nëse duan të jetë ndryshe mund ta ndalojnë në prokurë. Në vijim të këtyre dispozitave në nenin 117 dhe 118, ligji shprehet se bashkëshorti mundet të kryejë veprime administrimi të bashkëshortit tjetër. Megjithatë, nëse ka kundërshtime nga bashkëshorti tjetër, ai nuk i kryen dot ato dhe gjithashtu detyrohet për frutat që ekzistojnë dhe jo ato që janë konsumuar. Ndër të tjera legjislatori shprehet se nuk paguan shpenzimet vetëm në lidhje me disponimin, që është një tagër ngushtësisht i pronarit. Ky tagër është në kategorinë e të drejtave *iura in re propria*, të cilën pronari, në qoftë se nuk e ka këtë të drejtë, nuk është më pronar²⁷³. Me këtë sanksionim që bën ligji na krijon bindjen që bashkëshorti tjetër gëzon të dy të drejtat e pronës së bashkëshortit pronar, dhe vetëm në rast se ky i fundit ia ndalon, ai nuk mundet t'i

²⁷²Neni 64-78 Kodi Civil dhe neni 117 Kodi i Familjes.

²⁷³ Nuni A. & Hasneziri L., (2010), *E drejta civile II, Pronësia*, Tiranë, fq.529.

gëzojë. Duket sikur është një formë e prezumimit të së drejtës së posedimit dhe të gëzimit, por jo atë të disponimit. I gjithë ky qëndrim duhet të merret me rezervë, pasi bashkëshorti jo-pronar nuk mund të ndalohet të përdorë dhe të gëzojë pasuritë e bashkëshortit tjetër, për shkak se kjo të bie ndesh me parimet e përgjithshme që mbrojnë familjen²⁷⁴. Në regjimin e bashkësisë universal, situata është më e qartë për sa i përket të drejtave të pronësisë, pasi në këtë pikë bashkëshortët janë bashkëpronarë dhe për të kuptuar këtë do t'i referohemi dispozitave të kodit civil në lidhje me bashkëpronësinë në tërësi²⁷⁵, ku bën pjesë në kapitullin e bashkëpronësisë së detyrueshme. Duke na bërë kështu të kuptojmë prezumimin e ½ pjesë, por në tërësi të pasurisë dhe ata të dy së bashku janë pronarë në të gjithë pasurinë njëjloj. Në këtë pikë ato gëzojnë të drejtat e *iura in re propria* në tërësi pa u ndalur në të drejta të posaçme për secilin mbi sendet e bashkësisë. Ndërkohë ne kemi sqaruar edhe rastin e bashkësisë universale kur bashkëshortët vendosin të bëjnë pjesë të bashkësisë edhe përfshirjen e pasurive të luajtshme në bashkësi dhe të mund të jenë të dy pronarë të këtyre pasurive. Sërish këtu flitet për të drejtat e plota të pronarit dhe ata sillen njëjloj ndaj sendeve dhe përgjigjen ndaj të tretëve njëjloj për sendet në fjalë. Të njëjtin zbatim bëjmë edhe për pasuritë vetjake të nenit 77 të Kodit të Familjes, kur bashkëshortët vendosin t'i bëjnë pjesë të bashkësisë universale, përveç pikës c, ç dhe d, pasi nuk ka vend për diskutim për aq kohë sa ata janë njëjloj pronarë edhe tek dhurimet edhe tek trashëgimia etj., ku kanë të drejtat e plota të pronarit.

²⁷⁴ Çështja “Macleod v Macleod” 2008 UKPC 64

²⁷⁵Neni 231 i Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket të drejtës së *disponimit* është e drejtë që i përket vetëm pronarit²⁷⁶, duke qënë në kategorinë e së drejtës eksplicite të pronarit, ku me tjetërsimin e saj bëhet ndryshimi i subjektit të marrëdhënies juridike të pronësisë. Në këto kushte kuptojmë se në regjimin e pasurive të ndara, kjo e drejtë vazhdon dhe qëndron vetëm e pronarit dhe në asnjë moment nuk ndahet. Pikërisht në këtë mënyrë e mbron të drejtën e pronësisë kontrata e martesës me ndarjen e të drejtave ndërmjet bashkëshortëve. Në regjimin e pasurive të ndara shpjegojmë më lart se mund të lejohet në mënyrë të heshtur apo të shprehur mundësia e gëzimit apo posedimit të pasurive të bashkëshortit pronar, por nuk flet në asnjë rast për disponim. Madje kjo e drejtë është ajo që e ndan këtë regjim nga të tjerët, pasi vetëm këtu del mjaft qartë ideja që disponimi i përket vetëm bashkëshortit pronar dhe prandaj nuk janë bashkëpronarë dhe kanë zgjedhur këtë regjim, në mënyrë që të përcaktojnë vetë pronari mundësinë për ta tjetërsuar ose jo, për t'ia ndryshuar destinacionin ose jo.

Ndërsa disponimi tek regjimi i bashkësisë universale fitohet i tëri njëloj si nga pronari dhe jopronari fillestar, pasi në vijim bëhen njësoj pronarë dhe disponojnë mbi këtë send pa dallim ndërmjet tyre në lidhje me origjinën e sendit apo kontributin.

Të gjithë analizën e këtyre instituteve në lidhje me të drejtën e pronësisë, e bëjmë për të dalluar pavarësinë që ofron kontrata e martesës që në fillim në lidhje me zgjedhjen e regjimit pasuror cilido qoftë ai, si i pasurive të ndara, ashtu edhe regjimi i bashkësisë universale, si dhe në vijim alternativën e lirisë së mirëfilltë në regjimin e pasurive të ndara. E drejta e pronësisë mbrohet maksimalisht nga bashkimi i partnerëve në martesë, duke u ofruar atyre mundësinë e gëzimit, posedimit dhe disponimit të lirë, nëse duan, të pasurive të tyre dhe akoma më shumë duke e ligjëruar këtë me një akt noterial. Kjo garanci është jo

²⁷⁶Vep e cit, Galgano, F. (1992). *E drejta private*, Botimi i III, fq. 139.

vetëm paprekshmëri e sigurisë që duhet të ketë pronari në ushtrimin e së drejtës së pronësisë, por është pavarësi në marrëdhëniet ekonomike, liri në pjesëmarrjen e marrëdhënieve juridike civile dhe është drejtësi në kontribute e përfitime. Për të mbyllur qëndrimin në lidhje me çlirimin që i bën të drejtës së pronësisë kontrata e martesës, vlen të përmendet këtu se bashkëshorti me kontratë martese është i zhveshur nga detyrimi i kryerjes së çdo veprimi juridik, domosdoshmërisht me bashkëshortin tjetër. Gjithashtu në vijim të kësaj hipoteze, zgjerojmë idenë se edhe vetë të tretët, kreditorët janë më komod në kryerjen e veprimeve juridike me një subject, i cili pasuritë e tij i ka të mbrojtura me kontratë martese.

6.2. Barazia gjinore

6.2.1. Të përgjithshme për barazinë gjinore në Republikën e Shqipërisë

Problematikat e barazisë gjinore janë në vëmendje të ligjbërësve dhe politikbërësve për aq kohë sa ka disekuilibër në lidhje me gjinitë. Peshorja anon nga burrat të cilët më të angazhuar në politikë, pjesëmarrës në qeverisje, angazhohen në biznes dhe akoma konsiderohen si më të mundshëm në kontributin e shoqërisë. Ndërkohë demokracia, shteti i së drejtës dhe të drejtat e njeriut të imponojnë rregullimin e ekuilibrave dhe integrimin e barabartë në shoqëri të të dy gjinive. Gratë janë subjekte të së drejtës po ashtu si burrat dhe nuk mund të ketë asnjë lloj justifikimi diskriminimi i tyre apo ndarja gjinore e detyrave²⁷⁷. Ka rëndësi të veçantë të trajtohet kjo temë në lidhje me kontratën e martesës, pasi akoma nuk janë arritur ekuilibrat dhe ka shumë punë për të bërë si nga mekanizmat ligjorë po

²⁷⁷Neni 1 Protokollit nr.12 KEDNJ 4 Nëntor 2000

ashtu edhe ato socialë, për të ndryshuar gjendjen faktike. Republika e Shqipërisë është prekur nga një pabarazi gjinore në çdo aspekt dhe mund të flitet për elemente të barazisë vetëm 20 vitet e fundit ku hasen fillesat e para. Ndërkohë nga ana tjetër, nuk është e mundur që të arrijmë menjëherë në rezultatet e vendeve të zhvilluara në demokraci dhe barazi. Tashmë është vendosur kriter që duhet të marrim në konsideratë barazinë e burrit dhe gruas në integrimin social, politik dhe në çdo aktivitet tjetër. Gruaja normalisht ka të drejtat dhe detyrat e saj edhe në familje dhe në problematikat e sociale të familjes shqiptare, duhet të pranojmë se ekuilibri gjinor në familje është një sfidë më vete. Të gjitha këto detyrime burojnë fillimisht nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut²⁷⁸, ku duket mjaft qartë që në këtë dispozitë, është dashur të theksohet jo vetëm barazia e burrit dhe gruas ndërmjet

njëri-tjetrit, por edhe kundrejt detyrimeve që ata kanë ndaj martesës, marrëdhënieve me fëmijët si dhe barazinë me karakter civil. Secili bashkëshort përfaqëson veten e tij në marrëdhënie me të tretët në një marrëdhënie juridike civile, për aq sa është e mundur dhe nuk cënon interesat e familjes. Në vijim, në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë janë pasqyruar edhe ndryshime të tjera në lidhje me kontributin e ligjit drejtë barazisë gjinore, konkretisht në lidhje me ratifikimin e Konventës CEDAW, me Ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollit shtesë të kësaj konvente me Ligjin nr.9052, datë 17.4.2003. Shteti shqiptar ka shprehur vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit

²⁷⁸ Protokollin nr.7 I KEDNJ, neni 5 Barazia ndërmjet bashkëshortëve “*Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisë me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ky nen nuk i pengon Shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.*”

të grave. Ndërkohë janë krijuar mekanizmat në vijim për zbatim të kësaj konvente dhe për ta bërë konkrete në sistemin tonë të së drejtës duke aplikuar së pari frymën e kësaj konvente në ligjet që kishin lidhje për ndikimin në barazi gjinore dhe së dyti duke sanksionuar konkretisht edhe ligje të reja në shërbim të kësaj konvente. Më qartë ,një hap tjetër i rëndësishëm ishte ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar²⁷⁹ si dhe aktet normative dhe direktivat e Bashkimit Evropian për rregullimin e ekulibrave gjinorë. Së fundmi, gjenden raporte të njëpasnjëshme në lidhje me angazhimin e grave në politikë dhe shoqëri si dhe në eliminimin e diskriminimit gjinor për çdo lloj arsye²⁸⁰, sipas të cilëve është analizuar roli i gruas në punët e shtëpisë, kontributi i saj në familje, mundësia e punësimit në komunitet, përkrahja nga burri për iniciativat e saj, duke konstatuar akoma pabarazi të konsiderueshme sipas zonave dhe sipas brezave. Ajo që ka një vlerë të rëndësishme dhe tregon një panoramë përmbledhëse të gjithë rrugëtimit drejtë barazisë gjinore është raporti i institucionit Avokati i Popullit në vitin 2016, para Bashkimit Evropian²⁸¹. Gratë, në mënyrë të veçantë gratë e divorcuara, gratë prind i vetëm, gratë kryefamiljare, gratë rome, gratë me aftësi të kufizuar dhe grupe të tjera në nevojë përballen me probleme në lidhje me aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë, pabarazi në fushën e punës dhe barriera në përfitimet sociale dhe ekonomike²⁸². Në sistemin e drejtësisë janë aktivizuar mekanizmat si ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010), i ndryshuar, duke u mundësuar grave, për të kërkuar dëmshpërblim për veprimet e diskriminimit për shkaqe gjinore, këshillimi dhe ndihma ligjore për gratë, në mënyrë të

²⁷⁹ LIGJ Nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006”.

²⁸⁰ Studim Pilot “*Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri*”, Janar 2016 - Tiranë, Shqipëri

²⁸¹ Raport mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri, Tiranë 2016.

²⁸²Po Aty, fq 10.

veçantë për gratë në paaftësi pagueuse dhe të marginalizuara, ekzekutimi në kohë i vendimeve të gjykatës ku gratë janë subjekte të vendimit. Format social i aktivizimit të grave në shoqëri do të nisë nga familja dhe duhet të investohet për secilën grua në jetën e saj personale. Këtë duhet ta kuptojmë në interes të këtij punimi, që kontribut për barazinë gjinore është edhe aktivizimi në jetën familjare i gruas²⁸³. Aftësia e saj për të kontribuar në familje dhe për të administruar e vetme pasuritë e saj duke i dhënë pushtet në martesë dhe në familje, e nxit atë të jetë pjesëmarrëse në politikë, në aktivitete sociale si dhe të fitojë vetëbesimin e duhur për rolin e saj në shoqëri dhe në familje.

6.2.2. Ndikimi i Kontratës së martesës në barazi gjinore

Kontrata para-martesorë, është instituti juridik novator, i nxitur nga fenomeni social i konfliktit ndërmjet bashkëshortëve për të përcaktuar destinacionin e pasurisë së vendosur gjatë martesës, gjithashtu e nxitur për mundësi të secilit bashkëshort të shprehë vullnetin e tij në lidhje me pasuritë gjatë martesës. Nga ana tjetër, legjislacioni ofron mundësinë e mbrojtjes së pasurisë së secilit bashkëshort pa u kushtëzuar nga instituti i martesës, duke ruajtur edhe nocionin e familjes, por edhe duke i dhënë mundësinë bashkëshortëve në vendosjen e detyrimeve të tyre për familjen gjatë martesës²⁸⁴.

Me lidhjen e martesës, bashkëshortët tashmë janë të lirë të zgjedhin formulën e shtimit të pasurisë së tyre dhe të përcaktojnë lirisht detyrimet dhe pasojat e zgjidhjes së martesës.

²⁸³ Radacic I. "Gender Equality Jurisprudence of the European Court of Human Rights", European Journal of International Law, Volumi 19 shtator 2008

²⁸⁴ Mandro A, "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesorë", Tiranë 2014, Shkolla e Magjistraturës dhe UNDP, faqe 90.

Mundësia e secilit bashkëshort për të mbrojtur të drejtat e tij pasurore dhe për të siguruar mundësinë e shtimit të pasurisë si dhe pakësimit në mënyrë të pavarur, duket si tentacion i parealizueshëm, pasi ndikimi i elementeve socialë nuk i paraprin zhvillimit të legjislacionit. Aktualiteti tregon të kundërtën, ku konfliktet gjyqësore me objekt të pjesëtimit të pasurisë ndërmjet bashkëshortëve sa vjen e rritet dhe pamundësia për të përcaktuar prerazi përkatësinë e pasurive, degradon situatën në pasoja më të rënda.

Në punimin tim sjell vlerësimin e integritetit të kontratës martesore, si institut për destinacionin e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, duke marrë në konsideratë elementët juridik që duhet të përmbajë kjo kontratë, për të realizuar autonominë e bashkëshortëve, për të shmangur konfliktin final në pjesëtimin e pasurisë, fakt i cili, ndër të tjera, promovon edhe barazinë gjinore në rritjen e ndërgjegjësimin të secilit bashkëshort për investimin e tij dhe origjinën e pasurisë bashkëshortore. Shpesh bashkëshorti i diskriminuar dhe që është në realizimin e barazisë është gruaja. Autonomia pasurore i jep asaj mundësinë të gëzojë të drejtat e saj kundrejt burrit, por edhe të mbrohet nga veprimet që mund të bëjë ai me pasurinë e përbashkët për detyrimet vetjake.

Ligjvënësi, me parashikimin ligjor për herë të parë në K.F. të vitit 2003, solli një trajtim modern të të dy bashkëshortëve përsa i përket të drejtave të tyre kundrejt pasurisë së ardhshme të secilit. Megjithatë, deri më sot ky modernizim shihet si një akses i mundshëm i burrit më shumë se sa i gruas, derivim i formatit të disbalancimit gjinor.

Nisur nga ky qëndrim, është me vend të kujtojmë se në regjimin pasuror ligjor, bashkëshortët janë të kushtëzuar në këtë liri si për të tjetërsuar dhe të paragjykuar në shtimin e pasurisë. Liria e bashkëshortëve ndërthuret edhe me elemente social, pasi me rritjen e aktivizimit të gruas në jetën ekonomike dhe politike në shoqëri, është promovuar

pavarësia e saj dhe për rrjedhojë është ulur kushtëzimi i mbajtjes së një martese të cilës i ka mbaruar funksioni i saj vetëm për të jetuar, për t'u strehuar apo mundësimi i vazhdimësisë së jetës familjare të sigurt.

Si e realizon kontrata e martesës ekuilibrin gjinor?

Së pari, në kontratën e martesës bashkëshortët janë palë të kontratës dhe domosdoshmërisht i nënshtrohen parimit të barazisë së palëve, pasi ua imponon vetë fjala kontratë dhe e dinë mjaft mirë që në momentin e nënshkrimit do të jenë të detyruar për të zbatuar kushtet e saj. Si dhe sic i kemi analizuar në këtë punim elementët ligjorë në formë dhe përmbajtje të kontratës, ku duhet t'i referohen parimeve të përgjithshme të kontratave për aq sa është e mundur²⁸⁵.

Së dyti, bashkëshortët kërkojnë me vullnetin e tyre këtë lloj regjimi, shprehja e vullnetit të tyre është mundësi që ju jepet që nga fillimi i martesës dhe në vijim për të përcaktuar destinacionin që ata duan për pasuritë e tyre. Në këto kushte ato kontribuojnë me vetëdije të plotë në formulën e aplikueshme për pasuritë e tyre. Prandaj është parë nga ligjbërësit si kontribut në barazinë gjinore, sepse shprehja e lirë e vullnetit për mbrojtjen e pasurisë së secilit bashkëshort e angazhon gruan në ndërmarrje në lidhje me pasurinë e saj po ashtu edhe ndaj të tretëve²⁸⁶

Së treti, edhe pse martohen bashkëshortët nuk ndjehen të asimiluar nga bashkëshorti tjetër, siç mund të perceptohet pozicioni juridik i bashkëshortit në regjimin e bashkësisë ligjore, pasi ata këtu janë zotër të pasurisë së tyre dhe nëse e kanë pranuar regjimin e bashkësisë

²⁸⁵ Mandro A.- Balili,(2014) *“Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore”*, Tiranë, Shkolla e Magjistraturës dhe UNDP, faqe 93

²⁸⁶ Gail F. Brod, *“Premarital Agreements and Gender Justice”*, (1993), Yale Journal of Law & Feminism, Volumi 6, faqe 254

universale, e kanë zgjedhur vetë dhe nuk ju është imponuar. Vullneti i pronarit në destinacionin e pasurisë është vendimtar në lidhje me fatin e saj.

Së katërti, akses të barabartë në pasurinë bashkëshortore në lidhje me kufizimet dhe lejet, mundësi për vendimarrje të përbashkët, duke angazhuar kështu gruan së bashku me burrin të përcaktojnë investimin në familje. Duke qënë se deri më, sot kryesisht çiftet kanë zgjedhur ose kanë lejuar të aplikohet automatikisht bashkësia ligjore, e kanë marrë të mirëqenë *apriori* vendimin e bashkëshortit për çdo pasuri në vijim. Edhe nëse ka punuar gruaja më shumë janë konsideruar të familjes dhe pa rëndësi specifike për origjinën e këtyre të ardhurave. Me kontratën e martesës, partnerët nuk kanë gjini në investime, në kontribut dhe në përfitime, ata janë gjinorë aq sa ndjehen. Kjo barazi e tyre e promovon bashkëshorten që të punojë, investojë për familjen, por edhe për veten e saj duke mundësuar administrimin e pasurive që ajo sdo ti bëjë pjesë të bashkësisë dhe sdo ti përfshijë në bashkësi.

Së pesti, do të sqarojmë në vijim të këtij punimi se si bashkëshortët mund të përcaktojnë në kontratën e martesës edhe pasojat e zgjidhjes së martesës. Duke e ditur se cilat janë pasojat e zgjidhjes së martesës, në lidhje me mbiemrin, në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, kjo gjithmonë sipas ligjit, kontributi kompensues²⁸⁷, në lidhje me përdorimin e banesës familjare etj, gjithashtu mund të përcaktojnë pasojat pasurore që ato janë objekti i kontratës së martesës. Duke i marrë të bashkuara këto dy lloje grupe të drejtash, që janë pasurore dhe jopasurore, duket qartazi rritja e pozitës sociale si dhe

²⁸⁷ Cështja “*Macleod v Macleod*” 2008 UKPC 64, gjatë arsyetimit të gjykatës parashtrohej vlerësimi për barazinë gjinore në lidhje me integrimin e bashkëshortes kryesisht, kur bëhej fjalë për detyrimin e bashkëshortit të paguante për mirëmbajtjen e familjes dhe për identifikimin e pasurisë së bashkëshortes më vete.

angazhimi më i madh i gruas në familje. Kështu gruaja shpreh vullnetin e saj se si do të ndajë detyrat në rast se martesë e tyre nuk funksionon, por duke e bërë këtë në momentin më të lumtur të jetës së tyre dhe jo në atë final, ku ka mirëkuptim dhe marrëveshje më paqësore se sa në rastet e tjera të konfliktit pas divorcit apo ndërprerjes së bashkëjetesës faktike.

Së gjashti, ashtu siç e kemi përmendur më sipër, por tani në aspektin gjinor, pavarësia ekonomike i jep bashkëshortëve edhe pavarësi politike, pasi qenia njerëzore është e prirur të lidhë ngushtë liritë e saj me pasuritë e saj. Administrimi i vetëm i pasurive i jep mundësi bashkëshortes mos të ndjehet e kushtëzuar nga humbja e pasurive për shkak të martesës në vendimarrjet e saja, në lidhje me angazhimin social, politik si dhe jetën e saj personale.

Së fundmi, kontrata e martesës nuk është asgjë më shumë, veç se një veprim juridik sipas të cilit bashkëshortët rregullojnë mënyrën se si do të administrohet çështja e pasurive në të ardhmen ndërmjet bashkëshortëve. Normalisht, kjo kontratë i paraprin çdo konflikti të mundshëm, pasi i orienton bashkëshortët që në fillim për pozicionin dhe qëndrimin që duhet të mbajnë në jetën e tyre. Gjithashtu kontrata e martesës aktivizon të dy bashkëshortët në kontributin familjar, kjo për faktin se ata janë të përgjegjshëm dhe të detyruar për të punuar dhe për të kontribuar për familjen dhe jo për të përfituar ekonomikisht në emër të atij që punon më shumë dhe përmbush detyrimet financiare në familje më shumë²⁸⁸.

Bashkëshortët nënshkruajnë të sigurt këtë status duke e ditur që secili ka detyrimin dhe të drejtën të kontribuojë në familje për mënyrën dhe sasinë e kontributit. Në këto kushte

²⁸⁸ Lo Sardo, G. (1991). “*La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia*”. Rivista del Notariato, Milano: Giuffrè Editore, fq. 1256-1257.

bashkëshortët ndjehen të pavarur nga njëri-tjetri, nga ekonomia familjare si dhe nga fakti nëse këta bashkëshortë nuk do të kishin më dëshirën për të qëndruar me njëri-tjetrin apo nëse martesë do të mbaronte, e drejta e trashëgimisë çfarë rrjedhoje do të marre.

Nga kjo kontratë ata janë transparent dhe paralelisht të larguar nga konflikti. Asnjëri nuk shmang detyrime për të cilat duhet të përgjigjet duke abuzuar me potencialin ekonomik të secilit.

6.3. Kontrata e martesës është ekonomi gjyqësore në proces e drejta për proces e rregullt ligjor

6.3.1. Procedura ligjore e pjesëtimit të pasurisë pas zgjidhjes së martesës

Bashkëshortët para lidhjes së martesës angazhohen edhe në përcaktimin e llojit të regjimit që duan të zgjedhin, atë për të cilën kemi folur gjatë gjithë punimit që ka të bëjë me ndikimin pozitiv të kontratës së martesës në momentin final.

Deri më sot duke patur kryesisht martesë që i janë nënshtruar regjimit të bashkësisë ligjore, bashkëshortët i janë nënshtruar pjesëtimit të pasurisë. Sipas legjislacionit tonë²⁸⁹, bashkëshortët janë bashkëpronarë në tërësi të pasurisë së vendosur gjatë martesës, por në vijim të dispozitës thuhet se këto raporte rregullohen me Kodin e Familjes. Duke ditur parimin e përgjithshëm për bashkëpronësinë në tërësi e kemi të qartë se bashkëshortët do të jenë pronarë të së tërës në çdo pjesë të pasurisë. Në këtë mënyrë bashkëshortët nëse vendosin të zgjidhin martesën, duhet të kenë në konsideratë edhe pjesëtimin e pasurisë nëse kanë. Pjesëtimi i pasurisë mund të bëhet në mënyrë vullnetare nëse bien dakord, në rast të kundërt do t'i drejtohen Gjykatës për ta vendosur këtë. Nëse pjesëtimi i pasurisë bëhet në

²⁸⁹Kreu II i Kodit Civil, neni 231.

mëmyrë vullnetare në lidhje me objektin dhe pjesët në marrëveshje, atëherë palët mundën të nënshkruajnë një marrëveshje pëe pjesëtimin e pasurisë para noterit dhe këtë marrëveshje ta regjistrojnë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive, për të bërë kalimin e pronësive të pasurive që i janë nënshtruar pjesëtimit sipas marrëveshjes. Duke i bërë kështu pasuritë nga pasuri të bashkëpronësisë, në pronësi vetëm të njërit bashkëshort. Në rast se bashkëshortët nuk bien dakord për pjesëtimin e pasurisë së tyre me marrëveshje, atëherë ata i drejtohen Gjykatës me kërkesë padi dhe kërkojnë të mundësojnë atë që nuk mundën ta pjesëtonin me mirëkuptim. Themi gjithmonë sipas vullnetit të tyre, pasi janë bashkëshortët ata që mund ta vënë në lëvizje gjykatën dhe nuk mund të jetë Gjykata kryesisht që të mund të ndërhyjë në vullnetin e palëve për pjesëtimin e pasurisë. Kjo e fundit rregullohet sipas Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Familjes, për bashkëshortët. Fillimisht, rikujtojmë se me mbarimin e bashkësisë ligjore na lind nevoja të pjesëtojmë pasurinë. Bashkësia ligjore s'ka më efekt në rast se martesë ka mbaruar, por edhe më përpara mundet të mbarojë në raste të veçanta. Tani do të trajtojmë të dy rastet për të vënë re ndryshimin.

Rasti i parë dhe klasik i mbarimit të bashkësisë është ai që parashikohet si i tillë duke dhënë në mënyrë shteruese rastet e përfundimit të bashkësisë²⁹⁰, me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, shpalljen i zhdukur ose i vdekur të njërit prej tyre, shpalljen të pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës, me pjesëtimin e pasurive si dhe me ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjellin mbarimin e bashkësisë. Le t'i trajtojmë me radhë për të kuptuar mirëfilli se kur mbaron bashkësia. Vdekja e njërit bashkëshort duke e lënë bashkëshortin tjetër për ligjin të ve, tregon se martesë ka përfunduar nga një fakt juridik, pa vullnetin e bashkëshortëve për të mbaruar martesë. Duke qënë se mbaron martesë me vdekjen e njërit

²⁹⁰Neni 96 Kodi i Familjes, ligji nr.9062 datë 08.05.2003 "Kodi i Familjes".

bashkëshort atëherë është e qartë se nuk ka më vend të flasim për vazhdimin e bashkësisë, pasi kjo e fundit është mënyrë rregulluese e pasurisë gjatë martesës dhe nuk ka më vlerë për të folur për bashkësi, kur nuk ka martesë. Në këto kushte bashkëshortët me mbarimin e martesës nga vdekja e njërit, pasjetuesi ka të drejtë të kërkojë fillimisht pjesën e tij nga bashkësia ligjore gjatë martesës dhe pastaj mund t'i nënshtrohet pjesa e mbetur pjesëtimit nga trashëgimia. Problematikat e një rasti të tillë do të trajtohen në një kapitull më poshtë në këtë punim.

Si një rast tjetër i përfundimit të bashkësisë ligjore është shpallja i vdekur, e cila sipas ligjit barazohet me vdekjen natyrore. Ky institut rregullohet nga ligji²⁹¹ ynë dhe thuhet se shpallja i vdekur barazohet në çdo aspekt me vdekjen natyrore për sa i përket pasojave ligjore. Prandaj, për analogji do të zbatohen të njëjta rregulla edhe në lidhje me shpalljen i vdekur si me vdekjen natyrore. Diskutimi, i cili lind ka të bëjë me faktin se vetë ligji njeh mundësinë e rikuperimit të personit që është shpallur i vdekur dhe rikthehet ai në vendin e tij, atëherë çdo gjë i kthehet atij dhe merr formën e mëparshme ligjore. Legjislatori tregohet i kujdesshëm në këtë rast në lidhje me martesën, pasi parashikon se nëse bashkëshorti i shpallur i vdekur shfaqet dhe rikthehet tek njerëzit e tij, atëherë martesë e tij e fundit është e vlefshme, përveç rasteve kur bashkëshorti pasjetues i prezumuar, ka lidhur martesë të re. Rregulli i parë në këtë rast është mjaft i rëndësishëm për sa i përket faktit se bëhet në mbrojtje të personit që është shpallur i vdekur, pasi i mundësohet atij rikuperimi i menjëhershëm²⁹². Legjislatori në këtë rast ka qënë human dhe ligjor njëkohësisht në mbrojtje të së drejtave të njeriut duke përcaktuar kështu mundësinë e secilit që edhe pse

²⁹¹Neni 22 i Kodit Civil.

²⁹² Israel L., (2018), “The generous prenup”, Integrity Registry Press, New York, faqe 44.

për efekte të ligjit duhej të shpallej i vdekur si rezultat i garancive dhe sigurisë juridike, në momentin që kthehet i jepet mundësia e plotë për t'u quajtur i gjallë dhe me të drejtat e plota që ka pasur. Ndërkohë përjashtimi që bëhet në ligj në lidhje me faktin se nëse pasjetuesi i prezumuar ka lidhur martesë duke e menduar të vdekur bashkëshortin, por me vendim gjykate, martesë e parë quhet e mbaruar dhe është në fuqi martesë e dytë. Ky përjashtim me të drejtë është sanksionuar në mënyrë të tillë, pasi është e qartë se nuk mund të mbahet në pasiguri bashkëshorti pasjetues i prezumuar, në gjithë jetën e tij për të pritur rikthimin e bashkëshortit/bashkëshortes. Pasi pasjetuesi është vënë para situatës dhe faktit që ka një vendim gjykate që martesë të quhet e zgjidhur dhe në këto kushte ai ka status libertatus dhe është pa asnjë pengesë për tu martuar, si dhe martesë në themel të saj ka ndjenjën e dashurisë, respektit reciprok, besnikërisë dhe qëndron e lidhur me vullnet të dyanshëm, për aq kohë sa është lidhur një martesë e dytë prezumohet se kanë ekzistuar këto elemente, pra është lidhur martesë e dytë. I njëjti qëndrim është edhe për rastin e shpalljes i zhdukur, por duke analizuar shpalljen i vdekur pasojat janë më të dukshme dhe analiza bëhet më konkrete. Qëndron një përplasje ndërmjet këtyre koncepteve në ligjin familjar, pasi në nenin 96 Kodi i Familjes, parashikohen rastet e mbarimit të bashkësisë ndërsa në nenin 123, parashikohen rastet e mbarimit të martesës dhe në këtë të fundit nuk rezulton shpallja i zhdukur si mbarim i martesës. Në analizë të këtyre dispozitave mund të konkludojmë qëllimin e ligjvënësit, se 'shpallja i zhdukur' është mbarim i bashkësisë, por jo i martesës, pra ka efekte pasurore në lidhje me të drejtat dhe detyrimet. Si 'shpallja i zhdukur' dhe 'shpallja i vdekur' janë mosprezencë e partnerit në martesë dhe në këtë rast secili bashkëshort mund të kërkojë zgjidhjen e martesës, për shkak se s'ka jetë bashkëshortore, mungon bashkëjetesa faktike. 'Shpallja i vdekur' barazohet me vdekjen

civile dhe në këto kushte pasojat janë evidente dhe nuk është e nevojshme të bëhet një kërkesë në gjykatë për të kërkuar mbarimin e martesës.

I rikthehemi interesit tonë në këtë punim, duke analizuar rastin e tretë të mbarimit të bashkësisë me pjesëtimin e pasurisë, ku siç thamë më lart pjesëtimi është me marrëveshje ose me vendim gjykate nëse nuk arrihet marrëveshja. Me zgjidhjen e martesës bashkëshortët i drejtohen gjykatës nëse nuk kanë arritur marrëveshje, ndërkohë ligji parashikon dhe një rast specifik kur mund të pjesëtohet bashkësia edhe pa përfunduar martesa. Në nenin 98 të Kodit të Familjes, thuhet se pjesëtimi mund të lejohet gjatë bashkësisë në momentin kur ka paaftësi ose administrim të keq të njërit prej bashkëshortëve dhe kur kjo sjellje e bashkëshortit vë në rrezik interesat e familjes dhe të bashkëshortit tjetër. Kjo situatë është e qartë dhe e lejueshme vetëm nëse justifikohet sipas dispozitës dhe arrihet në konkluzionin se nuk mund të bëhet ndryshe, prandaj edhe duhet kërkuar ky pjesëtim edhe pa mbaruar bashkësia.

Në rast se bashkëshortët ose ish bashkëshortët do t'i drejtohen Gjykatës për pjesëtimin e pasurisë duhet të zbatohen rregullat e parashikuara në ligjin procedural²⁹³, për pjesëtimin e pasurisë sipas të cilit parashikohet se ky proces bën pjesë në gjykimet e posaçme dhe si i tillë do t'i nënshtrohet procedurave specifike, ndryshe nga proceset e tjera. Ligjvënësi parashikon se këto lloj procesesh bëhen me dy faza; në fazën e parë përcaktohet rrethi i bashkëpronarëve, pasuritë që do të pjesëtohen dhe pjesët takuese të tyre, ndërsa në fazën e dytë bëhet pjesëtimi në natyrë i pasurive sipas pjesëve që janë përcaktuar në fazën e parë. Nuk kalohet në fazën e dytë në rast se nuk është ezauruar faza e parë dhe nëse nuk është

²⁹³Neni 369 Kreu V, Kodi i Procedurës Civile.

ezaauruar edhe e drejta e ankimit të fazës së parë. Ka një disproporcion në lidhje me afatin e ankimit të fazës së parë me atë të fazës së dytë²⁹⁴, pasi vendimi i fazës së parë ankimohet më vete brenda 5 ditëve, ndërsa vendimi I fazës së dytë brenda 15 ditëve. Ky disproporcion ndërmjet fazave është justifikuar duke u shprehur legjislatori se vendimi i fazës së parë është vendim i ndërmjetëm dhe jo vendim përfundimtar dhe si i tillë, referuar nenit 451 të Kodit të Procedurës Civile, ankimohet brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së tij. Në një procedurë gjyqësore, ku do të zbatohen të gjithë elementet e procesit të rregullt gjyqësor, i jepet afati i duhur për të gjithë kërkesat palëve. Faza e parë nuk kalon ndonjëhre pa u ankimuar, pasi përcaktimi i pjesëve takuese në parim, pra i pjesëve ideale, në lidhje me $\frac{1}{2}$ dhe $\frac{1}{2}$ në rastin në fjalë, bashkëshortët prandaj kanë shkuar në gjykatë se nuk kanë rënë dakord për këtë lloj pjesëtimi. Duke qënë se nuk do bien dakord me vendimin e gjykatës cilido të jetë ai, njëra palë do të ankohet ose të dyja për çështje të ndryshme, është vënë re se bashkëshortët mbeten nëpër gjykata për një periudhë shumë të gjatë. Ankohen për fazën e parë, e cila deri sa të gjykohet në gjykatën e Apelit ka një kohë të konsiderueshme, nga praktika minimalisht 1 vit, në vijim ankimohen edhe në gjykatën e lartë dhe në këto kushte vetëm faza e parë merr një numër të konsiderueshëm kohe. Konkreisht, nga sistemi i Gjykatës së Lartë, gjejmë një çështje nga shumë të tjera me numër vendimi 434 dhe datë 11.07.2013 me palë ndërgjyqëse G.Ç. dhe L. Ç., të cilët e kanë filluar procesin e pjesëtimit të pasurisë në vitin 2008 dhe e ka zgjidhur Gjykata e Lartë në vitin 2013. Në vijim, po të lexojmë një vendim tjetër vihet re se procesi ka zgjatur deri në 5 vite vetëm për fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë duke u ankimuar dhe kthyer për rigjykim deri në momentin final të pranimi të kërkesë padisë nga Gjykata e Lartë. E gjithë kjo situatë na jep dukshëm se sa e

²⁹⁴VUGJL nr.628 viti 2000.

vështirë është që pasuria e bashkëshortëve të shkojë tek secili bashkëshort me pjesëtim, sepse procesi gjyqësor zgjat ndër vite shumë dhe mohon haptazi mundësinë për të disponuar lirisht këto pasuri, dhe janë objekt gjykimi dhe nuk mund të tjetërsohen duke i kushtëzuar bashkëshortët të qëndrojnë të lidhur pas procesit gjyqësor duke pritur të marrin pasuritë e tyre.

6.3.2. Aplikimi i kontratës së martesës menjëherë pas zgjidhjes së martesës

Nga ana tjetër çfarë ndodh me kontratën e martesës? Si munden bashkëshortët të shmangin kalvarin e gjatë të seancave gjyqësore të cilat është e qartë se do të japin pasurinë më vete të secilit bashkëshort, por është një rrugë e gjatë deri në identifikimin e pasurisë së secilit duke u lodhur kështu për të gëzuar, disponuar apo edhe poseduar lirisht pasurinë e vet secili bashkëshort. Përzierja që i kanë bërë në bashkësi pasurive përkthehet në kohë të gjatë në identifikimin dhe rikthimin e pasurisë tek pronari i vetëm. Kontrata e martesës ofron dy lloj, regjimesh atë të bashkësisë universale, që studjuesit e së drejtës e trajtojnë si regjim në vijim të regjimit të bashkësisë ligjore dhe regjimin e pasurive të ndara si pavarësi totale e bashkëshortëve ndaj njërit-tjetrit dhe detyrime specifike ndaj martesës. Në lidhje me bashkësinë universale situata komplikohet edhe më shumë se në bashkësinë ligjore, por bashkëshortët sjanë të prirur të kenë shumë konflikt pasi e kanë të qartë tablonë e pasurive që kanë bashkuar dhe kur e kanë krijuar e kanë zgjedhur vetë këtë regjim dhe mund të jenë edhe të prirur t'i pjesëtojnë me marrëveshje para noterit. Kjo nuk është gjithmonë e ditur dhe e provuar, pasi sjellja njerëzore dhe vullneti i subjekteve nuk mund të sekuestrohet në një kontratë për të ardhmen. Në regjimin e pasurive të ndara, pasuria është më e lehtë të identifikohet dhe si e tillë nuk ka nevojë të shkojnë në gjykatë bashkëshortët pasi nuk kanë

përzier asgjë dhe kanë kërkuar bashkime. Siç e kemi shpjeguar edhe më sipër, në regjimin e pasurive të ndara, pjesëtimi i pasurisë mund të jetë vetëm për ndonjë pasuri ku bashkëshortët s’e kanë rregulluar në kontratë regjimin e saj dhe ka mbetur e tillë, por përgjithësisht është mundësi dhe lehtësi që ka secili bashkëshort të gëzojë e të disponojë i lirë pasuritë e tij pa u kushtëzuar nga martesë.

Të kesh mundësi të zotërosh pasurinë tënde sa më shpejt, është proces i rregullt ligjor, siç parashikon neni 5 i KEDNJ, ku si të tillë duhet të kuptojmë që koha e konsiderueshme nëpër procese gjyqësore është dëm që i shkaktohet procesit të rregullt ligjor. Kujtojmë këtu parimin “drejtësi e vonuar drejtësi e mohuar”.

KAPITULLI VII: RREGULLIMI I PASOJAVE TË ZGJIDHJES SË MARTESËS ME KONTRATËN E MARTESËS. MBROJTJA E BASHKËSHORTIT PASJETUES

7.1. Pasojat e zgjidhjes së martesës në Kodin e Familjes

Rritja e numrit të madh të divorceve, angazhon secilin prej studjuesve të së drejtës, ligjbërësit si dhe aplikuesit e normave ligjore të gjejnë mjetet e duhura për të rregulluar çdo pasojë që vjen nga ky proces. Është e dukshme se i konsideruari “problemi” social, divorci, prek një numër të konsiderueshëm subjektesh duke filluar nga ata që janë direkt të përfshirë si dhe të tretët që në cilëndo mënyrë kanë ndërvepruar me këto subjekte. Drejtëpërsëdrejti nga ky proces preken bashkëshortët dhe fëmijët, në rast se ka, duke u konsideruar për ta jo vetëm përfundimi i një statusi actual, por edhe fillimi i një jete ndryshe me cilëndo nga të mirat apo të këqijat e saj.

Legjislacioni ynë, në Kodin e Familjes, konkretisht në kreun III, parashikon se cilat janë pasojat e zgjidhjes së martesës, duke filluar përdorimi i ishmbiemrit, kontributi kompensues, përdorimi i banesës, detyrimi për ushqim, rritja dhe edukimi i fëmijëve, etj. Institucioni përgjegjës për zgjidhjen e martesës është Gjykata, e cila merr angazhimin maksimal në dhënien e drejtësisë për konfliktet e kësaj natyre duke analizuar çdo element me kujdes, për të rregulluar pasojat e zgjidhjes së martesës për të dy bashkëshortët, si dhe për të miturit për të cilët duhet patur akoma më kujdes në lidhje me mbrojtjen e interesit më të lartë të tyre. Përballja me procesin e zgjidhjes së martesës i angazhon bashkëshortët të rimendohen dhe analizojnë pasojat të cilat ju vijnë nga divorci, duke qënë të tensionuar dhe jo gjithmonë të aftë të gjykojnë drejtë, ka ndikuar në cilësinë e jetesës pas zgjidhjes së martesës.

Prandaj mund ta shikojmë kontratën e martesës si mundësi që të amortizojë pasojat e zgjidhjes së martesës duke i njohur ato më përpara në kohë, pasi ju jep mundësinë që këtë rregullim mund ta parashikojnë më së miri dhe në interesin optimal në lidhjen e martesës ose gjatë funksionimit normal të saj.

Të gjitha rastet e zgjidhjes së martesës, i nënshtrohen pasojave sociale, psikologjike, ekonomike dhe çfarë është më e rëndësishmja atyre ligjore. Konkretisht, në kuadër të pasojave është e qartë se vetëm ato ligjore janë të pashmangshme dhe janë në vlerësim të elementëve racionale për të cilët vendos vetëm Gjykata, nëpërmjet funksionit kryesor të saj për dhënien e drejtësisë. Ligji ynë në Kodin e Familjes, Kapitulli III, parashikohen shprehimisht pasojat e zgjidhjes së martesës, duke i renditur ato sipas natyrës dhe sipas subjekteve. Duke analizuar subjektet që përfshihen si në procesin e lidhjes së martesës, konkretisht bashkëshortët dhe me fëmijët nëse ka në një martesë, parashikohet mënyra se si do të rregullohen kryesisht raportet ekonomike, banesa si dhe kujdesi i prindërve ndaj fëmijëve dhe si do mbahen këto raporte të angazhuara në interesin më të lartë të fëmijës, referuar dispozitave pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët. Këto ndarje të kësaj natyre, ligjvënësi i ka bërë duke analizuar se kush preket drejtpërsëdrejti dhe ku është e nevojshme të bëhet ndërhyrja ligjore për të shmangur pabarazitë, abuzimet si dhe dëmtime të mëtejshme që mund t'i shkaktohen anëtarëve të familjes nga zgjidhja e martesës.

7.2. Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët

Pasojat problematike dhe që gëzon trajtim të veçantë është ajo me fëmijët, pasi shpesh janë viktimë e këtij procesi edhe pse legjislacioni është munduar t'u sigurojë garancitë ligjore

për t'i mbrojtur ata. Praktika ka treguar se vullneti i mirë i prindërve është vendimtar në këtë fazë për rehabilitimin e tyre. Nisur nga vullneti, kontrata e martesës përfaqëson formën më të lartë të shprehjes së vullnetit të bashkëshortëve, brenda kuadrit ligjor duke ndërmarrë angazhimin e plotë edhe në rregullimin e pasojave. Ky aspekt i jep kontratës së martesës, frymën e një mjeti juridik që i vjen në shërbim edhe fëmijëve për sa i përket faktit se bashkëshortët që në lidhjen e kontratës, përcaktojnë se ata zotohen t'u sigurojnë fëmijëve të njëjtën jetë edhe pas zgjidhjes së martesës²⁹⁵. Në këtë kontratë bashkëshortët mund të përcaktojnë detyrimin që ata kanë për sa i përket krijimit dhe sigurimit të kushteve për një jetë të qetë familjare, të fëmijëve të tyre, në mënyrë të pavarur nga dëshira e bashkëshortëve për të qenë të martuar ose jo. Ky parashikim në kontratën e martesës çliron bashkëshortët nga përgjegjësia për martesë fiktive dhe të kushtëzuara, duke i dhënë kështu më shumë shëndet familjes dhe martesës ku në cilindo rast, jeta e fëmijëve pas zgjidhjes së martesës nuk është shkak për të qenë anëtar i martesës fiktive.

Angazhimi i ndërmarrë me kontratë, në lidhje me detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve i të dy bashkëshortëve dhe mundësia e sigurimit të të ardhurave, duke dërguar në interes të tyre një pjesë të të ardhurave, sërish do t'i nënshtrohet gjykatës, për të vlerësuar të gjitha kushtet që ligji kërkon për sa i përket këtij kontributi në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Në kontratë mund të mos përcaktohet vlera, por shprehet vullneti që në rastin eventual të zgjidhjes së martesës, bashkëshortët në cilësinë e prindërve të fëmijëve, përcaktojnë se cili nga bashkëshortët do të bëjë këtë pagesë dhe si do të veprohet në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Kushtëzimi që gjen ky sanksionim ka të bëjë me dy aspekte, atë të faktit se bashkëshortët mund të shprehen vetëm në lidhje me faktin se cili bashkëshort do të

²⁹⁵ Cooke, E. *“Child and Family Law Quarterly”*. fq. 98

mbajë fëmijët dhe cili detyrimin për ushqim, por në asnjë moment nuk mund të heqin dorë nga ky detyrim dhe të zhvishen nga pasojat që mund të vijnë nga zgjidhja e martesës.

Problematika më aktuale është rregullimi i vizitave të fëmijëve, fakt i cili është i rëndësishëm për fëmijët për të theksuar më shumë mundësinë e krijimit të jetës familjare ku prindërit zotohen t'i krijojnë fëmijëve të tyre të drejtën që ka prindi për t'i takuar, i cili nuk është caktuar nga gjykata për tu kujdesur për ta. Në këto kushte parashikimi në kontratën e martesës është garanci dyfishe që në momentin e lidhjes së martesës dhe sjellja e bashkëshortëve në momentin e zgjidhjes së martesës dhe pas saj, është më i mirëkuptueshëm. Bashkëshortët shpesh gjenden në mugesën totale të informacionit, duke mos e ditur që fëmijët pas zgjidhjes së martesës kanë të drejtën të takohen me të dy prindërit, t'u mundësohet jeta familjare dhe bashkëshortët kanë detyrimin të zbatojnë vendimin e gjykatës për krijimin e kushteve të jetës familjare për fëmijët. Nëse këta bashkëshortë e parashikojnë që në kontratën e martesës, vullnetin e tyre në lidhje me detyrimin që kanë ndaj fëmijëve të tyre si dhe angazhimin që merr secili për të plotësuar kushtet për një mjedis familjar, rasti kontraktor, nuk e lë bashkëshortin të surprizuar në lidhje me këto pasoja. Ky parashikim në kohë është në interes të fëmijës si dhe të bashkëshortëve, të fëmijëve për të gëzuar të drejtën e jetës familjare dhe të prindërve për të ushtruar përgjegjësinë prindërore të pakushtëzuar nga divorci dhe problemet sociale që vijnë nga ky i fundit.

Trajtimi ligjor, i frymëzuar nga parimi i respektimit të interesit më të lartë të fëmijës, mundohet të parashikojë dhe rregullojë në ligj mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, vizitat me prindin tjetër, detyrimin për ushqim, elemente të cilët gjykata në këto raste nuk i vlerëson dot e vetme, pasi bën hetimin nëpërmjet provave të paraqitura në

gjykatë, cakton ekspertët psikologë ose sociologë për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës tek fëmijët.

7.3. Pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët

Objekti i kontratës së martesës nuk mund të kufizohet vetëm në rregullimin e regjimit pasuror, pasi liria e bashkëshortëve, për të operuar me angazhimet e tyre në martesë, nuk mund t'u shmanget të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë, përgjegjësisë prindërore, rregullave të administrimit ligjor dhe kujdestarisë, ndërsa banesa, detyrimi për ushqim, kontributi kompensues, etj janë tërësisht elemente të cilat në mungesë të konfliktit, rregullohen më mirë se sa në gjykimin final.

Parashikimi i pasojave të zgjidhjes së martesës në kontratën e martesës duhet parë si mbrojtje që i bëhet subjekteve të prekur gjatë këtij procesi, pasi secili bashkëshort mund të vendosë më mirë në kushtet e mirëkuptimit me bashkëshortin tjetër, se sa në momentin konfliktual. Gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore të zgjidhjes së martesës, problematikat që hasen nga bashkëshortët janë si në mbrojtjen e të drejtave të tyre ashtu edhe në ato të fëmijëve, pasi për secilin bashkëshort të qenurit në konflikt i shndërron ata vetëm në palë ndërgjyqëse duke harruar anëtarësimin e tyre në një familje²⁹⁶. Pikërisht, parashikimi i mënyrës se si do të derivojnë pasojat e zgjidhjes së martesës pas zgjidhjes së martesës, në kohën kur këto subjekte janë një familje dhe me vullnetin e tyre i gëzohen këtij statusi është në dobi të të dy bashkëshortëve ashtu edhe të fëmijëve. Mbrojtja e secilit anëtar të familjes, duke e ndjerë më shumë se sa duke u detyruar, angazhon bashkëshortët t'i paraprijnë dhe të mos i shmangen zgjidhjes së martesës, nëse kjo e fundit ka humbur sensin dhe qëllimin e

²⁹⁶Stoner, K. E. *"Property rights if you divorce"*, Kapitulli 4, fq. 85.

saj. Garancia e rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës në kontratën e martesës nuk është vetëm në momentin final, por që në fillim të lidhjes së martesës, secili bashkëshort mund të ndjehet më i mbrojtur në lidhje me qëndrimin e tij gjatë martesës, pa penguar asnjë moment vullnetin e tij në lidhje me vazhdimin e martesës pasi mund të dëmtohet nga zgjidhja e martesës. Rastet nga praktika tregojnë se bashkëshorti më i dobët i shmanget kërimit të divorcit, pasi nuk është sigurt për banesën e tij pas zgjidhjes së martesës, nuk është i sigurt nëse fëmijët e tij do të kenë mundësi të ushqehen edhe nga bashkëshorti tjetër dhe pothuajse asnjëherë bashkëshortët nuk përfitojnë nga kontributi kompensues në procesin e zgjidhjes së martesës, në disa raste për çështje provueshmërie, në disa të tjera mungesë vullneti dhe pak herë edhe nga mungesa e informacionit.

Pra, parashikimi që në kontratën së martesës të detyrimeve pas zgjidhjes së martesës, duhet parë si një garanci për bashkëshortin më të dobët si dhe mbrojtje për fëmijët të përfshirë në procesin e divorcit. Asnjëri nga prindërit mund të mos heqë dorë në detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tij, por shpesh procesi gjyqësor i zgjidhjes së martesës nuk ka patur qasje pozitive nga bashkëshortët, në lidhje me mirëkuptimin e përfundimit të martesës, e për rrjedhojë kjo pasqyrohet edhe në të vetmet mjete juridike që mund t'u kenë mbetur atyre për t'u kundërvënë njëri-tjetrit, duke harruar kështu detyrimet që u lindin nga kjo fazë dhe automatikisht është dëmtuar edhe interesi më i lartë i fëmijës, për të përfituar një pension ushqimor më të lartë, apo për të vlerësuar sa më drejt lënien për rritje dhe edukim të tyre, apo mënyrën e vizitave me prindin tjetër. Nuk janë të pakta rastet ku fëmijët të cilët i lihen për rritje dhe edukim nënës, pësojnë një ndryshim rrënjësor të nivelit të jetesës duke u larguar kështu nga banesa e tyre, shpesh kanë mbetur dhe pastrehë pasi, kjo nuk ka gjetur

vullnetin e mire të babait të tyre dhe për rrjedhojë atë çfarë ligji e parashikon, gjykata nuk mundet t'ua garantojë. Në ekzistencën e kontratës së martesës, ky parashikim mund të ishte me vend si për bashkëshortët ashtu edhe për fëmijët, duke e konsideruar këtë hapsirë në kontratën e martesës një formë të rezervës ligjore, pa nxitur dhe pa penguar divorcin, përveçse duke përmirësuar statusin e secilit subjekt të përfshirë në zgjidhjen e martesës, pas procesit gjyqësor.

Siç i trajtuam me radhë pasojat më lart, duke sqaruar paraprirjen që ligji i bën në kohë fenomenit, për të zvogëluar sado pak dëmin për subjektin më të dëmtuar deri tek ai i konsideruar më pak i dëmtuar, praktika ka treguar se rëndësia e rregullimit të këtyre pasojave është e konsiderueshme, duke qënë se bashkëshortët në fazën e zgjidhjes së martesës nuk mjaftohen vetëm me humbjen e vullnetit për të bashkëpunuar për të lehtësuar jetën e secilit, por ka evoluar problem duke dëmtuar edhe fëmijët në mënyra të ndryshme nga sjellja e paligjshme e tyre. Shpesh në Republikën e Shqipërisë, prindi i cili ka fëmijët për rritje dhe edukim, abuzon me këtë të drejtë-detyrim, që gjykata i ka caktuar duke përdorur fëmijët në tërheqjen e vëmendjes apo hakmarrjen e ulët ndaj ish-bashkëshortit. Në mungesë të vullnetit të zbatimit të vendimit të gjykatës, legjislacioni ynë, nuk mjaftohet vetëm me rregullimin e pasojave, por ka parashikuar edhe sanksione nga moszbatimi i tyre, konkretisht në ligjin penal ka dispozita specifike që sanksionojnë këto lloj sjelljesh, *“Mosdhënia e mjeteve për jetesë”*²⁹⁷, *“Marrja e padrejtë e fëmijës”*²⁹⁸, *“Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”*²⁹⁹, dispozita këto që rëndojnë pikërisht mbi aktorët e këtyre padrejtësive, duke cënuar vendimet e gjykatës që kanë dhënë drejtësi në zgjidhjen e

²⁹⁷ Neni 125 i Kodit Penal, ligji nr.7895, datë 27.01.1995.

²⁹⁸ Neni 127 i Kodit Penal, ligji nr.7895, datë 27.01.1995.

²⁹⁹ Neni 320 i Kodit Penal, ligji nr.7895, datë 27.01.1995.

një konflikti. Ky normim, i bashkohet qëllimit të këtij punimi në lidhje me rëndësinë që ka parashikimi i pasojave juridike për zgjidhjen e martesës në kontratën e martesës.

Duke mos u ndalur në elementet konkretë të kontratës së martesës, në lidhje me objektin, subjektet, qëllimin e saj, zbatimin si dhe fuqinë juridike që ajo ka, si të njohur tashmë, në një seksion të saj, parashikimi i këtyre pasojave do të ishte për analogji, pothuajse si marrëveshja e parashikuar nga legjislacioni ynë³⁰⁰, tek zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve duke qënë se është akt i cili formulohet pikërisht në momentin final të martesës³⁰¹. Parashikimi i kësaj mënyre të zgjidhjes së martesës, me kërkesë të dy bashkëshortëve, kushtëzohet nga legjislacioni edhe nga depozitimi i një marrëveshje, e cila rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Seksioni i parashikimit të pasojave të zgjidhjes së martesës në kontratën e martesës dhe marrëveshja për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok, ndryshon për çastet e ndryshme në të cilën formulohen. E para ka të bëjë me rregullimin e çdo pasoje gjatë martesës në lidhje me ekonominë, administrimin, përveç atyre që ligji e ndalon që bashkëshortët ta vendosin vetë, ndërsa e dyta ka të bëjë me rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës pikërisht kur bashkëshortët me vullnetin e tyre të lirë dhe të përbashkët, mendojnë se martesë nuk duhet të vazhdojë më, i propozojnë gjykatës një projekt marrëveshje, jo vetëm për zgjidhjen e martesës, por edhe për rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës. Këtu qëndron jo vetëm ndryshimi, por edhe rëndësia e parashikimit të këtyre pasojave në një moment më të qetë dhe më produktiv,

³⁰⁰ Neni 125 i Kodit të Familjes, ligji nr.9062, datë 08.05.2003.

³⁰¹ Lamçe J., “Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok në Shqipëri. Vështrim krahasimor me Parimet e CEFL” Avokatia, 16 tetor 2015, faqe 71-86

përsa i përket kthjelltësisë së vendimit dhe vullnetit të mirë në përgjegjësitë e lindura nga ky proces.

Në kontratën e martesës, ata mund të rregullojnë problemet në lidhje me mbiemrin, duke caktuar mbiemrin e përbashkët ose të secilit, nëse martesë zgjidhet, duke eliminuar kështu pasigurinë se si do të jetë mbiemri i secilit bashkëshort i kushtëzuar nga ecuria e çiftit, element i cili mund të stepë secilin bashkëshort edhe në ndërmarrjen e veprimtarive personale. Gjatë martesës përfshirja në veprimtari mund të jetë e gjërë dhe pasoja e ndryshimit të mbiemrit, i ka kushtëzuar bashkëshortët në zgjidhjen e martesës në emër të realizimit social apo intelektual të tyre. Rregullimi i kësaj pasoje, në gjendje të qetë, me mirëkuptimin e plotë që në momentin e lidhjes së martesës, nuk i lë hapsirë asnjërit bashkëshort të përdorë shantazhin e mbiemrit me zgjidhjen e martesës.

Rëndësi të veçantë në trajtimin e pasojave gëzon kontributi kompensues, si element i kodit të fundit, në përkrahje të bashkëshortit, të konsideruar më të dëmtuar, për të eliminuar pasojat më të rënda në jetë pas zgjidhjes së martesës. Parashikimi në kontratën e martesës së këtij elementi, duhet konsideruar si niveli më i lartë i mirëkuptimit të bashkëshortëve, deri në atë pikë sa mund të duket si fshirje e çdo e pasoje që mendohet nga zgjidhja e martesës. Bashkëshortët në kontratën e martesës mund mos të dinë me saktësi se cili nga bashkëshortët, në rast të zgjidhjes së martesës, do jetë më i dobët dhe do konsiderohet i dëmtuar nga zgjidhja e martesës, por parashikimi në këtë kontratë i këtij elementi, merr një formë tjetër, në kuadër të shprehjes së vullnetit për angazhimin që merr secili dhe gadishmërisë që kanë, për të pranuar pagimin e kontributit kompensues ndaj bashkëshortit tjetër, që në momentin e zgjidhjes së martesës do të konsiderohet më i dëmtuar. Sërish, vlerësimi i elementeve ligjorë që ka sanksionuar Kodi i Familjes në nenin 149, në lidhje me

moshën, gjendjen shëndetësore, kohën e shpenzuar në lidhje me rritjen e fëmijëve, predispozitën për punë të reja, etj. janë tagër i gjykatës, nuk bëhen apriori të zbatueshme. Çaktimi konkret i kontributit, i përkthyer në shumën e mirëfilltë që duhet paguar, është rregullimi i cili edhe pse pjesë e kontratës së martesës, do t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës. Vlera juridike e parashikimit të kësaj pasoje që në kontratën e martesës, qëndron në mbrojtjen dyfishe që i ofrohet bashkëshortit të dëmtuar pas zgjidhjes së martesës, jo vetëm nga ligji, por edhe nga vullneti reciprok i bashkëshortëve në kontratë, aprovon sigurinë e secilit bashkëshort pas zgjidhjes së martesës.

E gjithë mbrojtja që mundohet të sigurojë ligji në raste të kësaj natyre, është mbrojtje që i sigurohet familjes dhe sensibilitetit që ka ky institut i së drejtës për sa i përket aspektit social të saj. Kjo mbrojtje i atribuohet, jetës familjare si një ndër katër dimensionet e jetës personale të individit³⁰², duke e nënvizuar më shumë rëndësinë që ka familja si dhe çdo veprim në dëmtim të saj. Një ndër mënyrat e krijimit të jetës familjare është martesa, e cila është baza e unitetit familjar³⁰³ dhe me interpretimet e fundit të jurisprudencës evropiane, nuk kufizohet në gjini apo në numër. Kjo duke zgjeruar kështu potencialin e krijimit të familjes dhe për rrjedhojë duke zgjeruar dhe legjislacionin i cili do të rregullojë këto marrëdhënie të reja për anëtarët e familjes. Duke arsyetuar mbi rëndësinë që ka jeta familjare dhe prishja e saj në rikthimin e anëtarëve të familjes në gjendjen e mëparshme, përse i përket statusit juridik të tyre në shoqëri, ka mjaftueshëm pasoja, aq sa duket sfidë e mirëfilltë përmbushja gjyqësore e subjekteve që preken nga zgjidhja e martesës për t'u integruar në shoqëri pa dallim social. Kjo është edhe arsyeja pse ligji ndërhyr duke

³⁰² Neni 8, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeirut.

³⁰³ Neni 1, Kodi i Familjes ligji nr.9062 datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”.

parashikuar se cilat janë pasojat e pashmangshme që duhet t'i nënshtrohen anëtarët e familjes zgjidhjes së martesës, duke u siguruar atyre garancitë ligjore në lidhje me mbiemrin, banesën, ekonominë si dhe ndihmën e ndërsjelltë ekonomike apo mundësinë e mbajtjes së afeksionit familjar edhe pas zgjidhjes së martesës.

Referimi që i bën ligji ynë, në pasoja që kanë lidhje me bashkëshortët dhe pasoja që kanë lidhje me fëmijët, vëmë re institute të së drejtës, të cilat vijnë në ndihmë të bashkëshortit më të “dobët” si dhe në ndihmë të fëmijëve, në respektim të parimit të interesit më të lartë të tyre. Që në interpretimin literal të rregullimit ligjor “pasojat e zgjidhjes së martesës” fillon pasoja e parë, konkretisht zgjidhja e martesës, në këtë moment nuk ekziston më martesa dhe me vullnetin e bashkëshortëve është vendosur ndryshimi i statusit të tyre, ndryshim i cili shoqërohet edhe ndikimi në të dhënat e identitetit të tyre. Konkretisht me zgjidhjen e martesës, bashkëshorti që kishte ndryshuar mbiemrin në lidhje të martesës, tashmë rimerr mbiemrin e tij para lidhjes së martesës, ndikim ky i menjëhershëm dhe i drejtëpërdrejtë në identifikimin e bashkëshortit me mbiemër të ndryshuar, ku në praktikë përkthehet në komplikim të procedurave administrative në lidhje me përfaqësimin e vetes së tij me të tretët. Jo vetëm ndryshimi i mirëfilltë i identitetit, por edhe komplikimi të aksesëve dhe të përfitimeve ligjore që i atribuohen cilitdo shtetas, por në rastin konkret i komplikohen bashkëshortit me mbiemër të ndryshuar. Ky proces në përballje me të tretët arrin deri në vënien në dyshim për unitetin e dy mbiemrave në një person, fazë e cila do të zgjasë për aq kohë sa do të bëjmë suksedimin e mbiemrit të rimarrë.

Pasoja e dytë në radhë, sërish në lidhje me bashkëshortët, mund të konsiderohet një formë reperacioni ndaj bashkëshortit që mund të konsiderohet se i ka ardhur dëm apo i është

shkaktuar një diferencë me zgjidhjen e martesës. Konkretisht bëhet fjalë për kontributin kompensues, institut i cili ka një fuqi të konsiderueshme, pasi në pak raste ndeshim terminologjinë “gjkata mund të detyrojë...”³⁰⁴, duke qënë se në marrëdhëniet familjare ndërhyrja e strukturave gjyqësore është gjithmonë e kujdesshme dhe mbetet në kuadrin e rekomandieve zgjidhja që mund të japë gjykata. Në interpretim të kësaj dispozite është e qartë se ndërhyrja e legjislacionit është në emër të mbrojtjes së bashkëshortit që mund të jetë më i dëmtuar nga zgjidhja e martesës. Vlen të sqarojmë se çfarë do të kuptojmë me bashkëshort të dëmtuar, pasi trajtimi juridik konsiston në aspektin ekonomik të konceptit, ku edhe në dispozitë thuhet se është pabarazia që krijon zgjidhja e martesës në lidhje me ndarjen e pasurisë. Kjo dispozitë e shkëputur është pak konfuze, duke qënë se me legjislacionin tonë në fuqi, procesi gjyqësor i zgjidhjes së martesës është në një fazë të dytë dhe kjo nuk mund të jetë e mundur të parashikohet që në momentin e zgjidhjes së martesës, me përjashtim të rasteve të zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve³⁰⁵, me nënshkrimin e marrëveshjes përcaktohet edhe bashkëshorti të cilit i krijohet një lloj pabarazie. Në vijim të kodit të familjes, në nenin 149, sqarohet se cilët janë elementet që do sillen në vëmendje të Gjykatës për të përcaktuar kontributin kompensues, por sërish këto nuk kanë të bëjnë me pjesëtimin e pasurisë dhe hetimi gjyqësor për këto elemente s’mund të jetë i plotë.

Pasoja e fundit për bashkëshortët, nga procesi i zgjidhjes së martesës, ka të bëjë me banesën, problem i cili ka shoqëruar pothuajse gjithmonë bashkëshortët në divorc, duke krijuar dëme të mirëfillta. Bashkëshorti më i dobët, pa mbështetje gjendet pa strehë, vetëm

³⁰⁴ Neni 147, Kodi i Familjes, ligji nr.9062 datë 08.05.2003.

³⁰⁵Po Aty, Neni 125.

si rezultat i zgjidhjes së martesës. Kontributi i këtij bashkëshorti në familje mund të ketë qënë i ndryshëm, por nëse legjislacioni nuk do të ndërhynte, konsiderohet i pallogaritshëm dhe pasoja sociale është majftueshëm e rëndë duke mos e integruar në shoqëri. Kjo e drejtë nuk përfitohet apriori, pasi kushtet që duhen plotësuar për të përfituar nga kjo dispozitë janë të konsiderueshme, të vlerësuara në varësi edhe të elemnetëve të tjerë, përballë mundësive dhe jo gjithmonë përmbushen këto kriterë, ku dispozita bëhet e aplikueshme.

Në momentin e lidhjes së kontratës së martesës, bashkëshortët mund të kenë pasuri dhe mund mos të kenë, por në secalin rast ka vlerë trajtimi i këtij elementi në këtë kontratë, duke i siguruar bashkëshortëve një të drejtë themelore. Së pari ,duhet sqaruar se çfarë do të quajmë banesë familjare. Për këtë na vjen në ndihmë jurisprudenca evropiane, e GJEDNJ e cila në interpretim të nenit 8 të KEDNJ, ka konsideruar si element të jetës private edhe banesën, dhe në ankimet në lidhje me respektimin e kësaj të drejte. Kjo gjykatë është zgjeruar në interpretimin e banesës³⁰⁶, duke e konsideruar atë një mjedis ku bashkëshortët kanë zgjedhur të jetojnë, pavarësisht veprimtarisë së gjërë jashtë saj, që mund të ushtrojnë subjektet që përdorin këtë banesë, por është strehimi i tyre dhe përfshin zotërimin paqësor të saj. Në kontratën e martesës bashkëshortët mund të parashikojnë mënyrën se si do ta zgjidhin këtë pasojë, për të mos i mohuar njëri-tjetrit një të drejtë themelore dhe jo vetëm atyre, por nëse do ketë fëmijë akoma më shumë prevalon nevoja e sigurimit të strehimit të fëmijëve, duke mos shkaktuar asnjë diferencë për ta në lidhje me ndryshimet që u kanë ardhur nga divorci i prindërve. Në rastin kur bashkëshortët me vullnetin e tyre të lirë përcaktojnë në kontratën e martesës se kush do të konsiderohet banesa familjare dhe kjo banesë ekziston në momentin e nënshkrimit të kontratës, atëherë rregullimi i kësaj pasoje

³⁰⁶Gillow kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykimi i 24 nëntorit 1986, paragrafi 46.

nëpërmjet kontratës bëhet më e mundur dhe më konkrete dhe merr vlerat e duhura, si garanci që kërkohet për secilin dhe për fëmijët.

7.4. Mbarimi i martesës me vdekjen e njërit bashkëshort

Format e mbarimit të martesës parashikohen në mënyrë shteruese në Kodin e Familjes dhe nuk ka hapsira për të alternuar rastet eventuale të cilësdo formë të ngjashme. Konkretisht, në nenin 123 të Kodit të Familjes, shprehen tri rastet kur mbaron martesa duke i sqaruar vetëm me doktrina më tej se çfarë janë këto raste dhe si parashikohen. Rasti i parë fillon me vdekjen e njërit bashkëshort, me shpalljen të vdekur të njërit bashkëshort si dhe me zgjidhjen e saj. Nga dispozitat na duket se rasti i parë me rastin e dytë ngjajnë dhe kanë të njëjtat pasoja juridike, por nga doktrina, thërrasim në ndihmë interpretimet e atyre institutive më vete për të identifikuar ndryshimin ndërmjet shpalljes i vdekur dhe vdekjes natyrore, për sa i përket pasojave juridike konkretisht me trashëgiminë dhe pasurinë. Ndryshimi ndërmjet këtyre dy rasteve është pikërisht tek gjendja statike e pasojave kur subjekti i së drejtës ndahet nga jeta për shkak të natyrës njerëzore dhe kur ai shpallet i vdekur. Shpallja i vdekur i një subjekti gëzon mbrojtjen e veçantë nga ligji, pikërisht për të rregulluar raportet ekonomike pasurore si edhe të drejta të tjera jopasurore dhe për këtë arsye për të shpallur të vdekur një subjekt duhet të zhvillohet një proces gjyqësor i cili për nga natyra konsiderohet proces i posaçëm dhe merr mjaftueshëm rezerva të garantuara nga ligji për të qenë korrekt në këtë përcaktim, pasi vdekja në këtë rast nuk është natyrore, por është si rezultat i fakteve njerëzore, duke qënë se nuk ka informacion prej 6 vitesh dhe nuk dihet se ku mund të jetë një subjekt, atëherë do të konsiderohet i vdekur, por jo domosdoshmërisht është i vdekur. Jo vetëm afati, por edhe procesi gjyqësor është i dyti në radhë për nga provat, pasi së pari

personi që të shpallet i vdekur duhet të jetë shpallur i zhdukur me vendim të gjykatës. Elementët natyrorë, humanë prevalojnë në konkurim me pasojat juridike, prandaj edhe ligji i garanton personit për të cilin nuk ka informacion një kohë të gjatë 6 vjeçare të pezullimit të të drejtave dhe formën e zhvillimit të këtij procesi me të gjithë karakteristikat e një procesi extra ordinem.

Nga ana tjetër ligji parashikon edhe kthimin, shfaqjen apo informacionin për personin që me vendim Gjykate është shpallur i vdekur, duke i mundësuar atij rikthimin e të gjitha të drejtave të tij në kohën kur ai i kishte lënë, nëse për nga natyra e të drejtave nuk janë shuar. Konkretisht në nenin 23 të Kodit Civil, thuhet se nëse personi që është shpallur i vdekur kthehet ose ka informacione se është gjallë ai ose të afërmit mund t'i kërkojnë Gjykatës prishjen e vendimit që e ka shpallur të vdekur. Me këtë veprim ligji i ka garantuar pa kufi çdo të drejtë pasurore personit të shpallur të vdekur të rikthyer, jo vetëm me pasurinë që ka patur në kohën kur ka qenë gjallë, por edhe me përfitimet që ka pësuar kjo pasuri, duke zhveshur tërësisht pronarin që kishte marrë titullin nga trashëgimia. Normalisht rikthimi i këtyre të drejtave do t'i nënshtrohet procesit gjyqësor dhe do të rregullohen marrëdhëniet juridike të cilat ishin krijuar si rezultat i rrethanave të tjera. Pikërisht, për këtë gjendje jostatike që ka 'shpallja i vdekur' në ndryshim nga vdekja e subjektit të së drejtës, ligji e parashikon si mënyrë ndryshme të mbarimit të martesës për të rregulluar pasojat.

Për sa i përket formës së tretë të mbarimit të martesës me zgjidhjen e saj, Kodi i Familjes ndalet në mënyrë të posaçme duke shpjeguar format e zgjidhjes së martesës, duke bërë dallim vetëm për sa i përket mënyrës dhe jo pasojave të zgjidhjes së martesës. Me zgjidhjen e martesës ish bashkëshortët kërkojnë edhe pjesëtimin e pasurisë, pasi regjimi pasuror martesor ka patur fuqi vepruese për aq kohë sa bashkëshortët kanë qenë në statusin e të

martuarit (*État matrimonial*). Në mënyrë standarde, ish bashkëshortët kërkojnë pjesëtimin e pasurisë në gjykatë për shkak të zgjidhjes së martesës, ndërkohë nga ana tjetër nuk haset praktika e kërkesave për të pjesëtuar pasurinë bashkëshortore me vdekjen e njërit bashkëshort. Kështu kur kërkohet lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë tek noteri, asnjëherë bashkëshorti pasjetues nuk paraqet vendim gjykate për veçimin e pjesës takuese nga kjo pasuri për të likujduar bashkësinë fillimisht dhe më tej për të realizuar kalimin e pronësisë vetëm të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët. Automatikisht ndodh që pasuria që ka patur trashëgimlënësi në emër të tij gjatë martesës, ku në rast se janë në regjimin e bashkësisë ligjore prezumohet kontributi i përbashkët dhe në këto kushte bashkëshortit të cilit nuk i rezulton emri, përfiton nga kjo pasuri vetëm si trashëgimtar në pjesë të barabarta nëse është në radhë me fëmijët dhe në $\frac{1}{2}$ në rast se konkuron me trashëgimtarë të tjerë. Me këtë veprim bashkëshortit pasjetues i është mohuar mundësia për të marrë pjesën e tij takuese, fillimisht si rezultat i kontributit gjatë martesës dhe në vijim si përfituese e pasurisë trashëgimore, për statusin si trashëgimtar. Praktika ka sjellë përplasje të kësaj natyre për disa arsye: së pari si rezultat i mungesës së informacionit, së dyti pasi procesi gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë nuk bëhet kryesisht, ai inicohet si rezultat i kërkesës së bashkëshortëve dhe në rastet e humbjes së një bashkëshorti neglizhojnë realizimin e këtyre pretendimeve, si edhe për faktin se ligjërisht nuk është e sanksionuar si kusht që lëshimi i dëshmisë trashëgimisë duhet të bëhet pasi të jetë likujduar bashkësia ligjore. Pasuria e mirëfilltë trashëgimore është e zhveshur nga shtesa dhe pakësime të origjinës së ndryshme në formimin e saj dhe nuk llogaritet e prezumuar, por është tërësisht e regjistruar me statusin e pasurisë trashëgimore. Bashkëshorti pasjetues mund edhe t'i shmanget detyrimeve që kanë lindur gjatë martesës si rezultat i veprimeve që kanë bërë me

bashkëshortin në regjimin e bashkësisë ligjore duke u fshehur edhe pas një detyrimi (huaje) për të cilën detyroheshin vetëm ata të dy, jo të gjithë trashëgimtarët në pjesët përkatëse. Pjesëtimi i pasurisë ndërmjet bashkëshortëve i jep bashkëshortit pasjetues pasurinë e tij dhe mbi këtë do të shtohet pjesa takuese si trashëgimtar i të ndjerit duke trashëguar sipas formulës dhe statusit të tij.

E gjithë situata komplikohet akoma më shumë në rastin e ekzistencës së një testamenti, pasi bashkëshortët gjatë martesës, kur janë në regjimin e bashkësisë ligjore, pa e rregulluar atë me një kontratë, kur shtojnë pasuritë nuk është e dosmosdoshme prania e bashkëshortit tjetër dhe në këto kushte mund të regjistrohet kjo pasuri edhe vetëm në emër të njërit prej bashkëshortëve. Ky bashkëshort në momentin e formulimit të testamentit si notarial edhe ollograf, mundet të disponojë në dukje pa asnjë pengesë këtë pasuri në emër të subjektit ku është vullneti i tij për këtë disponim, duke i mohuar kështu bashkëshortit tjetër pjesën e tij takuese si rezultat i kontributit gjatë martesës apo edhe prezumimit në pjesë të barabarta të pasurive të bashkësisë ligjore. Raste të kësaj natyre hasen në praktikë, pasi kanë goditur testamentin pikërisht për këtë arsye.

7.4.1. Pasuria bashkëshortore kundrejt asaj të trashëgimisë

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë³⁰⁷, parashikon në pjesën e tretë të tij institutin e trashëgimisë, duke i dhënë kështu rëndësinë përkatëse dhe për rrjedhojë dhe mbrojtjen ligjore që gëzojnë trashëgimtarët pas vdekjes së trashëgimlënësit. Normat ligjore në këtë pjesë shtrijnë efektin e tyre për sa i përket tërësisë së elementëve të marrëdhënies juridike të trashëgimisë, duke rregulluar kështu objektin, subjektin dhe përmbajtjen e marrëdhënies

³⁰⁷ I miratuar me Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 i ndryshuar për herë të fundit në 2016 me ligjin nr.113/2016, datë 03.11.2016.

juridike civile. Të gjithë këto elemente janë në vëmendjen e këtij studimi për të analizuar edhe mënyrën se si paraprihet me mjete juridike anashkalimi i secilit trashëgimtar për sa i përket pjesës takuese në lidhje me pasurinë trashëgimore.

Trashëgimia, si marrëdhënie juridike *mortis causa* kushtëzohet edhe nga institute të tjera të cilat gjithmonë në studimin e së drejtës nuk mund të merren të shkëputura nga njëra-tjetra. E drejta e pronësisë duke u konsideruar si e drejtë reale, madhore, absolute nuk mbaron asnjëherë. Subjekti i saj për shkak të fakteve juridike kalon të drejtat pasurore tek subjekte të tjerë të së drejtës duke u zhveshur kështu nga tagrat e pronarit dhe duke ia kaluar një subjekti tjetër. Është vetëm një kalim i të drejtave, por jo përfundim i marrëdhënies juridike, pasi e drejta e pronësisë ka natyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme³⁰⁸. Mënyra e kalimit të pronësisë merr rëndësi studimi dhe sanksionimi kur është e ligjshme dhe duhet të përcaktohet destinacioni i saj, ku ky i fundit ka krijuar së shumti probleme në praktikë dhe çlirimin e së drejtës nga çdo ndikim joligjor, subjektet e së drejtës përfitojnë më shumë në mbrojtjen e tyre. Kujtojmë gjithmonë se është e drejta në shërbim të individit dhe jo anasjelltas.

Referuar nenit 165 të Kodit Civil, për të normuar një nga mënyrat e fitimit të pronësisë në lidhje me trashëgiminë, dispozita parashikon rregullimin në pjesën e tretë të Kodit Civil. Për të vazhduar më tej në pjesën e tretë, konkretisht në nenet 360 e në vijim, në radhët e trashëgimtarëve na shfaqet bashkëshorti i cili herë pas here ndryshon formulën e përfitimit në varësi të trashëgimtarëve të tjerë. Radhët e trashëgimisë rregullohen me sistemin e mundësisë së njohjes dhe ndarjes së pasurisë trashëgimore, të bazuar në lidhje afektive të gjakut, bashkëshortë dhe persona të paaftë për punë, pra është e dukshme se e gjithë pjesa e

³⁰⁸ Nuni A. & Hasneziri L.(2010).*E drejta civile II, (Pronësia)*,Tiranë, fq.17-18.

trashëgimisë kujdeset për secilin subjekt nga pak i cili mund të jetë përfitues i pasurisë trashëgimore.

Radha e parë e dëshmisë së trashëgimisë, parashikon se mund të përfitojnë nga trashëgimlënësi pasuri, bashkëshorti dhe fëmijët. Këto subjekte përfitojnë në pjesë të barabarta. Në rast se trashëgimlënësi nuk ka fëmijë, bashkëshorti duke qënë se nuk është trashëgimtar ekskluziv i radhës së pare, zbret në radhën e dytë dhe konkuron me trashëgimtarët e asaj radhë. Këtu sërish, shfaqet fuqia mbrojtëse e legjislacionit duke mundësuar që bashkëshorti në këto rrethana përfiton gjithmonë $\frac{1}{2}$ e pasurisë dhe pjesa tjetër ndahet ndërmjet trashëgimtarëve të tjerë në mënyrë të barabartë³⁰⁹. E njëjta situatë ndodh edhe kur trashëgimlënësi nuk ka prindër apo person të paaftë për punë që mund të thirret në trashëgim në radhë të dytë, bashkëshorti zbret në radhën e tretë dhe sërish konkuron me trashëgimtarët e kësaj radhe, duke marrë përsëri $\frac{1}{2}$ e pasurisë ku ligji parashikon së në këtë radhë bashkëshorti është trashëgimtar ekskluziv dhe nuk zbret më në radhë të tjera nëse nuk ka trashëgimtar, por përfiton i vetëm të gjithë pasurinë trashëgimore. Statusi që gëzon bashkëshorti në trashëgimi është e dukshme se është ligjërisht i plotësuar duke i siguruar kryesisht privilegje për të mos lënë asnjë hapsirë në të cilat mund të cënohet³¹⁰. Në rrugëtimin ndër radhë të trashëgimisë, bashkëshorti është përfitues i pasurisë së trashëgimlënësit si çdo trashëgimtar, pra me statusin e trashëgimtarit dhe në këtë përfitim nuk flitet për pasurinë bashkëshortore që kanë vendosur gjatë martesës bashkëshortët me kontributet e tyre, por për atë pasuri që është e trashëgimlënësit.

³⁰⁹ VUGJL Nr.5/2009 dhe Nr.1/2014.

³¹⁰ Stange C.K., (2014), *“Prenuptial agreement line by line”*, Thomson Reuters, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, faqe 97.

7.4.2. Mbrojtja e bashkëshortit pasjetues

Një nga mënyrat e mbarimit të martesës është pikërisht vdekja e njërit prej bashkëshortëve, rast ky i parashikuar në nenin 123 të Kodit të Familjes Ligji, nr.9062 datë 8.5.2003, i cili barazohet për rrjedhojë edhe me vdekjen civile kur me vendim gjykate subjekti shpallet i vdekur. Te drejtat pasurore pas vdekjes së subjekteve të së drejtës nuk vdesin bashkë me të, por kalohen tek trashëgimtarët duke u rregulluar kështu sipas mënyrës së parashikuar nga trashëgimia ligjore apo ajo testamentare, rast pas rasti. Trashëgimia është një nga mënyrat e ligjshme të fitimit të pronësisë, *mortis causa*, ku trashëgimtarët sipas radhës përfitojnë pasuritë e trashëgimlënësit dhe marrin titull pronësie mbi këto pasuri. Në radhët e trashëgimtarëve gjendet edhe gruaja³¹¹, e cila nuk është trashëgimtare ekskluzive i radhës së pare, pasi në mungesë të pranisë së fëmijëve ajo konkuron me trashëgimtarë të tjerë me radhët në vijim. Praktika në shumicën e rasteve anashkalon pjesëtimin e pasurisë për shkak të mbarimit të martesës me vdekjen e njërit bashkëshort dhe në këto kushte pasuria e bashkëshortit pasjetues pjesëtohet sipas pjesëve takuese ndër trashëgimtarë të trashëgimlënësit dhe jo të zotëruesit të pasurisë që mund të jetë bashkëshorti pasjetues. Me ndryshimet në Ligjin Nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”, ndryshuar me Ligjin nr.131/2013, datë 29.4.2013, lëshimi i dëshmimeve të trashëgimisë i kalon autoritetit të noterisë dhe në këto kushte komplikohet më shumë situata për sa i përket hetimit që duhet të kryhet për të informuar trashëgimtarët në lidhje me pasuritë e tyre dhe mbrojtjes së bashkëshortit pasjetues apo respektimit të rezervës ligjore.

Të gjendur në rrethanat e mësipërme, martesa duket sikur kushëtzon edhe në momentin e mbarimit të saj dhe i kufizon mundësinë secilit prej bashkëshortëve të gëzojë i lirë pasuritë

³¹¹ Nuni A. & Hasneziri L.(2010).*E dretja civile III, (Trashëgimia)*, Tiranë, fq.57, 60.

e tij e të përcaktojë destinacionin final të tyre si mundësi ekskluzive e pronarit. Duke marrë shkas nga çfarë ka prodhuar deri më sot praktika dhe se si bashkëshortët shpesh kanë mbetur të zhveshur nga pronësia përballë institutive të tjera të së drejtës për shkak të regjimit të bashkësisë ligjore³¹², është me vend që të sanksionohet që në kontratën e martesës destinacioni pasuror në rast të zgjidhjes së martesës dhe në rast të vdekjes së njërit prej bashkëshortëve. Kjo, sepse ky disekuilibër i institutit të martesës dhe bashkëshortët në regjimin e bashkësisë ligjore janë inferior kundrejtë instituteve të tjera për sa i përket garancisë që i jep bashkëshortëve bashkësia ligjore. Kontrata e martesës do të rivendoste ekuilibrat përsa i përket pjesës së mbrojtjes së bashkëshortëve, të drejtave të tyre pasurore dhe statusin e tyre si bashkëshortë të ndarë nga statuse të tjera ku subjekti i së drejtës merr kur hyn në marrëdhënie juridike civile të tjera³¹³.

Mundësia e sanksionimit të bashkëshortit pasjetues, duke e normuar direkt në kontratën e martesës do t'i paraprinte çdo lloj përplasjeje para hyrjes së bashkëshortit në marrëdhënie të tjera juridike civile³¹⁴.

Askush nuk mund të kalojë më shumë të drejta sa vetë ka (*Nemo plus iuris ad alium transferre potest quam ipse habet*). Prandaj dhe është e nevojshme që kontrata e martesës të konsiderohet si garanaci dyfishe e bashkëshortit pasjetues. Sipas dispozitave ligjore, që rregullojnë kontratën e martesës, është e qartë se bashkëshortët zgjedhin lirisht formulën e shtimit të pasurive gjatë martesës, kështu ligji ju mundëson atyre regjimin e pasurive të

³¹² Cohen Lloyd, (1987) "Marriage, Divorce, and Quasi Rents", Legal Studies, Volumi 16, Nr.2, faqe 267 - 303

³¹³ Tadao Maruko kundër Versorgungsanstalt der deutschen Bühnen, 2008

³¹⁴ McLellan, D. (1996). "Contract Marriage-The Way Forward or Dead End" Journal of Law and Society. Vol 23, no. 2. Pg. 234-246.

ndara ose bashkësinë me kontratë sipas së cilës bashkëshortët përcaktojnë pjesët e tyre, ndryshojnë rregullat e administrimit, por edhe mund të vendosin të kenë bashkësi universale. Në rastin e pasurive të ndara, funksioni i kontratës së martesës dhe mbrojtja që ajo garanton është tërësisht e pastër dhe e dukshme duke i mundësuar kështu bashkëshortëve projektin e ndarjes së pasurive në çdo rast eventual të mbarimit të martesës. Ndërsa në lidhje me bashkësinë me kontratë, situata paraqitet ndryshe, pasi duket në disa momente sikur kemi sërish përplasje dhe përzierje të së drejtave, duke qënë se ata tejkalojnë edhe bashkësinë ligjore. Në të vërtetë në bashkësinë me kontratë, bashkëshortët guxojnë të tejkalojnë gamën e bashkësisë ligjore, por ata nuk fshihen në identitetin pasuror të njëri-tjetrit. Edhe sikur të ishte vendosur vetëm në emër të njërit bashkëshort, ekzistenca e një kontrate martese ku ka parashikuar se si do të rregullohen pasuritë e bashkëshortëve në të ardhmen, është garanci për titullin e pronësisë, pa patur nevojë për të provuar kontributin dhe për të përcaktuar pjesët, pasi atë e kanë parashikuar në kontratë.

Më qartë, në momentin e këkimit nga trashëgimtarët të lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, bashkëshorti pasjetues paraqet kontratën e martesës dhe lehtësisht mund të përjashtojë nga pasojat e dëshmisë së trashëgimisë pasuritë e tij. Sipas legjislacionit tone, dëshmia e trashëgimisë duhet të depozitohet në ZVRPP për t'u regjistruar, duke mundësuar kështu kalimin e pronësisë nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët, sipas pjesëve takuese, por jo pasuritë që sipas kontratës së martesës janë të bashkëshortit pasjetues³¹⁵.

³¹⁵Neni 348 Kodi Civil.

KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të këtij punimi shkencor është me rëndësi që të mund të evidentohen problematikat dhe risitë që janë sjellë nga ky studim. Qasja e kontratës së martesës ka qënë me natyrë pozitive, për sa i përket përkrahjes së këtij instituti dhe promovimit të tij në mundësinë e aplikimit më të gjërë në praktikë. Në formulimin e këtij kapitulli, kam hasur vështirësi në nxjerrjen e konkluzioneve, pasi ka pak literaturë dhe praktikë, ndërsa rekomandimet janë më të lehta, pikërisht për të sjellë të reja nga vendet e tjera në legjislacionin tonë. Prandaj katëgorinë e kapitullit të fundit trajtohet në formën e vlerave dhe kritikave duke i konsideruar të përmbledhura në konkluzione dhe rekomandime.

8.1. Konkluzione

Nga analiza e koncepteve të mësipërme të trajtuara në këtë punim, konkludohet si më poshtë vijon në disa tematika më të rëndësishme:

- Ndryshimet e Kodit të Familjes me Ligji nr.9062 datë 08.05.2003, kanë sjellë disa institute të reja, siç është bashkëjetetsa³¹⁶, ashtu edhe regjimet pasurore martesore. Kontrata e martesës ishte një rikthim i ligjërimit të saj në Kodin e Familjes pasi ka qënë edhe në Kodin Civil të 1929, si mundësi për të zgjedhur regjimin pasuror martesor. Konsiderohet me mjaft rëndësi ky ndryshim për faktin se tashmë ka alternativë në llojin e regjimit, jo vetëm ai ligjor por edhe ai kontraktor. Gjatë studimit është konkluduar se, si me regjimin ligjor ashtu edhe ate me kontratë, në mundësinë e alternativës, bashkëshortët kanë një nivel

³¹⁶ Neni 163 i Kodit të familjes, Kuptimi i bashkejetesës.

të shprehjes së vullnetit. Kjo duhet kuptuar se ndryshe nga ç' ishte ligji i mëparshëm³¹⁷, ku bashkëshortët kishin vetëm regjimin ligjor, tashmë ata kanë edhe llojet e regjimeve me kontratë dhe në të dy rastet vendosin me vullnetin e tyre të zgjedhin njërin apo tjetrin.

- Në kuadër të promovimit të kontratës së martesës, teknikisht në punim janë trajtuar lehtësitë që kontrata e martesës ju mundëson bashkëshortëve në njohjen e ligjit për t'i ofruar vetes së tyre alternativën më të mirë të mënyrës së administrimit të pasurisë bashkëshortëve. Me anë të metodës së krahasimit të regjimit pasuror të bashkësisë ligjore dhe atij me kontratë, konkludojmë se tek regjimi me kontratë promovohet autonomia pasurore e bashkëshortëve, kontributi i barabartë i tyre në ekonominë familjare si dhe barazia gjinore.

- Duke marrë shkas nga objekti i lidhjes së martesës, i cili sanksionohet në nenin 1 të Kodit të Familjes, ku shprehet: “*Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje...*” parashikohet barazia morale dhe juridike, ndërmjet burrit dhe gruas po ashtu edhe mjetet e duhura juridike në mbrojtje të kësaj barazie. Me anë të zgjedhjes së regjimit pasuror kontraktor, është evidentuar se bashkëshortët zhvishen nga mundësia për të përfituar nga të ardhurat e vetëm njërit bashkëshort apo edhe anasjellta që bashkëshorti me i mundshëm ekonomikisht të ndjehet i shfrytëzuar si rezultat i martesës. Me zgjidhjen e martesës ndër të tjera, vijnë edhe pasojat pasurore, prezumimi i pjesëve të barabarta, duke humbur ndonjëherë kontributin e njërit bashkëshort dhe duke mbrojtur më shumë bashkëshortin jo-kontribues. Me kontratën e

³¹⁷Edhe pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të 1994 (i cili hyri në fuqi në 1995), marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve vazhduan të rregulloheshin ende nga neni 86 dhe 87 i Kodit Civil të vitit 1981, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të Familjes, 21 Janar të vitit 2003.

martësës, nuk shkelim mbi themelet e martësës, duke qënë se bashkëshortët janë të sigurt se çfarë i pret dhe janë të sigurt në vendimarrje, pa u ndikuar nga asgjë tjetër që nuk është dëshira e tyre për të qëndruar me njëri tjetrin.

- Për të nxjerrë në pah rëndësinë dhe rritjen e aplikimit të saj janë trajtuar qëllimet në aspektin juridik, funksional dhe atë social . Gjithashtu del në pah qëllimi i ligjvënësit për institutin e kontratës së martësës në Kodin e Familjes. Qëllimi juridik ka qënë për ta mundësuar fillimisht këtë regjim në ligj dhe për ta aplikuar edhe më shumë si mundësi e autonomisë së bashkëshortëve. Qëllimi social vihet re në vazhdimësi të aplikimit të saj pasi bashkëshortët janë të pavarur ekonomikisht e për rrjedhojë dhe në jetën sociale, ndërsa qëllimi i saj funksional ka të bëjë me kohën e shkurtër në identifikimin e pasurisë në fund në zgjidhjen e martësës.

- Kontrata e martësës përshkohet nga elementet e kontratave të tjera aq sa mos të çënojë parimet themelore të familjes dhe martësës. Një ndër parimet bazë të kontratave që është trajtuar në punim, ka të bëjë me barazinë e palëve, duke sjellë kështu në vëmendje se kanë të drejta dhe detyrime të barabarta. Nga kjo barazi në kontratë ka edhe përfitime të barabarta pasi në zbatimin e kontratës, bashkëshortët ndjehen njëllor të detyruar për familjen dhe njëllor të mbrojtur për pasuritë e tyre. Kontrata e martësës, promovon barazinë gjinore, e trajtuar edhe në këtë punim, duke krahasuar bashkëshortin e regjimit pasuror të bashkësisë ligjore me bashkëshortin e regjimit me kontratë. Ky i fundit nuk mund të pengohet për shkak të konfliktit familjar apo mungesës së dëshirës së bashkëshortit tjetër për të kryer një veprim juridik. Gjithashtu, bashkëshortët duke disponuar lirisht pasuritë e tyre nuk ndikojnë tek njëri-tjetri në sipërmarrjet e tyre. Problematikat gjinore kryesisht e kanë origjinën në pavarësi ekonomike dhe si të tilla me kontratën e martësës asnjëri

bashkëshort nuk është i varur nga tjetri. Deri më sot partneri i diskriminuar ka qënë gruaja dhe të gjitha politikat janë drejtuar në rregullimin e balancës kundrejt rritjes së aktivizimit dhe përfshirjes së gruas në rolin social dhe ekonomik të jetës së saj, prandaj edhe me anë të kontratës së martesës gruaja nuk mund të ndjehet e kushtëzuar që ajo të jetë e vetmja e cila do të kontribuojë për rritjen e fëmijëve, por ajo ashtu si burri ka mundësi të punojë e të aktivizohet në jetën e saj sociale duke mundësuar krijimin e të ardhurave personale dhe administrimin e tyre individualisht.

- Kontrata e martesës përforcon të drejtën e pronësisë, që gjatë studimit e kemi përkufizuar si garanci e autonomisë pasurore. Bashkëshortët në regjimin e bashkësisë ligjore shpesh përfshihen në të pa e ditur se çfarë parashikon konkretisht dhe se cilat janë pasojat pasurore nga zgjidhja e martesës, për shkak të prezumimit të barazisë. Në regjimin e bashkësisë ligjore, përveç pasurive vetjake³¹⁸, gjithçka tjetër që është blerë apo e fituar nga njëri bashkëshort është i të dyve dhe në rast se duhet ta tjetërsojë këtë pasuri, duhet të shprehë vullnetin edhe bashkëshorti që nuk e ka blerë apo fituar. Ky i fundit e fiton tagrin më të rëndësishëm të pronarit, atë të disponimit mbi sendin, pa kontribuar në asnjë masë mbi sendin dhe në vijim, në rast se nuk dëshiron ta tjetërsojë mund të pengojë shitjen apo dhurimin e kësaj pasurie. Pikërisht ky vullnet pengues në lidhje me destinacionin dhe me tjetërsimin, konsiderohet kufizim i së drejtës së pronësisë që i bëhet bashkëshortit që e ka sjellë në bashkësinë e pasurive bashkëshortore. Siç orienton e drejta e pronësisë, që pronari ka tagra të plota mbi sendin e tij, regjimi i bashkësisë ligjore imponon që për shkak të martesës, bashkëshortët të jenë edhe bashkëpronarë, pavarësisht se kush e shton pasurinë bashkëshortore. Nga ana tjetër, kontrata e martesës, i detyron bashkëshortët në investim të

³¹⁸Neni 77, Kodi i Familjes.

përbashkët, aq sa është e nevojshme për mbarëvajtjen e familjes dhe nuk ndërhyr në vullnetin personal të secilit për pasuritë e tyre, pasi nuk e kushtëzon me asnjë detyrim martesor shtimin dhe pakësimin pasuror.

- Gjatë këtij punimi është hedhur hipoteza e mundësisë për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore Palët në një proces gjyqësor shpesh gjenden në vështirësi për sa i përket mundësisë për të kërkuar të drejtën e tyre dhe për të përfituar nga gjykimi mbi të drejtën që u është mohuar. Sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, fillimisht zhvillohet procesi i zgjidhjes së martesës dhe pasi të ketë marrë formë të prerë ky proces, mund të zhvillohet procesi i pjesëtimit të pasurisë. Pjesëtimi i pasurisë mund të zhvillohet jashtëgjyqësisht nëse palët bien dakort për të ndarë pasurinë e tyre me marrëveshje dhe mirëkuptim, në rast të kundërt ato i drejtohen gjykatës. Nga sa kemi sqaruar gjatë punimit, një proces gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore zgjat deri në 10 vite³¹⁹, Ndërsa në praninë e një kontrate martese është shumë e qartë se të kujt janë pasuritë dhe është shumë e qartë se si është shprehur vullneti i secilit në lidhje me origjinën dhe destinacionin e pasurisë, prandaj edhe nëse ka kërkesë padi në gjykatë për konfliktin e ndonjë pasurie specifike, nuk ka kundërshtim në tërësi për pasuritë Kështu konkludojmë se koha për të identifikuar pasuritë pas zgjidhjes së martesës me kontratë martesore, është më e shkurtër se sa në regjimin e bashkësisë ligjore.

³¹⁹ Trajtuar në kapitullin VI pika 3 ekonomia gjyqësore, duke kujtuar kështu se nga studimi I çështjeve në Gjykatën e Lartë në periudhën 2005 deri në 2015, harku kohor në të cilin asnjë proces gjyqësor nuk është më pak se 3 vite nga gjykimi në shkallë të parë, për pjesëtimin e pasurisë.

- Një konkluzion tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me faktin se me anë të kontratës së martesës bashkëshortët mund të parashikojnë edhe institute të tjera të së drejtës në lidhje me martesën. Këtu na vjen në ndihmë parimi se:

- “Çdo gjë që s’është e ndaluar, është e lejuar “prandaj në kontratën e martesës bashkëshortët mund të parashikojnë edhe rregullime të tjera, për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin³²⁰. Konkludojmë se, ligji na jep mundësinë e regjimeve tipike dhe ofron formulat përkatëse për secilin rast, siç e kemi sqaruar në atë ligjor dhe në atë kontraktor, duke e konsideruar të parin si regjim subsidiar, pasi në mungesë të kontratës aplikohet bashkësia ligjore. Por, ajo që ka mjaft rëndësi është se sa bashkëshortët mund të eksperimentojnë në aplikimin e këtyre regjimeve duke qënë se ligji ka ofruar alternativat e studjuara si më të përzgjedhura dhe më të mundshme, por gjithmonë praktika sjell nevojën e prodhimit edhe të elementeve të rinj për sa i përket mënyrës së administrimit të pasurisë bashkëshortore. Këtë përfundim e nxjerrim nga interpretimi i kombinuar i nenit 66 të Kodit të Familjes dhe dispozitave që rregullojnë regjimet me kontratë nga neni 108 deri tek neni 122 i Kodit të Familjes. Gjithashtu me nënshkrimin e kontratës së martesës, bashkëshortët janë të ndërgjegjësuar për pjesën ekonomike të investimit në familje dhe janë të gatshëm për angazhimin e tyre pasi ata vetë me mirëkuptim kanë zgjedhur mënyrën se si do të kontribuojnë në jetën familjare dhe ekonominë e tyre. Prandaj, bashkëshortët mund të rregullojnë më mirë me njëri-tjetrin dhe me marrëveshje ekonominë dhe të sigurohen për kontributin e vazhdueshëm të tyre në mbarrëvajtjen e jetës familjare. Në rast të

³²⁰Neni 66 (Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve), Kodi i Familjes parashikon se: *Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës.*

mospërmbushjes së detyrimeve, bashkëshortët janë të ndërgjegjshëm për pasojat, janë të gatshëm të marrin përsipër detyrimet dhe dinë mjaft mirë se deri ku shkojnë pretendimet e tyre ndaj njëri tjetrit.

- Një rëndësi specifike, ka patur sqarimi i përdorimit të terminologjisë “kontrata para-martesore”, “kontrata e martesës” dhe marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve. Kontrata para-martesore gjendet e përdorur në doktrinë duke dashur të përshkruhet kur bashkëshortët redaktojnë kontratën dhe sipas nenit 69 të Kodit të Familjes, kjo kontratë hyn në fuqi me lidhjen e martesës. Gjithashtu gjatë studimit janë sjellë në vëmendje shtetet e sistemit të *Common Law*, të cilët e kanë shumë të avancuar institutin e kontratës para-martesore (prenuptial agreement), duke iu referuar aktit që lidhet para lidhjes së martesës, por hyn në fuqi me lidhjen e martesës. Ata e sqarojnë shumë qartë se cili është ndryshimi ndërmjet këtyre akteve duke na bërë të reflektojmë në legjislacionin tonë se si ndodh. Ndërsa në legjislacionin tonë nuk ka një shpjegim të këtyre terminologjive dhe cili është dallimi ndërmjet tyre, gjejmë në dispozitat e Kodit të Familjes edhe përdorimin e një “marrëveshjeje” herë pas here. Prandaj na lindi nevoja të bëjmë identifikimin e rasteve se kur legjislatori ka dashur të përdorë terminologjinë kontrata para-martesore dhe kontrata e martesës. Konkretisht, në interpretim të kombinuar të dispozitave, arrijmë në konkluzionin që dallimi i këtyre dy koncepteve është vetëm në kohën kur këto dy akte lidhen, që do të thotë se kontrata para-martesore lidhet para lidhjes së martesës, por merr fuqi juridike me lidhjen e martesës ndërsa kontrata e martesës është rasti I kushtëzuar në nenin 72 të Kodit të Familjes, i interpretuar në Kpitullin e IV tek “fuqia juridike” veprimi i kontratës në kohë. Nga ky studim krahasimor dhe analitik dalim në konkluzionin se në Kodin e Familjes nuk gjejmë të rregulluar kontratën e martesës, pra aktit që lidhet pas lidhjes së martesës për të

ndryshuar regjimin, mund të parashikojmë edhe rregullimin pasurive që ishin shtuar deri në momentin e lidhjes së kontratës, por gjatë martesës.

- Në Kodin e Familjes në nenin 72, është parashikuar mundësia e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, pasi kanë kaluar të paktën 2 vite nga lidhja e martesës, duke e kushtëzuar këtë ndryshim në dy aspekte. *Së pari*, në kohë, pasi në dispozitë është përcaktuar afati 2 vjeçar i ndryshimit të kontratës së martesës. *Së dyti*, kushtëzimi lidhet me motivimin e interesit të familjes, duke e lënë evazive se kush do ta provojë këtë interes dhe kush do ta vlerësojë si dhe a është përcaktuar drejtë ky ndryshim. Gjatë analizës për kriteret e përcaktuara në këtë dispozitë, fillimisht vëmë re *ratio leges* të ligjvënësit që ka të bëjë me faktin se bashkëshortët kanë mundësi të ndryshojnë regjimin pasuror martesor duke i dhënë kështu një mundësi edhe atyre çifteve që kanë lidhur martesë para hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 9062, datë 8.5.2003 në rast se nuk ka funksionuar regjimi që zgjodhën në rastin e lidhjes së martesës. Gjithashtu kjo dispozitë u jep mundësi bashkëshortëve që me vullnetin e tyre të lirë, në rast se nuk ka qënë i përshtatshëm për ta regjimi që kanë zgjedhur në lidhjen e martesës të tyre. Kontrata e martesës është veprim juridik *sui generis*, pasi karakteristikat e saj janë të kushtëzuara nga martesja si institut i së drejtës familjare dhe ndikohet nga aspekte sociale që e ndryshojnë reagimin e kontratës. Nisur nga sa dimë për karakteristikat e kontratave të tjera, mund të themi lirisht se kontrata e martesës nuk krijon një marrëdhënie detyrimi të mirëfilltë, por është një marrëveshje për të ndërtuar marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve gjatë martesës. Siç e kemi shpjeguar edhe në punim, elementet e kontratës së martesës krijohen dhe analizohen duke u kushtëzuar nga lloji i veprimit juridik dhe përmbajtja e tij, pasi rrjedh nga martesja, institute që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ligji. Kontrata e martesës është kontratë, por në objekt të saj ka

marrëdhëniet ekonomike të bashkëshortëve dhe palët janë subjekte të posaçëm për të drejtën familjare. Liria kontraktuale e kontratës martesore, mund të shtrihet aq sa ligji jep mundësinë e tij dhe aq sa martesë lejon të kontraktohet. Vetë raporti familjar e kushtëzon kontratën dhe nuk e lejon të jetë një kontratë e parashikimeve të cilën e gjejmë në parimet e përgjithshme të kontratave në Kodin Civil,³²¹ pasi subjektet e kësaj kontrate, duke qënë në marrëdhënie të posaçme, kushtëzohen nga raporti i tyre për të rregulluar regjimin pasuror dhe ku lidhja e martesës mund të konfundojë. Prandaj konkludojmë se kontrata e martesës për shkak të llojit të saj dhe objektit, është e kushtëzuar në numër subjektesh, në objekt për sa i përket llojit të marrëdhënies që rregullon, në përmbajtje pasi nuk duhet të bjerë ndesh me parimet e përgjithshme të parashikuara në ligj në lidhje me familjen dhe martesën, nuk duhet të çenojë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe shumë institute të tjera të cilat rregullohen me Kodin e Familjes.

- Gjatë punimit janë sqaruar shembuj si në vendet e Common Law, që bashkëshortët mund të parashikojnë në kontratë edhe fakte të cilat nuk janë të rregulluara me ligj në lidhje me marrëdhëniet konkrete të tyre. Kjo do të thotë që nuk është e ndaluar që ata të rregullojnë në kontratë ritmin e tyre ditor, angazhimet në familje dhe mënyrën e përkushtimit ndaj njëri-tjetrit, por kjo nuk i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës dhe në rast se ka elemente që çenojnë të drejtat e njeriut dhe kushtëzojnë bashkëshortët në lirinë e tyre, goditet vetëm në pjesën e paligjshmërisë që ajo rregullon.
- Në vijim të këtij konkluzioni, në legjislacionin vendas, na është dashur të studjojmë se çfarë mund të rregullojmë me kontratën e martesës dhe sa munden bashkëshortët të

³²¹ Neni 659 (Përmbajtja e kontratës) citon se: *Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.*

eksperimentojnë me qëllimin e lidhjes së kontratës së martesës. Atë që kemi trajtuar në këtë studim duke ju referuar kryesisht Kodi të Familjes të Republikës së Shqipërisë, për të parë se si rregullohen raportet pasurore dhe jopasurore ndërmjet bashkëshortëve. përqëndrimi kryesor i vëmendjes ka qënë tek raportet pasurore, prandaj kemi arritur në konkluzionin se Kodi i Familjes parashikon dy grupe normash: norma që në rast se zgjedhim kontratën e martesës është e detyrueshme të rregullohen disa të drejta dhe detyrime, dhe një grup normash alternative, të cilat bashkëshortët mund të zgjedhin vetë nëse duan t'i përfshijnë në kontratë ose jo. Në grupin e parë hyjnë ato norma të cilat, edhe pse nën regjimin pasuror me kontratë, nuk mund të shmangen, pasi janë të detyrueshme për t'u parashikuar në kontratë. Ato kanë të bëjnë me kontributin material të nevojave të fëmijës³²², kufizimin e veprimeve tregtare, me banesën familjare, detyrimin e bashkëshortëve për kontribut minimal familjar, për jetesën e përditshme,. Këto norma të detyrueshme janë një formë e *rezervës ligjore* që ligji kujdeset gjithmonë në rastet e rrezikut të prishjes së ekuilibrave të të drejtave, për subjekte që kanë më shumë nevojë. Kjo shpjegohet me faktin se bashkëshortët janë të lirë të zgjedhin regjimin, por jo për t'u shmagur detyrimeve që lindin nga martesa duke prishur kështu ekuilibrat familjarë dhe duke rënë ndesh me parimet themelore të mbrojtjes që gjen familja në ligj. Referuar legjislacioneve frankofone që i kemi marrë si orientim gjatë gjithë studimit, i quajmë këto grupe të drejtash si "*régime primaire*", e përkthyer në shqip si *regjimi parësor* ose *kryesor*, ndërkohë sipas doktrënës belge është regjim i detyrueshëm dhe rregullohet nga dispozita urdhëruese e ligjit.

Ndërsa në grupin e dytë, bashkëshortët janë më autonomë dhe janë mirëfilli palë të një kontrate në lidhje me lirinë dhe vullnetin e gjërë, përse i përket asaj që duan të rregullojnë

³²²Neni 50 i Kodit të Familjes.

dhe faktit se nuk kanë një kufizim. Kjo sepse është e drejta e tyre të disponojnë siç duan mbi pasuritë e tyre gjatë martesës dhe të vendosin çfarë duan dhe çfarë nuk duan të rregullojnë me kontratën e martesës. Këtu kemi të bëjmë me pasuritë vetjake dhe pasuritë e tjera të tyre, të cilat nuk çënojnë jetesën familjare. Këto grupe normash njihen nga doktrina si të mundshme për të rregulluar “*régime secondaire*”³²³.

- Efektet e kontratës së martesës në lidhje me të tretët kanë një rëndësi të konsiderueshme, pasi mbrojtja ligjore nuk konsiston vetëm ndërmjet bashkëshortëve me njëri-tjetrin, por edhe në lidhje me raportet juridike të secilit bashkëshort me të tretët³²⁴. Legjislacioni ynë ka parashikuar mjetet juridike për mbrojtjen e të tretëve, detyrimin e noterit për të regjistruar kontratën, afate kohore por të posaçme për fuqinë juridike të kontratës në mënyrë që të njihen dhe të tretët me to. Kontrata e martesës, nuk mund të lidhet nga të miturit edhe pse ligji ka mundësuar një hapsirë të kushtëzuar për lidhjen e martesës, me autorizim të gjykatës. Është analizuar në mënyrë të detajuar momenti i lidhjes së martesës nga të mitur, të cilët nuk kanë mbushur moshën 18 vjec, por që me autorizimin e gjykatës këta kanë mundësinë të zhvishen nga kushtëzimi i moshës, në rast se provojnë se

³²³Nenet 1398 - 1450 të Kodit Civil Belg.

³²⁴ . Shpjegim: Është e nevojshme që ligji të parashikojë garanci të posaçme për të mbrojtur të tretët pasi edhe nëkushtet e mirëbesimit mund të dëmtohen për shkak të paqartësisë së pronësisë së secilit bashkëshort mbi pasuritë e tyre. Ligjvënësi ka vënë disa mjete mbrojtëse për të tretët. Së pari, kontrata e martesës ka procedura publiciteti të detyrueshme për fuqinë juridike duke detyruar noterin që ta regjistrojë menjëherë në Zyrën e Gjendjes Civile ku do të martohen bashkëshortët në mënyrë qënëdatën e lidhjes së martesës të rezultojë i shfaqur vullneti i bashkëshortëve të ardhshëm në lidhje me llojin e regjimit. Së dyti, ligjvënësi e siguron këtë mbrojtje edhe nëpërmjet afateve që ka kushtëzuar bashkëshortët për informacionin e të tretëve në lidhje me ndryshimin e regjimit. Kjo pasi në nenin 72 të Kodit të Familjes, dispozita parashikon një afat prej 3 muajsh të fuqisë në lidhje me ndryshimin e regjimit dhe në këtë rast themi se ratio i ligjvënësit ka qënë në shërbim të të tretëve për të patur mundësi të informohen për titullarët e të drejtave të pronësisë në marrëdhëniet juridike me bashkëshortët. Duke parë këtë konkluzion që kemi arritur nga trajtimi i momenteve të fuqisë juridike të kontratës së martesës mund të shprehemi lirisht se kontrata e martesës ka fuqi ndërmjet palëve “*inter partes*” dhe në lidhje me të tretët ka fuqi juridike “*erga omnes*”. Prandaj ligjvënësi avancon edhe më shumë me publicitetin e kontratës së martesës duke parashikuar edhe mundësinë e regjistrimit në regjistrat publik tregtar në rast se bashkëshortët kanë rregulluar raporte titujsh tregtar apo aksionesh të shoqërive tregtare.

kanë shkaqe objektive për të lidhur këtë martesë. Në këtë pikë nga analiza e detajuar e nenit 7³²⁵ të Kodit Civil dhe 70³²⁶ të Kodit të Familjes, kuptojmë se ligjvënësi me të drejtë ka kushtëzuar këto subjekte në përcaktimin e regjimit pasuror martesor me kontratë. Dalim në këtë konkluzion për faktin se, bashkëshortët e ardhshëm të mitur me marrjen e autorizimit para Gjykatës, janë çliruar nga kushti i moshës madhore për lidhjen e martesës, por nuk kanë fituar zotësinë e plotë për të vepruar në momentin e lëshimit të autorizimit. Duke qënë se kontrata e martesës lidhet para noterit, redaktimi i këtij akti kërkon një nivel vullneti sado i papërfillshëm të jetë, por të paktën të jetë i pavesuar dhe të jetë i mundshëm për të lidhur momentin volitiv të brendshëm me shfaqjen e jashtme të vullnetit. Në momentin që bashkëshortët e ardhshëm paraqiten para noterit, ata nuk kanë akoma zotësi të plotë për të vepruar, por e fitojnë me lidhjen e martesës. Në fakt, derisa të lidhet martesa mund të konstatohen ndalesa të tjera të parashikuara në ligj, për të cilat Gjykata nuk shprehet në autorizim, pasi nuk është në objekt të kërimit. Prandaj, edhe ligjvënësi, në mungesë të shprehjes së vullnetit, i ka ofruar bashkëshortit të ardhshëm regjimin e bashkësisë ligjore, i cili ngre dyshimin nëse ky regjim është më i përshtatshmi. Mbase ky nuk është opsioni më i përshtatshëm, por kur ligji ndërhyr për të zgjidhur ngërçin ligjor për mungesë të reagimit të palëve, aplikon formulën standarde të zgjedhur nga vetë ligjvënësi duke imponuar regjimin e bashkësisë ligjore.

³²⁵ Neni 7 i Kodit të Familjes (Moshë e lidhjes së martesës) citon se: *Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe.*

³²⁶ Neni 70 i Kodit të Familjes citon se: *Në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore derisa të mbushë moshën 18 vjeç, çast pas të cilit mund të kërkohe ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.*

- Kontrata e martesës është një veprim juridik, efektet e së cilës mund të jenë të menjëhershme ose në të ardhmen. Duke u nisur nga objekti i kontratës së martesës që bashkëshortët kanë dashur të rregullojnë nëpërmjet saj dhe kanë patur si qëllim në lidhjen e saj dhe zgjedhjen e këtij regjimi, mund të konkludojmë edhe në ndarjen e dy lloje kontratash për sa i përket fuqisë juridike të tyre. Sipas asaj që rregullojnë këto kontrata, objektit që kanë përcaktuar bashkëshortët i ndajmë në dy kategori. *Së pari*, bëhet fjalë për kontrata që kanë fuqi juridike menjëherë me lidhjen e martesës, në rastin kur bashkëshortët përcaktojnë me vullnetin e tyre që me anë të kësaj kontrate do të rregullojnë edhe administrimin e pasurive dhe ekonomisë familjare gjatë martesës së tyre. Përmendim këtu rastin kur bashkëshortët vendosin një kontribut të detyrueshëm mujor për ekonominë e përbashkët, kur përcaktojnë mënyrën e investimit në rritjen e fëmijëve, duke rikujtuar që nuk heqin dot dorë nga ky detyrim, etj. Prandaj është e dukshme se kjo kontratë ka rëndësi për palët që me nënshkrimin e saj dhe me aplikimin e saj të përdoret përmbajtja e saj në rregullimin edhe të raporteve me njëri-tjetrin gjatë martesës. Në grupin e dytë të kontratave, përmendim rastin kur kontrata e martesës rregullon kryesisht pasojat e zgjidhjes së martesës dhe si aplikohet ajo në momentin final. Në këtë kategori, kontrata e martesës në objekt të saj ka elementë të trajtimit të mënyrës së si do të ndahen pasuritë, mënyrës se si do të ushtrohet përgjegjësia prindërore, përdorimi i mbiemrit si dhe përdorimi i banesës bashkëshortore. Kontrata e grupit të dytë ka vlerë juridike vetëm me mbarimin e martesës, kujtojmë këtu edhe me vdekjen e njërit bashkëshort ose me ndryshimin e regjimit nga njëri tek tjetri sipas nenit 72 të Kodit të Familjes, duke i quajtur *kontrata me veprim final*.

8.2. Rekomandime

Duke analizuar në detaje dispozitat ligjore që rregullojnë regjimet pasurore në Shqipëri, dhe duke patur parasysh qasjen krahasimore me vendet më të zhvilluara, vihen re mangësi që duhen plotësuar dhe duhen përshtatur në shërbim të qëllimit të institut të kontratës së martesës.

I.Në lidhje me legjislacionin

- Gjatë studimit të dispozitave të kodit të familjes, krahasuar me shtetet e tjera që janë marrë si krahasim në këtë studim, ka paqartësi të sistemit të institutive dhe nuk ka unifikim të përdorimit të terminologjisë. Konkretisht, duhet të ishte më e qartë në ligj, se cili është regjim primar dhe cili dytësor . Gjithashtu gjatë leximit të kombinuar të dispozitave shpesh gjenden paqartësi në lidhje me përdorimin e termave, pasi nuk ka një unifikim të përdorimit të termit “kontratë martese” dhe “marrëveshje”. Në nenin 66, përdoret termi “marrëveshje të veçanta” dhe në nenin 69, që në titull të dispozitës “forma e kontratës së martesës”. Është e qartë se në të dy rastet bëhet fjalë për një veprim juridik që rregullon regjimin pasuror martesor me vullnetin e bashkeshortëve, por gjatë këtij studi pamë që kishte dallime ndërmjet terminologjive dhe prandaj duhet përdorur terminologjia e duhur. Në Kodin e Familjes, gjendet i sanksionuar detyrimi i noterit për të referuar në Regjistrin tregtar kontratën e martesës, nëse në objekt të saj bashkeshortët kanë rregulluar raporte tregtare në lidhje me shoqëritë tregtare (neni 71 Kodi I Familjes). Në vijim të arsyetimit do të ishte me vend që legjislatori të kishte sanksionuar dhe detyrimin e noterit për të regjistruar kontratën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi marrëdhëniet pasurore rregullojnë edhe këtë efekt. Detyrim të cilin e gjejmë në Kodin Civil

Francez³²⁷ dhe atë Belg³²⁸, duke e bërë të vlefshme kontratën e martesës për objektin që rregullon, pasi të jetë bërë publiciteti i duhur edhe në institucionet përkatëse. Ky sanksionim në legjislacionin tonë do të shmangë problematikat në lidhje me idnetifikimin e pronarëve në një pasuri e cila është vendosur gjatë martesës.

- Në lidhje me kontratën e martesës gjatë gjithë studimit është përdorur termi “kontratë e martesës” për të shprehur marrëveshjen në lidhje me regjimin pasuror martesor. Regjimi pasuror martesor sipas legjislacionit në fuqi nuk rregullohet vetëm para lidhjes së martesës, por edhe pas saj mund të ndryshohet me marrëveshje, siç e shpreh neni 72 i Kodit të Familjes. Për të dy rastet legjislacioni përdor togfjalëshin “kontratë e martesës” dhe “marrëveshje” pa referuar për përcaktuar se janë të njëjta apo të ndryshme. Duke marrë shkas se si gjendet në legjislacionet moderne konkretisht në ligjet Shteteve të Bashkuara, parashikohen me terma të veçantë “marrëveshje para-martesorë” dhe “marrëveshje post-martesorë”, përkatësisht “*prenuptial agreements*” dhe “*postnuptial agreement*”³²⁹. Ky dallim ka të bëjë me kohën e lidhjes së kontratës, pasi kontrata para-martesorë është një akt i cili hyn në fuqi me lidhjen e martesës dhe palët quhen bashkëshortë të ardhshëm, ndërsa në kontratën e martesës palët janë bashkëshortë dhe përveç pasurive që do të shtohen, rregullojnë edhe mënyrën se si ndahen pasuritë që janë shtuar apo ndryshuar nga lidhja e martesës deri në kohën e lidhjes së kontratës. Ndarja në këtë mënyrë do të ishte me vend edhe për studjuesit e së drejtës po ashtu edhe për vetë subjektet, pasi është e qartë

³²⁷ Butruille-Cardew Ch., (2017) “*Përmbledhje*”, Thomson Reuters, Francë, faqe

³²⁸ Neni 1399 Kodi Civil Belg

³²⁹ Boele K, Nina D, Werner G (eds). (2014). *Family Law and Culture in Europe. Developments, challenges and opportunities*. fq 1-28.

menjëherë që kanë mundësi të jenë në kohë për të ndryshuar regjimin e tyre pa u ndikuar nga koha e lidhjes së martesës.

- Duke qënë se Kodi i Familjes është redaktuar në ndikimin e Kodit Francez dhe atij Italian, kryesisht regjimet pasurore janë marrë në shembullin e Kodit Francez, vihet re se dispozita e ndryshimit të regjimit ka një ngjashmëri pothuajse identike me legjislacionin francez, për të njëjtin objekt. Siç e kemi trajtuar edhe në studim në nenin 72 të Kodit të Familjes, parashikohet ndryshimi i regjimit pasuror martesor, me kalimin e 2 viteve si dhe i kushtëzuar që ky ndryshim të jetë në interes të familjes. Legjislacioni ynë e lë të hapur se cilido të jetë autoriteti që do të vlerësojë që ky ndryshim është në interes të familjes apo jo. Kjo ka një rëndësi specifike, për aq kohë sa e kushtëzon për të provuar interesin e familjes, pra është kusht i cili duhet të përmbushet por s'ka autoritet që duhet ta vlerësojë. Prandaj do të ishte me vend të rishikohet, pasi palët nuk mundën të gjykojnë për interesin e familjes, duke qënë se janë të përfshira për shkak të marrëdhënies familjare. Në dispozita analoge, gjëndet Gjykata si autoritet vlerësues i interesit të familjes³³⁰. Duke marrë shkas nga ky arsyetim, rekomandojmë që edhe në Republikën e Shqipërisë, gjykata do të ishte autoritetit i duhur për të vlerësuar ndryshimin e regjimit pasuror, pa cënuar interesat në lidhje me anëatrë të familjes si dhe ndoshta interesat e të tretëve për të kamufluar detyrime të njërit bashkëshort apo tjetrit. Do të ishte me vend detyrimi i ndryshimit të regjimit vetëm para Gjykatës, pasi qëllimi i kalimit nga një regjim në tjetrin është i dyshimtë për sa i përket

³³⁰ Lamçe J., *“Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok në Shqipëri. Vështrim krahasimor me Parimet e CEFL”*

vlerës që ka patur regjimi ekzistues³³¹. Belgjika nuk e lë si alternativë Gjykatën, por e vendos si kusht dhe detyrim për të marrë vlerësim në autoritetin Gjyqësor.

- Sipas Kodit të Familjes parashikohet se regjimet pasurore martesore të propozuara nga ligji janë në dy grupe kryesore; ai me ligj dhe ai me kontratë. Duke analizuar në tërësi normat e Titullit III të Kodit të Familjes, arrijmë në përfundimin se regjimet pasurore të propozuara nga ligji janë tri: i pari është ai ligjor dhe dy të tjerët janë me kontratë, përkatësisht regjimi i pasurive të ndara dhe i bashkësisë universale. Bashkëshortët zgjedhin me vullnetin e tyre të shprehur për të hyrë në regjimin me kontratë dhe nëse nuk shprehen, automatikisht aplikohet regjimi i bashkësisë ligjore. Vendosja e regjimit të bashkësisë si regjimi i aplikueshëm direkt në rast të mosshprehjes së vullnetit të bashkëshortëve për kontratën, nuk mund të themi se është alternativa më e mirë. Imponimi i bashkësisë ligjore duhet të justifikojë qëllimin e përdorimit, por legjislacioni ynë ka lejuar këtë aplikim direkt për efekt të vetë origjinës së legjislacionit tonë që nuk ishte i mësuar me formatet e reja të regjimeve pasurore. Do të ishte me vend se si regjimi që aplikohet automatikisht në rast se bashkëshortët nuk shprehen, të vendosej regjimi i pasurive të ndara të paktën përfshirja në bashkëpronësi nuk konsiderohet si efekt anësor i lidhjes së martesës duke ndikuar kështu dëshirën për të lidhur martesë, sepse në nenin 69 të Kodit të Familjes, shprehet qartë se në rast se nuk ka shënim që ka kontratë, bashkëshortët janë në regjimin e bashkësisë ligjore. Në shtetin e Belgjikës regjimi që propozohet të aplikohet në rast të mospasjes së një kontratë në lidhjen e martesës është regjimi i pasurive të ndara. Ndërsa sipas parimeve të CEFL, regjimi i cili aplikohet automatikisht është një regjim tjetër që nuk parashikohet në

³³¹ Neni 1395 i Kodit civil Belg, (Titulli V, Për marrëveshjet ante-nuptiale dhe të regjimave martesore), Kapitulli I - Dispozitat e Përgjithshme).

legislacionin tonë “*Participation in acquisitions*”³³² duke e njohur si pjesëmarrje në shpenzime. Secili bashkësort blen pasuritë e tij, por ndan me tjetrin mirëmbajtjen dhe përdorimin gjatë martesës dhe duke e njohur investimin në rast të zgjidhjes së martesës. Për të mbështetur edhe më shumë këtë propozim, kemi analizuar edhe doktrinën belge, sipas së cilës regjimi i propozuar nga ligji është ai i pasurive të ndara, pasi nuk i angazhon bashkëshortët në pjesëmarrje të detyrueshme³³³. Nëse bashkëshortët duan të rregullojnë ndryshe marrëdhëniet e tyre pasurore, ata mund të hartojnë një kontratë martese me regjim të ndryshëm³³⁴.

- Gjithashtu duke marrë shkas nga Kodi Civil Francez dhe ai Belg³³⁵, vëmë re se i kushtohet një rëndësi specifike dhurimeve ndërmjet bashkëshortëve, duke i konsideruar të ndryshme nga ato të dhurimit të parashikuar nga pjesa e së drejtës së detyrimeve, kontrata e dhurimit. Motivi dhe palët në kontratën e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve kanë specifika të ndryshme nga dhurimi i përgjithshëm për shkak të raportit familjar të palëve të kontratës. Mënyra e lidhjes së kontratës, revokimi i saj apo llojet e dhurimeve në Kodin Civil Francez, rregullohen ndryshe nga dhurimet e tjera. Ai përmban një kapitull të veçantë që trajton mundësinë e dhurimit në martesë, nga të tretët ose ndërmjet tyre, si dhe parashikon mundësinë e dhurimit të veçantë ose të dhurimit të përgjithshëm. Në këtë kod rregullohet dhurimi i të tretëve ndaj bashkëshortëve veç e veç ose ndaj bashkësisë, si dhe ndaj fëmijëve

³³² Boele-Woelki K., dhe te tjerë. *Principles of European Family Law Regarding Property Relations Between Spouses*, by the Commission on European Family Law (CEFL), Kapitulli 3, seksioni A, fq.4.

³³³ Lamçe J., “*Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok në Shqipëri. Vështrim karahasimor me Parimet e CEFL*” Avokatia, 16 tetor 2015, faqe 71-86

³³⁴ Grégoire, M.(1995). *Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Bruylant Akademia s.a., fq.30.

³³⁵Neni 1081, (Titulli III, Kapitulli II - Kërkesat thelbësore për vlefshmërinë e marrëveshjeve), Kodi Civil Belg.

të martesës, nëse ka. Kjo formë e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve është parashikuar si koncept më vete nga kontrata e dhurimit tek pjesa e kontratave, duke rregulluar me ligj të gjithë format e dhurimit ndërmjet bashkëshortëve. Ky lloj konceptimi nuk është përfshirë në kodin tonë të Familjes për të specifikuar karakteristikat e dhurimit i cili mund të jetë me pohim para noterit duke e përfshirë në kontratën e martesës.

- Procedurat ligjore, për t'i dhënë fuqi juridike kontratës së martesës, duken të paqarta. Në Kodin e Familjes nuk gjejmë të specifikuar hapat që duhet të ndiqen njëri pas tjetrit në mënyrë kronologjike nga formulimi i kontratës së martesës, në vijim regjistrimi i saj si dhe deri në momentin që bashkëshortët e përdorin në Gjykatë për pjesëtimin e pasurisë. Për të qenë më i lehtë zbatimi i regjimit me kontratë, do të ishte me vend që në ligj të parashikohen lehtësitë në lidhje me procedurat. Në lidhje me parashikimin e regjimeve me kontratë në Kodin e Familjes, duken të paqarta llojet e regjimeve me kontratë pasi nuk janë të renditura mirë, duke mos përdorur teknikën legislative ashtu siç duhet në shërbim të koncepteve mund të ndodhë që krijon paqartësi, pasi nuk vijnë të rënditura regjimet e mundshme. Një riformulim i mirë mund të ishte kur bashkëshortët zgjedhin regjimin me kontratë mund të vendosin që gjatë martesës të jenë në regjimin e pasurive të ndara ose në regjimin me bashkësi universale. Riformulimi i duhur do të ishte më i qartë për studjuesit po ashtu edhe për zbatuesit e së drejtës.

- Mbrojtja e bashkëshortit pasjetues sot për sot bëhet vetëm me kërkesën e tij dhe jo nga ndonjë autoritet sic mund të jetë noteri i cili lëshon dëshminë e trashëgimisë. Ky kërkim duhet të shprehet në përmbajtje të dëshmisë së trashëgimisë dhe mund të qartësohet se trashëgimtarët përfitojnë pjesët takuese, vetëm të pasurisë së trashëgimlënësit në momentin e vdekjes dhe jo tërësisht, nëse ato janë të papjesëtuara nga martesa.

- Për efekt të transparencës, është e nevojshme të parashikohet detyrimi i bashkëshortëve, para lidhjes së kontratës së martesës, për të deklaruar të gjithë gjendjen e tyre pasurore. Deklarimi duhet të jetë individual dhe diskret kundrejt të tretëve, por gjithashtu i domosdoshëm për palët, noterin ose konsulentin ligjor të zgjedhur nga bashkëshortët në redaktimin e kontratës së martesës³³⁶. Ky lloj parashikimi në legjislacionin tonë do të shmangte çdo paqartësi ose pasaktësi në lidhje me të drejtat pasurore, duke iu mundësuar kështu edhe bashkëshortëve një formulë të pastër të zgjedhur ndërmjet tyre. E njëjta konsideratë vlen po ashtu edhe në lidhje me të tjetër, pasi nuk do të kishte vend për dyshim në lidhje me rrezikun e shmangies së detyrimeve përkatëse të secilit bashkëshort.

II. Në lidhje me llojin e regjimeve

- Duke marrë shkas nga krahasimi dhe studimi i legjislacioneve të tjera në lidhje me kontratën e martesës, shpesh mund të vlerësohet që për një arsye apo për një tjetër do të ishte me vend të kishim detajime dhe specifikime në lidhje me dispozitat që rregullojnë regjimet pasurore martesore dhe konkretisht ato me kontratë. Legjislacioni ynë nuk ka alternativa të shumta të regjimeve me kontratë. Së pari, legjislacioni shqiptar ka parashikuar vetëm dy lloj regjimesh. Së dyti, mbeten të paqarta mundësitë e aplikimit të regjimeve alternative. Konkretisht do të sygjeronim zbatimin edhe në Shqipëri të regjimit të pjesëtimit të shpenzimeve siç propozon CEFL, si regjim direkt të aplikueshëm, pasi është një alternativë ndërmjet regjimit të pasurive të ndara dhe atij të bashkësisë. Në këtë mënyrë edhe kalimi nga bashkëisa ligjore në atë me kontratë tek regjimet e pasurive të ndara, do të

³³⁶ Kodi Civil Belg, ka sanksionuar detyrimin e bashkëshortëve për t'i njohur njëri-tjetrit gjendjen pasurore të tyre, para lidhjes së kontratës martesore. “*Marital agreements and private autonomy in France and Belgium.*” fq. 79.

bëhej më lehtë për subjektet e së drejtës dhe do të kuptonin më mirë rëndësinë e zgjedhjes edhe të regjimeve separatiste. Një ndër shkaqet që mbeten si të paaplikura regjimet me kontratë që ligji ofron, është për faktin se duken si regjime ekstreme, pasi duket sikur me kontratën e martesës ndajnë çdo gjë ose bashkojnë çdo gjë³³⁷. Prandaj do të ishte me vend aplikimi i regjimeve alternative, siç mund të ishte regjimi me pjesë në tërësinë e pasurisë, pra një bashkësi totale dhe në rast ndarje të përcaktohen pjesët takuese që në kontratë.

- Nga hulumtimet që janë bërë në zyra të noterisë në Republikën e Shqipërisë, regjimi i bashkësisë universale rezulton të mos jetë aplikuar në asnjë rast dhe për shkak të moszbatimit nuk mund të parashikohen nga partenerët edhe pasojat e mundshme.
- Do të ishte me vend një riformulim i nenit 108, pasi shpesh zbatues të së drejtës e kanë konceptuar bashkësinë me kontratë si regjim i kushtëzuar nga bashkëisa ligjore. Në fakt, është vënë re se në praktikë bashkësia me kontratë është konsideruar si një regjim alternativ për të ndryshuar regjimin e bashkësisë ligjore dhe jo si një regjim fillestar që në lidhjen e martesës. Fakti që regjimi i bashkësinë me kontratë ka në përmbajtje regjimin e bashkësisë ligjore plus të tjera shtesa, nuk do të thotë që kushtëzohet nga fillimi i martesës me regjimin e bashkësisë ligjore. Ky konfondim ka ardhur si rezultat i paqartësisë së ligjvënënsit në formulimin e dispozitës, në të cilën parashikohet se bashkëshortët “*mund të ndryshojë bashkësinë ligjore...*”. Për këtë arsye, sipas interpretimit literal, duket sikur bashkëshortët nga bashkëisa ligjore mund të kalojnë në universale me kontratë martese. Megjithatë, *ratio* i ligjvënënsit nuk ka qënë ky, pasi është e dukshme që legjislatori nuk e ndalon lidhjen e kontratës në regjimin e bashkësisë universale në momentine lidhjes së martesës dhe as nuk shprehet për kohëzgjatjen e këtij regjimi. Ajo që ka dashur të

³³⁷ Neni 108 dhe 115 I Kodit të Familjes

përcaktojë ligjvënësi ka të bëjë vetëm me përmbajtjen e këtij lloj regjimi, duke ju referuar regjimit të bashkësisë ligjore. Gjithashtu, po në këtë dispozitë, në vijim gjejmë sërish formulim që lë hapsira për interpretim, pasi i referohet vetëm pasurive të luajtshme para lidhjes së martesës. Në këtë mënyrë lind pyetja: Në momentin kur do të zgjidhet regjimi me kontratë, si ndryshim pas dy vitesh sipas nenit 72, si do të rregullohen pasuritë e luajtshme gjatë periudhës minimalisht dyvjeçare?

- Së fundmi, *rekomandohet një studim social-ligjor mbi kontratën martesore*, jo vetëm në nivelin e brendshëm, por edhe në atë evropian. Disa pyetje kanë nevojë për zgjidhje, të tilla si: pse, kur dhe sa shpesh bashkëshortët kontraktojnë për përjashtimin e regjimit ligjor dhe për rrjedhojë zgjedhjen e një regjimi kontraktor. Dhe pyetja më e rëndësishme është: Cili është saktësisht lloji i regjimit pasuror kontraktor, që preferohet më shumë nga bashkëshortët³³⁸?

³³⁸Mbi nevojën e realizimit të një studimi social-ligjor për kontratën martesore në nivelin evropian shih: Boele-Woelki, Katharina, Braat, Bente, *Marital agreements and private autonomy in Netherlands, Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, Ed. Scherpe, Jens, Hart Publishing, Oxford, 2012, fq. 255.

ANEKS: Si të shkruajmë një kontratë martese në Republikën e Shqipërisë?

➤ Të përgjithshme

Rëndësia e secilit institut të së drejtës është në mundësinë e aplikimit të tij dhe aftësinë që ka ligji t'i shërbejë individit dhe të ndihmojë atë të hyjë në marrëdhënie me të tjerët duke u ndjerë i mbrojtur nga ligji. Çdo normë duhet të përmbajë në vetvete arsyen e drejtë (recta ratio) për të cilën është nxjerrë, duke vazhduar këtu me qëllimin për të cilin është ligj me qëndërzimin e individit³³⁹.

Mënyra e aplikimit të ligjit vjen në këtë formë, duke marrë shkas nga nevojat e individit, angazhohen ligjbërësit për t'i ardhur në ndihmë për një jetesë më të mirë subjektit të së drejtës dhe që mund të përfitojë nga e drejta. Qëndrimi filozofik për arsyen e të qenurit ligj i jep shpjegim çdo norme ligjore dhe se si kombinohen dhe ndërthuren në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në mundësinë e gëzimit të tyre, si edhe në ekuilibrin e zbatimit të drejtë të së drejtës. Në mënyrë proporcionale shpërndahen parimet e së drejtës në aplikimin e normave juridike duke patur në themel subjektin e së drejtës në raport me veten e tij dhe në raport me të tjerët. Është detyrë e ligjit të gjejë mjetin juridik për t'i ardhur në ndihmë subjektit të së drejtës dhe këtu rikujtojmë se për kontratën e martesës qëllimet që janë trajtuar më poshtë, janë shërbimet që i sjell ky institut individit. Çdo funksion i kontratës së martesës është ratio leges dhe është për qëllimin e lehtësimit të procedurave në lidhje me pasurinë e bashkëshortëve, administrimin dhe detyra të tjera që ata mund të duan të rregullojnë me vullnetin e tyre aq sa ligji jua lejon³⁴⁰. Palët e kontratës së martesës duhet të

³³⁹Çështja *Hyman v Hyman*, 1929 AC, 601.

³⁴⁰ Boele-Ëoelki, K., Miles, J., Scherpe, J. (Eds). (2011). *The Future of Family Property in Europe (European Family Laë)*. Publisher: Intersentia, fq. 61.

dinë mirë se çfarë duan, dhe ajo që ato kërkojnë t'u mundësohet me ligj dhe mund t'u ofrohet oportuniteti ligjor në sanksionimin e kushteve të kontratës.

Është e nevojshme që bashkëshortët e ardhshëm, fillimisht të kalojnë mjaftueshëm kohë në marrjen e informacionit bazë se çfarë pësojnë me lidhjen e martesës dhe cilat janë përgjegjësitë që atyre ju lindin si rezultat i lidhjes së martesës. Simbioza që kemi trajtuar më lart në lidhje me faktin se ky institut i së drejtës ka këtë të veçantë, pasi kombinohen elementë të marrëdhënies së detyrimit me ato të marrëdhënieve familjare për të realizuar një institut të ri siç është kontrata e martesës. Palët e kontratës së martesës nuk janë me formimin juridik dhe ligjor maksimal, domosdoshmërisht për të ditur se si mund të jetë e drejta në shërbim të tyre.

1. Faza informuese

Njohja është një proces intelektual sipërfaqësor, pasi realizohet nëpërmjet shqisave pa kaluar në angazhim më të madh intelektual, duke qënë se nevojitet vetëm për një regjistrim fillestar të fakteve. Bashkëshortët e ardhshëm kur vendosin të martohen, mendojnë kryesisht procesin e bukur të qëllimit të tyre dhe ligjërimin e raportit shpirtëror me vijimin e krijimit të familjes, duke anashkaluar atë që ne e quajmë edhe më të rëndësishme për studimin, pasoja ligjore. Më tej arrijnë deri në perceptimin e ndryshimeve ligjore që ato pësojnë dhe që ligji flet në një hapsirë të posaçme për të drejtat dhe detyrat që vijnë nga martesa, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me detyrimin për besnikëri, e drejta e mbiemrit, vendbanimi, detyrimi ndaj fëmijëve, etj. Ndër të tjera, rëndësi të veçantë me lidhjen e martesës merr ndryshimi i statusit pasuror të tyre, që në rast se ata nuk shprehin vullnetin për ndonjë formulë specifike se si duan ta rregullojnë pasurinë e tyre, është tërësisht e

mundur që të futen në regjimin e bashkësisë ligjore pa dashur dhe e pa e kuptuar drejtë se çfarë pasojash ju ka sjellë atyre, qoftë në drejtim të përfitimeve po ashtu edhe angazhimeve dhe detyrimeve që kanë ato ndaj martesës.

Martesa nuk është vetëm për të pasurit, pasi sot ka një prirje në rritjen e numrit të çifteve që aplikojnë kontratën e martesës³⁴¹ dhe që i drejtohen këtij instituti që në gjenezën e raportit të tyre, pa u kushtëzuar nga pasuria aktuale. Veprimi i shëndetshëm është trendi i fundit, pasi vetë kontrata e martesës nuk merret në mënyrë specifike për pasuritë e tashme, por kryesisht bën fjalë për mënyrën e rregullimit të pasurive dhe detyrimeve ligjore nga momenti i lidhjes së martesës e në vijim.

Shpjegimi i drejtë i kontratës së martesës do të thotë mundësi për të zgjedhur alternativën që ligji u ka dhënë bashkëshortëve në përcaktimin e destinacionit të pasurive të tyre.

Për sa i përket rastit që bashkëshortët do të lidhin martesë në Republikën e Shqipërisë është e nevojshme të lexojnë legjislacionin e vendit tonë për këtë institut të së drejtës dhe ata mund të dinë se cili është pozicioni i tyre në ligj si bashkëshort dhe anëtar i një familje të re. Kodi i Familjes³⁴² dhe Ligji nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen Civile” (i ndryshuar) janë paketat e para ligjore që bashkëshortët duhet të njihen në muajt para lidhjes së martesës.

Është e nevojshme që bashkëshortët të dinë se me lidhjen e martesës ata përfshihen në disa dispozita të reja ligjore për sa i përket jetës familjare dhe njëkohësisht janë të lirë edhe të mbrohen mjaft mirë nga detyrimet që deri më sot janë perceptuar apriori si pasojë e martesës dhe e metë e martesës. Për sa u shpjegua, është e rëndësishme të nënvizohet fakti

³⁴¹Francis, N. (2003). “*Neë Light on Prenuptial Agreements*”. Family Laë . Vol 33, 164-168.

³⁴² Ligji nr.9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”.

se informacioni është i nevojshëm të jetë i saktë, dhe i plotë pasi dimë mjaft mirë parimin e rëndësishëm se *“padijenja nuk përjashton nga përgjegjësia”*³⁴³ dhe nënshkrimi i një akti për të cilin nuk ke njohuri në përmbajtjen e tij mund të çojë në lajthim palët.

Këtë informacion bashkëshortët mund të vendosin ta marrin në zyrën e një avokati ose tek noteri. Në cilindo burim informacioni, është e nevojshme që bashkëshortët të dinë faktin që me lidhjen e martesës ka pasoja juridike për ta dhe që të dy këta kanë mundësinë të zgjedhin mënyrën se si do jenë këto pasoja dhe deri në çfarë pike mund të eliminojnë disa nga pasojat. Me lidhjen e martesës siç shpjegoam më lart, bashkëshortët futen në një regjim pasuror i cili sipas legjislacionit tonë ndahet në dy grupe të mëdha dhe në vijim ka detaje për të cilat mund të flitet për to, pasi të kenë zgjedhur. Regjimi është **ligjor** dhe ai me **kontratë**, ku i pari është një formulë e gatshme, për të cilën legjislacioni është kujdesur për të duke përcaktuar një listë me llojin e pasurive të cilat janë të përbashkëta dhe një listë me pasuritë të cilat në cilëndo rrethanë janë individuale. Ndërsa i dyti është një formulë e ndërtuar nga bashkëshortët që asnjëherë s’duhet të bjerë në kundërshtim me ligjin.

Duke marrë informacion për ligjin që do t’i nënshtrohen bashkëshortët e ardhshëm, duhet të njohin mirë pasojat që vijnë nga lloji i regjimit që zgjedhin, për të bërë të mundur parashikimin e zgjidhjes së problemeve në lidhje me pasuritë, administrimin si dhe pasojat e zgjidhjes së martesës.

Rasti i cili ka rëndësi për studim është regjimi me kontratë. Nëse bashkëshortët kanë rënë dakort që të zgjedhin regjimin me kontratë, atëherë ata duhet të njihen në mënyrë të detajuar se çfarë sjell kontrata për ta dhe çfarë rregullojnë ata me këtë regjim. Është me shumë rëndësi që bashkëshortët të dinë se çfarë mund të bëjnë me kontratën dhe çfarë nuk

³⁴³ Champenois G; Flour J.(2001). *Les Régimes matrimoniaux*, 2e édition, Publisher:Armand Colin, fq. 471.

mund të bëjnë me të. Konkretisht në legjislacionin tonë me kontratën e martesës mund të vendosësh të ndash gjithçka; regjimi i pasurive të ndara³⁴⁴ ose të bashkosh gjithçka³⁴⁵ si dhe sipas parimit të lirisë kontraktore mund të bëjnë përmbajtje tjetër sipas parashikimeve të ligjit.

Gjatë anketës të realizuar për qëllime të studimit të njohjes me faktin sesa të familjarizuar janë shqiptarët me kontratën martesore, në një grup prej 180 individësh rezultoi se 89% e tyre kishin dëgjuar për këtë kontratë, kryesisht në televizion, gazeta apo rrjete sociale dhe në shkollë. Kur 160 të anketuarit u pyetën nëse kontratën e martesës e konsideronin një vendim të duhur ose jo, në mënyrë thuajse të barabartë janë përgjigjur: pjesërisht vendim i duhur (33%), plotësisht vendim i duhur (34%) dhe plotësisht vendim i gabuar (29%). Këto përgjigje janë të shpërndara, referuar gjithmonë edhe informacionit që të anketuarit kanë për këtë kontratë (vetëm 9% u përgjigjën “shumë”, 42 % iu përgjigjën “Majftueshëm”, 37 % u përgjigjën “pak” dhe 12% iu përgjigjën aspak).

Nëse me lidhjen e martesës në mungesë të një marrëveshje, do të zbatohet formula e bashkësisë ligjore nga bashkëshortët, ata duhet të dinë se me kontratën e martesës është vullneti i tyre dhe çfarë nënshkruajnë ata brenda kufijve që ligji ua lejon të shkruajnë se si duan ata të bëhet kontrata e martesës. Gjatë shfletimit të Kodit të Familjes gjejmë edhe mundësi të tjera që mund t'i parashikojmë në kontratën e martesës, në lidhje me detyrimet që lindin nga martesa dhe në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës. Të dy këto grupe të drejta-detyrime mund të përcaktohen nga bashkëshortët në kontratë duke parashikuar se si duan ata të rregullojnë raportin e tyre në lidhje me çdo element që lind nga lidhja e

³⁴⁴Neni 115, Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.9062 datë 08.05.2003.

³⁴⁵Po Aty, Neni 108.

martësës dhe më pas nga zgjidhja e martësës. Ndër të tjera në këtë fazë bashkëshortët e ardhshëm njihen me përmbajtjen që mund të ketë një kontratë martese, me fuqinë juridike të saj për sa i përket kohës dhe aplikimit të saj, detyrimet që u lindin nga kontrata dhe çfarë përfitojnë ndryshe nga regjimi i bashkësisë ligjore. Bashkëshortët e ardhshëm në këtë fazë përballen edhe me opinionet *pro* dhe *kundra* kontratës së martësës duke bërë që të lëkundet vendimi i tyre, por edhe të avancojnë në studimin mbi këtë institute të së drejtës dhe qëllimit që ka patur legjislatori në parashikimin e saj në ligj. Është e rëndësishme që të sqarohet çdo pyetje e cila do të kalojë në mendjen e secilit bashkëshort në mënyrë që të sqarojnë të panjohurën dhe të mund të zgjedhin të çliruar nga dyshimi i oportunitetit të kontratës së martësës. Referuar anketës së bërë për kontratën e martësës, të pyetur nëse do e lidhnin një kontratë martesore me bashkëshortin e ardhshëm, rezultoi se pjesa më e madhe ishte në mëdyshje 42% ndoshta, një pjesë e konsiderueshme 31% u përgjigj me “Po” dhe pjesa tjetër 21% u përgjigj me “Jo”.

2. Faza planifikuese

Kjo fazë është më konkrete në lidhje me bashkëshortët dhe kujdesi duhet të tregohet kundrejt çdo elementi që ato duan të parashikojnë në kontratë, pasi aftësia në formulimin e një kontrate të drejtë, ka të bëjë pikërisht në faktin se duhet të përmbajë ato kushte që t'i sigurojë palëve qëllimin e arritjes së marrëveshjes, si parësore për vlefshmërinë e një kontrate, pa anashkaluar rëndësinë e zgjedhjes më të mirë në shërbim të palëve .

Bashkëshortët e ardhshëm ose ata aktual, mund të nënshkruajnë një kontratë martese e cila ju nevojitet atyre për marrëdhënie të krijuara para lidhjes së martësës, për rastin kur bashkëshortët bien dakord të zgjedhin bashkësinë universale, gjithashtu u nevojitet për

marrëdhënie gjatë lidhjes së martesës, pasi të dy këto në përfshirjen e tjetërsimit të pasurive apo në veprimtarinë e administrimit të zakonshëm, do të paraqiten me kontratën e martesës para autoriteteve publike për të përfaqësuar vullnetin e pavesuar, si dhe pas mbarimit të martesës, për sa i përket pasojave nga zgjidhja e martesës dhe rastit të mbarimit të martesës nga fakti juridik i vdekjes³⁴⁶.

Në këto kushte, aftësia e parashikimit në mbrojtjen e të drejtave të palëve i përket subjekteve që presumohet të dinë diçka në lidhje me ligjin, prandaj edhe legjislacioni ynë këtë autoritet ia ka dhënë noterit në mënyrë që të mund të redaktojë një akt të qartë, të drejtë dhe në shërbim të palëve³⁴⁷.

Pra kërkohet që, bashkëshortët e ardhshëm, para lidhjes së martesës, duhet të parashikojnë se cilat janë pasojat që do t'u vijnë atyre nga lidhja e martesës duke parë potencialin e tyre, ekonomik aktual deri në zhvillimin e mundësisë së alternativave të reja.

Kryesisht në kulturën amerikane janë të prirur që t'i konsumojnë pjesën përgatitore mjaft mirë, me hapat njëri pas tjetrit duke vendosur secili bashkëshort për veten e tij dhe në fund së bashku³⁴⁸.

Fillimisht bashkëshortëve të ardhshëm ju këshillohet të bëjnë një listë të pasurive që kanë dhe planin se si mund të shtohen këto pasuri dhe nëse janë në gjendje për të bërë një parashikim në lidhje me potencialin e shtimit të pasurive. Gjatë kohës së listimit të këtyre pasurive, ata mund të konsultohen me avokatë³⁴⁹ për të qënë njohës të mirë të ligjit, pasi duhet të dinë se cilat janë llojet e pasurive që mund të përfshihen në pjesë të përbashkëta

³⁴⁶ Kodi i Familjes, (2003), neni 123.

³⁴⁷Po Aty, neni 69.

³⁴⁸Katherine E.Stoner.(2012). “*Prenuptial agreement*”, Botimi IV, fq. 317.

³⁴⁹ Ligji 55/2018, “*Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë*”, neni 2.

dhe cilat nuk bashkohen. Këtu u duhet bërë me dije në mënyrë të detajuar se çfarë quajmë pasuri vetjake dhe çfarë mund të përfshijmë në kontratën e martesës tek të përbashkëtat. Në listimin e pasurive, bashkëshortët duhet të rendisin çdo pasuri, të qenurit transparent në këtë fazë nuk është cenim i jetës private të tyre, por ka të bëjë me mundësinë për t'i mbrojtur ata dhe për të ditur se ka lloj pasurish të cilat janë të tyre edhe po të mos nënshkruanin një kontratë martese, madje është detyrim në rast se i referohemi legjislacionit Belg si dhe parimeve të CEFL. Gjatë kësaj faze bashkëshortët e ardhshëm njihen edhe me terminologjinë: bashkësi ligjore, bashkësi universale, pasuri të ndara apo me konceptet bazë të sendeve, duke rikujtuar këtu sendet e luajtshme të paluajtshme, të pjesëtueshme të papjesëtueshme, etj etj. Duhet patur kujdes të mos jetë i njëjti përfaqësues përsa i përket nënshkrimit të kontratës së martesës për të dy bashkëshortët, pasi këtu kushtëzohemi nga parimet e përgjithshme në lidhje me aktin e përfaqësimit si dhe në lidhje me kryerjen e veprimeve juridike që duhet të kenë kusht thelbësor vullnetin e pavesuar³⁵⁰. Pasi të kenë zgjidhur pjesën e planifikimit se si do të rregullohet raporti ndërmjet tyre, në bazë të llojit të regjimit pasuror me kontratë që bashkëshortët kanë rënë dakort, ata individualisht përgatisin listën e pasurive që kanë secili. Kjo listë për të qënë në shërbim të formulimit të kontratës dhe për të sjellë efektet e duhura për bashkëshortët e ardhshëm, duhet të ketë transparencë dhe të përmbajë në renditje logjike pasuritë sipas dy grupimeve që kemi sqaruar më lart, ato të cilat munden të përfshihen në bashkësi dhe ato që nuk mund të përzihen ndërmjet tyre, pa u shprehur vullneti i bashkëshortëve, si dhe në grupin e tretë pasuritë të cilat në cilëndo rrethanë nuk mund të bëhen të përbashkëta sipas ligjit. Konkreisht, këtu referojmë Kodin e Familjes i cili përcakton mjaft qartë se në bazë të llojit

³⁵⁰Neni 67, Kodi Civil.

të regjimit pasuror që kanë zgjedhur bashkëshortët, mund të vendosin edhe grupin e pasurive që do të përfshihen në kontratë. I gjithë trajtimi në lidhje me këtë planifikim ka të bëjë me pasuritë që janë aktualisht në gjendje dhe që bashkëshortët e ardhshëm kanë nevojën të informohen, por edhe t'i sigurojnë ato nga përzierja që mund të marrin në gjendje normale nga regjimi i bashkësisë ligjore.

Pasi të jetë përcaktuar në mënyrë individuale cilado nga pasuritë që duhet të jetë në njërin nga grupet e pasurive të mësipërme, atëherë bashkëshortët e ardhshëm me marrëveshje ndërmjet tyre vendosin se cili nga regjimet me kontratë është më i përshtatshëm për to. Informacioni mbi regjimet me kontratë duhet të jetë profesional dhe i saktë, sepse kjo do të vendosë në mënyrë më konkrete formulën e zbatimit në këto pasuri dhe në këto kushte do të mund të vendosin me seriozitet se cili nga regjimet ju nevojitet bashkëshortëve. Rikujtojmë këtu llojet e regjimeve me kontratë duke ofruar për bashkëshortët informacionin e shkurtër se çfarë mund të bëjnë me një kontratë martesë.

Shpesh në këtë fazë bashkëshortët hasen me një lloj konflikti të heshtur ose të dukshëm, pasi tek ata krijon një lloj reaksioni individualizimi i bashkëshortëve në pasuri³⁵¹. Në pamundësi për të pranuar këtë lloj regjimi, konfliktohen duke mos kuptuar zgjedhjen e lirë të secilit, sepse e quajnë në shumë raste dëshirën për këtë lloj individualizimi si mungesë të ndjenjës së bashkëshortit të ardhshëm. Kontrata e martesës, në regjimin e pasurive të ndara, sipas objektit të kësaj kontrate do të përkthehet, në individualitet në investime, në kursime, kontribute të veçanta, jo bashkëpronësi dhe duke marrë në konsideratë edhe krijimin e familjes me lidhjen e martesës, ku shpesh bashkëshortët e ardhshëm e shohin me dyshim këtë lloj regjimi. Nga ana tjetër, në vendet evropiane që kanë aplikuar më shumë në

³⁵¹ Grégoire, M ; Rencho.(1996).*Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Pg.163.

numër kontratën e martesës, kryesisht bashkëshortët zgjedhin regjimin e pasurive të ndara, sipas të cilit bashkëshortët janë më të çliruar nga detyrimi i bashkësisë dhe bashkëpronësisë.

3. Faza redaktuese

Në këtë fazë protagonistët rriten në numër pasi përfshihen dhe profesionistët dhe e gjithë procedura merr një ngjyrim më ligjor dhe burokratik duke i vënë bashkëshortët e ardhshëm para faktit të zgjedhjes kryesore dhe mbetet vetëm momenti i ndonjë ndërhyrje të vogël.

Sipas legjislacionit tonë, siç e kemi përmendur, autoriteti konfirmimit të vullnetit dhe redaktimit të kontratës është noteri, të cilit i është besuar jo vetëm mbajtja e vullnetit të pavesuar, por edhe mundësia e redaktimit të këtij akti si detyrë thelbësore në ushtrimin e funksionit të tij³⁵². Bashkëshortët e ardhshëm mund të paraqiten në zyrën e noterit vetëm ose me avokatët e tyre, ose dhe vetëm përfaqësuesit e tyre për të redaktuar kontratën e martesës.

Pasi të kenë parashtruar listën e pasurive dhe llojin e regjimit që bashkëshortët kanë zgjedhur me vullnetin e tyre, noteri duhet të sigurohet për elemente të tjera ligjore që kanë mjaft rëndësi. Rast pas rasti, vigjilenca e duhur në përgatitjen e dokumentacionit, do të varet nga lloji i regjimeve që kanë zgjedhur bashkëshortët, pasi në rastin e regjimit të bashkësisë universale, kur bashkëshortët kërkojnë të bashkojnë edhe pasuritë që ata kanë patur në pronësi para lidhjes së martesës atëherë noteri duhet të sigurohet për origjinën e pronësisë së kësaj pasurie dhe ta pasqyrojë këtë pasuri në akt si formë e kalimit të pronësisë për shkak

³⁵² Ligji Nr.7829, datë 01.6.1994, “Për Noterinë”.

të kësaj kontrate. Kalimi i pronësisë nëpërmjet kontratës së martesës ka formën e një kontrate dhurimi, pasi legjislatori ka lejuar shtrirjen e bashkëshortit tjetër para lidhjes së martesës, për pasuritë e luajtshme. Se si do të bëhet ky kalim me kontratë më vete apo me po atë kontratë, nuk sqarohet direkt në ligj, por me sa duket nuk ka qënë i nevojshëm një sqarim i tillë, pasi legjislatori ka shpjeguar mjaftueshëm faktin se me kontratën e martesës bëhet edhe kalimi i pronësisë mbi këto pasuri që vendosin të jenë të përbashkëta. Në rrjedhën logjike, dimë që një mënyrë e ligjshme e fitimit të pronësisë është ajo me kontratë, e cila ka në objekt të saj ka të drejtat pasurore dhe jopasurore, ku për sa i përket të parave, duhet pranuar që është mjet juridik që ndihmon në fitimin e pronësisë. Për të sjellë pasojat e duhura juridike kjo kontratë duhet të regjistrohet në institucionin përkatës për të bërë kalimin e pronësisë edhe për bashkëshortin tjetër.

Për aq kohë sa kontrata e martesës është përcaktuar si një veprim juridik solemn e cila për të qënë e vlefshme duhet të përmbajë këto elemente dhe ndër to edhe redaktimin para noterit, e për rrjedhojë këtu duhen respektuar procedurat që noteri ndjek në redaktimin e një akti. Në kontratën e martesës shkruhet data e lidhjes së saj, vendi i lidhjes si dhe noteri i cili po mban aktin.

Në vijim vazhdohet me gjeneralitetin e palëve dhe me të dhënat specifike që angazhohet noteri të merret për t'u siguruar mbi identitetin e bashkëshortëve, duke specifikuar edhe gjendjen civile si e dhënë e kushtëzuar nga lloji i marrëdhënies juridike. Pasi noteri të jetë siguruar edhe për statusin e bashkëshortëve të ardhshëm, për shkak të vlefshmërisë së kontratës së martesës për aq kohë sa parimi i një martese të vlefshme është edhe monogamia, noteri është i interesuar që në kuadër të ushtrimit të detyrës së tij si dhe në kuadër të mbajtjes së një akti të vlefshëm të sigurohet për çdo element ligjor që mund të

shkaktojë problematika në akt. Në fazën e përmbajtjes së kontratës së martesës, bashkëshortët e ardhshëm mund të paraqesin para noterit, projektet e tyre në lidhje me mënyrën se si duan ata të funksionojë kjo kontratë në shërbim të raportit të pasurive. Në fazën e prezantimit të planit projekt të pasurive, noteri merr një informacion profesional, të detajuar në lidhje me regjimin e bashkëshortëve dhe në lidhje me vullnetin e tyre për sa i përket përfshirjes së pasurive në këtë kontratë. Konfirmimi i pasurive që bashkëshortët kanë deklaruar para noterit merr një rëndësi të veçantë në rast të zgjedhjes së regjimit të bashkësisë universale, pasi aty bashkëshorti i ardhshëm pronar, në një mënyrë vendos që të përfshijë dhe të bëjë pronar edhe bashkëshortin jopronar për shkak të lidhjes së martesës.

I rikthehem rolit të noterit dhe punës kërkimore që ai mund të bëjë, për të saktësuar atë çfarë bashkëshortët kanë shprehur. Sipas Ligjit “Për Noterinë”, neni 54, noterët mund të aksesojnë në sistetimin e të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe mund të marrin të gjithë origjinën e pronësisë në bazë të aplikimit që ata kërkojnë, duke u informuar nga faqja e tyre zyrtare dhe kodi i logimit për statusin e secilës pasuri. Lind nevoja e këtij kërkimi vetëm përse i përket deklarimit të secilit, por jo se cënon të drejta pasurore të njërit apo të tjetrit, pasi efektet e kontratës së martesës fillojnë menjëherë me lidhjen e martesës ose dy vite pas saj dhe pasuritë që kanë në gjendje bashkëshortët në momentin e nënshkrimit të kontratës janë vetëm për gjendjen ekonomike të tyre. Gjithashtu hetimi kushtëzohet për sendet e luajtshme, pasi ato fitohen vetëm nëse sendi nuk është i vjedhur edhe pse blerësi ka qënë në mirëbesim. Në këto kushte, funksioni i noterit nuk mund të shtrihet përtej tagrave që autoriteti publik i jep atij, pasi nuk mundet të tejkalojë në hetime penale për të marrë informacion për pasuritë e luajtshme nëse kanë qënë objekti i drejtëpërdrejtë i ndonjë vepre penale apo jo.

Në lidhje me shoqëritë tregtare dhe anëtarësinë që mund të ketë secili nga bashkëshortët në shoqëri tregtare në cilësinë e ortakut³⁵³, sipas vendimit që merr bashkëshorti për ta përfshirë bashkëshortin tjetër ose jo, duhet të bëhet edhe veprimi i noterit në lidhje me aksesin në QKB. Përsa i përket përfitimeve, ata mund të vendosin që fitimet nga kompania të jenë pjesë e bashkësisë ligjore dhe të mos rregullohen me kontratë martesë. Në këtë rast, lind nevoja të saktësohen aksionet dhe pjesët takuese në shoqëri të bashkëshortit ortak/aksioner. Duke qenë se kontrata e shitjes apo dhurimit të kuotave regjistrohet në QKB atëherë është e nevojshme që kontrata e martesës, që ka në objekt kuotat e një shoqërie tregtare duhet të regjistrohet në QKB për sa i përket pjesës takuese të bashkëshortëve. Ndër të tjera, në këtë rast noteri duhet të verifikojë faktin nëse bashkëshorti ortak mund ta bëjë këtë dhurim dhe përfshirje të bashkëshortit tjetër në ortakëri ose jo, pasi ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes³⁵⁴.

4. Faza e regjistrimit

Kontrata e martesës ka dy momente të hyrjes në fuqi të saj, momenti i parë ka të bëjë me kontratën para-martesorë, kur bashkëshortët e redaktojnë atë para lidhjes së martesës dhe sanksionojnë në kontratë se fuqia juridike e saj fillon me lidhjen e martesës.

Ndërsa momenti i dytë i hyrjes në fuqi të kontratës ka të bëjë me ndryshimin e regjimit pasuror sipas nenit 72 të Kodit të Familjes, sipas të cilit bashkëshortët vendosin të ndryshojnë regjimin pasuror martesor dhe legjislacioni i kushtëzon se këtë duhet ta bëjnë sipas formës së kontratës së martesës. Noteri sigurohet që të regjistrojë këtë kontratë në regjistrin e martesave, në zyrën e gjendjes civile, sa më shpejt, por nga momenti i

³⁵³ Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

³⁵⁴ Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

regjistrimit duhet të kalojnë 3 muaj për të hyrë në fuqi regjimi i ri, pasi kjo është në mbrojtje për të tretët.

Pra është e dukshme se është detyrë e noterit të garanatojë regjistrimin dhe të fuqizojë, juridikisht kontratën e martesës, duke i dhënë asaj frymën ligjore në lidhje me bashkëshortët dhe kundrejt të tretëve. Roli i bashkëshortëve në këtë fazë është i papërfillshëm, pasi ligji ka veshur autoritetin publik noterin dhe institucionin e administratës publike Zyrën e Gjendjes Civile në regjistrimin e kontratës së martesës.

BIBLIOGRAFIA

Burime Parësore

Legjislacion

- Legjislacioni Republikës së Shqipërisë
- 1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.
- 2. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994.
- 3. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8166, datë 29.03.1996.
- 4. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003.
- 5. Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, i cili hyri në fuqi në 1 Prill të vitit 1929 (i njohur si Kodi Civil i Zogut).
- 6. Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, ka hyrë në fuqi në 1 Janar të vitit 1982.
- 7. Kodi i Familjes i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 4020, datë 23.06.1965, i cili hyri në fuqi në 1 Janar 1966.
- 8. Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6599, datë 29.06.1982.
- 9. Ligji “Mbi martesën”, nr. 601, datë 18.05.1948
- 10. Ligji, “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”, nr. 3920, datë 21.11.1964.
- 11. Ligj nr. 4020, datë 23.6.1965 “Mbi Kodin e Familjes të Republikës Popullore të Shqipërisë”

12. Ligji 110/2018 “Për Noterinë”
13. Ligji “Për shtetësinë shqiptare”, nr. 8389, datë 05.08.1998.
14. Ligji “Për gjendjen civile”, nr. 10 129, datë 11.05.2009.
15. Ligji “Për të drejtën ndërkombëtare private”, nr. 10428, datë 02.06.2011.
16. Ligji 55/2018, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”,
17. Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

- **Legjislacion i Huaj**

1. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut
2. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të 16 dhjetorit 1966.
3. Konventa e Hagës “Për ligjin e zbatueshëm mbi regjimet pasurore martesore”, 14 Mars, 1978.
5. Protokolli nr.1 Pronësia, KEDNJ
6. Kodi Civil Gjerman, BGB.
7. Kodi Civil Grek, Neni 1400.
8. Kodin Civil Francez.
9. Kodi Civil Belg.
10. Kodi Francez i Procedurës Civile, neni 1292.
11. Kodi Civil Italian.
12. Kodi Civil Gjerman (BGB).
13. Ligji “Për Martesën” (Kinë).
14. Ligji Italian mbi të drejtën ndërkombëtare private i vitit 1995.
15. Akti i Reformës Ligjore në Familje 1978 (tani Akti Juridik Familjar), Kanada

16. Ligji për Amandamentin e Aktit të Martesës Australiane (1985)

B. Burime dytësore

Literaturë

1. Anastastasi A., “*Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar*” (2010) OSCE
2. Alexander S.G. “The New Marriage Contract and the Limits of Private Ordering”,
Indiana Law Journal
3. Begeja, K. (1985). “*E drejta familjare e RPSSH*”, Botimi i parë, Tiranë.
4. Boele-Woelki, K& Braat, B. (2012). *Marital agreements and private autonomy in Netherlands, Marital agreements an private autonomy in Comparative Perspective*, Ed.
Scherpe, Jens, Hart Publishing, Oxford.
5. Boele-Woelki, K& Dethloff N& Gephart W. (eds), (2014). *Family Law and Culture in Europe. Developments, challenges and opportunities*. Intersentia.
6. Boele-Woelki, K& Miles, J & Scherpe, J. (Eds). (2011). *The Future of Family Property in Europe (European Family Law)*. Publisher: Intersentia.
7. Brati, A. (2008). *Procedura Civile*. Tiranë: Botimet Dudaj.
8. Bartholomew & Wasznicky, “Prenuptial Agreements” November 30, 2015.
9. Brod F.G., “Premarital Agreements and Gender Justice”, Yale Journal of Law & Feminism, Volumi 6, 1993
10. Boiche A, (2007) “*Marriage Contract and prenuptial agreement in French Law*” Paris

11. Boele-Woelki K., dhe te tjerë. Principles of European Family Law Regarding Property Relations Between Spouses, by the Commission on European Family Law (CEFL), Kapitulli 3, seksioni A.
12. Butruille-Cardew Ch., (2017) “Përmbledhje”, Thomson Reuters, Francë.
13. Carrilo J., (2017), “*Liberty and Community in Marriage: Expanding on Massey ’s Proposal for a Community Property Option in New Hampshire*”, *Universiteti i Kalifornise*, faqe 299, SHBA.
14. Champenois G& Flour J.(2001). *Les Régimes matrimoniaux*, 2e édition, Publisher: Armand Colin.
15. Cochran, J.(1996). *Journey to Justice*. Publisher: Random House Audio.
16. Colomer, A. (2005). *Droit civil. Régimes Matrimoniaux*. (12^eed), Publisher: LexisNexis.
17. Cubeddu Maria, G.(2011). *Le convenzioni matrimoniali*, Torino.
18. Charlotte Butruille-Cardew, “Përmbledhje”, Nëntor 2017
19. Cooke, E& Miller, M. Law in Search of Discrimination (December 2, 2011). *Child and Family Law Quarterly*, Vol. 19, No. 1, pp. 98-111, 2007.
20. Commission Européenne, General Direction Justice And Home Affaires, (2001), Study on Matrimonial Property Regimes, and the Property of Unmarried Couples, in *Private International Law and Internal Law*, National Report, Sweden.
21. Dauti, N.(2001). *E drejta e detyrimeve*, Prishtinë.
22. De Rubertis, G. (1975). *Le convenzioni matrimoniali in generale*. Vita Notarile, Studi, Problemi e lettere del notariato, Palermo: Buttitta Edizioni Giuridice.

23. De Rubertis, G. (1976). *Il nuovo regime patrimoniale della famiglia e la trascrizione immobiliare*. Vita Notarile, I, Nr. 28, Palermo: Butitta Edizioni Giuridice,
24. Di Cecca D., Ferri G., Marcattili M., “Il pensiero giuridico italiano”, (1941),
25. Donatuti, G, (1936). “Separazione dei beni.” Enciclopedia Italiane
26. Downing A. “A thoughtful approach to prenuptial agreements”, 2018
27. Epstein L.M, (2012), “*Ketubah the Jewish marriage contract*”, The Jewish Theological Seminary, New York.
28. Fatri, I.(2005). “*Regjimi pasuror martesor*”, Tiranë.
29. Flour, J& Champenois G.(1995).“*Le régimes matrimoniaux*”. Editeur: Armand Colin
30. Francesca C, Gli accordi prematrimoniali, Giuffrè, Milano, 2011
31. Fairbairn C. “Pre-nuptial agreements”, Revista Numër 03752, 21 June 2017
32. Francis, N. (2003). “New Light on Prenuptial Agreements”. Family Law. Vol 33.
33. Galgano, F. (2006). *E drejta Private*. Botim i tretë. Tiranë: Luarasi University Press.
34. Galgano, F.(2011), *Il contratto* , Cedam, Padova,
35. Galletta, F. *La comunione convenzionale*, në *La comunione legale* a cura di C.M. Bianca, Milano (1989).
36. Garofalo, L.(1997). *I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*. Seconda Ed. Torino: Giappichelli Ed.
37. Grégoire, M., Rencho. (1995). *Les Contrats de mariage, Bilan, perspectives et formules pratiques*. Publisher: Bruylant Akademia s.a.
38. Gregoire M, “*Regimes Matrimoniaux. Formulaire Commente*”, 1977

39. Gregoire M, “Le regimes conventionnels: principes et limites de l’autonomie de la volonte et les communauts conventionnelles”, 1977
40. Gail F. Brod, “Premarital Agreements and Gender Justice”, (1993), Yale Journal of Law & Feminism, Volumi 6
41. Guchet L. “*Contrats de mariage regimes matrimoniaux*”, Botimi i II, Shtëpia Botuese Puits Fleuri (2010)
42. Haboubi C. (2016). “*Mon droit, mes libertes*”, Francë
43. Halley J., (2010), “*Behind the Law of Marriage*”, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
44. Hertz F., Doskow E., “Making It Legal”, prill 2018, Botimi V
45. Ieva M.(2012) “*Le convenzioni matrimoniali.*” Seconda edizione Milano: Giuffrè.
46. Islamaj, F.(2005). “Regjimi pasuror martesor”, Tiranë,.
47. Kadish J. “Pre- and postnuptial agreement tips and traps”, revista “In brief”, qeshor 2006
48. Kreitner R., (2007), “Calculating Promises; the emergence of modern American contract doctrine” Stanford University Press, Standford, California.
49. Lamçe J. dhe Aliu B.,“Përfshirja e kuotave/aksioneve të shoqërive tregtare në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve”.
50. Lamçe J. “Bashkëjetesa në çift në të drejtën familjare shqiptare:kuadri normativ aktual dhe debati për reformim”.
51. Lamçe J., “Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok në Shqipëri. Vështrim krahasimor me Parimet e CEFL”, Avokatia, 16 tetor 2015, faqe 71-86
52. Lo Sardo, G. (1991). “*La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia.*” në *Rivista del Notariato*, Milano: Giuffré Editore.

53. Mandro, A & Mecaj, V & Zaka, T & Fullani, A. (2006). *E drejta Familjare*. Shtëpia Botuese Kristalina, Tiranë.
54. Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*. Tiranë.
55. Mandro A, “*Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore*”, Tiranë 2014, Shkolla e Magjistraturës dhe UNDP
56. McLellan, D. (1996). *Contract Marriage-The Way Forward or Dead End?*” Journal of Law and Society. Vol 23, no. 2.
57. Merckoll E, “Family law in Norway”, (2017).
58. Mitchell S. Dylan, Revista “*New York Metro Super Lawyers*” 2011.
59. Morley Jeremy D. (2011), “*International Prenuptial Agreements Necessary but dangerous*”, Revista “*Family Law Review*”, New York
60. Mahar H., “Why are there so few prenuptial agreements”, studim nr.436, 09/2003
61. Mitchell S. Dylan, (2011). Revista “*New York Metro Super Lawyers*”.
62. McLellan, D. (1996). “Contract Marriage-The Way Forward or Dead End?” Journal of Law and Society. Vol 23, no. 2.
63. Morley D. J, (2011), International Prenuptial Agreements,. Law Shopping & Forum Shopping in International Prenuptial Agreements, Revista “*Family Law Review*”, New York.
64. Nielsen L., (2001), “*Study on matrimonial property regimes and the property of unmarried couples in private international law and internal law*” Juridiske Fakultete, Kobenhavens Universitet
65. Nuni, A & Haneziri, L. (2010). *Pronësia*, Tiranë.

66. Nicolas F, Marion L, “*Wealth, marriage and prenuptial agreements in France (1855 - 2010)*” 2018
67. Nuni, A & Haneziri, L. (2010). *Trashëgimia*, Tiranë.
68. Nuni, A “Parime të përgjithshme të së drejtës Civile”, (2012)
69. Omari, S. (2012). *E drejta familjare*, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë.
70. Planiol, M. (1959). *Traite ellmentaire de droit civil*, Botimi i 6. V.I/2, Louisiana State Law Institute.
71. Perillo J., “The origine of the objective theory of Contract formation and interpretation” *Revista Fordham law review*.
72. Pintens W, “National report Belgium”, Universiteti i Luven, 2008.
73. Radacic I. “Gender Equality Jurisprudence of the European Court of Human Rights”, *European Journal of International Law*, Volumi 19 shtator 2008
74. Raport mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri, Tiranë 2016
75. Roppo, V. (2011). *Il Contratto*. Publisher: Giuffrè.Torino.
76. Ruggiero Domenico G. (2005). *Gli Accordi Prematrimoniali*. Napoli: Edizioni Scientifiche Italiane.
77. Sanatoro – Passarelli, “L’autonomia privata nel diritto di famiglia”, volumi I, Napoli 1961.
78. Savvy, C. (2005). “*How to write a fair prenuptial agreement*”.
79. Silberberg, F.(2015). shkrimi shkencor “*Community property law governs the apportionment of a business interest*”.
80. Stoner, Katherine E & Irving, Sh., (2012). *Prenuptial Agreements: Hoë to ërite a Fair & Lasting Contract*, 4th Edition. NOLO.

81. Stoner, Katherine E. (2012). *“Prenuptial agreement”*, Botimi IV.
82. Studim Pilot “Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri”, Janar 2016 - Tiranë, Shqipëri.
83. Silberberg Fred, shkrimi shkencor (2015) “Community property law governs the apportionment of a business interest”.
84. Silberberg, F. (2015), “Community property law governs the apportionment of a business interest”.
85. Spaht K., dhe Karrol A., (2009), Louisiana Matrimonial Regimes, Vandeplass Publishing.
86. Stange C.K., (2014), *“Prenuptial agreement line by line”*, Thomson Reuters, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
87. Trinchillo C., “Partecipazioni sociali e comunione legale dei beni”, Revista del Notariato, 2002, fq. 851 e vijues
88. Viney, G. (2006). *Les conditions de la responsabilite*, Botimi III, LGDJ.
89. Xhafaj, P. (2010). *Evoluimi i regjimeve pasurore martesore në të drejtën Shqiptare. Rezultate dhe objektiva*. Tiranë.
90. Zaçe, V. (1996). *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*. Tiranë: Logoreci.
91. Zaka, T. (2004). *“Kodi i ri i Familjes - Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.”* në Jeta Juridike, Nr. 2, Tiranë: Botim i Shkollës së Magjistraturës.
92. Zaka, T.(1999). *Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krahasuese*, Disertacion. Tiranë.

93. Weissbrodt D., Wolfrum R., (1997) “The right for a fair trial” (Eds.).

94. Woods J., “*Money and Marketing*”, 19 shtator 2018, New York.

Praktikë Gjyqësore

1. Çështja *Marckx kundër Belgjikës*, aktgjykimi i 13 qershorit 1979, faqe 519, Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.
2. Çështja *Radmacher (formerly Granatino) kundër Granatino* [2010] UKSC 42.
3. Çështja *Gillow kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykimi i 24 nëntorit 1986, paragrafi 46.
4. Çështja *Hyman vs Hyman* ,1929 AC, 601.
5. Çështja “White v White”, vendimi I House of Lords 26 tetor viti 2000
6. Çështja “Dematteo v. Dematteo”, Supreme Judicial Court of Massachusetts, Plymouth, 08 shkurt 2002
7. Çështja “Macleod v Macleod” 2008 UKPC 64
8. Vendimi nr.9/05.01.1991.Indeksi i Gjykatës së Rrethit Tiranë, viti 1991.
9. Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.628 viti 2000.
10. Vendimi nr.1 datë 06.01.2009 i Gjykatës së Lartë.
11. Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara, nr. 5, datë 20.01.2009.
12. Vendimi Civil Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.5 viti 2009.
13. Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara Nr.5/2009 dhe Nr.1/2014
14. Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.5/2011.

Burime Dytesore nga Web-Site Zyrtare

1. Claire J. Vannette, (2016). *The purpose of a prenuptial agreement*, Ëhat is the purpose of a prenuptial agreement Shih në Quora.com: <https://www.quora.com>.
2. Commission Européenne, General Direction Justice And Home Affaires, (2001). *Study on Matrimonial Property Regimes, and the Property of Unmarried Couples, in Private International Law and Internal Law*, National Report, Sweden, 2001.
3. Commission Européenne. (2001). *Study On Matrimonial Property Regimes And The Property Of Unmarried Couples In Private International Laë And Internal Laë, Addendum, Portugal*, JAI/A3/2001/03, Marrë në: <https://www.mondroitmeslibertes.fr>
4. Kodi Civil Japonez (Pjesa IV dhe PjesaV) Shih në: Marrë nga: <http://www.international-divorce.com>.
5. Namarong, M. (2012). *The Story of Independence – Economic and Political Independence* (Pt 1). Marrë nga: <https://ourpacificways.wordpress.com/2012/07/19/the-story-of-independence-economic-and-political-independence-pt-1/>
6. OSBE. (2003). *Misioni në Kosovë, Raport mbi Qendrat për Punë Sociale*, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, Kosovë.
7. [http:// www.treccani.it](http://www.treccani.it).
8. <https:// www.iafl.com>
9. <http:// www.gjykataelartë.gov.al>.
10. <http:// www.hcch.net>.

11. [http:// www.international-divorce.com](http://www.international-divorce.com).
12. <http://www.qpz.gov.al>